ENVER HOXHA

Letra të zgjedhura

3

TIRANË, 1987

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

Me këtë vëllim mbyllet botimi i serisë së «Letrave të zgjedhura» të shokut Enver Hoxha.

Letërkëmbimi i shokut Enver Hoxha me kolektiva punonjës, institucione e organizata masash, me qytetarë e familje nga krahina të ndryshme të vendit, me shokë e bashkëpunëtorë të tij të afërt, me anëtarë të familjes së tij, si dhe me miq e simpatizues të vendit tonë, me organizata e parti revolucionare e demokratike në botë është, sigurisht, shumë më i gjerë nga fondi që ka përfshirë ky botim. Megjithatë, edhe këto tri vëllime të «Letrave të zgjedhura» japin një përfytyrim të qartë të lidhjeve të vazhdueshme, të ngushta e të ngrohta, që kishte ai me komunistë, me kuadro, me masat punonjëse në qytet e në fshat, me të gjitha shtresat e brezat e Shqipërisë socialiste. Korrespondenca e botuar është një dëshmi e gjallë e rëndësisë që i kushtonte ai këtij komunikimi të dyanshëm të pandërprerë.

Edhe vëllimi i tretë i «Letrave të zgjedhura», përfshin letra, telegrame, mesazhe e përshëndetje të viteve 1946-1985, të cilat janë zgjedhur duke pasur parasysh shtrirjen gjeografike të korres-

pondencës, shpërndarjen proporcionale në vite e problematikën e trajtuar në korrespondencë.

Sikurse në dy vëllimet e mëparshme të «Letrave të zgjedhura», edhe këtu mbizotëron ajo pjesë e korrespondencës me një karakter intim e shoqëror, në të cilën shfaqet kujdesi i udhëheqësit për t'u ndodhur pranë njerëzve në punën, në sukseset e në preokupacionet, në gëzimet e në hidhërimet e jetës personale e familjare. Këto letra e telegrame, me firmën aq të dashur, me ndjenjat e ngrohta e të sinqerta që i përshkojnë, kanë qenë inkurajim e frymëzim i madh për një numër të madh kolektiva punonjësish, organizata partie, për rininë e fëmijët e Shqipërisë, për të ecur përpara në rrugën e Partisë, ato kanë shtuar gëzimin e shtëpive shqiptare, u kanë dhënë zemër e guxim njerëzve për të kapërcyer çaste të vështira në jetën e në punën e tyre.

Edhe në atë pjesë të korrespondencës që botohet në këtë vëllim, ku trajtohen probleme të rëndësishme të Partisë, siç janë radiogramet dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia, si dhe letrat dërguar shoqes Nexhmije Hoxha nga Moska, kjo frymë komunikimi është kurdoherë e pranishme. Ajo është pasqyrim i dashurisë dhe i respektit reciprok të lindura në luftë e në punë, që i ka karakterizuar gjithmonë marrëdhëniet e shokut Enver Hoxha me shokët e bashkëluftëtarët e tij besnikë, shprehje e besimit të madh që kishte ai në vendosmërinë, në principialitetin e në saktësinë e gjykimit të tyre.

Letërkëmbimi i udhëheqësit të shtrenjtë me popullin është një pjesë e rëndësishme e veprës dhe e kontributit të tij të madh në krye të Partisë e të popullit për lulëzimin e forcimin e vazhdueshëm të atdheut. Këshillat e porositë e çmuara, idetë revolucionare që përçon në masat e popullit, ruajnë gjithnjë freskinë dhe forcën e tyre frymëzuese e transformuese. «Letrat e zgjedhura» të shokut Enver Hoxha janë një dëshmi e gjallë e atij uniteti të çeliktë që ai në krye të Partisë kaliti gjatë veprimtarisë së tij prej udhëheqësi të madh revolucionar. Ky unitet Parti-popull, që gjen pasqyrimin e vet edhe në fletët e këtyre tri vëllimeve, është një nga trashëgimitë e vyera që i la atdheut shoku Enver Hoxha, një realitet që gjen vazhdimin e vet në atë kohezion ideologjik, politik e shpirtëror të popullit shqiptar rreth Partisë, Komitetit të saj Qendror me shokun Ramiz Alia në krye.

LETËR DREJTUAR FAN S. NOLIT

[Prill] 1946

Zotit Fan Noli,

Hidhërohemi tepër kur shohim se shtypi amerikan dhe personalitete të larta amerikane mbajnë një qëndrim jo të drejtë dhe armiqësor ndaj Shqipërisë, e cila luftoi me trimëri të rrallë për kauzën e përbashkët. Çështja e të ashtuquajturit Vorio-Epir, e ngritur nga ana e monarko-fashistëve grekë, që mbrohet dhe përkrahet nga ana e këtyre personaliteteve, patjetër nuk e forcon miqësinë e popullit shqiptar me Shtetet e Bashkuara. Mbrojtja e një teze kaq të marrë nga ana e tyre sjell me vete edhe përgjegjësi ndërkombëtare, pse të mbrosh hajdutët fashistë, që kërkojnë të rrëmbejnë tokën e tjetrit, do të thotë të bëhesh pjesëtar në këtë kusëri. Të gjithë duhet të jenë të bindur se me të gërthitura dhe me «vendime» rreth tryezave të gjelbra, nuk copëtohet kollaj Shqipëria. Po të cenohen kufijtë e Shqipërisë, ju sigurojmë se ne do t'i mbrojmë deri në njeriun e fundit dhe agresorët fashistë nuk do t'ia arrijnë qëllimit. Kujt ia ka qejfi, mund ta diskutojë «çështjen e

Shqipërisë së Jugut», por duhet të mendojë se në mes të «vendimit» që mund të marrin monarko-fashistët grekë e miqtë e tyre dhe zbatimit të këtij «vendimi», ndodhet një kufi në Shqipërinë e Jugut, që do të jetë zor të kapërcehet. Ne nuk vëmë në diskutim atdheun tonë, por këtë e mbrojmë kundër çdo agresori. Për këtë, populli shqiptar është i gjithë në këmbë, ashtu siç jeni të gjithë ju, vëllezërit tanë të dashur në Amerikë. Populli ynë do të rrojë i lirë në vendin e tij dhe në marrëdhënie të mira me të gjithë. Ne mendojmë dhe jemi të sigurt se edhe ju mendoni si ne, se populli ynë luftoi jo për t'u futur në një robëri tjetër, por për të rrojtur i lirë, për të rrojtur i nderuar, ashtu sikundër ai nderon të tjerët. Ai kërkon t'i respektohen të drejtat e tij, ashtu sikundër respekton të drejtat e tjetrit. Ne jemi të bindur se për mëmëdheun dhe për mbrojtjen e të drejtave të tij do të ngrihen edhe vëllezërit tanë në Amerikë, ashtu si kanë bërë kurdoherë. Ne do të fitojmë mbi ata fashistë të rinj që do të kërkojnë të dëmtojnë vendin tonë, pse jemi në të drejtë. Në kohët më të errëta të luftës populli shqiptar nuk u tremb dhe ca më pak tani, pse ai ka besim në forcat e veta dhe në të gjithë demokratët e vërtetë të botës.

Gjeneralkolonel

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 3, f. 330

MESAZH PËRSHËNDETJEJE DREJTUAR SHQIPTARËVE QË JETOJNË NË SHBA

14 qershor 1946

Vëllezër shqiptarë të Amerikës,

Me rastin që po nisen për aty delegatët e Shqipërisë për në Konferencën Ndërkombëtare të Shëndetësisë, jam i lumtur t'ju dërgoj përshëndetjet e mia.

Këta shokë janë shqiptarët e parë që po vijnë nga Shqipëria e lirë e po takohen me ju. Ata do t'ju tregojnë për luftërat e mëdha plot sakrifica po dhe plot heroizma që bëri populli ynë për të luftuar zaptuesit e egër fashistë dhe nazistë, për të çliruar Shqipërinë e dashur nga thundra e huaj e fëlliqur dhe nga tradhtarët e pashpirt të vendit.

Populli ynë me Luftën Nacionalçlirimtare u radhit përkrah kombeve të bashkuara dhe tregoi faqe botës se sa e do lirinë, se si e derdh gjakun për të drejtat dhe pavarësinë e tij.

Populli ynë me Ushtrinë e tij Kombëtare të lavdishme, që lindi e u farkëtua në zjarrin e luftës më madhështore të historisë së tij, fitoi lirinë, ngriti pushtetin e tij të fortë demokratik dhe sot, po me atë entuziazëm që pati në luftë, i është përveshur punës së rindërtimit për të ndrequr gërmadhat e panumërta dhe për të shëruar plagët e rënda që na lanë armiqtë.

Përmes vuajtjesh të pashembullta, me dhëmbë e me thonj, ashtu si luftoi, populli ynë po punon për të ardhmen e tij, për një të ardhme të drejtë e të lumtur. Ai punon pse e do lirinë, do paqen e vëllazërimin, pse është i vendosur të ruajë e të forcojë të drejtat dhe pushtetin demokratik, që i fitoi me gjak, pavarësinë dhe integritetin tokësor të Shqipërisë si edhe të rrojë në harmoni dhe në bashkëpunim të plotë me të gjitha kombet paqedashëse.

Shokët që po vijnë do t'ju thonë se populli ynë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe unë personalisht i dimë dhe i kemi ndjekur me simpati të veçantë përpjekjet e vëllezërve shqiptarë të Amerikës për lirinë dhe të drejtat e atdheut të larget.

Ne që të gjithë shprehim besim të patundur se ju, ashtu si në të kaluarën, bij të denjë të popullit tonë, do të qëndroni bllok i pathyer, kurdoherë gati për të mbrojtur, kur ta lypë nevoja, lirinë dhe të drejtat e shenjta të atdheut tonë.

Unë ju uroj nga zemra gjithë të mirat dhe

jam i bindur se edhe larg atdheut, me punën, me sjelljen dhe me bashkimin tuaj, ju do ta nderoni emrin e Shqipërisë.

Kryeministri
Ministri i Mbrojtjes Kombëtare
dhe Ministri i Punëve të Jashtme
të Republikës Popullore të Shqipërisë

Gjeneralkolonel

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 3, f. 396

TELEGRAM DËRGUAR POPULLIT TË PESHKOPISË

31 gusht 1949

Me rastin e përvjetorit të pestë të çlirimit tuaj nga hordhitë fashiste dhe tradhtarët e vendit, ju dërgoj përshëndetjet më të përzemërta dhe urimet më të sinqerta. Populli i Peshkopisë, i shtypur dhe i shfrytëzuar për vite me radhë nga sundimi i klikave gjakpirëse të bajraktarëve, fitoi lirinë e tij dhe doli nga errësira në dritë, sikurse gjithë populli shqiptar, me Luftën heroike Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia jonë Komuniste. Me gjithë reaksionin e fortë të bajraktarëve të bashkuar me fashistët e nazistët, ju, nën udhëheqjen e shokëve komunistë, në çetat tuaja dhe në batalionin e Dibrës, të komanduar nga biri juaj i shquar e udhëheqësi trim, gjeneralmajor Haxhi Lleshi, luftuat dhe dhatë kontributin tuaj të vlefshëm në Luftën Nacionalçlirimtare. Qysh prej Çlirimit të Shqipërisë populli i

Peshkopisë ka korrur suksese të mëdha në luftën për ndërtimin e Shqipërisë së re, për zbatimin e politikës së drejtë të Partisë dhe të Qeverisë, duke u mobilizuar i tëri në luftën për ndërtimin e atdheut, për të goditur pa mëshirë mbeturinat e reaksionit të brendshëm e armiqtë e jashtëm dhe veçanërisht kundër armiqve të popullit tonë, grupit të Titos me shokë.

Gjeneralkolonel

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 6, f. 257

TELEGRAM DËRGUAR KOMITETIT TË PARTISË DHE KOMITETIT EKZEKUTIV TË DURRËSIT

4 shtator 1949

Realizimi i planit të grumbullimit të grurit dhe të thekrës në rrethin tuaj në afatin e caktuar, është nga njëra anë një fitore juaja dhe e gjithë njerëzve të Partisë dhe të pushtetit në betejën e madhe për realizimin e planit dyvjeçar, dhe nga ana tjetër është provë e patriotizmit të fshatarëve të rrethit të Durrësit, të cilët e kuptojnë mirë se sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit është në interesin e tyre dhe se është rruga që forcon aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, aleancë aq e nevojshme për ndërtimin e bazave të socializmit dhe për mbrojtjen e fitoreve të Luftës sonë Nacionalçlirimtare.

Le të bëhet fitorja juaj e parë nxitje për

fitore të tjera dhe një shembull për të gjitha rrethet që të plotësojnë planin e tyre të grumbullimit.

Kryetari i Këshillit të Ministrave

Gjeneralkolonel

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 214 (287), 6 shtator 1949

TELEGRAM DËRGUAR J. V. STALINIT

20 dhjetor 1949

Në emër të popullit shqiptar, të Qeverisë së RP të Shqipërisë dhe në emrin tim personal, me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes Suaj, ju urojmë nga zemra me plot dashuri, jetë të gjatë për të mirën dhe lumturinë e popujve sovjetikë, të gjithë popujve përparimtarë të botës dhe të popullit tonë.

Në ditën e 70-vjetorit Tuaj, ne kujtojmë me respektin më të madh luftën Tuaj të lavdishme përkrah gjenisë së madhe të Leninit për triumfin e Revolucionit Socialist të Tetorit dhe për ndërtimin e shtetit të parë socialist në botë, kujtojmë veprat Tuaja të pavdekshme si udhëheqës i shtetit sovjetik në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit, udhëheqjen Tuaj të shquar në luftën kundër hordhive nazifashiste për mbrojtjen e Bashkimit të lavdishëm Sovjetik dhe për shpëtimin e botës nga murtaja fashiste, udhëhe-

qësin e luftës të të gjithë popujve përparimtarë në luftën për paqe kundër nxitësve të një lufte të re, imperialistëve amerikano-anglezë etj.

Jeta dhe veprat Tuaja të lavdishme për ne kanë qenë, janë dhe do të jenë gjithnjë drita që ndriçon rrugën tonë për fitoret e deritanishme dhe për fitoret tona të ardhshme.

Populli shqiptar sheh te Ju, shoku Stalin, mikun dhe mbrojtësin e tij më të madh, që, në krye të Bashkimit të lavdishëm Sovjetik, e shpëtoi nga skllavëria, e ndihmon në ndërtimin e jetës së re dhe në mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut të tij.

Duke festuar 70-vjetorin Tuaj me punë ndërtimtare paqësore, populli ynë brohoret me entuziazëm: «Të rrosh sa malet, shoku Stalin!».

Kryetari i Këshillit të Ministrave
të RP të Shqipërisë
Gjeneral-Armate
Enver Hoxha

Vepra, vëll. 6, f. 415

PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPULLIT TË MOKRËS

Pogradec

10 tetor 1950

Komisionit iniciator për festën e Mokrës,

Ju lutemi t'i transmetoni popullit trim dhe patriot të Mokrës përshëndetjet dhe urimet e përzemërta të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Qeverisë dhe të miat, me rastin e përvjetorit të tetë të çlirimit të krahinës së Mokrës prej pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit.

Populli i Mokrës, si gjithë populli shqiptar, luftoi me heroizëm dhe fitoi lirinë në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë heroike dhe të luftës çlirimtare të Ushtrisë Sovjetike të komanduar nga i madhi Stalin.

Populli i Mokrës dhe i rrethit të Pogradecit,

nën drejtimin e Partisë dhe të Qeverisë, gjithmonë ka punuar dhe punon për të ruajtur dhe për të forcuar fitoret e Luftës Nacionalçlirimtare, për të ndërtuar një jetë më të mirë dhe më të lumtur.

Festa juaj le të vlejë për t'u mobilizuar akoma më shumë në luftën ndërtimtare që bën i gjithë populli shqiptar për mbrojtjen e paqes, të pavarësisë dhe për ndërtimin e themeleve të socializmit.

Në këtë ditë të shënuar që ju festoni plot hare, ju urojmë nga zemra suksese të reja në të ardhmen.

Sekretari i Përgjithshëm
i KQ të PPSH

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 7, f. 444

PËRSHËNDETJE DREJTUAR NDËRTUESVE TË KOMBINATIT TË TEKSTILEVE «STALIN»

1 nëntor 1951

Shokë të kolektivit punonjës,

Me gëzim të madh mora letrën ku më njoftoni për mbarimin dhe vënien në shfrytëzim të kombinatit. Ju falënderoj nxehtësisht të gjithë ju, shokë punëtorë, teknikë, inxhinierë për punën e shkëlqyer që keni bërë duke i dhënë popullit këtë vepër monumentale që mban emrin e të madhit Stalin.

Ky kombinat është një nga veprat më të mëdha të socializmit, që gëzon pa masë popullin tonë, pse ai do t'i sigurojë veshje në sasi të mjaftueshme. Kjo vepër, që Partia ia premtoi popullit dhe sot ia bëri realitet, u ngrit në sajë të ndihmës së Bashkimit Sovjetik dhe të interesimit personal të shokut Stalin.

Ju uroj suksese akoma më të mëdha në rea-

lizimin e veprave të tjera të planit pesëvjeçar, i cili do të bëhet realitet në sajë të zotësisë dhe të heroizmave tuaj.

Rroftë organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit tonë, Partia e Punës!

Të rrojë sa malet i madhi Stalin që na udhëheq në rrugën e lavdishme të socializmit e të paqes!

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 8, f. 370

PËRSHËNDETJE DREJTUAR NDËRTUESVE TË UJËSJELLËSIT LANABREGAS—TIRANË — KOMBINATI I TEKSTILEVE «STALIN»

2 nëntor 1951

Shokë të kolektivit punonjës të kantierit për ndërtimin e Ujësjellësit Lanabregas — Tiranë— kombinati i tekstileve «Stalin»,

Ju përgëzoj për mbarimin e punimeve të Ujësjellësit Lanabregas — Tiranë — kombinati i tekstileve «Stalin». Populli i kryeqytetit të atdheut tonë të lirë e të lumtur do t'ju jetë mirënjohës përjetë për ndërtimin e kësaj vepre të madhe të socializmit.

Rroftë Partia jonë e Punës!

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 8, f. 372

LETËR DREJTUAR NXËNËSVE DHE MËSUESVE TË SHKOLLËS SË MESME «ASIM ZENELI»

Gjirokastër

3 prill 1954

Ju përshëndes dhe ju uroj nxehtësisht festën e shkollës suaj!

Me keqardhje ju them se punët e Partisë dhe ato shtetërore më penguan të vija, por ju siguroj se sot zemra ime është atje, te ju, ajo është e gëzuar, pse ju jeni të gëzuar dhe të lumtur.

Shkolla juaj më është shumë e dashur, pse tridhjetë e një vjet më parë atje kam mësuar edhe unë dhe ruaj shtrenjtë në kujtesë momentet e gëzuara dhe të hidhura të vegjëlisë sime.

Me respekt kujtoj sot mësuesit e mi të vjetër patriotë, të cilët afro 40 vjet më parë, kur atdheu dhe populli lëngonin nën zgjedhën e imperialistëve barbarë, na mësonin me guxim të shkruanim

dhe të këndonim gjuhën tonë të ëmbël amtare, na mësonin historinë e lashtë heroike të popullit, na mësonin të urrenim dhe të luftonim okupatorët dhe tradhtarët e vendit tonë.

Sot ju, shoqe dhe shokë të mi të dashur të rinisë, jetoni të gëzuar në atdheun tonë të lirë, kur populli, pas Luftës legjendare Nacionalçlirimtare që bëri kundër okupatorëve dhe tradhtarëve, ndërton me sukses bazat e socializmit. Partia jonë heroike e Punës, që e udhëhoqi popullin në fitoren më të shkëlqyer të historisë së tij, drejton me guxim dhe urtësi të madhe fatet e vendit. Jeta e popullit tonë çdo vit po bëhet më e bukur. Ditë akoma më të lumtura do të shohin populli dhe rinia heroike e vendit tonë, pse e gjithë puna dhe preokupacioni i Partisë dhe i Qeverisë sonë kanë këtë qëllim.

Mësoni me të gjitha forcat tuaja, pse atdheu ka nevojë shumë për njerëz të mësuar. Me mijëra shkolla të kategorive të ndryshme dhe institute të larta ka hapur për ju pushteti i popullit.

Shokë arsimtarë dhe të rinj! Populli i ka sytë te ju, kujdesi i veçantë i Partisë është për ju dhe e meritoni plotësisht këtë dashuri dhe besim të madh që ushqejnë populli dhe Partia, pse keni qenë heronjtë e çlirimit të atdheut dhe do të jeni heronjtë e ndërtimit të bazave të socializmit.

Në çdo moment dhe në çdo punë tuajën të mendoni dhe të punoni për të mirën e popullit. Çdo gjë tuajën e lidhni me interesin e përgjithshëm. Shtoni dhe çelikosni në zemrat tuaja da-

shurinë dhe besnikërinë ndaj atdheut, ndaj popullit, ndaj Partisë.

Të doni shkollën dhe mësuesit tuaj. Mësoni në mënyrë të tillë që jo vetëm të mos ngelet asnjë në klasë, por nota 5 të jetë e vetmja notë për ju!

Ju uroj nxehtësisht shëndet dhe sukses në mësime dhe në provime, detyrë e madhe patriotike për nxënësit dhe mësuesit!

Rroftë rinia heroike dhe studiuese e vendit tonë!

Rrofshin mësuesit dhe profesorët patriotë!

Juaji

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 11, f. 286

LETËR DREJTUAR PIONIERËVE TË SHKOLLËS SË FERMËS «ÇLIRIMI»

Fier

Tetor 1954

Mora letrën që më dërguat me rastin e 46-vjetorit të ditëlindjes sime dhe ju falënderoj nga zemra. Me këtë rast edhe unë ju uroj të gëzoni shëndet dhe të keni kurdoherë suksese në mësime.

Ashtu si gjithë populli shqiptar që është mobilizuar për ndërtimin e një jete më të mirë, edhe ju, të dashur pionierë, të bëni përpjekje të vazhdueshme për të mësuar. Ata që do të mësojnë më mirë nga ju, kur të rriten do të dërgohen në shkollat e mesme dhe në institutet e larta që janë hapur për të mësuar brezi i ri i vendit tonë. Tani ju i keni të gjitha mundësitë që në të ardhmen të bëheni agronomë, inxhinierë, teknikë, doktorë, profesorë e të tjerë, për të cilët vendi ynë ka shumë nevojë. Bazat e shkencës ju do t'i fitoni në shkollë, ato do t'jua mësojnë mësuesit tuaj. Pran-

daj t'i doni e t'i nderoni mësuesit, Partinë heroike të Punës, që kujdeset aq shumë për edukimin e rinisë sonë heroike. Të doni me gjithë shpirt Republikën Popullore të Shqipërisë dhe atdheun, ku ju mësoni të lirë e të lumtur.

E ardhmja ju takon juve, prandaj duhet që përpjekjet tuaja të jenë të shumta për të mirën e popullit tonë.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR KONVIKTORËVE TË BALLSHIT

Tetor 1954

Ju falënderoj për urimet që më bëtë me rastin e 46-vjetorit të lindjes sime. Me këtë rast ju uroj shëndet dhe suksese të shkëlqyera në mësime. Partia dhe pushteti kanë besim se detyrën që ju ka ngarkuar për të mësuar, që në të ardhmen t'i shërbeni sa më mirë atdheut e popullit, do ta kryeni me nder.

Mendoni ju, shokë të rinj, vuajtjet e prindërve tuaj në të kaluarën. Ata jo vetëm nuk kishin mundësi të ndiqnin shkollat, por shumë herë u mungonte edhe buka e fëmijëve. Arsimi në regjimet antipopullore ishte vetëm për njerëzit e privilegjuar, për bijtë e bejlerëve, të agallarëve, të tregtarëve dhe të nëpunësve të lartë.

Përmbysja e pushtetit të vjetër të feudoborgjezisë i dha mundësinë popullit tonë jo vetëm të përmirësojë jetën e tij çdo ditë e më shumë, por

edhe të fitojë dritë dhe arsim. Kudo janë hapur shkolla, teknikume dhe institute të larta, ku mësojnë bijtë e punëtorëve dhe të fshatarëve. Këto janë fitore që populli ynë i realizoi në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë së tij të Punës.

Juve, bijve dhe bijave të popullit tonë, Partia ju ka ngarkuar detyrën fisnike të mësoni sa më mirë, të fitoni dituri dhe shkencë, që kur të rriteni dhe të mbaroni shkollat t'i shfrytëzoni aftësitë tuaja për të mirën e familjeve, të popullit tonë heroik dhe të atdheut tonë të bukur.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR KURSANTËVE TË RAFINERISË SË NAFTËS TË CËRRIKUT NË MOSKË

Tetor 1954

Ju falënderoj për urimet që më bëtë me rastin e 46-vjetorit të ditëlindjes sime dhe me këtë rast edhe unë ju uroj të korrni suksese të shkëlqyera në mësime dhe të kryeni kështu me nder detyrën që ju ka ngarkuar Partia.

Porosia e Partisë është të mësoni sa më shumë, të përvetësoni teknikën dhe metodat e përparuara që përdoren në industrinë e naftës, në mënyrë që të bëheni të aftë për t'i sjellë shërbime të çmuara atdheut dhe popullit tonë kur të mbaroni studimet.

Mos harroni për asnjë çast vuajtjet dhe shtypjen e klasës sonë punëtore, e cila në të kaluarën shfrytëzohej pa mëshirë nga kapitalistët e huaj dhe borgjezia e vendit. Por sot me kujdesin e Partisë klasa jonë punëtore që është bërë zot në

atdheun e vet, po punon pa u lodhur për të ngritur ekonominë popullore për të mirën e gjithë popullit. Ju jeni dërguar në Bashkimin Sovjetik për të studiuar, që të bëheni kuadro me eksperiencë dhe specialistë të zotë, për të nxjerrë sa më shumë naftë për popullin, për të ndihmuar pasurimin dhe begatinë e popullit tonë.

Partia jonë e Punës ka besim se ju do ta kryeni me nder këtë detyrë që ju ka ngarkuar dhe do të vini të gjitha forcat për të mësuar shkencën dhe eksperiencën e përparuar sovjetike.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR DY MIQVE TË SHQIPËRISË, ZHYSTEN GODARIT DHE ADMIRAL MULEKUT

Paris

2 dhjetor 1955

Zotërinjve Zhysten Godar dhe Admiral Mulek,

Falënderojmë nga zemra Ju dhe nëpërmjet Jush miqtë e Shqipërisë në Francë për urimet e bëra me rastin e 11-vjetorit të Çlirimit të Atdheut tonë.

Populli shqiptar ndjek me simpati të madhe përpjekjet heroike të popullit francez në luftën e tij fisnike për forcimin e paqes dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë luftë populli i Francës ka miq të shumtë kudo në botë, prandaj ajo do të kurorëzohet me sukses në favor të bashkëjetesës paqësore midis popujve.

Pranoni me këtë rast, të dashur miq, urimet

tona më të nxehta për suksese të mëtejshme në punën tuaj fisnike, për forcimin e miqësisë në mes popullit shqiptar dhe popullit vëlla francez.

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 13, f. 95

LETËR DREJTUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË TË STUDENTËVE E TË KURSANTËVE QË STUDIOJNË JASHTË SHTETIT

13 mars 1956

Partia jonë, qysh gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, i kushtoi një vëmendje të posaçme ngritjes kulturore e arsimore të masave të gjera të popullit tonë, si në radhët e forcave partizane, ashtu dhe në zonat e çliruara. Në këtë drejtim ajo aktivizoi inteligjencien progresive dhe gjithë shokët që kishin njohuritë minimale në këtë sektor dhe hodhi bazat e para të luftës kundër prapambetjes, që armiqtë e vendit tonë qëllimisht ia kishin imponuar popullit.

Pas Çlirimit, në bazë të programit të Partisë për ndërtimin e socializmit, çështja e kulturës dhe e arsimit u bë një nga problemet shumë të rëndësishme dhe imediate. Për këtë qëllim Partia e Qeveria jonë morën të gjitha masat për krijimin

e inteligjencies së re nga radhët e klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse. Filloi dhe përfundoi me sukses lufta e madhe kundër analfabetizmit. U ngritën kurse, shkolla fillore e 7-vjeçare në të katër anët e atdheut. U shtuan në mënyrë të pakrahasueshme me të kaluarën shkollat e mesme e teknikumet dhe për herë të parë u ngritën institutet e larta.

I gjithë ky zhvillim që është arritur në këta vjet të Çlirimit, tregon se masat tona punonjëse kanë bërë një revolucion të vërtetë në përgatitjen e tyre kulturoro-arsimore e tekniko-profesionale. Kjo tregon patriotizmin e lartë të popullit tonë dhe është një garanci për ndërtimin e socializmit në Shqipëri.

Ju, ashtu si dhe qindra studentë e kursantë që kanë mbaruar fakultetet, shkollat e kurset, si brenda dhe jashtë atdheut, po përgatiteni që në të ardhmen të bëheni kuadro të vlefshëm, që kulturën dhe eksperiencën tuaj që keni fituar e do të fitoni nga kurset, shkollat, institutet dhe nga jeta shoqërore e vendit ku studioni, t'i vini në dispozicion të interesave të popullit e të atdheut tonë.

Partia, populli e vendi ynë presin nga të gjithë kuadrot, që janë në punë ose që përgatiten për punë, që të realizojnë me sukses detyrat që u janë ngarkuar dhe, konkretisht nga ju, presin që të mësoni sa më tepër për t'u bërë të aftë në profilin që vazhdoni të ndiqni dhe pjesëtarë të

inteligjencies së re, që rritet e zhvillohet në shoqërinë tonë socialiste.

Komiteti Qendror i PPSH ka ndjekur me kujdes të veçantë jetën, përparimin dhe aktivitetin tuaj shkollor e jashtëshkollor dhe vëren me kënaqësi se ju i keni kuptuar mjaft mirë detyrat që ju janë ngarkuar, si për sa u përket rezultateve në mësime, duke ngritur mesataren e notës dhe duke dhënë mjaft provime të prapambetura dhe të përsëritura, ashtu edhe në jetën shoqërore, duke shtuar në mënyrë të kënaqshme aktivitetin kulturor-shoqëror.

Të gjitha këto suksese që janë arritur, në radhë të parë, janë rezultat i punës së mirë që kanë bërë organizatat-bazë të Partisë, të cilat kanë forcuar jetën e brendshme të tyre, duke u njohur më mirë me problemet që u dalin, kanë zhvilluar më mirë kritikën e autokritikën konstruktive, duke goditur më me objektivitet të metat e gabimet dhe kanë organizuar më me sistem aktivitetin shoqëror, si në popullarizimin e vendit tonë, ashtu dhe në punën për forcimin e miqësisë së popullit tonë me popujt e tjerë.

Edhe ambasadat që përfaqësojnë Partinë e shtetin tonë në shtetin ku ju studioni, kohët e fundit kanë qëndruar më afër jush dhe ju kanë ndihmuar më tepër në çështjet që ju janë paraqitur.

Por, me gjithë sukseset që keni arritur, është e nevojshme që ju t'i shtoni akoma më shumë përpjekjet, sepse vërtetohen akoma mjaft dobësi e të

meta, si për sa i përket përparimit në mësime, ashtu edhe për sa i përket disiplinës shkollore e jashtëshkollore.

Në radhë të parë, duhet të keni parasysh se burimi i të metave dhe i dobësive tuaja qëndron në një numër shfaqjesh të huaja, që janë dukur te disa studentë e kursantë, siç janë, për shembull, nënvleftësimi i mësimeve, mendjemadhësia e shfaqje të tjera në kundërshtim me moralin tonë komunist.

Vetëm fakti se gjatë vitit 1955 u është prerë bursa 12 studentëve e kursantëve për shfaqje të tilla, bën të qartë edhe pasojat që kanë sjellë me vete këto[1].

Gjithashtu vihet re se mjaft studentë e kursantë, duke u tërhequr nga interesat e tyre personalë, gabojnë në dëm të shëndetit të tyre, të rezultateve në mësime dhe të detyrave të tjera që kanë ndaj shoqërisë. Këto gabime konsistojnë përgjithësisht në blerjen e plaçkave e të sendeve të tepërta nga bursa e tyre shkollore, në martesat që bëjnë me shtetaset e huaja, pa u thelluar e pa e studiuar në mënyrë të gjithanshme këtë veprim, dhe në indiferentizmin që tregojnë për jetën kolektive.

---

1. Më poshtë bëhet fjalë për këta studentë që u është prerë bursa, sepse kanë qenë të padisiplinuar, mendjemëdhenj dhe të prapambetur në mësime, si dhe për studentë e kursantë të tjerë, të cilët, me sjelljet e tyre jokorrekte në jetën shkollore e jashtëshkollore, kundrejt ambasadave tona, qytetarëve e ligjeve të shtetit ku studionin, i kanë detyruar organizatat-bazë të Partisë të merrnin masa ndëshkimore ndaj tyre.

Nga këta shembuj e konstatime organizatat-bazë, të gjithë komunistët, duhet të nxjerrin konkluzione dhe detyra për forcimin në shkallën e duhur të luftës kundër mbeturinave mikroborgjeze, duke i mbështetur këto detyra në luftën e sakrificat e mëdha që bën populli ynë në të gjitha fushat.

Partia e di se për pajisjen e intelektualëve të rinj me virtyte të larta, siç e kërkon shoqëria jonë e re, duhet të bëhet një punë e madhe, këmbëngulëse dhe e vazhdueshme; këtë detyrë Partia ua ka ngarkuar organizatave-bazë të Partisë e përfaqësive tona jashtë shtetit. Prandaj është e domosdoshme që ato të shtojnë ndihmën e kontrollit në punën e komunistëve dhe të gjithë studentëve e kursantëve, duke shfrytëzuar në të njëjtën kohë të gjitha format e edukimit marksist-leninist, sidomos vendimin e Plenumit të Komitetit Qendror të muajit prill 1955 «Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj».

Kongresi i 3-të i Partisë, që do të mbahet në muajin maj të vitit në vazhdim, ku do të paraqitet bilanci i rezultateve të punës plot sukses të kryer gjatë planit të parë pesëvjeçar, si dhe perspektivat e detyrat lidhur me planin e dytë pesëvjeçar, duhet t'ju mobilizojnë dhe t'ju vënë në garë me njëri-tjetrin, si individë dhe si organizata, që të merrni angazhime për të mësuar sa më shumë e për t'u dhënë fund dobësive e të metave që ekzistojnë, ashtu si po angazhohen të gjitha masat tona puno-

njëse përpara kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme për Partinë, popullin e atdheun tonë.

Komiteti Qendror i PPSH, i mbështetur në forcat e organizatave-bazë të Partisë aty, që janë të gjalla e të shëndosha, ashtu si edhe në tërë Partinë tonë e në ndihmën që do t'ju japin ambasadat dhe trupi mësimor i shkollave dhe i instituteve, shpreh bindjen e plotë se do të mund t'i zhdukni edhe ato të meta e gabime që keni.

Komiteti Qendror i PPSH nga ana e tij do t'ju japë të gjithë ndihmën e nevojshme që ju të siguroni rezultatet e dëshiruara dhe është i sigurt se këtë ndihmë do ta vlerësoni e do ta përdorni në dobi të luftës sonë të madhe për ndërtimin e socializmit në Shqipëri.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

«Për arsimin dhe edukatën»
(Përmbledhje veprash), botim
i dytë, f. 70

TELEGRAM DËRGUAR KOLEKTIVIT PUNONJËS TË UZINËS «ENVER»

Tiranë

20 tetor 1956

Ju falënderoj përzemërsisht për urimet që më dërguat me rastin e ditëlindjes sime dhe ju uroj suksese të mëtejshme në realizimin dhe në tejkalimin e detyrave të ndërmarrjes suaj të përparuar.

Uzina juaj i ka kryer gjithmonë mirë detyrat që i ka ngarkuar plani i shtetit. Kjo është siguruar në sajë të udhëheqjes së organizatës suaj të Partisë dhe të entuziazmit luftarak të të gjithë punonjësve.

Uroj edhe një herë që edhe në të ardhmen kolektivi juaj të plotësojë e të tejkalojë detyrat e planit dhe të japë kontributin e vet në ndërtimin socialist të atdheut tonë të dashur.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR PIONIERËVE TË SHKOLLËS 11-VJEÇARE «SKËNDERBEU»

Krujë

21 tetor 1957

Të dashur shokë të vegjël,

Ju falënderoj nxehtësisht për urimet që më dërguat me rastin e 49-vjetorit të ditëlindjes sime.

Jam shumë i gëzuar që me këtë rast t'ju uroj edhe unë suksese në punët tuaja shkollore për t'u bërë të vlefshëm për veten dhe familjet tuaja, për popullin tonë heroik, punëtor e paqedashës dhe për Partinë tonë të lavdishme.

Shkolla juaj mban emrin e heroit të madh të popullit tonë, Gjergj Kastriotit, Skënderbeut, i cili gjatë jetës së tij punoi dhe luftoi pa u lodhur kundër pushtuesve otomanë për lirinë dhe lumturinë e popullit. Mbajeni lart emrin e stërgjyshit tonë legjendar, bëjeni shkollën tuaj shembull në çdo drejtim, punoni pa u lodhur që nga gjiri i

shkollës suaj të dalin çdo vit djem dhe vajza të pajisura me dije e kulturë të shëndoshë, për t'i vënë këto në shërbim të popullit dhe të Partisë.

Në punët tuaja shkollore dhe në kohën e lirë dëgjoni me kujdes këshillat e prindërve, të mësuesve dhe të edukatorëve tuaj, që duan të mirën tuaj; t'i nderoni, t'i respektoni dhe t'i doni ata ashtu sikurse u ka hije pionierëve.

Edhe një herë ju uroj me gjithë zemër shëndet, lumturi dhe kurdoherë suksese në punët shkollore, për t'u bërë bij të denjë të atdheut tonë të bukur socialist dhe të Partisë sonë të dashur.

Juaji

Enver Hoxha

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO

Moskë, 16 nëntor 1957

Konsulta e caktuar në mes partive të vendeve socialiste filloi punimet e saj në datën 14 dhe mbaroi më 16. Në këtë mbledhje delegacioni i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë nuk mori pjesë. Gjatë diskutimit të deklaratës së përbashkët të gjithë përfaqësuesit e partive u shfaqën plotësisht dakord mbi të gjitha çështjet, me përjashtim të shokëve polakë, nga ana e të cilëve pati rezistencë mbi çështjet më themelore të deklaratës.

Pas diskutimesh të gjata në komisionin e redaktimit, ata u tërhoqën dhe në mbledhjen plenare deklarata u pranua me unanimitet edhe nga ata. Konsulta me partitë komuniste e punëtore të vendeve të demokracisë popullore dhe të vendeve kapitaliste filloi në datën 16 në orën 17^{00}. Punimet vazhdojnë të hënën.

Hollësira mbi punimet do t'ju jap kur të vij-

më atje. **Me avionin e të hënës po ju dërgojmë deklaratën,** e cila dy ditë pas firmimit të saj do të botohet në të gjitha organet qendrore të partive komuniste dhe punëtore. Datën e botimit do t'jua njoftojmë ne me telefon. Merrni masa të menjëhershme për përkthimin e saj. Në qoftë se do të ketë ndonjë korrigjim, do t'ju njoftojmë.

Të fala gjithë shokëve.

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR ANËTARËVE TË KOOPERATIVËS BUJQËSORE «UDHA E LENINIT»

Ajazmë—Shkodër

16 dhjetor 1957

Me gëzim të madh morëm njoftimin tuaj për realizimin me sukses të zotimeve të marra për nder të 40-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, lidhur me zhvillimin më të shpejtë të blegtorisë.

Marrja e 490 kuintalë qumësht për çdo 100 hektarë tokë bujqësore, shtimi i prodhimit të qumështit në lopë, nga 921 kilogramë që ishte vitin e kaluar, në 1 300 kilogramë, domethënë me një shtesë vjetore prej 379 kilogramësh, si dhe sukseset e tjera, tregojnë se sa rezerva të mëdha fshihen në bujqësi dhe që, me një punë të përbashkët të organizuar, mund të shfrytëzohen fare mirë në dobinë e kooperativistëve në veçanti dhe të ekonomisë popullore në përgjithësi. Është shumë kup-

timplotë fakti që rritja e shpejtë e produktivitetit të qumështit në kooperativën tuaj u arrit si rezultat i ushqyerjes së lopëve me jonxhë dhe me sasi të mëdha silazhi.

Ekipet e përbashkëta të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë që pak muaj më parë studiuan rezervat e brendshme në të tëra rrethet dhe qarqet, treguan në mënyrën më bindëse se sa shpejt mund të shtohen prodhimet bujqësore e blegtorale në kooperativa, duke plotësuar numrin e kafshëve dhe të shpendëve, si dhe duke forcuar bazën ushqimore, për të cilat në kooperativat tona ka mundësi të pakufizuara.

Duke përshëndetur për sukseset e arritura, ju uroj suksese edhe më të mëdha, për të mirën e kooperativistëve tuaj dhe të mbarë popullit tonë.

Enver Hoxha

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 303 (2890), 18 dhjetor 1957

TELEGRAM DËRGUAR KRYESISË SË KOOPERATIVËS BUJQËSORE TË LESKOVIKUT

19 dhjetor 1957

Në pamundësi për të marrë pjesë personalisht në festën tuaj, ju falënderoj për ftesën që më bëtë dhe përshëndes gjithë kooperativistët me rastin e 2-vjetorit të jetës kolektive.

Ju uroj suksese në forcimin ekonomik dhe organizativ të kooperativës, në shtimin e rendimenteve të kulturave bujqësore e produktivitetit të blegtorisë, në përmirësimin gjithnjë e më shumë të jetës materiale e kulturore të kooperativistëve.

Me rastin më të parë, kur të vij në Korçë, do të vizitoj edhe kooperativën tuaj.

Enver Hoxha

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR PUNONJËSVE TË SHTYPSHKRONJAVE «K. MARKS» TË POSNEKUT DHE «A. NEKSE» TË LAJPCIGUT

17 qershor 1958

Të dashur shokë e vëllezër,

Kemi mbetur jashtëzakonisht të kënaqur nga puna e pastër dhe me cilësi shumë të lartë që keni bërë ju në shtypjen e «Veprave të zgjedhura» të K. Marksit dhe F. Engelsit dhe të «Veprave të zgjedhura» të V. I. Leninit në gjuhën shqipe. Në emër të komunistëve shqiptarë, të punonjësve të vendit tonë dhe timin personal ju falënderoj nga zemra dhe ju shpreh përgëzimet e mirënjohjen më të thellë për punën tuaj fisnike.

Kjo është një dëshmi tjetër e gjallë e miqësisë dhe e lidhjeve vëllazërore midis punonjësve të Republikës Demokratike Gjermane dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë, të cilët i bashkojnë

qëllimi dhe lufta e përbashkët për socializmin dhe paqen.

Ndihma shumë e çmueshme që u dhatë ju punonjësve të vendit tonë duke shtypur në gjuhën shqipe veprat e mësuesve të mëdhenj të proletariatit, Marksit, Engelsit dhe Leninit, do të shërbejë si një mjet për forcimin akoma më shumë të miqësisë dhe të lidhjeve tona vëllazërore. Këta libra do të shërbejnë, gjithashtu, si shembull i punës suaj të shkëlqyer për punonjësit tipografë të Republikës Popullore të Shqipërisë, të cilët duhet të përfitojnë nga eksperienca juaj e madhe.

Ju uroj me gjithë zemër suksese gjithnjë më të mëdha për lulëzimin e atdheut tuaj në rrugën e socializmit!

Rroftë dhe u forcoftë miqësia midis punonjësve të Republikës Demokratike Gjermane dhe Republikës Popullore të Shqipërisë!

Përshëndetje revolucionare

Enver Hoxha

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Vepra, vëll. 15, f. 482

TELEGRAM DËRGUAR KOMISIONIT PËR ORGANIZIMIN E FESTËS SË BATALIONIT TË DUMRESË

Elbasan

21 qershor 1958

Të dashur shokë,

Mora me gëzim ftesën tuaj për të marrë pjesë në festimin e 15-vjetorit të Batalionit të Dumresë, dhe ju falënderoj me gjithë zemër për këtë ftesë. Më vjen keq që nuk do të mund ta plotësoj dëshirën tuaj për shkak se jam i zënë me punë, veçanërisht në mbledhjen e Kuvendit Popullor.

Me këtë rast i dërgoj popullit trim e liridashës të krahinës së Dumresë përshëndetje të përzemërta për këtë përvjetor dhe urimet më të mira për suksese sa më të mëdha në punë, për lumturinë dhe begatinë e krahinës suaj dhe të të gjithë popullit tonë.

Unë jam plotësisht i bindur se populli i kra-

hinës së Dumresë, që iu përgjigj me aq gatishmëri thirrjes së Partisë gjatë luftës për çlirimin e vendit, do të punojë edhe në të ardhmen me të gjitha forcat për zbatimin e detyrave që shtron Partia për ndërtimin socialist të atdheut tonë.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO

Karlovi-Vari, 11 gusht 1958

Vetëm shokut Hysni...

Diskutoni në Byro sa më poshtë dhe vendosni:

1) Mendoj se duhet t'i përsëritet edhe një herë me një notë më të rreptë qeverisë jugosllave për krimin[1] e kryer nga banditët e Tito-Rankoviçit. Të bëhet qeveria jugosllave përgjegjëse, të përsëriten kërkesat tona të notës së parë, dhe si konkluzion t'u thuhet se në rast se nuk merren këto masa që propozojmë, atëherë Qeveria Shqiptare do të arrijë në konkluzionin logjik se jo vetëm

1. Më 5 janar 1958 Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH, me propozimin e Qeverisë, aprovoi dekretin «Mbi amnistinë e shtetasve shqiptarë të arratisur jashtë shtetit». Qytetari shqiptar Hasan Spata, gjatë rrugës për t'u riatdhesuar u vra barbarisht në Jugosllavi nga organet jugosllave me dijeninë e plotë të qeverisë jugosllave.

jeta e nënshtetasve shqiptarë që jetojnë ose kalojnë nëpërmjet Jugosllavisë nuk është e sigurt në bazë të ligjeve ndërkombëtare, por është në rrezik edhe jeta e personelit diplomatik të Shqipërisë në Beograd. Prandaj Qeveria Shqiptare pret përgjigjen dhe bën përgjegjëse qeverinë jugosllave për krimin e kryer dhe për konsekuencat që mund të rrjedhin prej tij.

2) Ky të jetë një paralajmërim i parë, prandaj unë mendoj që po nuk na dhanë satisfaksion dhe pa prerë marrëdhëniet diplomatike, duhet të tërheqim ministrin tonë nga Beogradi, mundet dhe një pjesë të personelit, duke lënë një ose dy nëpunës të rangut të ulët.

3) Në lidhje me krimin Ministria jonë e Jashtme duhet të organizojë një informacion për trupin diplomatik, ku të demaskojë këtë krim të kurdisur në Beograd. Kjo të vihet në shtyp. Gjithashtu, Ministria e Jashtme të bëjë dhe një informacion shtypi me gazetarët tanë dhe të akreditуar në Tiranë e të bëhen leckë titistët.

4) Mendoj se legata jugosllave dhe personeli i saj në Tiranë duhet të vihen në vëzhgim të rreptë. Milatoviçi të bojkotohet dhe të përbuzet, e kam fjalën të mos thirret në asnjë manifestim.

Sidomos duhet të ruhemi nga ndonjë provokacion i jugosllavëve ose nga agjentura e tyre, pse mund të organizojnë ndonjë atentat kundër ndonjë nënshtetasi jugosllav në Shqipëri, për të neutralizuar krimin e tyre. Tani për tani, duhet të ndalohet hyrja-dalja në Jugosllavi dhe të ndalohet

qarkullimi për në Shqipëri i nënshtetasve jugosllavë për arsyet që thashë më lart.

5) Në rast se e dorëzojnë kufomën, atëherë kudo që të kalojë kufoma, duhet të bëhen demonstrata antititiste.

6) Përveç këtyre, shtypi dhe radioja jonë duhet me këtë rast kaq flagrant të demaskojnë kriminelët, banditët, vrasësit etj., etj. të Beogradit, me një fjalë, pa druajtje aspak, duke hequr gurin e fundit, duke cituar edhe ligjet ndërkombëtare. Domethënë jo vetëm sharje. Por mendoj se është rasti që propaganda jonë duhet të kalojë njëkohësisht në demaskimin e krimeve të titistëve karshi shqiptarëve të Kosovës. Pa ngritur çështjen territoriale, duhet të mbrojmë shqiptarët e Kosovës, duke demaskuar vrasjet, internimet, rrahjet, zhdukjen e gjuhës, të zakoneve, rrëmbimin e tokave etj. Krali Tito ndjek rrugën e kralëve të mëparshëm të Serbisë.

Unë jam mirë, ashtu dëshiroj dhe për ju. Si do të vendosni më lajmëroni dhe mua. Unë më 12 gjendem në Pragë. Shumë të fala.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT TË SHKODRËS PËR KOOPERATIVISTËT E LOKALITETIT TË DAJÇIT

29 shtator 1958

Me kënaqësi të madhe mësuam se fshatarësia patriote dhe besnike e lokalitetit të Dajçit, duke bashkuar vullnetarisht në kooperativa 97,3 për qind të tokës, e para në rrethin e Shkodrës, e përfundoi kolektivizimin e bujqësisë. U transmetoni përgëzimet tona më të nxehta gjithë kooperativistëve të Dajçit për këtë fitore të madhe që kanë arritur duke ndjekur vijën e drejtë të Partisë sonë marksiste-leniniste.

Kolektivizimi i bujqësisë është e vetmja rrugë e drejtë për ngritjen dhe përparimin e shpejtë të bujqësisë. Duke ndjekur këtë rrugë të sprovuar, më se 2/3 e fshatarësisë sonë ka bashkuar tokat e saj në kooperativat bujqësore dhe po ndërton e lumtur jetën e saj të re.

Përfundimi i kolektivizimit në shumë rrethe dhe lokalitete, duke përfshirë edhe Dajçin, gëzon

pa masë zemrat e tërë popullit shqiptar. Njëkohësisht ai është grusht dërrmues kundër armiqve të vendit tonë, sidomos kundër revizionistëve të urryer të Beogradit, të cilëve çdo ditë e më shumë po u del boja dhe gjithë bota po e kupton se janë vënë në shërbim të imperialistëve, armiqve më të tërbuar të njerëzimit.

Populli shqiptar, me Partinë e tij të Punës në krye, do të shkojë gjithnjë përpara, drejt fitoreve të reja. Më kot janë përpjekur dhe po përpiqen armiqtë tanë të na pengojnë në rrugën e socializmit.

Të dashur shokë,

I forconi dhe i ruani kooperativat tuaja si gjënë më të shtrenjtë. Në to ju do të përmirësoni shpejt ekonominë tuaj dhe do ta bëni jetën më të bukur. Prandaj, nën drejtimin e organizatave të Partisë, vini të gjitha forcat për të organizuar sa më mirë punën dhe për të shtuar prodhimin.

Duke ju uruar suksese gjithnjë më të mëdha, ju përshëndes me gjithë zemër!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit» nr. 236, (3137), 1 tetor 1958

TELEGRAM DËRGUAR VILHELM PIKUT

Berlin

20 tetor 1958

I shtrenjti dhe shumë i nderuari shoku Vilhelm Pik,

Më lejoni t'Ju shpreh falënderimet e mia më të përzemërta për urimet e nxehta që më dërguat me rastin e 50-vjetorit të ditëlindjes sime.

Urimet që më dërguat, i dashuri shoku Vilhelm Pik, më kanë prekur shumë dhe njëkohësisht ato m'i kanë shtuar edhe më shumë forcat për t'u shërbyer edhe më mirë Partisë, popullit dhe atdheut tim.

Përfitoj nga ky rast t'Ju dërgoj urimet më të nxehta për shëndet të mirë, jetë të gjatë dhe suksese akoma më të mëdha në punën Tuaj të lavdishme për të mirën e popullit mik gjerman, në luftën Tuaj të drejtë për bashkimin paqësor të atdheut Tuaj në një shtet të vetëm demokratik e

paqedashës, për të mirën e lëvizjes punëtore dhe komuniste ndërkombëtare, për forcimin e mëtejshëm të miqësisë midis dy popujve tanë.

Enver Hoxha

Sekretar i Parë i KQ të PPSH
dhe anëtar i Presidiumit të Kuvendit
Popullor të Republikës Popullore
të Shqipërisë

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOQES ANDROMAQI HARITO

20 tetor 1958

Ju falënderoj nga zemra, shoqja mësuese, Andromaqi Harito, për urimet që ju më bëtë me rastin e 50-vjetorit të datëlindjes sime.

Ju uroj, gjithashtu, shëndet dhe suksese në detyrën tuaj të lavdishme si mësuese e brezit të ri. Ju falënderoj, gjithashtu, ju dhe nxënësit tuaj, për fletoret që më dërguat dhe që më gëzuan shumë për punën e mirë që bëjnë nxënësit dhe mësuesja e tyre.

Shumë të fala juve dhe nxënësve të dashur.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT RITA MARKO

22 tetor 1958

I dashur shoku Rita,

Mora urimet që më dërguat me rastin e 50-vjetorit të ditëlindjes sime, si edhe urime nga shumë shokë të tjerë që studiojnë në Moskë. Ju falënderoj me gjithë zemër për këto urime të mira që më keni dërguar dhe, gjithashtu, ju lutem t'u shprehni falënderimet e mia edhe shokëve të tjerë, të cilëve nuk kam mundësi t'u përgjigjem veç e veç.

Unë e di që urimet që më kanë ardhur me rastin e 50-vjetorit të ditëlindjes nga shokët dhe miqtë e mi, i përkasin Partisë sonë të lavdishme dhe popullit tonë, ushtarë të të cilëve jemi të gjithë ne komunistët, u përkasin ideve të mëdha të marksizëm-leninizmit, për të cilat ne luftojmë, ndërsa meritat që më atribuohen mua janë, në radhë të parë, merita të udhëheqjes së Partisë

sonë, merita të të gjithë shokëve tanë të Byrosë Politike.

Duke falënderuar edhe një herë ju dhe shokët e tjerë për urimet që më keni dërguar, ju uroj me gjithë zemër shëndet të mirë dhe suksese në përvetësimin e bazave shkencore të marksizëm-leninizmit, për të mirën e Partisë e të popullit tonë.

Shumë të fala e përqafime.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR BASHKATDHETARIT ANDON ZUNI

Paris

25 tetor 1958

I nderuari zoti Andon,

Ju falënderoj me gjithë zemër për urimet që më dërguat me rastin e 50-vjetorit të ditëlindjes sime dhe për fjalët e mira që thoni për mua.

Këto urime dhe fjalë të mira i përkasin në radhë të parë popullit tonë heroik që me luftën e tij të pashembullt, i udhëhequr nga Partia e lavdishme e Punës, shporri një herë e mirë pushtuesit, fitoi lirinë dhe me pushtetin popullor në duart e veta ndërton me entuziazëm jetën e re, socializmin, duke lulëzuar e duke bërë dita-ditës më të begatshme jetën e vet.

Përfitoj nga rasti t'ju uroj familjarisht shën-

det të mirë, jetë të gjatë dhe suksese në veprimtarinë tuaj të frytshme patriotike për të mirën e Shqipërisë e të popullit shqiptar.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR EVELINA REDUTH

RDGJ

7 maj 1959

Vogëlushja ime Evelina,

Shumë faleminderit për urimet që më dërgove me rastin e festës së madhe të punonjësve të të gjithë botës, 1 Majit, si edhe për fotografitë.

Po të dërgoj si kujtim nga Shqipëria, populli i së cilës e do me gjithë shpirt popullin vëlla të Republikës Demokratike Gjermane, disa kukulla porcelani dhe disa materiale të ilustruara mbi jetën e re në Shqipëri.

Të uroj ty, prindërve, mësuesve, shoqeve dhe shokëve të tu shëndet të mirë dhe suksese në mësime, për t'u bërë vajzë e mirë, e vlefshme për veten tënde, për familjen dhe për atdheun tënd.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR KOMISIONIT TË FESTËS SË ÇLIRIMIT TË GJIROKASTRËS

17 shtator 1959

Të dashur shokë,

Mora ftesën që më dërguat për të marrë pjesë në festimin e 15-vjetorit të çlirimit të qytetit të Gjirokastrës nga pushtuesit fashistë dhe tradhtarët e vendit, dhe ju falënderoj me gjithë zemër.

Në ditët e vështira të pushtimit të atdheut tonë, populli heroik i Gjirokastrës, sikurse i gjithë populli shqiptar, në zemrat e të cilit vlonte urrejtja për pushtuesit e huaj e tradhtarët e brendshëm dhe dëshira e zjarrtë për të çliruar prej tyre atdheun tonë të bukur, iu përgjigj me vendosmëri të madhe thirrjes së Partisë sonë të Punës, duke rrokur armët në Luftën Nacionalçlirimtare. Trashëgimtar i denjë i traditave të larta të Çeços[1]

1. Çerçiz Topulli.

me shokë, ai luftoi me trimëri për çlirimin e vendit dhe shumë nga bijtë dhe bijat më të mira të qytetit tonë të dashur dhanë jetën e tyre në këtë luftë të shenjtë.

Pas Çlirimit të atdheut, populli i Gjirokastrës, me të njëjtin shpirt luftarak dhe plot vrull revolucionar, duke zbatuar porositë e Partisë dhe nën udhëheqjen e saj, punoi me vetëmohim për rindërtimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore dhe ka arritur suksese të mëdha, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në luftën e mbarë popullit shqiptar për ndërtimin socialist të vendit.

Duke ju kërkuar falje që nuk mund të marr dot pjesë personalisht në festën e çlirimit të qytetit tonë, për shkak se jam shumë i zënë me punë, ju lutem t'u transmetoni pjesëmarrësve të festës dhe gjithë vëllezërve e motrave të Gjirokastrës, përshëndetjet më të nxehta dhe urimet më të mira të Komitetit Qendror të Partisë dhe të miat personale, për suksese të reja edhe më të mëdha në punë për ngritjen e vazhdueshme të mirëqenies materiale dhe të nivelit kulturor të punonjësve, për lulëzimin e qytetit të bukur heroik të Gjirokastrës, për të mirën dhe lumturinë e të gjithë popullit tonë!

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 17, f. 292

PËRSHËNDETJE DREJTUAR REDAKSISË SË GAZETËS «PIONIERI»

16 dhjetor 1959

Të dashur shokë,

Me rastin e 15-vjetorit të botimit të gazetës «Pionieri» Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, ju dërgon juve, shokë të redaksisë, bashkëpunëtorëve tuaj, mësuesve, shkrimtarëve, pionierëve dhe gjithë lexuesve të vegjël, përshëndetjet dhe urimet më të mira!

Gazeta «Pionieri» filloi të botohet që në ditët e para të Çlirimit, kur para Partisë dhe popullit tonë qëndronin detyra të rëndësishme për të shëruar plagët e rënda të luftës. Kjo tregon vëmendjen e madhe, dashurinë dhe kujdesin e veçantë të Partisë sonë për edukimin e fëmijëve.

Gjatë këtyre 15 vjetëve gazeta «Pionieri» ka luftuar që t'i edukojë fëmijët për çështjen e madhe të Partisë dhe të popullit. Ajo është bërë

një ndihmëse aktive e shkollës duke bërë një punë të madhe për përvetësimin e mësimeve, për forcimin e disiplinës në shkollë dhe të sjelljeve të mira në familje e në shoqëri.

Komiteti Qendror i Partisë uron që edhe në të ardhmen gazeta të luftojë me të gjitha forcat, që pionierët dhe fëmijët tanë t'i duan Partinë, atdheun, shkollën dhe mësimin, të rriten të mençur e me duar të arta. Gazeta «Pionieri» duhet t'i njohë edhe më mirë fëmijët me traditat patriotike të popullit tonë, me luftën e Partisë sonë për ndërtimin e socializmit, të rrënjosë gjithnjë e më shumë në ta dashurinë për paqen dhe miqësinë midis popujve.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim se gazeta «Pionieri» do të jetë një mik dhe shok i ngushtë i pionierëve, që të çojë tek ata këshillat e urta të Partisë, t'i mësojë të duan e të nderojnë prindërit dhe mësuesit e tyre.

Me rastin e këtij jubileu Komiteti Qendror i PPSH i uron gazetës «Pionieri» suksese të mëtejshme në punën e saj për edukimin komunist të pionierëve dhe të fëmijëve tanë!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Vepra, vëll 17, f. 516

TELEGRAM DËRGUAR KOLEKTIVIT PUNONJËS TË STACIONIT HEKURUDHOR

Durrës

9 maj 1960

Të dashur shokë,

Mora urimet që më dërguat me rastin e festës së madhe të punonjësve të mbarë botës, «1 Majit» si dhe fotografinë, për të cilat ju falënderoj me gjithë zemër.

Me këtë rast ju uroj ju të gjithëve dhe familjeve tuaja shëndet, jetë të gëzuar e të lumtur dhe suksese në realizimin dhe në tejkalimin e planit të shtetit, për të mirën dhe lumturinë e popullit tonë heroik, për ndërtimin me sukses të socializmit në vendin tonë.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT[1]

21 qershor 1960

Vetëm shokut Hysni

Nga radiogramet e tua shohim se gjendja po rrokulliset në rrugë të gabuar, prandaj paraqitet shumë delikate.

Bëj shumë kujdes. Lëru të kuptojnë se ti do të marrësh pjesë vetëm në mbledhjen që kemi vendosur së toku, ku do të jenë vetëm partitë e kampit të socializmit, për të caktuar datën dhe vendin e mbledhjes së ardhshme më të gjerë të partive komuniste e punëtore. Na mbaj në korent. Na lajmëro ekzaktësisht kur do të bëhet mbledhja.

Përqafime

Enver

Vepra, vëll. 19, f. 1

1. Në atë kohë kryetar i delegacionit të PPSH në Kongresin e 3-të të Partisë Punëtore Rumune dhe në Mbledhjen e partive komuniste e punëtore në Bukuresht.

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT

23 qershor 1960

Shoku Hysni,

Siç po zhvillohet situata ka mundësi që të propozohet të mos zhvillohet Mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore që është caktuar për më vonë. Në një rast të tillë ti shfaq mendimin e udhëheqjes sonë se ajo mbledhje është e domosdoshme dhe nuk mund të zëvendësohet me këtë që do të zhvillohet tani në Bukuresht.

Enver

Vepra, vëll. 19, f. 20

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT

24 qershor 1960

I dashur Hysni,

Në mbledhjen e mëngjesit që do të bëhet thuaj: «Udhëheqja jonë, nga letrat e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, di se delegacionet tona, jo të nivelit të lartë, këtu në Bukuresht, do të caktojnë vetëm datën dhe vendin e Mbledhjes së ardhshme të partive komuniste e punëtore. Në ato letra thuhet se mund të shkëmbehen mendime mbi situatën politike të jashtme të krijuar nga dështimi i Konferencës së Parisit. Kurse këtu shoh që po shtrohen gjëra jashtëzakonisht serioze.

Nga delegacioni sovjetik na u dha një material voluminoz vetëm 10 orë para mbledhjes dhe as na jepet fare kohë të marrim frymë. Ne kjo gjë na çudit».

Kur të marrësh fjalën në mbledhje duhet të deklarosh: «Mbi këto çështje nuk jam i autorizuar të prononcohem, sepse udhëheqja jonë di se këto çështje do të diskutohen në Mbledhjen e ardhshme të përfaqësuesve të partive, ashtu si kurse kemi rënë dakord të gjithë». Në rast se «ndonjë i madh» bën ndonjë aluzion provokues për mosprononcimin tonë në këtë mbledhje, atëherë ti nxirr deklaratën zyrtare që të dërguam për t'ia komunikuar udhëheqjes sovjetike me anën e Andropovit dhe lexoje pas fjalës që do të mbash. Nëse aluzioni bëhet pasi ti të kesh folur, atëherë kërko fjalën për të dytën herë dhe lexo deklaratën e Komitetit tonë Qendror që i transmetove Andropovit.

E kuptojmë situatën tënde të vështirë, por mos u shqetëso fare se jemi në rrugë të drejtë. Shëndet e durim.

Enver

Vepra, vëll. 19, f. 21

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT

24 qershor 1960

Hysniut

Në qoftë se paraqitin komunikatë ose rezolucion si konkluzion të mbledhjes, dhe ku të bëhet qoftë aluzioni më i vogël jashtë përmbajtjes së Deklaratës së Moskës [1957], ti nuk duhet ta firmosësh. Ti, pa humbur kohë, pyet dhe kërko zyrtarisht a do të ketë komunikatë dhe, nëse ka, kjo të të dorëzohet. Na njofto për përmbajtjen e saj dhe prit pikëpamjen tonë për pranimin ose jo të kësaj komunikate.

Enver

Vepra, vëll. 19, f. 23

LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT

25 qershor 1960

I dashur Hysni,

Morëm radiogramet e mbrëmjes dhe të shkruaj këtë copë letër tash në mëngjes[1], për të thënë vetëm se mirë ia ke dhënë përgjigjen «mikut»[2]. As hiç mos u turbullo kur të të provokojë ndonjë, por përgjigju, bile dhe fort, veçse me gjakftohtësi. Poshtërsira po bëhen, por e drejta kurdoherë fiton. Në rast se vazhdojnë të bëjnë provokime, mos lërë gjë mbi kurrizin tonë, por ua lër në kurriz.

Të përqafoj

Enver

Vepra, vëll. 19, f. 28

1. Dërguar me avionin që do të sillte në atdhe shokun Hysni.
2. Nikita Hrushovi.

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT

25 qershor 1960

Shoku Hysni,

Ti duhet të flasësh nesër sipas udhëzimeve të Byrosë Politike që i ke marrë me letër. Në fund të fjalës tënde, ose gjej vendin a rastin e përshtatshëm, deklaro: «Unë, në emër të Partisë sonë, deklaroj se Partia e Punës nuk është kurrsesi dakord me frymën e me metodat që përdoren në këtë mbledhje për zgjidhjen e këtij problemi kaq të madh për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Mendimi i Partisë sonë është se këto çështje duhen trajtuar me kujdes, me gjakftohtësi dhe në frymë shoqërore sipas normave leniniste». Në rast se pas kësaj deklarate të drejtohen pyetje ose vërejtje provokuese, ngrihu dhe thuaj: «Përveç atyre që thashë nuk kam tjetër për të thënë në këtë mbledhje». Në rast se ke folur, kërko të

flasësh përsëri dhe bëj këtë deklaratë. Në rast se nuk të japin fjalën, atëherë fjalimin që do të mbash dorëzoje në kryesinë e mbledhjes duke kërkuar që të regjistrohet në procesverbal.

Të presim. Mirë ardhsh!

Enver

Vepra, vëll. 19, f. 29

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË

9 tetor 1960

Shoku Hysni,

Mora radiogramin dhe kuptova si zhvillohen situatat. Shumë mirë shkon puna. U nxehën gjakrat. Të demaskohen plehrat. Përveç të tjerave që ti i di vetë, Suslovit i thuaj edhe këtë: «Zor do të jetë për falsifikatorët të akuzojnë komunistët shqiptarë se nuk e kuptojnë dhe se janë kundër bashkekzistencës. Ata kanë qenë dhe do të jenë kurdoherë për bashkekzistencën, ashtu siç na mësojnë Lenini dhe Stalini. Por më zor akoma është që përkrahësit e tradhtarit fashist kundërrevolucionar, Imre Nagit, të akuzojnë Partinë e Punës të Shqipërisë për një parti borgjeze dhe komunistët shqiptarë për kerenskë. Sidoqoftë, me fakte së shpejti ne do të vërtetojmë kush janë kerenskët dhe kush janë marksistë-leninistët e vërtetë».

Të tjerat i shiko vetë, por ta hajë këtë Suslovka, të shohin edhe të tjerët se kanë qenë sovjetikët të parët që na atakuan në këtë mënyrë dhe të mos çuditen për ato që do të rrëzohen në kokën e hrushovianëve në nëntor. Të gustojnë parathënien.

Shumë të fala

Enver

Vepra, vëll. 19, f. 324

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË

11 tetor 1960

Shoku Hysni,

Jam dakord me ty. Mos i harxhoni argumentet e mëdha në një mbledhje të atillë. Vetëm futjuni disa thika paralajmëruese të gjithë atyre që e meritojnë. «Fronti» që kanë krijuar, në nëntor do të shpartallohet më shumë se tash. Bravo indoneziani! Ka shumë rëndësi që të shohin sovjetikët e lakenjtë e tyre se jo të gjithë hanë bar. Ramizi, në komision, t'ua heqë turinjve provokatorëve e shpifësve. Avioni vjen sot.

Të fala

Enver

Vepra, vëll. 19, f. 328

LETËR DREJTUAR NJË QYTETARI ÇEKOSLLOVAK

25 tetor 1960

Shoku Jan,

Ju falënderoj për urimet e mira që më dërguat me rastin e ditëlindjes sime. Edhe unë ju uroj, gjithashtu, shëndet të mirë, jetë të gëzuar e të lumtur me familjen dhe suksese sa më të mëdha në punë.

U gëzova shumë kur, me anën e letrës që më drejtuat, kuptova që ju e keni mësuar gjuhën shqipe jo vetëm ta flisni, por edhe ta shkruani pa gabime.

Ju falënderoj, gjithashtu, për fotografitë që më dërguat dhe, sipas dëshirës që keni shfaqur, po jua kthej kopjen e tretë me nënshkrimin tim.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOQES NEXHMIJE HOXHA

Moskë, 13 nëntor 1960

E dashura ime Nexhmije,

Më ka marrë shumë malli për ty, sa s'më kishte marrë ndonjëherë tjetër, pse të tjera gjendje shpirtërore kanë qenë të parat kur ka qëlluar që jemi ndarë. Ti e kupton vetë. Por sidoqoftë, ndjenjat e tua, mendimet e tua, dashuria jote më vjen deri këtu dhe më qëndron pranë në këto momente të vështira, por për një çështje të drejtë, pse jemi duke luftuar për çështjen e madhe të Partisë sonë të dashur, të popullit tonë heroik, të komunizmit. Jemi në rrugë shumë të drejtë, kurse grupi i Hrushovit është në rrugë antimarksiste. Këtë s'e luan as topi. Këtu çdo gjë që ngjet, dhe shumë gjëra ngjasin, vërtetojnë drejtësinë tonë.

Vetëm, siç e di, zemrën e kemi copë për popullin sovjetik që ka rënë në të tilla duar. Është edhe kjo që na bën të luftojmë me rreptësinë më të madhe dhe t'ia shpërblejmë sadopak të mirat që i ka bërë njerëzimit dhe popullit tonë. Ne do të fitojmë!

Nexhmije, momenti i parë pas fjalimit në dukje mund të mos jetë i favorshëm për ne, por më vonë ndryshe do të ngjasë.

Me sovjetikët patëm tri pjekje, bënë një mijë poshtërsira, por e panë me kë kishin të bënin dhe morën përgjigjen e merituar. Sigurisht do të zgjatesha po të t'i shkruaja të gjitha. Erdhi Torezi na thirri për darkë (i shtyrë). Ai u soll shoqërisht, por s'është në të, as me ne dhe, sidomos, në bllok kundër Kinës. Presim me padurim nisjen, të vijmë në shtëpinë tonë, pse s'ka si shtëpia tënde. Bukë e kripë, por në shtëpi. Prandaj hiç mos u bëj merak, e dashura Nexhmije, jam shumë mirë nga shëndeti, analiza është e mirë, tensioni i gjakut 8 me 12-13. S'ka më mirë.

Lufta për çështjen e drejtë të Partisë më bën edhe më të fortë. Prandaj duke të puthur me mall, me shumë mallllll e mbyll letrën, të të gjejë mirë me gjithë fëmijët tanë të shtrenjtë.

Yti përjetë

Enver

Anesë i puth dorën, Sanos shumë të fala, të tjerëve gjithashtu.

Kinezët mund të flasin nesër. Ne ose nesër ose pasnesër, e shumta. Në Tiranë do të vijmë në fund të kësaj jave.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOQES NEXHMIJE HOXHA

Moskë, 16 nëntor 1960

E dashura ime Nexhmije,

Megjithëse të thashë se s'të shkruaj, prapë s'm'u ndejt pa të shkruar, pasi më telefonove, pse kur dëgjova përsëri zërin tënd dhe të fëmijëve, m'u ndez malli i madh për ju dhe për atdheun e shokët. Fjalimin e mbajta sot. Ishte, siç e di, top. Do të marrësh vesh për fjalimin e poshtër të Ibarrurit dhe të të tjerëve. Por s'ka gjë, ne i kishim parashikuar të gjitha. Armiqtë do të na atakojnë, por rruga jonë është e drejtë, ne do të fitojmë dhe ata do të dërrmohen. Ibarrurin e duartrokitën, por 10 parti as e duartrokitën, këto parti, pra, haptazi ishin solidare me ne dhe me Kinën. Në Bukuresht ishim 2 parti, tash u bënë 10. Më vonë grupi i Hrushovit do të mbetet vetëm. Ju mos u mërzitni se i kemi nervat të fortë, si shkëmb jemi, ashtu siç e kemi Partinë dhe popullin. Duhet me thënë, nga ana tjetër, se fjali-

mi im bëri përshtypje të madhe. Ne e kemi parashikuar që efekti momentan do të jetë për trockistët, por efekti më vonë do të jetë për ne, në favorin tonë.

Novotni dhe Torezi folën para nesh, por shumë poshtër kundër Kinës. Prestia i Brazilit foli mirë, në mënyrë të rezervuar, por edhe mjaft të tjerë nuk e atakuan direkt Kinën; japonezi, indoneziani, vietnamezi, australiani, neozelandezi, s'kanë folur akoma.

Tash presim sa të mbarojë kjo mbledhje, pse s'kam parë kurrë në jetë atmosferë më mbytëse dhe më armiqësore, derisa hapur përpiqen të na përpunojnë në mënyrë agjenturore. Por s'ka gjë, jemi mësuar me luftë, do të kalojnë edhe këto halle.

Mendjen dhe zemrën i kam tek ti, Nexhmija ime e dashur. Fëmijët i puth me shumë mall. Si lum ti që i ke afër. Propozimin tënd për udhën e kthimit e morëm parasysh. Ai tash bëhet shumë i rrezikshëm nga çdo anë, kemi gjetur variantin më të mirë dhe më të sigurt.

Të përqafoj dhe të puth me shumë-shumë maaall.

Yti përjetë

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOQES NEXHMIJE HOXHA

Moskë, 20 nëntor 1960

E dashura ime Nexhmije,

Të puth e të përqafoj me shumë mall. Nga shëndeti jam shumë mirë. Bëra analizën e sheqerit dhe më dolli 1 e 7. Siç e shikon nervat i kemi në vend, me gjithë andrallat që kemi në kokë. Kjo ngjet se jemi në rrugë të drejtë dhe ndërgjegjen e kemi të qetë.

Edhe shokët të gjithë janë mirë, bile Hysniut analiza i del më mirë nga unë, 1 e 1.

Unë rri në ambasadë, këtu ha, pi, fle. Ishte masë e domosdoshme, pas gjithë këtyre që ngjanë. Ti kuptoje vetë. Deri këtu ka shkuar puna me ta. Nga ana protokollare s'ka asnjë rëndësi, kurse Hysniu dhe Ramizi rrinë në Zarjeçe. Çdo gjë shkon shumë mirë, siç e kemi pasë parashikuar. Këta janë tmerrësisht të poshtër dhe po demas-

kohen. Ne drejtësisht ua çorëm maskën. Ata si s'arritën dot me presione të na trembnin, pasi folëm ne, filluan me fjalë të poshtra të na atakonin. Pasionarja, Gomulka, Ali Jata dhe më në fund Georgiu Dezhi ishin më të poshtrit. Këtë e bënë për të trembur të tjerët dhe të provokonin ndonjë reaksion të hapët nga ne. Por ne qëndronim si Olimpi. Unë dëgjova vetëm Gomulkën dhe vendosa të mos asistoja, shokët e tjerë po. Pas kësaj, si e panë që s'u ndezi, disa të tjerë folën më ndryshe, pa zënë në gojë emër, por me termin delegacioni shqiptar, disa thanë nga një gjë të vogël që të kalonin radhën, shumë miq s'folën fare. Indoneziani foli shumë mirë, bile fjalimi ishte shkruar në një mënyrë që mbronte çështjen tonë dhe ne që i hapëm petën lakrorit.

Kur foli indoneziani trockistëve u ra pika. Pastaj u ngrit një i Amerikës Latine dhe tha: «Ç'janë këto fjalë pa vend që po dëgjojmë këtu, jo shpifje, jo provokacione» etj. Kështu që dita e shtunë ishte fitore për ne dhe disfatë për revizionistët.

Çështja qëndron shumë rëndë për ta, pse po u dështon çdo gjë, dhe, në rast se nuk hiqen nga deklarata çështja e fraksionit, Kongresi XX e XXI, komunizmi nacional etj., ajo nuk do të nënshkruhet jo vetëm nga ne, por gati nga 10 parti. Ho Shi Mini foli shumë mirë. Këtë s'e pritnin revizionistët dhe u ra në kokë si vare. Disa që thanë nga një gjë të vogël për ne, na lajmëruan të mos e marrim për keq pse s'kishin ç'të bënin.

Tash po bëjmë sehir si në televizor manovrat e poshtra të revizionistëve, të cilat do t'u dështojnë të gjitha.

Shumë delegacione janë në tym, s'kuptojnë gjë, ca janë të qorruar. Në radhët e tyre ka konfuzion. Mbledhjet vazhdojnë me të madhe në prapaskenë.

Dje vajtëm i bëmë vizitë protokollare Liu Shao Çisë. Na priti jashtëzakonisht mirë. Çfarë nuk tha të mirë për Partinë tonë, «vepra juaj heroike, — tha, — do të shkruhet në histori» etj. Sot na e ktheu vizitën në ambasadën tonë.

Ambasada jonë është e rrethuar ditë e natë, hapët dhe fshehtë, vëzhgohet me njerëz dhe me aparatura nga brenda e nga jashtë. E tillë është poshtërsia, por ne i kemi nervat të fortë dhe s'çajmë kokën fare. Tash e dimë qartë me kë kemi të bëjmë.

Koreanët, pas fjalimit tonë, na shtrënguan dorën dhe na thanë «shumë mirë».

Kanë mbetur për të diskutuar edhe 20 veta. Besojmë se të martën ose e shumta të mërkurën të mbarojmë dhe menjëherë do të nisemi nga rruga që dini.

Disa vështirësi do të kemi patjetër, por të gjitha do t'i kalojmë, Nexhmija ime e dashur. Ne i kemi Partinë dhe popullin të mrekullueshëm. Miq të hapët kemi shumë, por edhe sepse tash për tash shumë nga këta s'flasin dot hapur, i kemi me miliona. Koha punon për ne, për drejtësinë, për marksizëm-leninizmin.

Gjëja kryesore tash është të kthehemi sa më parë në atdhe, në gjirin e popullit dhe të Partisë sonë të dashur, në gjirin e familjes sonë, afër, afër teje, ashtu siç na e do zemra të dyve.

Pranvera kur më flet në telefon, kërkon të bisedojë me mua ashtu siç flasim kur jemi në dhomën e bukës. Më kërkon se ç'do t'i sjell, por kot sepse, e para, s'mund të merrem me këto gjëra, por edhe Vangjeli[1] më tha se vajtën, panë dhe s'gjetën gjë. Ca që ishin, ishin për lumë dhe të shtrenjta.

Dje, të shtunën, iku për në Çekosllovaki Novotni. Akoma s'e shpjegojmë dot ikjen e tij. Por në rast se s'ka ikur për ndonjë arsye të brendshme, duhet të kenë diçka në mes tyre. Fjalimi i Novotnit ishte shumë i keq kundër kinezëve. Ai foli para meje. Të nesërmen e fjalimit tim. u poqëm në korridore, e salutuam, ai s'na u përgjigj. Vetëm dje. Baraku dhe shoku i tij, salutuan Ramizin dhe P. Bitën[2]. Pirros, ish-shoku i shkollës së çekut që ishte me Barakun, ia shtrëngoi fort dorën.

Ikja e Novotnit në rast se nuk jepet arsye zyrtare për ndonjë çështje të brendshme, do të bëjë bujë në arenën ndërkombëtare dhe s'ka si të kuptohet ndryshe përveçse si mosmarrëveshje serioze me Hrushovin në lidhje me përfundimin e

1. Vangjel Beçi, në atë kohë punonte si kamerier pranë shokut Enver.

2. Pirro Bita, në atë kohë drejtor i Drejtorisë së Jashtme në aparatin e Komitetit Qendror të Partisë.

mbledhjes. Është për të pranuar përçarjen apo jo? Do të shohim zhvillimin e manovrave nesër. Se këtu nga këta vetëm manovra dhe prapaskena ka. Sekretariati s'është mbledhur asnjëherë, komisioni i redaktimit po ashtu; mbledhja gati po merr fund dhe komisioni as thërritet. Lëre ç'vete, vetë zot — vetë shkop, por shkopi iu thye Hrushovit. Flasin për rregulla, por as i mbajnë fare. Është bërë çorbë derri e kanë humbur toruan, kjo është e qartë.

Sot u lexua raporti im nga të gjithë shokët shqiptarë të Shkollës së Partisë, ishin shumë entuziastë. Të gjithë janë top. Por besoj se qëndrimi i tyre këtu do të jetë i shkurtër, se sovjetikët nuk do t'i lejojnë të shfaqin pikëpamjen e Partisë sonë, kështu që shpejt ose vonë do të na kërkojnë t'i tërheqim...

Anesë i puth dorën. Mëmës tënde të fala si dhe Sanos, fëmijët i përqafoj me mall dhe ty të puth me maaaallll të madhdh.

Yti

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR PIONIERËVE DHE NXËNËSVE TË SHKOLLËS 7-VJEÇARE «KUVSHINSKAJA»

26 dhjetor 1960

Të dashur pionierë dhe nxënës të shkollës 7-vjeçare «Kuvshinskaja»[1],

Nga letra që më drejtuat mësova me gëzim se ju keni krijuar muzeun shkollor për Vladimir Iliç Leninin. Iniciativa juaj është për t'u lavdëruar se ju, pjesëtarë të denjë të brezit të ri, interesoheni të mësoni sa më shumë për jetën dhe veprimtarinë e mësuesit tonë të madh e të paharruar, V. I. Leninit.

Lenini ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë frymëzuesi ynë i madh në luftën për socializëm dhe komunizëm. E gjithë figura e tij, e tërë jeta

1. Pionierët e kësaj shkolle i luteshin shokut Enver t'u dërgonte për muzeun e shkollës një vlerësim për figurën e V. I. Leninit dhe një urim për ata vetë dhe nxënësit sovjetikë.

dhe veprimtaria e tij vigane janë një shembull i shkëlqyer për brezat e rinj. Lenini shquhej për energjinë e tij të pashterur revolucionare, për besimin e tij të thellë në vrullin revolucionar të klasës punëtore dhe të punonjësve të shtypur, për urrejtjen e tij të madhe kundër shtypjes dhe shfrytëzimit, kundër armiqve të klasës punëtore dhe të popullit punonjës, për dashurinë dhe kujdesin e madh që tregonte për punonjësit, për pasionin e pakufishëm revolucionar me të cilin luftonte për çështjen e socializmit dhe të komunizmit. Lenini sa ishte i madh, aq ishte edhe i thjeshtë e modest.

Unë dëshiroj dhe uroj që jeta dhe veprimtaria e Leninit, shembulli i shkëlqyer i jetës së tij, të jenë gjithmonë një mësim i gjallë për ju, të dashur pionierë të atdheut të Leninit të madh.

Ju uroj, të dashur pionierë dhe nxënës, suksese në mësime dhe në punë. Ju uroj të rriteni luftëtarë të denjë të çështjes së madhe të Leninit.

Enver Hoxha

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MESAZH PËRSHËNDETJEJE DREJTUAR UILIAM FOSTERIT, KRYETAR NDERI I PK TË SHBA

28 shkurt 1961

I dashur shoku Uiliam Foster,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, në emër të të gjithë komunistëve dhe të popullit shqiptar ju dërgon përshëndetje të nxehta dhe vëllazërore me rastin e 80-vjetorit të ditëlindjes suaj.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar përshëndesin te ju luftëtarin e palodhur dhe besnik për mbrojtjen e interesave të klasës punëtore amerikane, një nga personalitetet e shquara të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, që ka luftuar me konsekuencë kundër fraksioneve të djathta, trockistëve, oportunistëve të ndryshëm, dhe sidomos kundër rrezikut revizionist, që në periudhën e fundit kërcënonte ekzi-

stencën e Partisë Komuniste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke mbrojtur kështu me vendosmëri partinë dhe parimet marksiste-leniniste të ndërtimit të saj.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ju uron me gjithë zemër shëndet të plotë dhe jetë të gjatë për të vazhduar edhe më tej luftën në shërbim të popullit dhe të klasës punëtore të vendit tuaj, kundër shfrytëzimit të egër kapitalist, kundër imperializmit amerikan dhe veglave të tij, oportunistëve dhe revizionistëve të çdo ngjyre!

Përshëndetje revolucionare!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 20, f. 359

RADIOGRAM DËRGUAR DELEGACIONIT SHQIPTAR NË MBLEDHJEN E KOMITETIT POLITIK KONSULTATIV TË TRAKTATIT TË VARSHAVËS

Moskë

28 mars 1961

Letrën e Greçkos hidheni në shportë[1], përgjigjjuni vetëm atyre çështjeve që ai edhe të tjerët do të shtrojnë në mbledhje. Prandaj fjalimi juaj duhet rishikuar në këtë dritë. Mos flisni të parët.

---

1. Është fjala për një letër dorëzuar delegacionit tonë orën e fundit para se të fillonte Mbledhja e përfaqësuesve të vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës, që u zhvillua në Moskë më 28-29 mars të vitit 1961. Në letër kërkohej që Qeveria e RP të Shqipërisë të hiqte dorë nga baza ushtarako-detare e Vlorës dhe i gjithë territori i saj të vihej nën drejtimin e qeverisë sovjetike, forcat e armatosura të marinës shqiptare të tërhiqeshin nga ky territor, kurse të gjitha anijet luftarako-detare, ndihmëse etj., t'u jepeshin në dorëzim ekuipazheve sovjetike.

Çështja e bazës. Qeveria Shqiptare nuk pranon as ndryshimin më të vogël nga statukuoja aktuale e përcaktuar nga marrëveshjet zyrtare në mes dy qeverive. Hidhni poshtë shpifjet dhe arsyetimet e tyre, përmendni dhe shpërndani promemorien tonë e të Andrejevit në lidhje me ngjarjet në bazë. Argumentoni çështjen nga ana politiko-ushtarake, tregoni përgatitjen shembullore të marinarëve tanë. Lidhni kërcënimet dhe shantazhet e mëparshme të Hrushovit për këtë çështje dhe thoni se Qeveria Shqiptare nuk pranon tezat e mareshalit Greçko, pse janë pa vend. Theksoni se çdo vendim që do të marrin në drejtim të tërheqjes prej tyre të mjeteve të bazës dhe të mosfurnizimit të saj me armatime sipas marrëveshjeve dhe kontratave, dobëson mbrojtjen e kampit socialist e të Shqipërisë dhe i bën krejtësisht përgjegjës. Si konkluzion, u thoni se në emër të Partisë dhe të Qeverisë, ne nuk pranojmë dhe do të votojmë kundër çdo vendimi që mund të merret kundër statukuosë në bazë dhe mosrespektimit të marrëveshjeve midis BS dhe RPSH.

Na mbani në korent. Qëndroni në lartësinë e Partisë sonë.

Enver

Vepra, vëll. 20, f. 368

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA NË PEKIN

26 maj 1962

Në lidhje me problemet që do të diskutoni, ju vëmë në dukje ta keni parasysh vajtjen e Hrushovit në Bullgari dhe fjalët e mira që tha ai atje për Jugosllavinë.

Duket qartë se Hrushovi kërkon të fitojë kohë, të përfitojë nga pushimi i kritikave të hapëta, për të përgatitur një akt të ri armiqësor kundër deklaratave të Moskës. Siç duket, të gjithë revizionistët, fshehurazi, kanë rënë dakord që të afrojnë haptazi grupin titist të Beogradit dhe ta rehabilitojnë atë totalisht. Vijën e dha Hrushovi në Varna dhe të gjithë, njëri pas tjetrit, po e ndjekin haptazi. Çështja e unitetit për Hrushovin është një blof. Ai po e vë hapur në zbatim vijën e Titos për shpartallimin e kampit duke thënë e vepruar se «Bashkimi Sovjetik bën edhe pa Kinën, sikundër Kina bën edhe pa Bashkimin So-

vjetik» ose «të ndërtosh socializmin nuk varet nga marrëdhëniet që mbahen me Bashkimin Sovjetik». Me fjalë të tjera, Hrushovi provokon, me qëllim që të marrë një argument që gjoja të shfajësohet për planin armiqësor që po zbaton pa asnjë ngurrim, dhe pa as më të voglën shpresë që të ndalet, pa le të kthejë kurs. Delegacionet e shumta që venë e vijnë te njëri-tjetri janë, mendoj unë, përgatitje për nëntorin. Ne mendojmë se ata do të bëjnë mbledhje pa ne, por edhe pa Kinën në qoftë se ajo nuk vete. Ata, sigurisht, nuk bëjnë mbledhje të përgatitur sipas normave leniniste; do të ishte një iluzion të besosh ndryshe. Mbledhjen do ta bëjnë papritur, me rastin e festës. Mbledhja do të jetë e përgatitur për ta dhe në befasi për kinezët. Këta do t'i vënë përpara faktit të kryer, pra, po të doni ejani, po të doni mos ejani, punë s'na prish. Në qoftë se kinezët bëjnë gabim e venë, atëherë do t'i sulmojnë dhe do t'i dënojnë unanimisht si përçarës. Në qoftë se s'venë, ata do të marrin vendime të atilla të poshtra, që ne do të na duhet të mblidhemi dhe të marrim vendimet tona të drejta. Në fakt do të përçahemi, do të ketë dy vija në lëvizjen komuniste botërore, jona, marksiste-leniniste, dhe tyrja, revizioniste, reformiste. Logjika e luftës antimarksiste e grupit renegat të Hrushovit dhe të shokëve të tij, do të na çojë këtu, pas gjithë përpjekjeve tona të drejta. Kjo rrugë e luftës së hapët dhe të pamëshirshme kundër tradhtarëve të marksizëm-leninizmit është

lufta më e vështirë, por më e drejtë, më frytdhënëse.

Çështja është nëse kinezët e shohin këtë perspektivë të zhvillimit të ngjarjeve në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ua thoni pikëpamjen tonë. Ata janë vetë përgjegjës dhe në gjendje të mendojnë e të vendosin, por s'është keq që të studiojnë edhe pikëpamjet tona. Pjesëmarrja në mbledhjen eventuale, pse gjoja do t'i demaskojë ata në sytë e partive të tjera, «pse atje do të luftojmë», ne mendojmë se është një shpresë e kotë. Ata që do të marrin pjesë në mbledhje janë të përpunuar, janë njerëz të zgjedhur nga Hrushovi, të cilëve nga një vesh u hyjnë e nga një vesh u dalin ato çka do të themi ne dhe kinezët. Me pjesëmarrjen tonë do të krijonim përshtypjen se ata kanë shumicën dhe ne pakicën, kurse po të mos vemi, ata e humbasin këtë armë demagogjike. Partitë e tyre do t'u kërkojnë llogari, pse e bënë mbledhjen pa Kinën dhe Shqipërinë, pse mbledhja u bë e papërgatitur etj. Ata do të gjenden në situata shumë të vështira. Sikur në këtë mbledhje eventuale të mos marrin pjesë as Koreja, Vietnami, Indonezia dhe ndonjë parti tjetër, atëherë do të jetë një sukses i madh për marksizëm-leninizmin. Në rast se ndonjë nga këto parti s'e gjen kurajën dhe vete, atëherë ajo duhet natyrisht ta sabotojë veprimtarinë e revizionistëve nga brenda, duke marrë pretekst mosvajtjen tonë.

T'i keni parasysh këto në bisedime dhe ve-

proni, natyrisht, me takt. Shumë të fala. Çdo gjë këndej shkon mirë. Duhanin e kemi mirë. Fushata e zgjedhjeve është në kulm.

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA

1 qershor 1962

Ju e dini sa dobët i kemi lidhjet me partinë dhe qeverinë kineze, këtu në Tiranë. Sigurisht, kjo është një e metë e madhe, duke marrë parasysh situatat e rëndësishme, problemet e shumta e të koklavitura dhe distancën e madhe. Kështu s'mund të ecet dhe ju e dini arsyen, s'është nevoja t'jua shkruaj. Prandaj ua shtroni shokëve kinezë këtë çështje, si do të bëhet ky problem me rëndësi.

Në këto situata vendosja e linjës ajrore, me avionë kinezë, direkt Pekin—Tiranë, është e domosdoshme, absolutisht e domosdoshme. Shokët kinezë duhet të mendojnë seriozisht për këtë, pa marrë parasysh shpenzimet.

Ju përqafoj

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA

1 qershor 1962

Sovjetikët dhe të tjerët, me anë të Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke na drejtuan një letër ku na thoshin se në rast se ne nuk tërheqim letrën[1] tonë të parë, Këshilli as do të na ftojë në mbledhje, as do të na dërgojë materialet.

U dhamë përgjigje dhe ua hodhëm poshtë me fakte plotësuese dhe u thamë: «Në rast se zyrtarisht ju nuk ndreqni gabimet që keni bërë karshi shtetit tonë, ne abstenojmë nga mbledhje të tilla». Pra ata jo vetëm që nuk marrin iniciativa drejt njohjes së gabimeve, për të cilën ne s'kemi asnjë iluzion, por kërkojnë që ne të ulim kryet dhe ata të na poshtërojnë. Prandaj ju qën-

1. Në atë letër Qeveria jonë protestonte kundër masave diskriminuese ndaj vendit tonë dhe njoftonte se vendi ynë nuk do të merrte pjesë në mbledhje në rast se këto masa nuk hiqeshin.

droni të patundur dhe mos lëvizni aspak nga kushtet që kemi vënë për sovjetikët, të cilët duhet të njohin gabimet tërësisht dhe botërisht, ndryshe ne nuk piqemi me ta, nuk bisedojmë me ta dhe në mbledhje eventuale të partive komuniste e punëtore nuk vemi. Rreth këtij strumbullari ju vërtituni dhe shokët kinezë duhet të binden për drejtësinë dhe efikasitetin e këtij argumenti të madh.

Ju përqafoj

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA

13 qershor 1962

Sigurisht ju jeni në gjendje të kuptoni më mirë nga ne nuancat e thënieve të Tenit në lidhje me ndihmën dhe mbrojtjen e çështjes sonë në frymën internacionaliste, ose që të na bindin ne të ndjekim taktikën e tyre në luftë kundër revizionistëve, dhe sidomos për vajtjen në mbledhje. Sidoqoftë, çështjen e mbrojtjes sonë ju mos lini pa e theksuar se ajo është një detyrë internacionaliste; mbrojtja e PPSH është luftë kundër revizionizmit në format më akute dhe çështja e Shqipërisë është një atu e shëndoshë për të gjithë marksistët e vërtetë.

Duke ju dërguar këtë radiogram, kërkoj që ju të gjeni rastin dhe t'u lini kinezëve të kuptojnë se çështja e Shqipërisë dhe e Partisë sonë nuk mund të mbrohet, me atë formë siç e bën Kina, nga ana e partive të Koresë, Indonezisë, Japonisë,

Vietnamit e të tjera parti që qëndrojnë në pozita afër nesh. Ato na mbrojnë shumë dobët, për të mos thënë fare. Brenda në partitë e tyre nuk flitet hapur dhe si duhet pro nesh, kurse në shtyp as taktikën e Kinës nuk e fillojnë, që edhe kjo s'është gjë tjetër veçse një mbrojtje indirekte. Ju mund t'u thoni kinezëve për miqtë e tjerë si koreanët, vietnamezët e të tjerë, se për ta është e qartë lufta e madhe që na bën neve banda e Hrushovit me të gjithë agjentët e tij në botë. Atëherë a e quajnë ata të mjaftueshme dhe a e kryejnë ata detyrën internacionaliste karshi PPSH dhe RPSH, duke heshtur në shtyp e në parti, duke nxjerrë nga ndonjë lajm të rastit, dhe duke ecur në mënyrë kaq prudente dhe oportuniste, për të mos zemëruar Hrushovin?! U thoni atyre se ne nuk mund të jemi të kënaqur me këtë qëndrim dhe nuk mendojmë që ata të rreshtohen plotësisht me ne, por në qoftë se ata na japin të drejtë në çështjet parimore, atëherë duhet ta manifestojnë këtë në disa mënyra më të dukshme. Ne mendojmë se qëndrimi i tyre në këtë rast duhet të jetë një mjet lufte i përshtatshëm kundër revizionizmit. Në qoftë se ata nuk e bëjnë këtë, që është një çështje tashmë e hapët, kur dhe si do ta bëjnë luftën kundër revizionizmit?! Atëherë lufta e tyre do të mbetet si lufta e Zhivkos kundër revizionizmit, domethënë me një formulë. Ne nuk do të vdesim, por e drejtë s'është që për hir të një uniteti fals, të lejohen revizionistët të na luftojnë ne dhe të kenë përballë vetëm propagandën tonë, në

përmbajtje shumë e fuqishme, por me mjete të dobëta teknike.

Kinezët thonë se Hrushovi ka «ambasadorë» shumë, dhe bën punë shpifëse kundër nesh, por as të mos u shkojë mendja se edhe pas mbledhjes së Moskës, që insistojnë të bëjnë, Hrushovi do të ketë «ambasadorë» më pak dhe do të bëjë më pak punë kundër nesh. Këto janë arsyetime pa baza të shëndosha dhe frikë e tërheqje «e lezetshme» nga lufta dhe përpjekjet. Në qoftë se ata kanë arsye më të shëndosha se këto, me karakter taktik dhe strategjik, le të na i thonë hapur dhe atëherë mund të bindemi. Por po të kishim marrë parasysh potencialin ekonomik, politik, propagandistik të Hrushovit dhe të miqve të tij, atëherë ne s'duhej ta kishim hapur gojën as për dy shekuj. Jo, këto arsyetime s'janë as të drejta, as reale dhe as revolucionare. Prandaj ju përpiquni dhe lëruni kinezëve të kuptojnë se, në këto situata, taktika jonë duhet të jetë aktive, luftarake, revolucionare, e pararojës dhe jo e praparojës, në bisht të Hrushovit, me teorizime të tilla, si «të presim ç'të thotë ai», ose «të veprojë ai i pari» etj., etj. Pra, taktika e tyre për mbrojtjen e çështjes sonë duhet të jetë më direkte dhe të hiqen këto restriksione që duken kohët e fundit, për të qëndruar medoemos në vijë, ndërkohë që Hrushovi po vepron. Si është e mundur të mos flitet për Jugosllavinë, kur vetë Titoja na jep armë për ta luftuar?! Apo e heshtën luftën për hatër të Hrushovit, pse foli mirë për Titon? Sa për koreanët

e të tjerë u lini të kuptojnë se ata e kanë për detyrë të ndërrojnë taktikë karshi mbrojtjes së PPSH dhe RPSH.

Kaq kisha për këto çështje. Përpiquni, me taktin që nuk ju mungon, t'ua shfaqni shokëve kinezë këto mendime, që për ju s'janë të reja.

Ju përqafoj

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA

13 qershor 1962

Nuk dimë më shumë nga ju se ç'u fol, e ç'u vendos në mbledhjet e Moskës[1], përpiquni të mësoni. Ju keni marrë vesh për komunikatat[2] tona qeveritare për të dy llojet e mbledhjes. Ne, natyrisht, do të presim përfundimin e bisedimeve aty; por kini parasysh eventualitetin shumë probabël, që me hapjen e Kuvendit Popullor, ne do të flasim për prishjen e marrëdhënieve diplomatike, ekonomike, politike, ideologjike (këto të fundit shkurt), për mbledhjet e fundit të Moskës, atë të Këshillit Ekonomik e të Traktatit të Varshavës. Pra, pushimi merr fund dhe këtë e bëjmë pse Hrushovi s'mori asnjë iniciativë, përkundrazi, ai i hodhi edhe ca kyçe të tjera portës dhe me mbledhjet që bëri, e theksoi akoma më shumë dhe

1. Është fjala për mbledhjen e Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke, të 6 qershorit 1962, dhe mbledhjen e Komisionit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, të 7 qershorit 1962, në Moskë, që u zhvillua pa pjesëmarrjen e RPSH. Në këto mbledhje u shqyrtua problemi gjerman dhe ai i Berlinit Perëndimor.

2. Shih gazetën «Zëri i popullit» datë 9 qershor 1962 dhe 13 qershor 1962.

hapur armiqësinë kundër PPSH dhe RPSH. Në këto kondita ne e bëmë detyrën, më tej nuk ecet. Ju u thoni kinezëve që të mos habiten dhe të mos kenë iluzione të kota.

Një çështje tjetër që ju duhet të vëzhgoni me kujdes gjatë bisedimeve është nëse këto bisedime do të mbajnë karakter sekret apo shokët kinezë lënë të kuptojnë se mund të lëshohet ndonjë komunikatë. Lëshimi i një komunikate, ku të thuhet se jemi plotësisht dakord me njëri-tjetrin në çdo çështje, është një angazhim i madh për ta dhe një grusht kundër revizionizmit modern në këto momente, është një aprovim nga ana e kinezëve i vijës, taktikës dhe i strategjisë së Partisë sonë. Ky do të jetë një sukses, prandaj në qoftë se ata e hedhin një mendim të tillë, ju e hapni. Në rast se ata, dhe kjo ka mundësi më shumë, nuk e hapin këtë defter, hapeni ju në njëfarë mënyre, në fund të bisedimeve, por pa krijuar përshtypjen sikur ne insistojmë. Por po të arrihet, ne mendojmë se do të jetë një sukses, pavarësisht se, në ndonjë çështje taktike, ne mund të mos jemi të një mendimi.

Ju përqafoj

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA

16 qershor 1962

Morëm radiogramin e fundit. Çdo gjë e qartë dhe e parashikuar.

Kur të bëni konkluzionet ju mos lëvizni nga pozitat. Bëni një përmbledhje të unitetit të pikëpamjeve të të dyja partive tona në çështjet me rëndësi parimore të problemeve politike dhe ideologjike. Të dyja partitë kanë pikëpamje të njëjta mbi rrezikshmërinë e madhe të revizionizmit modern, të grupit revizionist tradhtar të N. Hrushovit dhe pasuesve të tij etj., dhe janë të vendosura t'i luftojnë këta deri në fund. Pasi të theksoni këto, u thoni kinezëve që ju do të raportoni në udhëheqje për të gjitha.

Kur ata thonë se mbledhja është ndërkombëtare dhe s'mund të vihen kondita, ju theksoni, përveç të tjerave, edhe kundërargumentin, se ne nuk i vëmë kondita mbledhjes, por i vëmë kon

dita Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, domethënë grupit të Nikita Hrushovit, sepse, sipas vendimeve të marra bashkërisht në konferencë, janë ata që e kanë të drejtën e thirrjes së mbledhjes, dhe ata e thërresin në fakt, pavarësisht se disa parti të mesme e kërkojnë. Pra, ne kemi arsye t'i vëmë kondita atij që ka të drejtën të thërresë mbledhjen dhe që ka shkelur ligjet. Pasi të vihet në rrugë të drejtë kjo, atëherë mund të bëhet mbledhja, me kushte të barabarta. Ndryshe s'jemi në kushte të barabarta. N. Hrushovi që po bën krime, hiqet si prokuror, dhe ne që jemi në rrugë të drejtë, thirremi në bankën e të akuzuarve. Prandaj ne nuk lëvizim nga pozitat tona të drejta revolucionare.

Më në fund edhe ju thoni, meqenëse në këtë çështje s'jemi të një mendimi, se Kina nuk është në pozitat tona karshi mbledhjes dhe ajo mund të vejë e të luftojë brenda në mbledhje, ne do të luftojmë nga jashtë. Sa për atë që do të thonë Hrushovi dhe pasuesit e tij, se Shqipëria e ka vënë veten jashtë lëvizjes komuniste ndërkombëtare etj., këtë gjë ata e kanë bërë dhe po e bëjnë me kohë dhe me të madhe, ata kanë arritur të na quajnë edhe agjentë të imperializmit. Por kjo s'do të ketë jetë të gjatë. Ne do të qëndrojmë si kurdoherë në pozita të patundura të marksizëm-leninizmit dhe shpejt apo vonë lëvizja komuniste botërore do të gjykojë se kishte të drejtë Partia jonë.

Pavarësisht se bisedimet aty do të përfundoj-

në jo me akord për këtë çështje, kini parasysh që çdo gjë të shkojë në mënyrë miqësore. Ftoni, gjithashtu, edhe delegacionin e tyre, pa përcaktuar data.

Përqafime

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA

19 qershor 1962

Kini parasysh vijën e përgjithshme që zhvillon revizionizmi modern për përçarjen e marksizëm-leninizmit.

Kinezët na pyesin çdo herë kur ftohen për mbledhje të ndryshme nga revizionistët sovjetikë, nëse na kanë ftuar edhe ne dhe nëse do të vemi ne. Mirëpo ata duhet të kuptojnë se revizionistët tashmë e kanë bërë vijë që jo vetëm të mos na thërresin ne e të thërresin jugosllavët, por edhe të krijojnë një vijë ose taktikë të tillë që «ne thërresim kë të duam; po ju thirrëm, në daç ejani, në daç mos ejani». Këtë taktikë ata kanë vendosur ta ndërrojnë në strategji.

Prandaj për marksistët çështja nuk shtrohet «të vemi ose jo në mbledhje, po qe se vete ose nuk vete Shqipëria». Çështja duhet të shtrohet të organizojmë luftën kundër një taktike të tillë armiqësore, likuidatore.

Tash në të gjitha manifestimet që bëjnë, hrushovianët thërresin kurdoherë titistët. Kjo po bëhet vijë, që do të shkojë duke u forcuar, derisa të duket një gjë e zakonshme. Krahas Jugoslla-

visë, ngjisin edhe Kubën, që të japin përshtypjen se kampi i socializmit përbëhet jo nga 12, por nga 15 vende, nesër hyn dhe Naseri e më vonë edhe Sukarnoja e të tjerë. «Natyrisht, — thonë revizionistët, — kemi disa mosmarrëveshje ideologjike, por në vijën kryesore jemi dakord». Dhe në fakt janë dakord.

Prandaj për marksistë-leninistët detyrë urgjente është mbrojtja me të tëra forcat e parimeve të marksizëm-leninizmit dhe këto t'i mbështetim me fakte, të mbrojmë unitetin e vërtetë marksist-leninist, duke luftuar pa mëshirë revizionizmin. Të mos bëhet pozë për demaskimin e Titos, dhe të pritet të vemi në mbledhje se mos i mbetet qejfi Hrushovit.

A do t'i lërë propaganda jonë partitë komuniste të Lindjes së Afërt të notojnë në pellgjet e Hrushovit e të Titos, apo për arsye të «bashkekzistencës», nuk u dashka të propagandojmë rrugën e vërtetë të socializmit, dhe as të demaskojmë gjithë këtë llum që po ngrihet?!

Një sëmundje e tillë në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar për hir të konsideratave të përcipta. Ose me masat, ose me krerët. Tash e kanë fuqinë krerët, jo masat. Me krerët të zbatojmë drejt parimet leniniste të bashkekzistencës, por jo parimet hrushoviane të bashkekzistencës.

Sigurisht problemet e taktikës me njërin ose me tjetrin, në situata të veçanta janë të shumëllojshme, diku të lehta, diku të koklavitura, diku me rezultate, diku me disfata, por parimet duhen

mbrojtur e duhen ruajtur si sytë e ballit, duhet luftuar për to dhe kjo luftë duhet bërë në mënyrë të organizuar. Forcat tona e të komunizmit ndërkombëtar janë më të forta, kjo s'ka dyshim, por në gjumë nuk duhet të vihemi dhe të mos mendojmë se armiqtë rrinë duarlidhur. Atyre s'duhet t'u lëmë iniciativë. Ajo duhet të mbetet në dorën tonë. Por, ama, që shqetësimi dhe taktika jonë të përmblidhen vetëm në çështjen «të vemi apo jo në mbledhje», kjo s'është aspak e drejtë, aspak realiste. Armiqtë punojnë në ethe në të gjitha fushat, në atë politike, ekonomike, ideologjike, ushtarake, kurse shokët kinezë hezitojnë të shkruajnë një artikull në mbrojtje të Shqipërisë, si për shembull me rastin e fitores sonë në zgjedhjet, ose të sulmojnë titistët që na dhanë armë vetë me duart e tyre.

Këto ju i dini dhe i keni parasysh, por në rast se i gjeni volinë, i shprehni si mendime tonat, natyrisht pa bërë asnjë aluzion. Interesant për ne është të kuptojmë edhe një çikë më thellë taktikën dhe strategjinë e kinezëve sepse duke thënë se «do të duhet një kohë e gjatë», kjo s'na thotë shumë gjëra.

Ju përqafoj

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA

20 qershor 1962

Radiogramin e fundit e morëm. Siç duket bisedimet në nivelin e lartë do të fillojnë më vonë, megjithëse Maoja s'flet shumë. Por çështja është se gjatë kësaj kohe që ju do të bëni vizita, udhëheqja kineze do t'i studiojë me kujdes tezat tona...

Tash që këto çështje u shtruan, neve do të na interesonte shumë që ju të bisedoni edhe për disa probleme të tjera ndër të cilat:

— Duam të informohemi mbi gjendjen në vendet e demokracisë popullore dhe në partitë e tyre, veçanërisht ç'ngjet në Bashkimin Sovjetik dhe në partinë sovjetike, pse ne, siç jeni në dijeni, s'dimë asgjë. Nga radiogramet që marrim prej jush, informatat që ju japin janë shumë të përgjithshme.

— Në Kongresin e Paqes, sikurse ju kanë

thënë kinezët, do të vejë edhe Mao Ce Duni, dhe siç kuptojmë, ata nuk i kanë vënë rëndësi të madhe kësaj çështjeje. Mirëpo duhet të pyesni nëse kinezët do të luftojnë atje, apo do të lidhin duart, siç bënë në atë mbledhjen e grave që na raportoi Vitoja, ju kujtohet? Në rast se nuk i vënë rëndësi, do të thotë të mos luftojnë për pikëpamjet e drejta tonat, gjë që s'është tjetër veçse një tërheqje dhe një deziluzion për ata që presin nga shokët kinezë. Kinezët mund të mos i vënë rëndësi kongresit, ta zëmë, por të tjerët i vënë, bëjnë punën e tyre, dhe janë të kënaqur që ata heshtin dhe pranojnë në heshtje veprimet e tyre.

Në qoftë se miqtë i vënë shumë rëndësi mbledhjes së Moskës, pse atje, siç thonë ata, do të demaskojnë revizionistët, është e pakuptueshme dhe jo konsekuente nga ana e tyre, të mos i vënë rëndësi Kongresit të Paqes, ku mund të luftohet dhe do të luftohet kundër tezave kryesore të revizionizmit modern. Në rast se kinezët nuk do të luftojnë gjallërisht në këtë kongres, atëherë kur dhe si do të luftojnë? Do të jetë e pakuptueshme në rast se ngjet kështu. Kësaj i thonë të mos prishim «qetësinë», të mos prishim «paqen» oportuniste. Në rast se shokët kinezë kanë vendosur që atje të luftojnë, duhej që për këtë çështje të bisedonin hollësisht me ju, të koordinonim punën, të shkëmbenim mendimet, të sqaronim taktikat dhe vijën e përgjithshme. Sipas radiogramit tuaj, ata në të kaluar ju kanë thënë dy fjalë sa për informim. Prandaj ju pyes-

ni, si do të bëhet në kongres, çfarë tezash do të shtrojnë ata, ç'parashikime kanë etj.

Qëndrimin tonë ju e dini, ne do t'i themi ato që mendojmë edhe sikur të mbetemi vetëm, por vetëm s'duhet të mbetemi. Prandaj edhe i pyesni, edhe i stimuloni dhe na lajmëroni për këtë çështje.

Ju përqafoj

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR PROFESOR DOKTOR MAKSIMILIAN LAMBERCIT[1]

18 korrik 1962

Zoti profesor doktor,

Me rastin e 80-vjetorit të ditëlindjes suaj, më lejoni t'ju dërgoj urimet më të mira dhe përshëndetjet më të përzemërta në emrin tim personal, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar! Në personin tuaj vendi ynë ka pasur gjithmonë një mik të vyer, që ia ka kushtuar një pjesë të mirë të jetës së tij miqësisë midis dy popujve tanë vëllezër. Për këtë ne ju jemi dhe do t'ju jemi kurdoherë shumë mirënjohës. Urojmë që të gëzoni gjithmonë shëndet të mirë dhe të keni jetë sa më të gjatë për lumturinë tuaj familjare, për vazhdimin e mëtejshëm

1. Prof. dr. Maksimilian Lamberc (1882-1963) — një ndër albanologët e shquar që ka dhënë një kontribut të çmuar për gjuhën shqipe.

të punës suaj fisnike shkencore, për forcimin e miqësisë midis popujve tanë! Urojmë, gjithashtu, që së shpejti, me rastin e festës sonë kombëtare, 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, t'ju kemi midis nesh!

I transmetoni, i dashur mik, përshëndetjet tona të përzemërta dhe zonjës suaj të nderuar, Josefa.

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 23, f. 369

TELEGRAM DËRGUAR KOLEKTIVIT PUNONJËS TË HIDROCENTRALIT TË BISTRICËS

10 tetor 1963

Lajmi që më dërguat mbi përfundimin e hapjes së tunelit të Hidrocentralit të Bistricës më gëzoi pa masë; ai do të gëzojë të gjithë Partinë e popullin tonë. Ju kryet një punë të zorshme, ju kapërcyet shumë pengesa të natyrës, por, nën udhëheqjen e Partisë, ju punuat në mënyrë heroike për t'i dhënë sa më parë atdheut një nga veprat më të rëndësishme të planit të tretë pesëvjeçar. Kjo është edhe një provë e shkëlqyer që vërteton rritjen e kuadrove tanë teknikë, të cilët janë në gjendje të zgjidhin me sukses detyrat më të vështira.

Patriotizmi, vetëmohimi, aftësitë dhe fitorja e re e punëtorëve, teknikëve dhe e inxhinierëve të Hidrocentralit të Bistricës dëshmojnë për njeriun e ri që po kalit Partia e Punës, dëshmojnë

për drejtësinë e vijës së përgjithshme të saj marksiste-leniniste.

Ju përgëzoj për këtë fitore të madhe dhe uroj që në të ardhmen të arrini fitore të tjera për atdheun tonë socialist.

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 243 (4713), 11 tetor 1963

LETËR DREJTUAR BARINË LËKLERIT

Eno — Belgjikë

29 shtator 1964

Mirëdita, mikeshë e vogël,

Mora letrën tuaj dhe me kënaqësi po ju plotësoj dëshirën, duke ju dërguar një kukull folklorike shqiptare.

Puna që bëni ju duke mbledhur kukulla të tilla, është e dobishme, sepse edukon te njeriu ndjenjën fisnike të dashurisë për popujt. Prandaj ju uroj sukses.

Uroj, gjithashtu, që të rriteni vajzë e mbarë, të mësoni sa më mirë në shkollë e në jetë, në mënyrë që të bëheni sa më e denjë për popullin e atdheun tuaj. Ju uroj lumturi.

Përshëndetje prindërve, shokëve e shoqeve tuaja.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËRSHËNDETJE DREJTUAR EFEKTIVIT TË POLICISË POPULLORE

14 maj 1965

Të dashur shokë të Policisë Popullore,

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të gjithë komunistëve, të popullit tonë dhe në emrin tim personal, ju përshëndes nga zemra me rastin e festës suaj jubilare, 20-vjetorit të krijimit të Armës së Policisë Popullore dhe ju përgëzoj për sukseset që keni arritur në punë, si edhe për kontributin që keni dhënë në forcimin dhe në konsolidimin e rendit tonë socialist.

Policia jonë Popullore, pjesë e forcave tona të lavdishme të armatosura, e krijuar nga Partia dhe Qeveria për t'u shërbyer interesave të popullit, i ka kryer dhe po i kryen me nder dhe me devotshmëri detyrat shumë të rëndësishme që i janë ngarkuar. Shumë nga kuadrot e Policisë Popullore janë vënë në shërbim të atdheut dhe të po-

pullit qysh gjatë Luftës heroike Nacionalçlirimtare, duke luftuar me armë në dorë kundër pushtuesve dhe tradhtarëve të vendit. Të tjerë më të rinj, së bashku me shokët e tyre të luftës, kanë kryer dhe po e kryejnë me nder detyrën që u është ngarkuar gjatë këtyre 20 vjetëve.

Efektivi i Policisë sonë Popullore përbëhet, pra, nga bij besnikë të popullit shqiptar, patriotë të flaktë, trima, të ndërgjegjshëm, të ndershëm, të thjeshtë e të dashur, të lidhur ngushtë me masat, me zemër e shpirt të pastër e që janë të gatshëm në çdo moment të japin edhe gjënë më të shtrenjtë, jetën e tyre, për interesat e popullit dhe të atdheut. Ja përse efektivi i Policisë sonë Popullore gëzon dashurinë dhe besimin e gjithë masave tona punonjëse. Qëndrimi dhe puna juaj e përditshme, të mbështetura në ligjet e republikës, në porositë dhe në vendimet e Partisë dhe të Qeverisë, çmohen nga i madh e i vogël, nga gjithë qytetarët në vendin tonë, të cilët shikojnë te ju shokun, birin e vëllanë e tyre.

Mbrojtja dhe zbatimi i ligjeve ka qenë dhe është detyrë e shenjtë kryesore e Policisë sonë Popullore qysh nga dita e krijimit të saj. Ju kurdoherë keni qenë në nivelin e detyrës për ruajtjen e rendit tonë juridik nga kushdo që kërkon ta cenojë sadopak atë.

Në kushtet e rrethimit kapitalist dhe revizionist, populli ynë, i udhëhequr me urtësi nga Partia jonë heroike e Punës, me vrull dhe entuziazëm po ndërton me sukses socializmin. Vendi ynë po

zbukurohet e po forcohet çdo ditë e më tepër. Në arritjen e sukseseve të mëdha historike të popullit shqiptar në përgjithësi e veçanërisht në forcimin e pushtetit tonë popullor dhe në zbatimin e ligjshmërisë sonë socialiste, policia jonë ka dhënë kontributin e saj të vlefshëm. Duke bërë sot bilancin e veprimtarisë suaj 20-vjeçare, ju, shokë, keni përse të krenoheni, sepse së bashku me gjithë popullin edhe ju keni kontribuar në ndërtimin e Shqipërisë sonë të shtrenjtë socialiste, që qëndron e do të qëndrojë e pamposhtur në shekuj.

Populli ynë e ka të qartë perspektivën. Duke ndjekur me vendosmëri mësimet e Partisë së Punës dhe në unitet të pathyeshëm me të, ai do të realizojë suksese të reja edhe më të mëdha në të ardhmen. Po ne jemi të ndërgjegjshëm se ngjitja jonë e pandërprerë, shokë, drejt objektivave më të lartë nuk do të jetë e lehtë, pa pengesa e pa vështirësi, përderisa në botë do të ekzistojnë imperializmi, revizionizmi dhe armiqtë e tjerë.

Imperialistët amerikanë, satelitët e tyre, ashtu si dhe tradhtarët e marksizëm-leninizmit, revizionistët modernë hrushovianë dhe titistë, ushqejnë një armiqësi të madhe ndaj Partisë së Punës, Republikës sonë Popullore, popullit dhe atdheut tonë. Ata, ashtu si deri tani, do të përpiqen të shfrytëzojnë çdo rast e mundësi për qëllime armiqësore dhe do të aktivizojnë çdo mbeturinë të shoqërisë sonë për të realizuar qëllimet e tyre djallëzore.

Ju takon edhe juve, shokë të policisë, që pla-

neve kriminale të armiqve të popullit, kur është rasti, në bashkëpunim të ngushtë me popullin dhe me organet e tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme t'u prisni, ashtu si gjithmonë, rrugën, t'i zbuloni me kohë e t'i goditni me ashpërsinë e duhur, duke bërë drejt diferencimin midis elementëve të ndërgjegjshëm dhe atyre që kanë gabuar. Puna edukative që ju duhet të bëni me njerëzit duhet të jetë e vazhdueshme. Rëndësi të madhe dhe kryesore ka, gjithashtu, që puna juaj të arrijë që çdo krim eventual ta zbuloni në tentativë, pa u kryer akoma, sepse në këtë mënyrë do të evitonit çdo dëm që mund t'u bëhej interesave të atdheut dhe do t'i sillni kështu një shërbim akoma më të vyer çështjes për të cilën ju kanë ngarkuar Partia dhe Qeveria.

Shërbimet tuaja janë shumë të gjera e komplekse, të lidhura ngushtë me tërë jetën e popullit e zhvillimin e pandërprerë të atdheut tonë socialist. Prandaj, ashtu si deri tani, edhe në të ardhmen prej jush kërkohen njohuri të përgjithshme e kulturë profesionale në nivel të lartë, për të cilat jo vetëm që duhet të bëni të gjitha përpjekjet t'i përvetësoni, por edhe t'i vini në zbatim. Kërkohet që ju t'i forconi gjithnjë e më shumë lidhjet me masat punonjëse, të përmirësoni vazhdimisht e më shumë qëndrimet dhe sjelljen me to, si gjatë shërbimit, ashtu edhe jashtë tij.

Komiteti Qendror i Partisë dhe unë personalisht kemi besim të plotë se organet e repar-

tet e Policisë sonë Popullore, të udhëhequra si kurdoherë nga Partia, ashtu si deri tani edhe në të ardhmen do të punojnë me të gjitha forcat që shërbimi dhe niveli i kryerjes së detyrave nga ana juaj të ngrihen në një shkallë edhe më të lartë.

Duke shfrytëzuar këtë rast, ju uroj, të dashur shokë, gëzuar 20-vjetorin e festës suaj dhe suksese kurdoherë më të mëdha në realizimin e detyrave shumë të rëndësishme që ju janë ngarkuar!

Enver Hoxha

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

«Gjithmonë vigjilencë» (Për Organet e Punëve të Brendshme), vëll. i 2-të, f. 90

LETËR DREJTUAR TRAKTORISTIT SHYQYRI KANAPARI

25 qershor 1965

Shoku Shyqyri,

Lexova me gëzim telegramin tuaj me anën e të cilit më njoftonit se ju, duke marrë pjesë në emulacionin socialist për zgjatjen e jetës së traktorit, arritët të kryeni me traktorin DT-54 mbi 20 000 hektarë unitet hamullor. Ky është një sukses i rëndësishëm që do të gëzojë të gjithë punonjësit e bujqësisë, në radhë të parë, dhe do të përshëndetet si një fitore e re në frontin e prodhimit.

Më lejoni, me këtë rast, t'ju përgëzoj me gjithë zemër për punën tuaj të palodhur dhe rezultatet që keni arritur, për përpjekjet tuaja të mëdha për ta mirëmbajtur dhe për t'i zgjatur jetën traktorit. Shembulli juaj në punë është shprehje e patriotizmit të flaktë dhe e vendosmërisë

së punonjësve të pararojës për të realizuar me sukses planin e vitit të fundit të pesëvjeçarit të tretë, duke vënë kështu në jetë detyrat historike të caktuara nga Kongresi i 4-t i Partisë.

Jam i bindur se ju edhe paskëtaj do të vini të gjitha forcat për t'i thelluar edhe më tepër sukseset në detyrat që ju janë ngarkuar dhe do të qëndroni si kurdoherë në pararojë dhe shembull i lartë frymëzimi për të gjithë fshatarësinë tonë në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë për punonjësit e SMT-ve.

Ju uroj shëndet dhe suksese të mëtejshme në punën tuaj!

Enver Hoxha

«Për bujqësinë socialiste» (Përmbledhje veprash), vëll. II, f. 493

LETËR DREJTUAR NXËNËSVE TË INSTITUTIT TË FËMIJËVE TË VERBËR E SHURDHMEMECË

Tiranë

18 janar 1967

Të dashur nxënës e nxënëse,

Ju falemnderit shumë për urimet që më dërguat me rastin e Vitit të Ri. Edhe unë, gjithashtu, ju uroj me gjithë zemër ta kaloni të gëzuar vitin 1967, me shëndet dhe suksese sa më të mira në mësime.

Në letrën që më dërguat ju keni shumë të drejtë për fjalët aq të mira që shprehni për Partinë, mëmën tonë më të dhemshur e më të dashur që udhëhoqi popullin në luftën e lavdishme të çlirimit dhe sot e udhëheq atë me sukses në ndërtimin e jetës së re socialiste dhe në ruajtjen e fitoreve të arritura.

Me porosinë dhe kujdesin e Partisë është hapur edhe instituti ku ndodheni, me qëllim që jo vetëm t'ju lehtësohen fatkeqësitë trupore, por edhe të mësoni e të edukoheni për t'u bërë qytetarë aktivë, të aftë për vete dhe të dobishëm për atdheun. Letra juaj është një dëshmi e qartë e dëshirës së zjarrtë dhe e aftësive tuaja për të mësuar dhe për të punuar.

Të jeni të bindur, të dashur nxënës e nxënëse, se kujdesin prej mëme të Partisë, dorën e saj bujare, ashtu si tani në institut, ju do ta ndieni kurdoherë pranë edhe kur të rriteni dhe kam besim se, duke zbatuar porositë e saj dhe këshillat e mësuesve tuaj, ju do të përgatiteni për jetën si njerëz me vullnet të fortë, jo vetëm për të përballuar vështirësitë fizike, por me mendjen dhe punën tuaj në të ardhmen, të ndihmoni edhe për ndërtimin e lulëzimin e atdheut tonë socialist.

Ju uroj edhe një herë shëndet, gëzime në jetë dhe suksese në mësime.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËRSHËNDETJE DREJTUAR NXËNËSVE DHE MËSUESVE TË POLITEKNIKUMIT «7 NËNTORI»

23 janar 1967

Të dashura shoqe dhe shokë,

Me rastin e festës së 20-vjetorit të riorganizimit të shkollës suaj, në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe timin, më lejoni t'ju dërgoj përshëndetjet më të nxehta revolucionare juve, nxënësve dhe mësuesve, për punën e madhe dhe për kontributin e çmuar që keni dhënë gjatë gjithë kësaj periudhe për ndërtimin socialist të atdheut. Nga bankat e shkollës suaj kanë dalë me qindra kuadro të industrisë, minierave e të sektorëve të tjerë, besnikë ndaj interesave të socializmit e të revolucionit, të cilët i kanë nderuar shkollën e atdheun.

Revolucioni ynë ecën vazhdimisht përpara me vrull të pandalshëm. Në të katër anët e vendit kanë shpërthyer lëvizje e iniciativa të shumta përparimtare të masave punonjëse për të vënë në jetë detyrat historike të Kongresit të 5-të të Partisë, të cilat i kanë hapur perspektiva të shkëlqye-

ra gjithë jetës së vendit, zhvillimit të ekonomisë, kulturës e shkencës. Gjithçka në vendin tonë po ndryshon me ritëm të shpejtë. Si në çdo fushë të jetës te ne, edhe arsimi, kultura, shkenca, teknika dhe eksperimentimi shkencor po marrin një zhvillim gjithnjë më të madh e më masiv, prodhimi rritet, jeta përmirësohet vazhdimisht, po revolucionarizohet mendja e njerëzve tanë të mrekullueshëm. Të gjitha këto suksese e kanë burimin te sistemi ynë shoqëror, tek iniciativa, vrulli e ndërgjegjja e lartë socialiste e masave, të udhëhequra nga Partia jonë e dashur.

Kongresi i 5-të i Partisë, krahas zhvillimit të ekonomisë, shtroi detyra me rëndësi historike edhe për zhvillimin e revolucionarizimin e mëtejshëm të arsimit, të shkollës, të cilën e pret një e ardhme e shkëlqyer. Partia i shtron sot shkollës me forcë detyrën e lidhjes së ngushtë të mësimit me jetën, të teorisë me praktikën, me përpjekjet për ndërtimin e socializmit. Për realizimin e kësaj detyre që caktoi Kongresi i 5-të, një rëndësi të veçantë ka zhvillimi i atyre hallkave të sistemit tonë arsimor që i japin rinisë mundësi për një përgatitje të drejtpërdrejtë për jetën dhe për punën, ashtu siç bën edhe shkolla juaj.

Gjatë gjithë periudhës pas Çlirimit Partia ka bërë një punë të madhe për krijimin dhe zgjerimin e vazhdueshëm të rrjetit të shkollave teknike e profesionale, të ulëta dhe të mesme, duke përgatitur në to me qindra mijë punëtorë të kualifikuar, teknikë e specialistë. Në të ardhmen

këto shkolla do të zgjerohen e do të zhvillohen edhe më shumë, në përshtatje me nevojat e ekonomisë dhe të të gjithë sektorëve të jetës së vendit, si dhe me kërkesat e vetë popullsisë dhe të rinisë.

Partia dhe Qeveria kanë marrë masa të rëndësishme për një pjesëmarrje më të gjerë të rinisë shkollore në punën prodhuese dhe fizike. Rinia jonë shkollore, e së bashku me të të gjithë kuadrot tanë arsimorë pedagogjikë, po i kuptojnë gjithnjë më thellë këto masa të rëndësishme revolucionare, prandaj janë hedhur në aksione konkrete, duke luftuar kështu çdo koncept e qëndrim jo të drejtë ndaj punës fizike, ndaj punës në prodhim.

Detyra të mëdha të rëndësishme ka në këto momente organizata e rinisë e shkollës suaj, për të mobilizuar masat e rinisë që të mësojnë me vullnet e këmbëngulje, të pajisen me dijeni të thella shkencore-teknike, me teori e praktikë, në mënyrë që, kur të mbarojnë mësimet, të jenë të zotët jo vetëm për të vënë në lëvizje makinat që do t'u besojnë populli dhe pushteti, por edhe t'i perfeksionojnë ato më tej, të shpikin të tjera më të mira, që të lehtësojnë punën e njeriut, të shtojnë prodhimin dhe ta bëjnë atë më të lirë.

Por nga shkolla ne nuk kërkojmë vetëm njerëz të aftë, me njohuri shkencore e përgatitje profesionale. Në radhë të parë Partia dhe populli kërkojnë prej saj njerëz të brumosur me pikëpamje komuniste, të kalitur politikisht, ideologjikisht dhe fizikisht, të gatshëm për çdo punë dhe

sakrificë, plotësisht të ndërgjegjshëm për t'i shërbyer popullit dhe çështjes së madhe të socializmit me të gjitha forcat e në çdo skaj të atdheut, ku do të jetë nevoja.

Sa rreziqe të mëdha e vështirësi të shumta kanë kaluar populli dhe Partia jonë gjatë këtyre 25-26 vjetëve! Ata kanë zhvilluar një luftë heroike, si kundër armiqve të brendshëm e pushtuesve fashistë ashtu edhe më vonë kundër imperializmit, me SHBA-në në krye, dhe kundër revizionizmit titist e hrushovian. Por të gjitha këto rreziqe e vështirësi janë kapërcyer me sukses. Liria, pavarësia e sovraniteti i atdheut, revolucioni u fituan dhe po mbrohen me sukses në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë dhe patriotizmit të zjarrtë revolucionar të të gjithë popullit, e veçanërisht të rinisë sonë heroike. Shkolla dhe organizata e rinisë duhet ta edukojnë vazhdimisht rininë tonë me traditat e shkëlqyera luftarake të të parëve tanë, me frymën klasore revolucionare, me virtytet më të mira të moralit proletar, me shpirtin e guximit e të devotshmërisë për çështjen e atdheut e të revolucionit. Organizata e rinisë dhe shkolla jonë duhet ta ushqejnë, ta kalitin e ta brumosin çdo ditë brezin e ri me idetë e marksizëm-leninizmit, me vijën e drejtë të Partisë sonë, me eksperiencën e saj të madhe revolucionare, për të bërë që çdo i ri dhe e re të mendojë, të punojë e të jetojë kurdoherë si revolucionar i vërtetë. Ata duhet ta hedhin rininë më aktivisht në aksionet e mëdha të punës prodhuese dhe ato

politike, ta bëjnë gjithnjë e më shumë luftëtare të papajtueshme me çdo shfaqje të ideologjisë e koncepteve borgjeze e revizioniste, ta kalitin fizikisht e ushtarakisht, ta bëjnë që të jetë gjithmonë vigjilente, aktive e të gatshme në çdo kohë për mbrojtjen dhe konsolidimin e fitoreve të revolucionit socialist kundër çdo armiku.

Të dashur nxënës dhe mësues,

Mbani gjithnjë lart e çoni përpara traditat revolucionare të shkollës suaj, luftoni më me guxim për të vënë në jetë detyrat historike të Kongresit të 5-të të Partisë sonë, për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, duke mbajtur kurdoherë lart flamurin e kuq të Partisë, emrin e lavdishëm të Revolucionit të Madh të Tetorit që mban shkolla juaj, revolucion që shënoi një kthesë vendimtare në historinë e njerëzimit, përgatitni kuadro të denjë për ndërtimin socialist të atdheut, ngrini më lart punën për edukimin e gjithanshëm komunist të të gjithë kolektivit.

Nga zemra ju uroj suksese të mëtejshme në punën tuaj të lavdishme. Përshëndetje revolucionare.

Enver Hoxha

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 25 (5750), 29 janar 1967

TELEGRAM DËRGUAR VULLNETARËVE TË BRIGADËS «ADEM REKA»

20 shkurt 1967

Shokë vullnetarë të brigadës së rinisë «Adem Reka»,

Ju uroj fitoret. Të gjithë ju të rinj heroikë të hekurudhës Rrogozhinë—Fier po e gëzoni popullin me punën që po bëni. Ngrini lart e më lart flamurin e Partisë. Emri dhe vepra heroike e Adem Rekës të jetë kurdoherë për ju një flamur i Partisë.

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i rinisë», 22 shkurt 1967

TELEGRAM DËRGUAR GRAVE DHE VAJZAVE TË SHALËS TË LOKALITETIT TË DUKAGJINIT[1]

22 shkurt 1967

Mëma dhe motra të dashura të Shalës të lokalitetit të Dukagjinit,

Patriotizmi, pjekuria politike dhe trimëria juaj na japin forca të reja. Partia, Qeveria dhe gjithë populli janë me ju dhe ndjekin me gëzim luftën tuaj përparimtare.

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 46 (5771), 23 shkurt 1967

1. Në letrën e tyre dërguar shokut Enver Hoxha, 100 plakat që kishin jetuar të kaluarën e zezë dhe 100 vajzat e lindura në pushtetin popullor, i shprehnin gëzimin e madh për perspektivat që po u hapte Partia për një të ardhme më të bukur, përkrah burrave.

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT THOMA PAPAPANO

Gjirokastër

3 mars 1967

Ju uroj nga zemra për titullin e lartë «Mësues i popullit» që ju dha Presidiumi i Kuvendit Popullor për punën e madhe të palodhur që keni bërë gjatë gjithë jetës suaj në shërbim të arsimit popullor dhe edukimit të brezit të ri të atdheut tonë.

Kur të vij në Gjirokastër do t'ju bëj një vizitë dhe t'ju uroj për këtë nder plotësisht të merituar.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR POPULLIT TË KATUNDIT GRESHICË TË MALLAKASTRËS[1]

9 mars 1967

Të shtrenjtë vëllezër të katundit Greshicë të Mallakastrës,

Letra që më dërguat e që më gëzoi pa masë, nuk është një letër, por një flamur, një program i madh revolucionar, program i madh i Partisë, i shprehur me aq zjarr, me aq patriotizëm, me aq vendosmëri shembullore nga populli i Mallakastrës heroike, i asaj Mallakastre shumë të shtrenjtë për të gjithë popullin tonë, që në çdo kohë të historisë së saj ka qenë çerdhja e trimave me fletë, e njerëzve të sakrificës për çështjen e shenjtë të lirisë së popullit. Ju vëllezër dhe motra të Mallakastrës, keni luftuar si ju me Rrapo Hekalin, gjokset tuaja u bënë një nga kështjellat më të fuqishme të Partisë dhe të Luftës Nacionalçlirim-

1. Në përkrahje të iniciativave të pleqve të Lapardha-Moravës, të kuvendit të pleqve të Kukësit, edhe 52 pleqtë e katundit të Greshicës të Mallakastrës në letrën e tyre drejtuar shokut Enver Hoxha, premtonin se do të luftonin kundër zakoneve prapanike dhe mbeturinave fetare, do të vinin në jetë vendimet historike të Kongresit të 5-të dhe gjithë porositë e Partisë dhe të udhëheqësit të saj të dashur.

tare, bijtë dhe bijat tuaja ranë heroikisht në fushat e luftës çlirimtare, ju luftoni me të gjitha forcat tuaja nën flamurin e Partisë për ndërtimin e plotë të socializmit.

Ju thashë se letra juaj është një flamur, pse atje shprehen ndjenjat dhe dëshirat më të pastra e më të zjarrta të popullit e që duhet të zbatohen dhe jam i bindur se ajo do të këndohet me kujdes nga të gjithë dhe të gjithë do të ecin me vrull revolucionar në rrugën e ndritur të Partisë që na frymëzon e na bën të pamposhtur dhe fitimtarë mbi çdo armik.

Ky hov revolucionar, në të cilin po na udhëheq Partia, do t'u sjellë të mira të pallogaritshme atdheut dhe popullit, në ekonomi, në arsim, në kulturë, në mbrojtjen e republikës, do të sjellë fitore të pallogaritshme në kalitjen e njeriut të ri të Shqipërisë socialiste.

Mallakastra si gjithë vendi ynë do të lulëzojë më me shpejtësi. Prandaj, përpara vëllezër dhe motra të dashura, të mos ndalet për asnjë çast lufta jonë, të mbahet kurdoherë ndezur zjarri i madh i revolucionit, të na prijë si kurdoherë në luftëra e në fitore flamuri i kuq i Partisë.

Ju përqafoj

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 59 (5784), 10 mars 1967

TELEGRAM DËRGUAR KOMISIONIT TË FESTËS[1]

Tepelenë

1 korrik 1967

Të dashur shokë,

Ju falënderoj nxehtësisht për ftesën që më dërguat për të marrë pjesë në festën tuaj tradicionale, që përkujton epopenë e lavdishme të luftës masive dhe të heroizmit të madh të të gjithë popullit të rrethit tuaj kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës, të Qeverisë, të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik dhe timin, ju dërgoj përshëndetjet më të përzemërta. E kalofshi gëzuar këtë ditë të shënuar për popullin e rrethit tuaj, popull me tradita të larta patriotike dhe atdhedashurie, që ka larë brez pas brezi me gjakun e bijve e bijave më të mira tokën tonë të shtrenjtë.

---

1. Më 2 korrik 1967 populli i rrethit të Tepelenës festoi 24-vjetorin e goditjes së parë të forcave partizane kundër pushtuesve fashistë.

Populli i rrethit të Tepelenës, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë, gjatë Luftës heroike Nacionalçlirimtare u ngrit i tëri në këmbë dhe, si një trup i vetëm, luftoi me vetëmohim gjer në çlirimin e plotë të atdheut, duke dhënë kështu një kontribut të paçmuar me gjakun e dëshmorëve të rënë për fitoren dhe vendosjen e pushtetit të ri popullor. I paharruar përjetë do të jetë kujtimi i vajzave dhe i djemve trima të Tepelenës për çështjen e madhe të popullit dhe të Partisë. Theroritë e atyre që dhanë jetën për këto ditë të bukura lufte e pune revolucionare që po jetojmë, frymëzojnë gjithë popullin shqiptar për ta mbajtur kurdoherë lart e më lart me nder flamurin e lirisë dhe të pavarësisë që na i lanë trashëgim të parët tanë, për ta ngritur kurdoherë më lart flamurin e kuq të Partisë për ndërtimin e socializmit në Shqipëri.

Populli me shpirt të paepur luftarak dhe punëdashës, minatorët e Memaliajt, punëtorët e qytetit dhe fshatarët patriotë të të gjithë rrethit tuaj, ashtu si në luftë, edhe pas Çlirimit të atdheut kanë punuar pa u lodhur edhe për zbatimin e detyrave të Partisë për ndërtimin e atdheut, për zhvillimin e pandërprerë të revolucionit tonë proletar. Ja, sot në festën tuaj, bashkë me gëzimin, po bëni edhe bilancin e sukseseve dhe po caktoni detyra të reja, akoma më të mëdha, jo vetëm për realizimin, por edhe për tejkalimin e detyrave që i ngarkoi Kongresi i 5-të i Partisë rrethit tuaj.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria kanë besim të patundur në vendosmërinë dhe në patriotizmin tuaj që brenda një kohe të shkurtër ta ktheni rrethin tuaj malor në një rreth ku të lulëzojnë kooperativat bujqësore, ku të shtohet bollëku i prodhimeve bujqësore e blegtorale, të zhvillohen arsimi dhe kultura jonë socialiste dhe të shkulet nga rrënjët çdo gjë e vjetër që na lanë pushtuesit e huaj e klasat e përmbysura. Forconi dhe mbani si kurdoherë lart vigjilencën revolucionare, frymën e lartë të partishmërisë proletare dhe gatishmërinë luftarake që atdheu ynë i shtrenjtë socialist dhe populli ynë, si kurdoherë, të qëndrojnë ballëlart dhe të paepur si malet tona shekullore, që Shqipëria të mos e ndryshojë kurrë ngjyrën e vet revolucionare klasore, por të mbetet për jetë të jetëve një kështjellë e pamposhtur e socializmit dhe e komunizmit në brigjet e Adriatikut.

Ju uroj me këtë rast, të dashur shoqe e shokë, suksese gjithnjë më të mëdha në punë dhe lumturi, që jeta juaj të bëhet gjithnjë më e mirë, ashtu siç na e do zemra jonë.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 159 (5884), 4 korrik 1967

LETËR DREJTUAR DJALIT, SOKOLIT

Durrës, 13 korrik 1967

I dashuri im Toli,

Të përqafojmë dhe të puthim me mall që të gjithë, pse të gjithë më kanë vënë mua të të shkruaj, më thonë se gjoja unë u hedh kripë letrave.

Unë u them, «nuk e ka shumë qejf kripën, por piperin do Sokoli», megjithatë mamaja zgjodhi sheqerin, dhe besoj se ajo që po të dërgon me Çelon, do të të pëlqejë më shumë. S'ke ç'i thua Toli, kësaj pune. Mamaja të do shumë, prandaj edhe ti duhet ta duash shumë mamanë, se e kemi shumë të mirë. Atë e ka marrë shumë malli për ty, por edhe Pranverën; kurse ne burrat nuk e tregojmë kollaj, por megjithatë ti e merr me mend vetë.

Gëzohemi që punon mirë dhe që kompania juaj tejkalon planin, që është shpallur sulmuese

dhe që shpresohet që në gjoksin e Sokolit të bjerë gjithashtu për së shpejti **një «S» dhe jo një eshkë,** megjithëse ti je **shpuzë** (s'm'u durua pa i hedhur pak piper gjellës, por ti mos ma merr për keq, unë e di që ty të pëlqen humori).

Vazhdo, biri im, të punosh me të gjitha forcat për popullin dhe për Partinë, kurrë të mos lodhesh, kurrë të mos bësh uf, në ballë të luftës, në ballë të sakrificës, ashtu i thjeshtë, i guximshëm, kurdoherë i qeshur siç je. Lidhu ngushtë me shokët, me kolektivin, kurrë mos u izolo nga shokët. Gëzohem kur më flasin mirë për ty.

Po afron dita e mbarimit të detyrës. Atëherë do të gëzohemi kur të na vish i nxirë nga dielli, i shpëlarë nga shiu që ka rënë kaq shumë dhe që ka bërë kaq mirë për bujqësinë.

Por sidomos do të të gëzoj kallot e duarve dhe kallot në ndërgjegje. Këto janë kryesoret dhe vendimtaret për ty.

Plazhi qëndron bosh, asnjeri nuk futet në det se bën ftohtë.

Kur të vijë Sokoli do të vijë edhe dielli në plazh. Prandaj në këto pushime fituam vetëm gjumin, veç jo babai, pse ti e di, që unë jam zog i mëngjesit. Edhe tash që të shkruaj është shumë mëngjes. Mamaja, Liloja, Pranvera, Dhurata, nëna, aneja të gjithë flenë, përveç «bariut» plak nga mosha, por jo nga zemra.

Nuk e zgjat më letrën, se kam frikë se të lë pa punë, duke kënduar letrën time që këtë herë ta bëra të gjatë si lumi që ju kalon atje pranë. Por ti

e kupton pse e zgjata (po ta them në vesh: se më mori malli për ty), prandaj edhe një herë të puth, të uroj shëndet, punë të mbarë dhe të frytshme dhe të presim me padurim kur të mbarosh detyrën.

Babai yt

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHOKUT HAXHI KROI, TIRANË

Durrës, 23 korrik 1967

I dashuri shoku Haxhi,

Sot mësuam me hidhërim vdekjen e mëmës suaj dhe vijmë me këtë telegram, t'ju ngushëllojmë nga zemra, të rroni vetë dhe të gjithë të dashurit e zemrës suaj. Jo vetëm që ajo ishte mëma juaj, por për ne ishte dyfish e respektuar, pse ishte njëkohësisht edhe motra e Avni Rustemit, i paharruar kurrë në zemrat e shqiptarëve.

Enver Hoxha

Nexhmije Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR KUFITARËVE TË REPARTIT USHTARAK «N»

Kukës

23 nëntor 1967

Të dashur shokë kufitarë,

Partia dhe populli ju falënderojnë ju, që kryeni me besnikëri dhe heroizëm detyrën tuaj patriotike ndaj atdheut socialist.

Unë ju përgëzoj që regjistruat në efektivin e repartit tuaj heroinën komuniste Shkurte Vatën, emrin e së cilës ju do ta lexoni kurdoherë në numërimin luftarak kur niseni për të kryer shërbimin. Reparti juaj u forcua kështu një mijë herë më shumë.

Ju uroj shëndet dhe festat t'i kaloni gëzueshëm.

Ju përqafoj

Juaji

Enver

«Gjithmonë vigjilencë» (Për Organet e Punëve të Brendshme), vëll. i 2-të, f. 119

LETËR DREJTUAR KOOPERATIVISTËVE TË RRASHBULLIT

25 nëntor 1967

Të dashur shoqe dhe shokë të kooperativës së Rrashbullit!

M'u bë zemra mal kur mësova nga letra juaj për sukseset e mëdha që keni arritur në realizimin e tejkalimin e planit të prodhimeve bujqësore, blegtorale e të sektorëve të tjerë ndihmës të kooperativës suaj. Ju përgëzoj për të gjitha sukseset, si dhe për vendimet që morët në mbledhjen ku diskutuat mbi materialet e Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror të Partisë. Unë ju uroj me gjithë shpirt që në të ardhmen të korrni fitore të reja akoma më të mëdha.

Me përpjekje e punë të palodhur, me vullnetin tuaj të madh, të frymëzuar kurdoherë nga vija e drejtë e Partisë që ju e doni aq shumë, krahas rritjes së rendimenteve të prodhimeve buj-

qësore, ju po zhvilloni me sukses blegtorinë, keni zgjeruar sektorët ndihmës të artizanatit dhe po zbatoni një sërë masash të rëndësishme, siç janë dhënia leje me të drejtë page grave për lindje, pagesa e anëtarëve për paaftësi në punë, ngritja e çerdheve dhe e ambulancës, marrja e masave për furnizimin e popullsisë me perime, zhvillimi i arsimit e i kulturës në kooperativën tuaj etj.

Të gjitha këto masa të rëndësishme me karakter të thellë shoqëror, ekonomik e kulturor kanë një rëndësi shumë të madhe dhe mund të merren vetëm në një ekonomi socialiste me baza të shëndosha. Ato shtojnë besimin e anëtarëve në rendin tonë kooperativist, çimentojnë fitoret tona politike e ideologjike, u presin rrugën çdo shfaqjeje të huaj dhe mbeturine mikroborgjeze, zhvillojnë ndërgjegjen socialiste, kalitin tek ata vetitë e moralit komunist dhe rritin nivelin material e kulturor të kooperativistëve. Ato krijojnë, gjithashtu, kushte për një përsosje të mëtejshme të organizimit socialist të punës e të prodhimit, të jetës shoqërore, të zhvillimit kulturor e teknik të kooperativës suaj.

Zotimet e shumta që keni marrë, janë inkurajuese, prandaj ju përgëzoj nga zemra dhe kam besim se ju do të mobilizoheni që t'i realizoni ato plotësisht. Me punë të palodhur ju po forconi kooperativën, jo vetëm që jeta e anëtarëve të saj të përmirësohet çdo vit, po njëkohësisht të ndihmoni edhe në forcimin e gjithë ekonomisë popullore të

atdheut tonë, që brezat e ardhshëm të rrojnë të lumtur, që Republika jonë Popullore të ngrejë gjithmonë lart e më lart flamurin e Partisë.

Si një vullkan kanë shpërthyer hovi revolucionar dhe iniciativat e masave kudo në vendin tonë. Kjo vërteton drejtësinë e vijës së Partisë dhe besimin e pakufishëm të popullit në këtë vijë, gjë që i tmerron së tepërmi armiqtë tanë. Kur një popull si yni ngrihet i tërë në këmbë dhe udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste, ai është i pamposhtur.

Ju dëgjoni çdo ditë ç'po ngjet në të katër anët e atdheut, ç'ndërgjegje të lartë po kalit Partia te punonjësit tanë, si po krijohet te ne figura morale e njeriut të ri të socializmit. Gjithë kjo punë e madhe që bën Partia ka për qëllim që popullin ta bëjë edhe më të mrekullueshëm, që të shkëlqejë jo vetëm brenda, por edhe jashtë vendit, si shembull lufte, vendosmërie, heroizmi, urtësie e ndershmërie, njëkohësisht edhe shembull pune, diturie dhe pjekurie marksiste-leniniste.

Me gjithë fitoret e mëdha që kemi arritur, të dashur shoqe e shokë kooperativistë, kurrë të mos dehemi e ta flemë mendjen. Armiqtë do të përpiqen kurdoherë të na i rrëmbejnë fitoret nga duart, prandaj, siç na mëson Partia, të jeni gjithnjë vigjilentë e sypatrembur dhe njëkohësisht me punët e kooperativës, përgatituni të mësoni edhe artin ushtarak për të qenë në çdo kohë të gatshëm, ushtarë të denjë të Republikës sonë Popullore.

Duke mbajtur si kurdoherë lart flamurin e kuq të Partisë, përpara për fitore të reja!

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Adriatiku», nr. 57, 26 nëntor 1967

LETËR DREJTUAR ANËTARËVE TË KOOPERATIVËS BUJQËSORE «21 DËSHMORËT» TË CEPOS

Kardhiq

26 nëntor 1967

Të dashur shoqe dhe shokë të kooperativës «21 Dëshmorët» e Cepos të krahinës heroike të Kardhiqit,

Sukseset e kooperativës suaj dhe zotimet revolucionare që keni marrë për ta çuar atë më përpara, më kanë gëzuar pa masë. Ju uroj nga zemra punë të mbarë, dhe dalshi kurdoherë faqebardhë në detyrat e mëdha që i keni vënë vetes.

Hovi i madh patriotik e revolucionar që ka përfshirë anëtarët e kooperativës suaj e ka burimin mbi të tjerat, tek traditat e mrekullueshme patriotike që ju dhe gjithë krahina juaj e Kardhiqit keni trashëguar nga gjyshërit e baballarët, nga nënat heroike të Labërisë që me armë në

dorë e këngë në gojë, luftuan brez pas brezi për liri kundër pushtuesve të huaj. Cepoja jonë e dëgjuar ka qenë tmerr e barrikadë ku kanë thyer kokën me radhë njëri pas tjetrit të gjithë armiqtë, pushtuesit otomanë, shovinistët grekë, zogistët, fashistët italo-gjermanë dhe gjithë tradhtarët ballistë që ishin bërë njësh me ta në Luftën Nacionalçlirimtare, gjatë së cilës fshatrat e kooperativës suaj të bashkuar kontribuan me gjakun e kulluar të 21 partizanëve, duke ngritur edhe më lart traditat heroike të paraardhësve tanë.

Por krahas traditave luftarake, të frymëzuar nga mësimet e Partisë, sot ju po zhvilloni me guxim edhe traditat e punës. Revolucionarizimi i prodhimit, siç më njoftuat me letër, zhvillimi më tej i bujqësisë e i blegtorisë, përparimet në sektorët e tjerë të ekonomisë së kooperativës, zbatimi i eksperimentimit shkencor etj. si dhe avancimet që keni menduar t'i bëni përgjithësisht planit, flasin për vendosmërinë në zbatimin e vijës së Partisë, për rritjen e ndërgjegjes në përpjekjet për ndërtimin e socializmit në fshatrat e kooperativës suaj.

Sistemi ynë kooperativist në fshat tashmë po e tregon çdo ditë e më shumë epërsinë e tij mbi ekonominë e vogël fshatare, mbi rendin e ekonomisë kapitaliste në fshat. Besimi i patundur në rrugën e ndritur të socializmit, në mësimet dritëdhënëse të Partisë, ka bërë që sot në të katër anët e vendit tonë ka shpërthyer një hov e entuziazëm si askurrë ndonjëherë për të ecur me hapa

të shpejtë përpara për realizimin e vendimeve historike të Kongresit të 5-të të Partisë.

Edhe vendosmëria juaj e lartë, shokë dhe miq të mi të dashur, fryma revolucionare dhe vullneti për të avancuar akoma më tepër shifrat e planit pesëvjeçar për zhvillimin në mënyrë të harmonizuar të të gjithë sektorëve të ekonomisë suaj kolektive, sipas parimit të kooperimit socialist të ekonomisë, e kanë burimin te mësimet e Partisë. Besimi i patundur në drejtësinë e vijës së saj ju mobilizon dhe ju jep krahë për të zhvilluar e për të forcuar më tej ekonominë kooperativiste, për të mirën tuaj dhe të të gjithë vendit tonë.

Krahas masave me karakter ekonomik e social që keni marrë, u jepni rëndësi të veçantë edhe masave të tjera edukative-kulturore, edukimit revolucionar klasor të masave e veçanërisht të brezit të ri e të grave, zhvillimit më tej të revolucionit tekniko-shkencor, mbajtjes kurdoherë lart të vigjilencës revolucionare ndaj armiqve imperialistë e revizionistë. Të gjitha këto kërkojnë që të forcohet pa pushim puna me anëtarët, që secili të kuptojë se në socializëm punohet për lumturinë dhe mirëqenien e të gjithëve me punë të përbashkët, me një ndërgjegje të lartë socialiste që karakterizon sot shumicën dërrmuese të punonjësve të vendit tonë. Bashkë me këtë duhet të inkurajohet në çdo rast zhvillimi i iniciativës krijuese të kooperativistëve për rritjen e prodhimit, të tregohet vëmendje për dëgjimin e zërit të

masës, të forcohet gjithnjë më shumë demokracia kooperativiste dhe të kritikohet pa frikë e druajtje çdo shfaqje e dëmshme dhe çdo njeri që gabon, kushdo qoftë ai. Rendi ynë socialist është më i fuqishëm nga çdo rend tjetër i mëparshëm, pikërisht sepse mbështetet te fuqia e masave punonjëse, te populli në fuqi i udhëhequr nga Partia dhe i ndriçuar nga ideologjia e saj, nga ideologjia e klasës punëtore.

Duke përfunduar ju uroj me gjithë zemër, të dashur shoqe dhe shokë, t'i realizoni me nder të gjitha detyrat që keni caktuar dhe të ngrini akoma më lart flamurin e rendit tonë kooperativist, flamurin e Partisë sonë të lavdishme në fshatrat tuaja të bukura bregdetare. Ju uroj, gjithashtu, gëzuar festat tona të shënuara të 28 dhe 29 Nëntorit.

Ju përqafoj të gjithë

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Pararoja», nr. 63, 29 nëntor 1967

LETËR DREJTUAR SHOKUT RUSTEM GRORI

Romanat—Durrës

22 janar 1968

I dashur shoku Rustem,

Letra, me të cilën ju më njoftonit për vdekjen e djalit tuaj, Selmanit, që ra në krye të detyrës si ushtar i denjë i Ushtrisë sonë Popullore, më preku thellë.

Selmani nuk ishte vetëm djali i madh dhe i dashur i familjes suaj, por ai ishte një ushtar shembullor, një i ri revolucionar i rritur dhe i edukuar nga familja dhe Partia, i cili kreu me nder e ndërgjegje të lartë detyrën karshi atdheut, gjersa dha jetën e tij. Ju dhe familja juaj, duke mposhtur me guxim këtë hidhërim të rëndë, nuk derdhët lot për djalin tuaj, ashtu siç e ka traditë shqiptari që trimat nuk i qan, por u thur himne e këngë lavdie. Ky është një qëndrim i lartë patriotik që flet për trimërinë dhe burrërinë e famil-

jes suaj, për dashurinë e madhe që ju, ashtu si gjithë populli ynë ushqeni për atdheun tonë socialist, për Partinë tonë heroike, e cila po rrit dhe edukon njerëz të mrekullueshëm, që s'dinë të përkulen kurrë përpara vështirësive, që janë të gatshëm të sakrifikojnë edhe jetën për të mirën e përgjithshme, për socializmin.

Në letrën tuaj aq të përzemërt, i dashur Rustem, si partizan i vjetër i viteve heroike të Luftës Nacionalçlirimtare, ju keni shfaqur dëshirën që sot në moshën 60-vjeçare të ngjeshni pushkën dhe të zëvendësoni djalin tuaj. Ky akt burrëror të mbush me krenari e guxim dhe tregon figurën e lartë të nënave dhe të baballarëve tanë trima që me shekuj kanë ruajtur virtyte të mrekullueshme, të cilat revolucioni ynë i ngriti akoma më lart. Këtë e tregon edhe akti revolucionar i të riut Hamit Hosku, i cili, megjithëse sapo është kthyer nga shërbimi ushtarak, kërkon të zëvendësojë shokun e tij, Selmanin. Partia, duke ju falënderuar për këtë shembull vendosmërie e patriotizmi të flaktë që vlon në zemrat tuaja, ju shpreh mirënjohjen e saj më të thellë, dhe e gjen të arsyeshme që ju të qëndroni në frontin tuaj po aq të rëndësishëm, në kooperativën bujqësore, për fuqizimin e ekonomisë socialiste, ku punoi edhe Selmani, duke pasur besim të patundur se ju, ashtu si gjithë populli shqiptar, do të jeni kurdoherë në këmbë për të forcuar e mbrojtur fitoret e revolucionit tonë.

Siç më shkruanit në letër, i dashur Rustem,

ju tani keni shumë bij e bija të fshatit e të gjithë Shqipërisë. Kjo është e vërtetë. Brezi ynë i ri i mrekullueshëm, anëtar i të cilit ka qenë e mbetet djali juaj, do të dijë ta mbajë me nder pushkën e Selmanit, të ruajë me respekt e dashuri kujtimin e tij dhe të vazhdojë me sukses veprën e madhe të Partisë, ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Ju shpreh ngushëllimet e mia të përzemërta dhe i uroj familjes suaj lumturi, shëndet e gëzime në jetë dhe suksese në punë.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOQES XHEVRIJE XHINDOLLI

Durrës

22 qershor 1968

E dashur nënë Xhevrije,

E mora letrën që më shkrove ditën kur shoku ynë i paharruar, biri yt, Feriduni, mbushi 24 vjet nga dita që ra dëshmor për çlirimin e atdheut.

I gjithë populli shqiptar me të drejtë krenohet dhe do të krenohet në shekuj për trimërinë dhe heroizmat e komunistëve, partizanëve dhe luftëtarëve të vet, një nga të cilët ishte dhe djali juaj, që kurrë nuk u gjunjëzuan para vështirësive e sakrificave të panumërta, po duke vënë në jetë porositë e Partisë, çanë përpara me guxim e vendosmëri, gjersa atdheu u çlirua plotësisht nga pushtuesit dhe tradhtarët. Për ne kjo fitore dhe të gjitha ato që u arritën më vonë janë shumë të shtrenjta, pse në themel të tyre kanë sakrificat

e mëdha të popullit dhe gjakun e pastër të 28 000 dëshmorëve, emrat e të cilëve do të mbeten të skalitur përjetë në historinë e lavdishme të Shqipërisë. Ata do të jenë brez pas brezi burim frymëzimi për brezin e ri, për gjithë njerëzit tanë, që vendi ynë i shtrenjtë të qëndrojë kurdoherë i lirë, të zbukurohet dhe të lulëzojë gjithnjë si pranvera, që populli shqiptar të jetojë i lumtur e i gëzuar dhe të mbrojë me vigjilencë fitoret e tij nga çdo armik e tradhtar.

U gëzova shumë që, megjithëse e moshuar, por me zemrën të re, së bashku me djemtë, si i gjithë populli ynë, punoni të vendosur për çështjen e madhe të Partisë. Duke qëndruar si një trup i vetëm rreth Partisë, e dashur nënë Xhevrije, populli ynë do t'i çojë gjithnjë lart e më lart fitoret dhe amanetin e atyre që dhanë jetën për këto ditë të lumtura që gëzon sot në atdheun e shtrenjtë socialist.

Të uroj shëndet e pleqëri të gëzuar.

Të përqafoj si nënë

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT SPIRO KOLEKA

Gjirokastër

7 korrik 1968

I dashuri Spiro,

Të uroj nga zemra 60-vjetorin e ditëlindjes tënde: t'i rrosh Partisë sa malet. U nisa të vij në shtëpi, por më thanë se ishe në Gjirokastër. Kur vendosëm këtë[1], ti s'fole fare, si ato nuset e reja. Fakti është, pra, se ne sot nuk festojmë 60-vjetorin tënd, por jemi të gëzuar dhe të lumtur që të kemi kurdoherë të ri, nga zemra, nga kthjelltësia e mendimeve dhe fizikisht të fortë, kurdoherë në

1. Shoku Spiro Koleka ndodhej në Gjirokastër, i deleguar i KQ të Partisë e i Këshillit të Ministrave, për të marrë pjesë në përurimin e elektrifikimit të Dropullit.

krye të detyrës, shoku i shtrenjtë, i talentuar, besnik deri në vdekje i Partisë dhe i popullit.

Të përqafoj me dashuri.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT GANI BURNACI

Lushnjë

23 dhjetor 1968

I dashur shoku Gani,

U gëzova shumë që, nën kujdesin e një pune të ndërgjegjshme të mjekëve tanë, drita e syve, që për pak e humbët gjatë kryerjes së detyrës, po të rikthehet.

Të përgëzoj për vullnetin e madh dhe dëshirën që pasi të shërohesh, të rikthehesh përsëri në radhët e ushtrisë sonë të lavdishme për të kryer detyrën e shenjtë të mbrojtjes së atdheut dhe të fitoreve të arritura gjatë këtij çerekshekulli nën udhëheqjen e Partisë sonë të lavdishme.

Të uroj shërim të shpejtë.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR PRINDËRVE TË KUFITARIT KRISTAQ MONE

Tiranë

9 janar 1969

Të dashur Eftali dhe Kozma Mone,

Humbja e parakohshme e djalit tuaj, kufitarit tonë trim Kristaq Mones, bashkë me dhimbjen e thellë që hapi në zemrat tuaja si prindër, dëshpëroi shumë jo vetëm shokët e repartit, me të cilët ai qëndronte natë e ditë në gatishmëri për mbrojtjen e kufijve të shenjtë të atdheut, por edhe të gjithë ne. Me këtë rast të hidhur ju dërgoj ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Por përpara kësaj të papriture kaq shumë të dhimbshme, ju prindërit e tij nuk u përkulët dhe, siç ju ka mësuar Partia, mendja ju shkoi menjëherë në kufi, prandaj ti, shoku Kozma, pavarësisht nga mosha, si komunist besnik dhe i vendosur, shprehe dëshirën fisnike për të zënë vendin që la bosh djali juaj në radhët e ushtrisë, që aftësia mbrojtëse e saj të mos dobësohet asnjë çast, por të jetë kurdoherë në gatishmëri të plotë dhe e aftë për të shkatërruar çdo orvatje të cilitdo

armik që mendon të sulmojë fitoret historike të popullit tonë.

Për këtë qëndrim të lartë patriotik e revolucionar unë ju shpreh falënderimet më të ngrohta, por mendoj se edhe në punën ku jeni, ju e kryeni njëlloj detyrën, mbasi edhe aty është gjithashtu një front i rëndësishëm pune, lufte e betejash për forcimin e lulëzimin e mëtejshëm të atdheut tonë të dashur socialist, në rojë të të cilit qëndroi gjer në fund djali juaj.

Emri i Kristaq Mones, kufitarit të guximshëm e shembullor, do të mbetet i paharruar dhe do të rreshtohet përgjithnjë në radhët e atyre që dhanë jetën për mbrojtjen e këtij trualli të lashtë, të lagur me gjak në betejat heroike të popullit tonë, të papërkulur nga rrebeshet e stuhitë e shekujve dhe do të frymëzojë njerëzit e Shqipërisë së re për të kryer me dashuri e devocion të pakufishëm çdo detyrë që do t'u ngarkohet nga Partia dhe populli ynë.

Duke përfunduar ju uroj, të dashurit e mi, shëndet të plotë dhe suksese kurdoherë më të mëdha në punë.

Juaji

Enver Hoxha

«Gjithmonë vigjilencë» (Për Organet e Punëve të Brendshme), vëll. i 2-të, f. 129

LETËR DREJTUAR SHOKUT QANI MUSKAJ[1]

Patos

31 mars 1969

I dashur shoku Qani,

Gëzohem shumë në radhë të parë që tani je më mirë me shëndet dhe të uroj shërim sa më të shpejtë. Kjo është jo vetëm dëshira jote dhe e familjes tënde, por edhe e gjithë kolektivit të ndërmarrjes ku ke punuar, ashtu edhe imja.

Gatishmëria jote për t'u kthyer përsëri në gjirin e kolektivit të mrekullueshëm të naftëtarëve tanë heroikë me qëllim që, pavarësisht nga humbja e këmbës, të vazhdosh të punosh së bashku me ta, është një qëndrim i lartë proletar ndaj

1. Motorist i naftës në Patos. Në letrën e tij drejtuar shokut Enver, ai shkruante se, megjithëqë humbi njërën këmbë aksidentalisht në punë, i frymëzuar nga heroizmi i njerëzve tanë, premtonte të kthehej përsëri në gjirin e kolektivit të tij punonjës, për t'i dhuruar Partisë një zonë të re nafte në Cakran.

punës dhe shprehje e dashurisë së madhe që ti ke për popullin, Partinë e atdheun.

Studimi i Historisë së Partisë që je duke përfunduar, i dashur Qani, është një nga detyrat më të rëndësishme për ngritjen ideologjike, për kalitjen marksiste-leniniste të çdo punonjësi të vendit tonë. Kujtdo që e lexon atë, kujtdo që i bën mish e gjak idetë e mëdha të Partisë, i kalitet më tej vullneti e vendosmëria për çështjen e madhe të socializmit dhe të komunizmit. Kam besim të madh se me vullnetin që të karakterizon, me zemrën e zjarrtë dhe idealin e Partisë në gji, do të dish ta japësh kurdoherë kontributin tënd në zbatimin e vijës dhe mësimeve të saj.

Të uroj shëndet dhe suksese në dëshirat e tua fisnike, gëzim e lumturi në familje.

Përqafime

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë stpas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT SHABAN REXH HAJDARMATAJ, NË KOOPERATIVËN BUJQËSORE TË ZOGAJT

Tropojë

3 prill 1969

I dashur Shaban,

Mora letrën tënde dhe, pasi e lexova me kujdes, m'u kujtua emri yt që nuk është i padëgjuar. Për ty, për qëndrimin burrëror, për ndërgjegjen e lartë socialiste ndaj punës, për vendosmërinë për t'i shërbyer mbrojtjes së atdheut, megjithëse ndodhesh në kushte të vështira fizike pas fatkeqësisë së sëmundjes, nga e cila humbe të dyja këmbët, kisha mësuar para një viti nga një shkrim në gazetën «Zëri i popullit». Këto më kujtoheshin mirë pse, kur pata lexuar gazetën, më kishin lënë mbresa të thella qëndrimi dhe vullneti yt i papërkulur.

Njerëz me vullnet të hekurt si ti, që megji-

thëse pa këmbë arrin të bësh 300 ditë-punë në vit, kurse sivjet ke vendosur të bësh 350 ditë-punë për nder të 25-vjetorit të Çlirimit, që mposhtin dhimbje e vështirësi të mëdha, janë shumë të dashur e të shtrenjtë për ne. Ata i nderon dhe i respekton shumë Partia dhe mbarë populli, si për punën që bëjnë, por sidomos më shumë për qëndrimin shembullor, për ndërgjegjen e lartë socialiste, për shpirtin e sakrificës, për vënien para së gjithash të interesit të përgjithshëm mbi atë personal.

Unë të përgëzoj, i dashur Shaban, për sa ke bërë dhe vazhdon të bësh, si për të mirën e kooperativës, ashtu edhe për kontributin që jep në çështjen e mbrojtjes, që është detyra kryesore e çdo shqiptari dhe me këtë letër dëshiroj të të uroj me gjithë zemër shëndet, suksese në realizimin e detyrave fisnike që i ke vënë vetes dhe gëzime në familje.

Të përqafoj

Yti

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR PENSIONISTËVE DHE INVALIDËVE TË QYTETIT TË CËRRIKUT

21 prill 1969

Të dashur shokë,

Nga letra që më dërguat mësova se ju po bëni një punë të mrekullueshme. Pjesëmarrja në aksionet nacionale e lokale, puna vullnetare në ndërtimin e banesave dhe zbukurimin e qytetit tuaj, lidhjet e ngushta që mbani me institucionet dhe ndërmarrjet ku keni derdhur mundin e djersën tuaj, puna që keni vendosur të bëni me rastin e 25-vjetorit të Clirimit e të fitores së revolucionit popullor për t'i njohur të rinjtë me traditat heroike e revolucionare të popullit tonë, janë një kontribut i madh që ju jepni për ndërtimin socialist të vendit dhe që atdheu ynë, Shqipëria, të bëhet çdo ditë më e bukur, më e begatshme, më e fuqishme.

Ju vërtet jeni të moshuar dhe nuk i keni mu-

ndësitë fizike si disa vjet më parë, po zemrën e keni gjithnjë të re. Mësimet marksiste-leniniste të Partisë sonë ju frymëzojnë, ju mprehin mendjen, ju përtërijnë forcat, ju dhjetëfishojnë energjitë dhe ju bëjnë të mos njihni ç'është pleqëria dhe invaliditeti. Njeriu kurrë nuk plaket kur gjithë jetën e tij ia kushton çështjes së Partisë e të popullit.

Përpjekjet, mundin dhe eksperiencën tuaj të çmuar shumëvjeçare, ju e keni bashkuar me luftën e gjithë popullit tonë, i cili, nën udhëheqjen e Partisë, si një trup i vetëm, është ngritur në këmbë dhe me vrull të paparë ndonjëherë, po shkruan faqe të tjera të historisë së tij të lavdishme. Populli shqiptar është krenar për të kaluarën e për të tashmen dhe ecën me besim të patundur në të ardhmen.

Ju uroj, të dashur shokë, që 25-vjetorin e Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor ta kaloni të gëzuar e me suksese edhe më të mëdha. Paçi shëndet dhe jetë të gjatë.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR DJALIT, ILIRIT

24 qershor 1969

Ilir i dashur,

Letrën tënde e morëm dhe u gëzuam që je mirë dhe që punon mirë.

Në punë, djali im, të jesh i palodhur, pse puna të kalit trupin dhe ndërgjegjen. Kalitja e kësaj të fundit është vendimtare në jetë, dhe kur kjo të kalitet në rrugën e Partisë, do të ta bëjë jetën të lumtur, të gëzuar dhe do ta vësh atë plotësisht në shërbim të Partisë dhe të popullit. Unë jam shumë i lumtur që të kam të dashur dhe të thjeshtë me njerëzit, kjo është kryesorja.

Jeta atje duhet të jetë e gëzuar në mes rinisë entuziaste; si lum ju për konditat që ju krijon Partia dhe pushteti. Kush e di, pas pune lëvojnë kënga e shakatë! Kur të vish do të na i thuash të gjitha, se do të të pyesim, pse ne pleqtë kemi nevojë për freskinë e rinisë.

Sot festuam datëlindjen e Pranverës, të uroj dhe ty, pse na mungoje, por e ngritëm gotën edhe për shëndetin tënd.

Pranverës i bëra një peshqesh, e merr me mend se çfarë?... Një qeskë me sheqerka, qeskë të vogël, se i prishen dhëmbët. Pjesën tënde ta kam ruajtur, mos u mërzit.

Këto ditë kemi një mbledhje të plenumit të KQ për arsimin. Pas punimeve, do të shkojmë në Durrës dhe atje të presim, pse do mbetemi vetëm. Sokoli do të punojë në liqenin e Tiranës dhe Pranvera, siç e di, do të vijë aty në hekurudhë.

P.S.

Tash që po të shkruaja, futbollisti Pele po qëllon në portë të kundërshtarit: rezultati hiç, prandaj mos u mërzit që nuk e ndoqe dot ndeshjen.

Pra, punë të mbarë, i dashuri Lilo, të puth me mall dhe të presim.

Yti

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR VAJZËS, PRANVERËS

Durrës, 6 korrik 1969

E dashura Pranverë,

Jam shumë i gëzuar që ti je në aksion dhe punon me zell dhe entuziazëm të madh tok me shoqet dhe shokët e tu, në ndërtimin e hekurudhës Elbasan—Përrenjas. Kjo është një vepër e madhe, që rinia po ndërton për popullin dhe unë jam shumë i lumtur që edhe fëmijët tanë, derdhin edhe ata djersën e tyre. Ti për herë të parë punon në hekurudhë, por je e vjetër në aksione. Unë nuk e harroj punën tënde vullnetare në Peshkopi, në kallkan e në të ftohtit e madh të dimrit. Atëherë ishe edhe më e vogël, por nuk u ndave asnjë grimë nga shokët e vëllezërit. Më kujtohet mirë fytyra tënde e skuqur nga të ftohtit, që nuk të trembi për asnjë çast. Ti u kalite atje dhe tash në sektorin e Labinot—Fushës, ku ti punon, sigurisht e ke më të lehtë, pse është edhe verë. Vendi ku punoni është i bukur, me pemë, me hije dhe me ujë të ftohtë. Lumi ju shkon afër. Për mua ato vende janë shumë të dashura, pse andej kam luftuar. Aso kohe kishim halle shumë në kokë, luftohej për jetën e

populli. Moshatarët e tu në ato kohë luftonin me pushkë në dorë dhe vriteshin në luftëra, që populli të rrojë i lumtur. Shumë herë, në kohën e luftës, e kam kaluar lumin që ju rrjedh afër, e s'na vinte mendja për t'u larë, siç ju vjen juve sot, por ne e kapërcenim natën në errësirë, me ujë deri në brez, pse na gjurmonte mitralozi i okupatorit. Atje afër është një pasarelë, që e quajnë ura e Haxhi Beqarit. Në kohën e luftës ajo na shërbente, por një natë dimri, në qoftë se nuk gabohem, erdhën më raportuan se ura u hodh në erë. Kush e hodhi? — pyeta. Më thanë se e hodhi me dinamit një ... major anglez, gjoja aleat. E thirra qen bir qenin dhe e bëra rezil, pse ishte e qartë se ai e hodhi urën në erë, që të mos kalonin dot partizanët. Dhe kështu ngjau: një natë dimri, tok me forcat e brigadës, nuk e kaluam dot lumin, pse kishte dalë shumë, dhe u detyruam të ktheheshim në Çermenikë, ku përballuam operacionin armik dhe dimrin e madh.

Prandaj, kur të shikosh lumin, pasarelën ose malin e Polisit për karshi, kujto partizanët, tok me ta edhe babën tënd, mendo ç'vuajtje kanë kaluar dhe bjeru kazmës e lopatës më me forcë. Lart, lart, në malin e Shmilit, në mes të një pylli me dushk ishte një kasolle e vogël dhe e varfër e një fshatari patriot plak, që e quanin Ram Karagjozi. Në atë kasolle dhish me Ramën kam ndenjur disa net në kohën e reaksionit më të egër. Flinim tok me disa dhi se na mbanin ngrohtë, qeni i Ramës bënte rojë. Natën dilnim në ma-

jë, gjëmonte lugina nga mitralozat gjermanë. «Bien në Babje» thoshte Rama. «Gjermanët qëllojnë pse i kanë frikë partizanët dhe natën», i thosha unë.

Tash, Pranvera ime, kaluan ato kohë, tash gjëmojnë minat tuaja që çani tunelin, gjëmon kënga juaj e gëzueshme. Ram Karagjozi duhet të ketë vdekur tash, por edhe në varr ai thotë: «Or Enver gjëmon Babja, por ky është tjetër gjëmim».

Mos i harroni kurrë, bija ime, luftërat dhe sakrificat e mëdha të popullit tonë dhe të Partisë, pse ato janë në bazë të lumturisë dhe të jetës së gëzuar të rinisë. Pa ato nuk mund të arriheshin të gjitha këto gjëra dhe këto duhet t'i fuqizojmë, t'i fuqizojmë vazhdimisht, që popullit të mos i dhembë koka kurrë.

Pak kohë kemi që jemi ndarë, po më ka marrë malli për ty, prandaj të përqafoj ty dhe gjithë shoqet e tua, pse njësoj ju kam dhe ju dua të gjitha. Puno pa u lodhur dhe kur të kesh një copë kohë të lirë, na shkruaj.

Yti

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR ANËTARËVE TË KOOPERATIVËS BUJQËSORE QINAM-RADOVICKË TË RRETHIT TË KOLONJËS

16 shtator 1969

Të dashur shokë kooperativistë të fshatrave Radovickë, Qinam, Orgockë dhe Kurtes,

Në radhë të parë ju uroj të gjithëve punë të mbarë e suksese gjithnjë më të mëdha në kooperativën tuaj, shëndet dhe lumturi në familje.

Letrën që më dërguat nga mitingu juaj, e prita me kënaqësi të veçantë, për arsye se më dhatë lajmin e gëzuar që në kuadrin e jubileut të madh të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor, ju përfunduat elektrifikimin e fshatrave të kooperativës, u lidhët me rrugë automobilistike dhe me një linjë telefonike. Këto ju gëzojnë dhe zbukurojnë jetën tuaj, na gëzojnë edhe ne, siç gëzojnë gjithë popullin e gjithë Partinë.

Fitoret tuaja të mëdha janë në radhë të parë fryt i mençurisë, zotësisë, mobilizimit dhe punës së palodhur që keni bërë ju malësorët patriotë të zjarrtë e trima të Kolonjës e të Dangëllisë nën udhëheqjen e urtë të Partisë, pa të cilën për të gjithë ne shqiptarët nuk do të kishte Shqipëri të lirë, të pavarur, ku populli ndërton, siç do vetë, jetën e tij të lirë e të lumtur që gëzon sot. Ju më të moshuarit e mbani mend mirë se punëtorët e fshatarët tanë dhe ca më keq malësorët e zonave të thella në të kaluarën vuanin të zitë e ullirit dhe për të siguruar kafshatën e gojës ishin të detyruar të bridhnin lart e poshtë për një torbë misër. Po sa ndryshime të mëdha janë bërë tani në Shqipërinë tonë socialiste. Deri edhe ju në ato zona të thella, sidomos pas bashkimit në kooperativë, përveç fitoreve të tjera si ato që përmendni në letër, këta 3 vjetët e fundit arritët ta siguroni vetë bukën, bile të krijoni edhe rezerva. Të gjitha këto i detyrohen bindjes suaj në vijën e drejtë të Partisë, e cila, në udhëheqje të popullit shqiptar, çan përpara me guxim e trimëri dhe e çon atë nga suksesi në sukses.

Për nder të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut ju keni marrë një varg zotimesh e detyrash shumë të rëndësishme, që kanë të bëjnë me rritjen në një shkallë gjithnjë e më të lartë, në radhë të parë të ndërgjegjes ideopolitike, të vigjilencës revolucionare dhe aftësimit tuaj për mbrojtjen e atdheut në çdo rast nga armiqtë imperialistë e revizionistë, me rritjen e prodhimit bujqësor e bleg-

toral dhe të forcimit të kooperativës suaj. Realizimi gjer në fund i këtyre detyrave do ta bëjë jetën tuaj më të mirë, më të pasur shpirtërisht dhe materialisht dhe ju, së bashku e krahas me të gjitha kooperativat bujqësore të mbarë vendit, do të kontribuoni për lulëzimin dhe forcimin e mëtejshëm të Shqipërisë, kësaj kështjelle të pathyeshme të socializmit buzë Adriatikut.

Ju uroj edhe një herë, të dashur vëllezër e motra, suksese të mëtejshme në realizimin e detyrave që keni përpara dhe dalshi kurdoherë faqebardhë.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR FAMILJES SË DËSHMORIT BAJRAM MAKRIU

Gjirokastër

20 shtator 1969

E dashur nënë e Bajram Makriut,

Të dashur vëllezër Ago dhe Osman Makriu,

Mora letrën tuaj të datës 13 shtator 1969 dhe u hidhërova shumë që, për fajin dhe për mosinterpretimin e drejtë të direktivës nga shokët e rrethit të Gjirokastrës, janë hequr nga varrezat e dëshmorëve eshtrat e birit e vëllait tuaj dhe shokut tonë, Bajram Makriut.

Ky veprim i padrejtë në thelb dhe i dënueshëm në mënyrën si është vepruar e që me të drejtë ju ka lënduar zemrat, kam dhënë urdhër të riparohet sa më shpejt, domethënë eshtrat e shokut Bajram të varrosen në varret e dëshmorëve, pse atje e kanë vendin. Biri e vëllai juaj dhe

shoku ynë Bajram është dëshmor i atdheut dhe me Ð të madhe.

Ju lutem shumë të zhduket nga zemrat tuaja hidhërimi dhe brenga që ju shkaktoi kjo ngjarje dhe ju kërkoj t'ua falni gabimin që kanë bërë pa dashje shokët e rinj të rrethit.

Unë dhe gruaja ime Nexhmija kujtojmë me mall të madh çastet që kaluam me ty nënë, me djalin dhe me nusen e djalit në shtëpinë tuaj. Ne nuk do ta harrojmë dashurinë tuaj të ngrohtë. Prandaj të jeni të gëzuar si më parë dhe pranoni nga unë shumë të fala e përqafime.

Juaji

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT SEJD CAKRRAJ NË KATUNDIN LLUGAJ

Tropojë

20 tetor 1969

I dashur shoku Sejd,

Lajmi i vdekjes së parakohshme të birit tënd të dashur, ushtar Hasan Cakrrajt, ashtu si familjen tuaj, më hidhëroi shumë edhe mua, prandaj me këtë rast fatkeqësie ju dërgoj ngushëllimet e mia më të përzemërta ty dhe gjithë pjesëtarëve të familjes.

Djali juaj Hasani, i edukuar nga familja dhe nga ti, shoku ynë i vjetër partizan, jo vetëm u dallua për ndërgjegje shembullore gjatë shërbimit ushtarak, por për mbrojtjen e interesave të popullit ai bëri fli deri jetën e tij të re. Me njerëz të tillë, me rininë tonë të edukuar dhe të kalitur nga Partia me një dashuri të zjarrtë për popullin dhe atdheun, Shqipëria do të rrojë e lirë në shekuj.

Ju përgëzoj ty dhe djalin tjetër Mehdiun për dëshirën që më shprehni në letër për të zëvendësuar Hasanin në repartin ku shërbente, por tani për tani s'ndihet nevoja. Partia ka prova për patriotizmin e familjes suaj dhe është e bindur se, kur të jetë nevoja, ju do t'i përgjigjeni menjëherë çdo thirrjeje të saj.

Ju përshëndes ty, njëkohësisht Mehdiun dhe gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR KRYESISË SË LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE TË ARTISTËVE TË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS-BAZË TË PARTISË TË KËTIJ INSTITUCIONI

24 tetor 1969

Të dashur shokë,

Mora letrën me të cilën më njoftonit se në konkursin letrar dhe artistik, të shpallur për nder të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, shkrimtarët dhe artistët tanë kanë paraqitur mbi një mijë vepra të gjinive të ndryshme.

Për Partinë dhe për mua ky është një lajm i gëzueshëm, pse tash e tutje populli ynë artdashës do të ketë në duar më shumë vepra dhe me siguri të një niveli më të lartë ideologjik dhe artistik. Ky lajm do të gëzojë së tepërmi, gjithashtu, klasën punëtore, fshatarësinë kooperativiste, inteligjencien tonë popullore dhe brezin e ri, që e çmojnë shumë punën e lavdërueshme të punonjësve të letërsisë dhe të arteve, të cilët, ashtu si dhe ata, me frymëzimin e tyre të lartë patriotik dhe me një ndjenjë të thellë krenarie për popullin dhe për Partinë e tyre kanë mobilizuar të tëra energjitë dhe aftësitë krijuese për ta pritur me sa

më shumë rezultate jubileun e lavdishëm të Shqipërisë socialiste. Me këtë rast, dëshiroj t'ju shpreh kënaqësinë e veçantë të Partisë dhe personalisht timen, të përgëzoj e të uroj nga zemra gjithë pjesëmarrësit në konkurs për të dalë si kurdoherë faqebardhë për të mirën dhe lulëzimin e artit tonë revolucionar të realizmit socialist.

Unë kam ndjekur me vëmendje prodhimtarinë e letrarëve, kompozitorëve apo të skulptorëve, sidomos atë të kohëve të fundit. Nga ç'kam lexuar e ç'kam parë, kam vënë re se krijimtaria jonë në këto fusha po ecën në rrugë të mbarë. Duke zbatuar e duke pasqyruar gjithnjë e më mirë porositë e Partisë dhe kërkesat e popullit, arti ynë është bërë më i shëndetshëm, i thjeshtë, i bukur, i fuqishëm, më frymëzues dhe luftarak. Në pjesën më të madhe të këtyre veprave, masat punonjëse shohin atë që ato kanë realizuar në jetë me sakrifica, trimëri e zgjuarsi, të udhëhequra nga Partia e tyre e dashur. Në to ato gjejnë të shprehur në forma të bukura artistike, me frymëzim popullor dhe entuziazëm revolucionar të kaluarën, të sotmen dhe të nesërmen akoma më të bukur të Shqipërisë socialiste, për të cilën populli ynë, duke mbajtur në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën, ka luftuar dhe lufton me një heroizëm të pashembullt. Materializimi i këtyre cilësive të larta të popullit tonë nga ana e krijimtarisë artistike dëshmon se arti ynë, i përfshirë nga vrulli i pandalshëm revolucionar, që ka shpërthyer si vullkan kudo në vendin tonë,

është në ngjitje dhe kjo është një meritë e veçantë e punonjësve tanë të frontit të arteve dhe të letërsisë sonë socialiste. S'ka dyshim se ai do të ecë gjithnjë e më përpara, pse për të kujdeset vazhdimisht Partia e klasës punëtore, pse ai ndodhet në duart e sigurta të shkrimtarëve dhe të artistëve tanë të talentuar e patriotë, të cilët, pa u kursyer dhe me devotshmëri, u shërbejnë masave punonjëse, frymëzohen nga populli dhe e frymëzojnë atë, dëgjojnë me respekt të madh dhe zbatojnë me këmbëngulje në punën e tyre krijuese fjalën e urtë e dritëdhënëse marksiste-leniniste të Partisë.

Duke u nisur nga këto dhe duke pasur besim të madh në vullnetin, frymëzimin, aftësitë dhe partishmërinë e njerëzve tanë të krijimtarisë, jam i bindur se ata si në këtë konkurs ashtu dhe në të ardhmen, kanë nxjerrë dhe do të nxjerrin nga duart e tyre vepra militante të një cilësie më të lartë ideoprofesionale për edukimin e masave e veçanërisht të brezit të ri me ideale e shije revolucionare më të kualifikuara, me frymën e socializmit dhe të komunizmit. Kjo do të bëjë që letërsia dhe arti ynë të kapërcejnë çdo vështirësi të rritjes, të zhvillohen e të transformohen së toku me tërë fushat e jetës, pra të ecin kurdoherë krah për krah me revolucionin, me popullin.

Për t'ia arritur plotësisht këtij qëllimi shkrimtarët dhe artistët tanë në të ardhmen do të mbajnë gjallë me siguri dhe do ta çojnë akoma më lart frymën revolucionare që karakterizoi mobilizimin e paparë të punonjësve të letërsisë dhe

të arteve për konkursin e madh për nder të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe fitores së revolucionit popullor. Tani më tepër se kurrë thellimi i revolucionit ideologjik e kulturor shtron detyrën që të rriten aftësitë krijuese të shkrimtarëve dhe të artistëve tanë, në mënyrë që ata të mendojnë, të punojnë e të krijojnë me kurajë e guxim prej revolucionarësh për çdo gjë që u sheh syri, për çdo gjë që u rreh zemra, për çdo gjë që do populli. Vitaliteti dhe efekti edukativ i veprës artistike të realizmit socialist qëndron në përsosmërinë e saj, në pasqyrimin me madhështi të mendimit punëtor, të frymës proletare, të dinamikës dhe të brendisë së thellë ideoestetike marksiste-leniniste.

Edhe një herë dëshiroj të përshëndes nga zemra për punën e tyre fisnike gjithë pjesëmarrësit e konkursit, si dhe forcat e tjera letraro-artistike të vendit tonë dhe t'u uroj atyre gëzuar festën tonë të madhe të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor, dhe suksese përherë e më të mëdha për t'i dhënë popullit tonë në të ardhmen vepra akoma më të bukura e me përmbajtje të thellë revolucionare!

Juaji

Enver

«Mbi letërsinë dhe artin», f. 302

LETËR DREJTUAR PESËDHJETË GRAVE E TË REJAVE TË DROPULLIT TË POSHTËM

Gjirokastër

31 dhjetor 1969

Të dashura motra dropullite,

Midis telegrameve e urimeve që po marr për festën e Vitit të Ri, lexova edhe letrën tuaj të thjeshtë, por shumë të ngrohtë e plot ndjenja dashurie për Partinë tonë heroike.

Unë, që e njoh që në vegjëli krahinën e Dropullit, me letrën tuaj jetova disa momente së toku me ju, me kujtimet, me punën, me përpjekjet tuaja. Është shumë e vërtetë ajo që thoni ju, se e vështirë dhe fort e hidhur ka qenë e kaluara për gruan shqiptare. Shoqëria e vjetër që përmbysëm me luftë ishte ndërtuar në atë mënyrë që e nënvleftësonte dhe e poshtëronte gruan. Si për të gjitha gratë e vendit tonë, edhe për ju dropullitet s'ekzistonte në të kaluarën pothuaj asnjë

e drejtë. Shteti feudo-borgjez, feja dhe e gjithë shoqëria e asaj kohe ishin ndërtuar në atë mënyrë sa deri edhe në familje i mohonin gjithçka gruas shqiptare. Megjithatë ajo mbante mbi supet e veta barrën më të rëndë të jetës, duke punuar e duke u robtuar tërë ditën. Veçanërisht ju grave e vajzave dropullite ju duhej të kacafyteshit edhe me beun dhe aganë që shfrytëzonin pa mëshirë mundin dhe djersën tuaj, mbasi pjesa më e madhe e prindërve e vëllezërve tuaj shkonin në kurbet për të shitur rininë e tyre dhe për të nxirë jetën e nënave tuaja që t'u dërgonin pak para, të cilat ata i fitonin me gjak në kushtet e rënda të rendit kapitalist.

Por të gjitha këto tani i përkasin së kaluarës. Populli ynë, i vuajtur e i shtypur sa s'kish ku të vente më, nxori nga gjiri i vet Partinë e tij, këtë titane të pamposhtur që e organizoi, e edukoi dhe e udhëhoqi në luftë për të përmbysur botën e vjetër e mizore me varfërinë e saj të tmerrshme materiale e shpirtërore, për të varrosur një herë e përgjithmonë shfrytëzimin, shtypjen, padrejtësitë dhe vuajtjet shoqërore. Në këtë luftë heroike ju, shoqe dhe motra dropullite, ashtu si të gjitha gratë e Shqipërisë, keni dhënë kontributin tuaj shumë të çmueshëm.

Tani, duke mbajtur fishekun në fole të pushkës, kundër çdo armiku që do të guxonte të prekte truallin e shenjtë të atdheut, si mbarë populli shqiptar, populli patriot i krahinës së Dropullit, ashtu si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare,

merr pjesë pa u kursyer në frontin e ndërtimit socialist të vendit dhe në frontin e madh të edukimit të njeriut tonë të ri, për begatinë dhe fuqizimin e pandërprerë të Republikës sonë Popullore.

U gëzova shumë që në kuadrin e punës së madhe edukative që po bëhet kudo në vendin tonë, ju keni marrë iniciativën për hapjen në qendër të lokalitetit të një kursi tremujor për edukimin tuaj marksist-leninist, pa u shkëputur nga puna. Kjo tregon sa thellë i kuptoni ju mësimet e Partisë. Kursi që keni hapur do t'ju ndihmojë e do t'ju armatosë ju edhe më shumë me idetë jetëdhënëse të marksizëm-leninizmit, për të njohur akoma më mirë vendimet e porositë e Partisë, historinë e saj, ligjet e zhvillimit të shoqërisë, luftën e drejtë dhe të vendosur që bën Partia për forcimin e mbrojtjen e atdheut e të marksizëm-leninizmit kundër imperializmit, revizionizmit modern dhe gjithë armiqve të tjerë të Shqipërisë socialiste.

Unë kam bindjen e plotë se ju do të mësoni shumë mirë e do të përfitoni mjaft nga ky kurs, sepse gruaja jonë shqiptare ka hyrë tani në një rrugë të atillë sa s'ka forcë në botë që të ndalë marshimin e saj përpara. Kjo është një garanci e madhe drejt emancipimit të plotë të gruas, është një fillim fitimtar në luftën deri në fund kundër prapambetjes, zakoneve e ligjeve poshtëruese, kundër konservatorizmit e fanatizmit fetar, kundër thashethemeve e mbeturinave mikroborgjeze.

Duke e mbyllur këtë letër, dëshiroj t'ju uroj nga zemra suksese të reja në mësime dhe në të gjitha fushat e jetës dhe njëkohësisht t'ju uroj gëzuar edhe Vitin e Ri, të dashura shoqe dhe motra. Me forca të reja le të punojmë akoma më mirë për të arritur suksese të mëtejshme në punë për lulëzimin e atdheut tonë socialist.

Juaji

Enver Hoxha

«Për gruan» (Përmbledhje veprash), f. 470

LETËR DREJTUAR NJËZETEPESË GRAVE TË KATUNDIT DOMGJON TË LOKALITETIT TË FANIT NË RRETHIN E KUKËSIT

10 janar 1970

Të dashura motra,

Lexova me kënaqësi letrën tuaj të ngrohtë e plot dashuri për Partinë tonë heroike dhe u gëzova pa masë që ju, gratë e reja dhe nënat me fëmijë të vegjël të kooperativës bujqësore «Pjetër Llesh Doda» të katundit malor Domgjon, pasi mbaruat para disa vjetësh 4 klasët e shkollës fillore, tani po vazhdoni me zell shkollën 8-vjeçare pa shkëputje nga puna. Kjo ngjarje me rëndësi shënon një hap përpara në ngritjen e nivelit tuaj arsimor e kulturor dhe është një ndër hallkat më të rëndësishme në luftën tuaj drejt emancipimit të plotë.

Është e vërtetë, sikurse më shkruani në letër, se për të ndjekur shkollën u ndeshët me mendimet prapanike, sipas të cilave «grave s'ka ç'u duhet shkolla». Por ju njëzetepesë malësoret, duke zbatuar mësimet e Partisë dhe nën udhëheqjen e saj, duke u frymëzuar dhe nga heroizmi i gruas shqiptare në luftë e në punë, u ngritët si

burrnesha kundër këtyre paragjykimeve reaksionare që janë pjellë e shëmtuar e botës së vjetër.

Ju lumtë, të dashura motra dhe shoqe! Qëndrimi juaj karshi kësaj detyre të rëndësishme është për t'u lavdëruar.

Unë kam bindje të plotë se ju, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që ju ka krijuar Partia për të vazhduar shkollën, do ta përfundoni atë me sukses, do të ngrini nivelin tuaj kulturor, do të rritni kështu akoma më shumë personalitetin tuaj, ndërgjegjen politike dhe nivelin tuaj ideologjik, gjë që do t'ju lypset shumë për ngritjen e mëtejshme të ekonomisë, të arsimit e të kulturës jo vetëm në fshatin tuaj, po në tërë krahinën e Fanit. Mësimi në shkollë do t'ju ndihmojë shumë edhe në kryerjen sa më mirë të detyrës mjaft delikate e fisnike të nënës për rritjen dhe edukimin e shëndoshë të fëmijëve me ndjenjën e dashurisë së thellë për Partinë dhe atdheun tonë të shtrenjtë.

Me këtë rast ju uroj me gjithë zemër shëndet e gëzime në jetë dhe dëshiroj që të jeni kurdoherë kooperativiste të dalluara në punë, ushtare besnike të Partisë dhe nxënëse të zellshme në shkollë.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Mësuesi», nr. 4 (537), 14 janar 1970

TELEGRAM DËRGUAR HAJRIE KALBAJT E HALIL GJONAJT[1] NË FSHATIN GEGHYSEN

Tropojë

26 janar 1970

Ju uroj martesën mbi bazën e dashurisë së sinqertë në kundërshtim me zakonet e një bote të perënduar. Jetë të gjatë, lumturi familjare dhe punë të mbarë në detyrën që ju ka caktuar Partia.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

1. Në letrën e tyre dy bashkëshortët e rinj i shkruanin udhëheqësit të Partisë se të frymëzuar nga mësimet e Partisë e të shokut Enver, të njohur përmes punës, ata thyen të parët zakonet prapanike fisnore, duke e lidhur jetën me njëri-tjetrin brenda fshatit të tyre.

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHOQES LILO ANDONI (NUSHI) NË PEKIN[1]

9 prill 1970

E dashura Lilo,

Na hidhëroi jashtëzakonisht shumë të gjithë humbja e parakohshme e Gogos, vëllait tënd dhe shokut e mikut tonë të vjetër e të shtrenjtë që tërë jetën e tij prej militanti të vendosur komunist nuk kurseu asgjë për lirinë e popullit, ndërtimin e socializmit dhe fitoren e marksizëm-leninizmit, po jetoi, luftoi dhe punoi gjer në fund në udhëheqje të Partisë e të klasës punëtore. Në këto momente shumë të dhimbshme na shkon mendja edhe për ty, aty larg atdheut dhe njerëzve të dashur të familjes dhe me këtë rast vijmë t'ju sjellim ngushëllimet tona më të përzemërta e të

1. Në atë kohë bashkëshorti i saj, Jovan Andoni, ndodhej me punë në ambasadën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në Republikën Popullore të Kinës.

marrim pjesë bashkë me ju në këtë hidhërim të madh që na pikëllon zemrat.

Enver Hoxha

Nexhmije Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR NJËZETESHTATË FAMILJEVE VLLEHE, SEKTORI STJAR NBSH DELVINË

3 mars 1971

Të dashur shokë dhe shoqe,

Mora nga ju letrën që më dërguat të gjithë së toku, ku më shkruani thjesht e sinqerisht për atë gëzim të madh që ndieni në zemër për Partinë e lavdishme të Punës, që na solli të gjithëve ditë të bardha e po na udhëheq dita-ditës nga fitorja në fitore. Unë ju falënderoj nxehtësisht për fjalët e mira dhe ju përgëzoj për gjithë ato suksese që keni arritur, duke punuar në Stjarin e ri e të bukur të agrumeve.

Gjatë leximit të letrës suaj qysh në fillim më tërhoqi vëmendjen fakti që ju keni ngritur një shkollë që e vazhdojnë 29 të rinj e të reja pa shkëputje nga puna. Mos vallë është e rastit ose kështu «e zuri kalemi» që ju e filloni letrën nga shkolla dhe jo nga ndonjë problem tjetër? Jo, përkundrazi. Kjo tregon se ju e keni kuptuar drejt direktivën

e Partisë se pa shkollë nuk ecet, se socializmi kërkon njerëz të mësuar. Ju, shokë dhe shoqe, punoni në një sektor agrumesh, shumëzimi, zhvillimi dhe prodhimi me bollëk i të cilave nuk mund të arrihet pa një agroteknikë të lartë, pa dije shkencore, pa ngritur gjithnjë e më shumë nivelin tuaj politik, arsimor, kulturor e profesional. Po si ia arrihet kësaj? Vetëm me vullnet të fortë, këmbëngulje e luftë, duke mësuar në punë e sipër dhe në shkollë, pse puna dhe shkolla janë të pandara. Ju, të rinj e të reja vlleh që vazhdoni shkollën, mos harroni kurrë sa shumë e kanë ëndërruar atë gjyshërit e prindërit tuaj blegtorë aq të zotë. Po ku të mësonin ata? Në majë të samarit të mushkës e duke u endur andej-këndej me bagëtitë e tyre dhe pa asnjë kujdes nga regjimet antipopullore? Një dëshirë e tillë e ligjshme në atë kohë nuk ishte e mundur të realizohej. Kurse ju tani i keni të gjitha kushtet për ta vazhduar shkollën, prandaj bëni shumë mirë që mësoni dhe kam besim se do të jeni jo vetëm punëtorë dhe ushtarë të dalluar, por edhe nxënës të dalluar.

Në letrën tuaj më shkruani, gjithashtu, për luftën që po bëni kundër zakoneve prapanike e paragjykimeve fetare, të cilat na kanë mbetur nga e kaluara si ferrat nëpër këmbë dhe na pengojnë për të ecur përpara. Midis të tjerave, më gëzon fakti që aty po thyhet koncepti i vjetër se «vllahu duhet të martohet vetëm me vllahkë» dhe, siç e thoni vetë në letër, po krijohen familje të reja, në bazën e të cilave qëndron martesa me vullnetin

e lirë të vetë vajzave dhe djemve. Derisa djali dhe vajza punojnë bashkë dhe njohin njëri-tjetrin, atëherë është e drejta e tyre që të martohen me atë që duan, pavarësisht se ç'besim fetar kishin të parët e kësaj ose asaj familjeje. Kjo është në rrugën e drejtë, në rrugën e Partisë. Iku ajo kohë kur klasat sunduese dhe feja në shërbim të tyre na ndanin e na përçanin. Tani ne jemi më të bashkuar se kurrë ndonjëherë. Në këtë çështje edhe ju e hidhni hapin njësh me Partinë dhe veproni sipas mësimeve të saj. Kurrë s'gabon njeriu po të zbatojë drejt në jetë ato që i thotë Partia, pse vija e saj ka qenë dhe është gjithmonë e drejtë.

Me punën tuaj të mirë ju keni merituar titullin «Sektor sulmues i pesëvjeçarit të 4-t». Ky është një vlerësim i lartë, i cili, natyrisht, nuk ju ka dehur, por ju ka nxitur për një mobilizim të ri në të gjitha drejtimet në ndërmarrjen bujqësore shtetërore. Mua më gëzuan shumë zotimet tuaja revolucionare, prandaj me këtë rast ju uroj që ato t'i plotësoni me sukses.

Shumë të fala e përshëndetje të përzemërta.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT ISMAIL HOSHAFI, STUDENT NË FAKULTETIN E SHKENCAVE POLITIKO-JURIDIKE, DEGA E DREJTËSISË

1 tetor 1971

I dashur Ismail,

Të përgëzoj për zotimin e marrë për të punuar tre vjet në Minierën e Kurbneshit, duke zëvendësuar punën e Heroit të Punës Socialiste Frrok Kolë Kaçorri. Jam i bindur se ti do ta kryesh me nder këtë zotim, për të cilin të frymëzoi akti i lartë i komunistit mirditor, prandaj të uroj suksese në punë e në mësime, si minator dhe njëkohësisht si student.

Me këtë rast u dërgoj të falat e mia shoqeve dhe shokëve të organizatës së rinisë ku bën pjesë, familjes dhe ty personalisht.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 236 (7213), 3 tetor 1971

LETËR DREJTUAR NXËNËSVE DHE MËSUESVE TË SHKOLLËS PEDAGOGJIKE «LUIGJ GURAKUQI»

Elbasan

13 tetor 1971

Të dashur nxënës dhe mësues,

Është një gëzim për ne, që në prag të festave të mëdha të Nëntorit, na vijnë lajme nga të gjitha anët e Shqipërisë me të cilat Partia njoftohet për realizimin dhe tejkalimin e detyrave, për akte heroizmi në punë, për inaugurime të reja veprash që kryen me vetëmohim mbarë populli ynë. I tillë ishte edhe njoftimi juaj, të dashur nxënës e mësues, për ndërtimin e konviktit të ri të shkollës.

Kjo vepër, që ju e ngritët me punën dhe djersën tuaj, mund të duket si diçka e thjeshtë

në vargun e madh të ndërtimeve të tjera shumë të mëdha që bëhen në vendin tonë, por edhe ajo është një monument i kohës që reflekton karakteristikat e njeriut tonë të ri, të edukuar çdo ditë nga Partia jonë e Punës.

Kurrë ndonjëherë në të kaluarën nuk mund të mendohej që nxënësit e mësuesit t'i bënin duart me baltë, të gatuanin llaç, të digjnin gëlqere, të piqnin tulla e të ngrinin vetë një ndërtesë të madhe e të bukur. Ndërsa tani ndodh krejt ndryshe. Duke ndërtuar konviktin me forcat tuaja, ju treguat edhe një herë se çfarë guximi, iniciativë, vendosmëri, ndërgjegje të lartë e respekt për punën ka rinia jonë e mrekullueshme, si fiton ajo mbi konceptet reaksionare të botës së vjetër, që shkollarin e përfytyron vetëm me libër e penë në dorë. Jo, kësaj lloj shkolle ne ia kemi mbyllur derën një herë e përgjithmonë. Njeriu ynë, i edukuar nga Partia, është i aftë jo vetëm të mësojë, por edhe të punojë e të ndërtojë, edhe t'i mbrojë ato që krijon. Libri, kazma dhe pushka janë tri simbolet e rinisë shkollore, e cila mëson në bankat e shkollës sonë të re, që revolucionarizohet nga dita në ditë.

Tani ju, të dashur nxënës, bashkë me festat e mëdha të Nëntorit, po hyni në konviktin e ri. Gëzuar përjetë këto festa dhe nga zemra ju uroj ta gëzoni shtëpinë e re që e ndërtuat me mençurinë dhe punën tuaj të palodhur! Shëndet e suksese gjithnjë më të mëdha në mësime, në punë e

në gjithë veprimtarinë për kalitjen tuaj revolucionare.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 246 (7223), 15 tetor 1971

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT TAQO QIRICI NË PARIS

13 shkurt 1972

I dashur Taqo[1],

Të uroj për operimin me sukses[2], shërim të shpejtë e të kthehesh sa më parë me shëndet të plotë.

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

1. Për vite me radhë ka shërbyer pranë shokut Enver.
2. Në fakt kishte sëmundje të pashërueshme.

PËRSHËNDETJE DREJTUAR KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT TË POGRADECIT

20 prill 1972

Të dashur shokë,

Komiteti Qendror i Partisë u informua me hollësi për stërvitjen treguese mësimore që u zhvillua me sukses të plotë në rrethin tuaj me kuadrot e Partisë, të pushtetit dhe të ushtrisë më 3 dhe 4 prill 1972.

Në këtë stërvitje populli trim e punëtor i rrethit tuaj, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, tregoi edhe një herë se ka kuptuar e vlerësuar drejt mësimet dhe direktivat e Partisë për forcimin e mbrojtjes. Në stërvitje u vu re një pjekuri e lartë ideologjike e politike, një frymë e shëndoshë patriotike e revolucionare, një përgatitje e mirë luftarake e një disiplinë shembullore nga masat punonjëse, si dhe një organizim e drejtim i shëndoshë e një bashkëveprim i ngushtë nga

ana e të gjitha organeve të Partisë, të pushtetit e të ekonomisë në terren dhe e organeve të Partisë e komandave në ushtri.

Në mënyrë të veçantë vlen të vihet në dukje puna juaj e madhe këmbëngulëse dhe rezultatet e arritura në veprat xheniere fortifikuese, sidomos në përgatitjen dhe në sigurimin e strehimeve me të gjitha pajisjet e domosdoshme për mbrojtjen qind për qind të popullsisë së qytetit nga goditjet ajrore.

Mjetet rrethanore për mbrojtjen e popullsisë nga lëndët kimike, radioaktive e biologjike, mjetet e tjera për likuidimin e pasojave të goditjeve ajrore, si dhe ato të luftës me mina etj., të përgatitura nga vetë populli dhe ndërmarrjet ekonomike, jashtë kohës prodhuese, të cilat i keni demonstruar aq bukur në ekspozitën e çelur për këtë qëllim, tregojnë se në rrethin e Pogradecit bëhet një punë krijuese, e gjithanshme, e lavdërueshme.

Për të gjitha këto, Komiteti Qendror i Partisë përgëzon nxehtësisht klasën punëtore, fshatarësinë kooperativiste, komunistët, të rinjtë dhe të rejat, gratë, pionierët e pensionistët, gjithë punonjësit, Komitetin e Partisë të Rrethit, kuadrot e pushtetit, të ekonomisë dhe të organizatave të masave, repartet ushtarake dhe forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore të rrethit të Pogradecit dhe u uron atyre suksese gjithnjë e më të mëdha si në të gjitha fushat e tjera, ashtu dhe në zbatimin e të gjitha detyrave që ka shtruar Partia për forcimin e mbrojtjen e atdheut.

Sukseset tuaja janë një shembull frymëzues për të gjithë punonjësit, për organet e Partisë, të pushtetit dhe komandat e forcave vullnetare të vetëmbrojtjes popullore në të gjitha rrethet e vendit.

Të dashur shokë,

Stërvitja treguese mësimore që ju zhvilluat ishte një shkollë e madhe për gjithë pjesëmarrësit. Ju tani keni fituar një përvojë më të madhe, keni krijuar një bazë materiale më të gjerë, të cilat duhet t'i zhvilloni e t'i përsosni vazhdimisht po me atë vullnet, këmbëngulje e disiplinë që treguat në përgatitjen dhe në zhvillimin e stërvitjes.

I kushtoni gjithnjë kujdes të madh përvetësimit në teori dhe zbatimit në praktikë të mësimeve të Partisë për përgatitjen e popullit dhe të vendit për mbrojtje, njohjes së Artit Ushtarak të Luftës Popullore si nga kuadrot, ashtu edhe nga masat punonjëse. Vëmendje e posaçme të tregohet për stërvitjen dhe kompaktësimin e vazhdueshëm të forcave vullnetare të vetëmbrojtjes popullore, për rritjen e aftësive dhe mjeshtërisë luftarake të tyre, për forcimin e bashkëveprimit të tyre me repartet e ushtrisë, për përvetësimin e mirë nga ana e tyre të llojeve të ndryshme të luftimeve, sidomos të luftës me mina, si dhe të mënyrave për likuidimin e pasojave dhe për shpëtimin e popullatës nga goditjet ajrore. Repartet

vullnetare të vetëmbrojtjes përbëjnë një forcë kolosale, masive të mbrojtjes sonë.

Vazhdoni të stërvitni rregullisht gjithë popullatën për të ditur se si duhet mbrojtur në rast lufte, për të njohur e për të zbatuar me përpikëri rregullat në rast alarmi, për të përvetësuar përdorimin e mjeteve mbrojtëse nga lëndët helmuese, për ndihmën e shpejtë vetjake dhe reciproke etj.

Përvojën e madhe dhe shumë të vlefshme që ju keni fituar në ndërtimin e strehimeve për mbrojtjen e popullatës së qytetit, ta shtrini edhe për tunelizimin e objekteve ekonomike dhe të vlerave kulturore të rrethit tuaj. Përhapeni atë edhe në fshat për të shpejtuar e për të zgjeruar punimet xheniere mbrojtëse-fortifikuese.

Bashkëpunimi i ngushtë midis organeve të Partisë, të pushtetit dhe organeve të Partisë e komandave në ushtri dhe forcimi i lidhjeve të shëndosha të popullit me ushtrinë janë garanci për suksese të mëtejshme në përgatitjen e masave punonjëse për mbrojtjen e atdheut. I forconi dhe i çelikosni këto lidhje përherë e më shumë. Komandat e reparteve të Ushtrisë Popullore, si kurdoherë, të japin të gjithë ndihmën e nevojshme për propagandimin dhe përvetësimin e njohurive të Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore nga të gjitha masat punonjëse.

Në vendin tonë sot ka shpërthyer kudo një hov i paparë revolucionar dhe një atmosferë e shëndoshë pune për të vënë në jetë programin madhështor të Kongresit të 6-të të Partisë dhe de-

tyrat e planit të pestë pesëvjeçar. I gjithë populli, krahas punës vetëmohuese për ndërtimin e socializmit, qëndron si një trup i vetëm në roje të fitoreve të socializmit. Ai nuk do të lejojë kurrë që të preken sadopak kufijtë e shtrenjtë të atdheut tonë socialist. Kush do të orvatet të ndërmarrë një aventurë të tillë, ai do të gjejë vdekjen e sigurt.

Nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës, të ndriçuar nga vija e saj e drejtë marksiste-leniniste, me radhë të shtrënguara, të ecim me guxim përpara, për ta bërë atdheun tonë më të fortë, më të bukur e më të begatshëm.

Përshëndetje komuniste

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Vepra, vëll. 48, f. 354

TELEGRAM DËRGUAR ATHINA E KOLË KITOS

Sarandë

6 maj 1972

Të dashur Athina e Kolë.

Letra juaj nga fshati Qenurjo i Vurgut të rilindur, së bashku me ngrohtësinë e fjalëve dhe dashurinë që shprehni në të për Partinë, më solli lajmin e hidhur të vrasjes në krye të detyrës të djalit tuaj, Sotirit, në Hidrocentralin e Vaut të Dejës.

Para së gjithash, me këtë letër, dëshiroj t'ju transmetoj ngushëllimet e mia më të përzemërta ju të dyve, fëmijve dhe gjithë njerëzve të dashur të Sotirit, që dha jetën e tij të re në frontin e madh të ndërtimit socialist.

Vepra e birit tuaj të dashur dhe të Partisë, ashtu si e gjithë atyre që nuk kursejnë asgjë për

të mirën e popullit dhe të atdheut, është e do të mbetet një pishtar drite i pashuar për punonjësit e sotëm dhe brezat e ardhshëm të Shqipërisë. Madhështinë e saj e kuptoni dhe e ndieni fort ju të dy, që, siç më shkruani në letrën tuaj të ngrohtë e plot optimizëm, si revolucionarë të edukuar nga Partia, pas Çlirimit të atdheut, u hodhët në betejat e reja për ndërtimin e veprave të para socialiste. Duke kapërcyer vështirësitë e mungesat e shumta të asaj kohe, krah për krah mijëra vajzave e djemve të tjerë, ju punuat e dhatë kontributin për transformimin socialist të vendit. Dhe këtë patriotizëm të lartë ju e kthyet në një traditë të mrekullueshme në familje, duke ua transmetuar e forcuar çdo ditë e më shumë fëmijëve e në mënyrë të veçantë Sotirit. Se jeni të brumosur me një formim të tillë, prandaj ju e mposhtët hidhërimin e madh që ju solli humbja e papritur e djalit.

Brezi i ri, fëmijët tanë, tani po e ngrenë e do ta ngrenë gjithnjë e më lart lavdinë e atdheut. Sot kjo ndodh jo vetëm se ata kanë forca e mundësi më të mëdha, por kanë edhe eksperiencën tonë, kanë, në radhë të parë, ideologjinë e Partisë dhe ndërgjegjen e shoqërisë socialiste. Kjo më duket mua është vepra më e madhe që ka krijuar Partia. Njeriu ynë ka marrë tani tipare të reja, është pajisur me idealet e thella të dashurisë për atdheun dhe për popullin. Të shkoje në të kaluarën nga Vurgu në Veriun e Shqipërisë, ishte njëlloj si të shkoje në fund të botës. Po sot? Njerëzit ta-

në punojnë si vëllezër të një familjeje, së bashku kapërcejnë vështirësitë dhe në çdo skaj të Shqipërisë e ndiejnë veten si në vatrën e shtëpisë. Ndaj rinia jonë e mrekullueshme ka bërë të vetën heroizmin e kohëve që po jetojmë. Atë mund ta gjesh kudo ku ka vështirësi, ku ka përpjekje, ku ka luftë për ndërtimin e vendit dhe është e gatshme për të përballuar çdo rrezik, nga çdo anë që mund t'i kërcënohet vendit. Për ta shtëpi e atdhe është çdo kënd i truallit amtar, sado i largët që të jetë. Shembull i gjallë për këtë është puna dhe vepra e djalit tuaj, Sotirit, të cilin ju e edukuat të punonte e të luftonte si revolucionar.

Duke kujtuar fjalët që Sotiri ju shkruante në letrën e fundit, se nuk do të vinte me leje në mars, meqenëse do të shkonte në një vepër tjetër më të madhe, në Hidrocentralin e Fierzës, të bie menjëherë në sy qëndrimi i tij revolucionar, vënia e interesit të përgjithshëm mbi çdo gjë dhe se të ardhmen e mirëqenien e tij ai e kishte lidhur ngushtë me të ardhmen e lulëzimin e Shqipërisë. Vdekja e papritur ia ndërpreu dëshirën, i këputi në mes ëndrrën e bukur, por idealet që e frymëzuan do të rrojnë në shekuj në shqipërinë socialiste, pse ato i ruan, i zhvillon dhe i mbron populli ynë trim e punëtor, i edukuar nga Partia heroike e Punës.

Duke përfunduar ju dërgoj shumë të fala, ju uroj shëndet e punë të mbarë dhe shpreh bindjen se gjithë fëmijët tuaj janë e do të bëhen po aq

punëtorë, trima e guximtarë si vëllai i tyre i paharruar, Sotiri.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR NXËNËSES MERITA SINANI

Gjirokastër

22 maj 1972

E dashur Merita,

Kur fillova të lexoj letrën që më dërgove, e ndjeva veten sikur isha aty, midis jush, nxënësve të shkollës «Naim Frashëri» dhe shikonim së bashku bukurinë e Manalatit dhe pamje të tjera nga qyteti ynë i lashtë i Gjirokastrës.

Pastaj jetova çaste në familjen tuaj. U gëzova shumë që ti je nxënëse e shkëlqyer në mësime, që babai, motrat dhe vëllezërit e tu janë mirë me shëndet dhe të gjithë tregoni një dashuri të madhe për Partinë.

Por, e dashur vogëlushe, njeriu në jetë nuk ka vetëm gëzime. Atij i qëllon të ketë edhe hidhërime, siç ndodhi kohët e fundit në familjen tuaj me vdekjen e parakohshme të njeriut më të

shtrenjtë në jetë, nënës. Me këtë rast marr pjesë edhe unë në hidhërimin e madh të të gjithë familjes suaj.

Ti, Merita, je akoma e vogël, të ardhmen e ke përpara. Sa punë, suksese e gëzime të presin! Dhe në këtë rrugë, ashtu siç e thua shumë drejt në letër, nënë përjetë do të kesh Partinë. Partia është e do të jetë kurdoherë me ty, pse ti je e Partisë, bijtë dhe bijat e së cilës e kanë zakon të mposhtin çdo vështirësi e dhimbje dhe të çajnë gjithmonë përpara.

Të uroj shëndet dhe suksese në mësime. Shumë të fala babait. Motrat dhe vëllezërit e tu i përqafoj me dashuri.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR ORGANIZATËS-BAZË TË PARTISË TË KUÇIT

Vlorë

27 maj 1972

Të dashur shokë komunistë,

Gëzuar festën e 30-vjetorit të themelimit të celulës së parë të Partisë në fshatin tuaj. E lindur në gjirin e popullit trim të Kurveleshit dhe e pagëzuar në zjarrin e Luftës Nacionalçlirimtare, ashtu si të gjitha celulat që përbënin atëherë themelet e Partisë sonë, celula juaj dhe më vonë organizata-bazë e Partisë, në udhëheqje të popullit patriot kuçjot, i ka kryer vazhdimisht me nder detyrat që i janë ngarkuar, ka luftuar dhe ka fituar, pse ka mbajtur kurdoherë lart flamurin e Partisë.

Me këtë rast ju uroj nga zemra suksese në

luftën që po bëni për zbatimin e vijës së drejtë të Partisë sonë heroike.

Përshëndetje komuniste

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR KATO DHE OLIMBI DURIT

Tiranë

12 qershor 1972

I prekur thellë nga vdekja e mëmë Sillës, ju dërgoj juve ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Ne do ta kujtojmë kurdoherë me respekt këtë grua trime e sypatrembur, luftëtaren e orëve të para të vijës së drejtë të Partisë, këtë mëmë shqiptare që lindi, rriti dhe edukoi shokun tonë të paharruar, Heroin e Popullit, Mihalin.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SERANI

Tiranë

18 tetor 1972

Prindërve të pilotit trim Azbi Serani, bashkëshortes, motrave dhe vëllezërve të tij,

Të dashur Ramadan, Tajane, Liri, motra dhe vëllezër të Azbiut,

Ashtu si ju të gjithë, edhe unë u preka jashtëzakonisht shumë për vdekjen e papritur të djalit, burrit, vëllait tuaj, birit tonë të dashur dhe pilotit trim, Azbiut. Kjo humbje e parakohshme nuk ka hidhëruar vetëm familjen tuaj, atë e ndiejmë të tërë, e ndiejnë shokët, reparti, mbarë efektivi i armës së aviacionit dhe i ushtrisë sonë, pse Azbiu ishte një ushtarak me veti të larta, bir besnik i popullit dhe i Partisë, të cilëve u shërbeu vazhdimisht me devocion të pafund. Pikërisht

për këto veti ishte bërë i njohur dhe i respektuar, i rrethuar me dashuri të madhe nga të gjithë ata që panë në çdo rast tek ai ushtarin, pilotin, komunistin, shokun dhe familjarin shembullor.

Azbiu tani nuk ndodhet më midis shokëve të repartit dhe gjirit të ngrohtë të familjes, po njerëzit si ai nuk harrohen kurrë, kujtimi i tij do të mbetet gjithmonë i gjallë, cilësitë e tij të larta politiko-luftarake e morale do të jenë burim frymëzimi jo vetëm për pilotët, por për çdo ushtarak të vendit tonë, për gjithë rininë dhe popullin.

Ju, prindërit e Azbiut, brumosët tek ai ideale revolucionare. Qysh në vogëli e edukuat me dashuri të thellë për atdheun, për popullin, për punën, për mësimin. Këto veti ia çelikosi atij Partia, që e rriti, e mësoi dhe e bëri luftëtar të zgjuar e të patrembur për mbrojtjen e atdheut, për çështjen e madhe të popullit e të revolucionit. Dhe nuk vonoi që ai ta tregonte me vepra se ishte biri juaj, bir i denjë i popullit tonë të mrekullueshëm dhe i Partisë sonë të Punës. Në këto momente të rënda për ju si prindër, për bashkëshorten, motrat dhe vëllezërit e tij dhimbja jonë e përbashkët kthehet në forcë. Këtë forcë na e jep Partia jonë, na e jep puna dhe jeta e Azbiut dhe e të gjithë atyre që ranë për lirinë e atdheut, për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e fitoreve tona.

Është një krenari e ligjshme që në gjirin e popullit tonë sot po rriten dhe edukohen filiza të tillë, të cilët me vendosmëri të madhe janë në

gjendje që, po ta lypë nevoja, të mbrojnë me gjoksin e tyre të çeliktë atdheun tonë të dashur, duke luftuar në të gjitha drejtimet: nga toka, nga qielli, nga deti. Shqipëria socialiste është shumë e shtrenjtë për të gjithë bijtë e bijat e saj, për çdo njeri të ndershëm. E tillë qe ajo edhe për Azbiun, i cili sa herë fluturonte me avion, e shihte atë si zbukurohej e lulëzonte pandërprerë, e kishte përpara syve të tij vigjilentë dhe hapësirën e saj e pati futur thellë në zemrën e tij të re.

Me këtë rast të hidhur gjithë familjes suaj i dërgoj ngushëllimet më të përzemërta.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT HEKURAN ISAI[1]

Peshkopi

7 maj 1973

I dashur shoku Hekuran,

Me rastin e 40-vjetorit të lindjes të uroj nga zemra shëndet dhe suksese në kryerjen e detyrës.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

1. Në atë kohë shoku Hekuran Isai ishte sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Dibrës.

LETËR DREJTUAR SHOQES RAZE SYLA

Shkodër

12 qershor 1973

Shoqes Raze Syla,
Shofere trimëreshë në sektorin më të vështirë të Sharrave të Pukës,

Fjalimi që mbajte në Kongresin e 7-të të Bashkimit të Grave të Shqipërisë më entuziazmoi dhe nuk do ta harroj, pse në të ishin mishëruar dëshirat dhe realizimet e grave të Shqipërisë, që i nxori në dritë Partia jonë sokoleshë.

Të uroj jetë të lumtur, sokoleshë pukjane, motër dhe shoqe e nderuar.

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHTABIT DHE GJITHË NDËRTUESVE VULLNETARË TË HEKURUDHËS ELBASAN—PËRRENJAS

12 janar 1974

Të dashur të rinj e të reja, vullnetarë heroikë, ndërtues të Hekurudhës Elbasan—Përrenjas,

Ju përgëzoj nga zemra për përfundimin me sukses të Hekurudhës Elbasan—Përrenjas, ku ju punuat me vetëmohim të pashembullt, duke kapërcyer vështirësitë me vendosmëri rinore e revolucionare.

Populli dhe Partia ju lindi, ju rriti, ju edukoi për të kryer vepra të mëdha, të cilat do të mbeten të paharruara brez pas brezi e do të mbrohen me dashuri, sepse në to është derdhur djersa juaj, si dhe gjaku i shokëve e i shoqeve tuaja, dëshmorë të rinj të punës.

Të dashur ndërtues të hekurudhave në vendin tonë, të rinj kooperativistë, punëtorë, nxënës e studentë, komunistë e veteranë, pensionistë,

ushtarë të republikës, teknikë e specialistë, kudo që jeni, ju uroj dhe ju përqafoj.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 11 (7929), 13 janar 1974

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHOKUT EGON GJADRI

Tiranë

14 mars 1974

Vdekja e profesor Gjovalin Gjadrit më hidhëroi pa masë. Ju humbët me këtë rast babanë tuaj të dashur, kurse vendi ynë humbi një nga shkencëtarët e shquar, një qytetar të ndershëm dhe kuadër të vlefshëm, këmbëngulës në punën e tij shumë të dobishme për ndërtimin e Shqipërisë socialiste. Profesor Gjadri e donte me gjithë zemër atdheun e vet dhe si bir i denjë i tij ai e nderoi atë me veprën e tij, duke punuar pa u lodhur deri në momentin e fundit të jetës.

Me këtë rast ju dërgoj ngushëllimet e mia më të thella.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR KOLEKTIVIT NDËRTUES TË HIDROCENTRALIT TË FIERZËS

4 prill 1974

Të dashur punëtorë, teknikë dhe inxhinierë,

Ju përgëzoj për sukseset e mëdha të arritura, sidomos në hapjen e tunelit të parë, që përbën çelësin kryesor për vazhdimin e ndërtimit të Hidrocentralit të Fierzës. Partia ka besim të plotë në heroizmin dhe vendosmërinë tuaj të patundur për ta mbaruar në afat atë vepër të madhe.

Ju uroj nga zemra shëndet, fitore të tjera në fronte të reja të punës suaj të lavdishme.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 81 (7999), 5 prill 1974

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR TOTE MEKSIT

Tiranë

Durrës, 8 gusht 1974

E dashura nënë Tote,

Me hidhërim të madh mësova për vdekjen e Fotos, shokut tonë dhe djalit tënd të dashur që punoi deri në fund pa u lodhur në rrugën e Partisë. Jam i sigurt se edhe këtë dhimbje të re ti do ta përballosh si trime që je, sikurse përballove me kurajën tënde shembullore dhe aq frymëzuese rënien në fushën e nderit, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, të birit të popullit dhe të Partisë, trimit të paharruar Sofo Meksit.

Të dërgoj me këtë rast të dhimbshëm ty, bashkëshortes së Fotos dhe fëmijëve të tij ngushëllimet më të përzemërta të miat dhe të Nexhmijes.

Të përqafoj

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOQES FAHRIJE SALIÇAJ

Tiranë

26 janar 1975

E dashura shoqe Fahrije,

Kisha dëshirë të vija vetë, por në pamundësi po të dërgoj urimet e mia më të përzemërta me rastin e 40-vjetorit të ditëlindjes tënde. Të rrosh edhe njëqind vjet, e lumtur e me shëndet të plotë, të vazhdosh të punosh me sukses si gjithmonë si përfaqësuese e denjë e klasës punëtore dhe një nga udhëheqëset e palodhura dhe të vendosura të Partisë sonë heroike; si marksiste-leniniste të jesh kurdoherë në mbrojtje të vijës së Partisë dhe të ndërtimit të socializmit.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT SPIRO LERA

Korçë

7 maj 1975

I dashur Spiro,

Shumë më gëzove me sihariqin që më dhe për realizimin e dy planeve pesëvjeçare brenda pesë vjetëve dhe që ke dy muaj që po punon për llogari të vitit 1981.

Me punën aq të ndërgjegjshme dhe vetëmohuese ti le pas vitet dhe në të njëjtën kohë po u tregon të gjithëve se njerëzit e brumosur me mësimet jetëdhënëse të Partisë janë në gjendje të kalojnë çdo parashikim. Shembulli yt është një frymëzim për gjithë punonjësit e vendit tonë dhe sidomos për shoferët tanë patriotë. Prandaj të përgëzoj me gjithë zemër për suksesin që arrite si dhe për zotimin e ri për të realizuar deri në fund të këtij viti planin e vitit 1981.

Të uroj, shoku Spiro, shëndet, gëzim në shoqëri dhe në familje.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR 170 PUNËTORËVE TË RRETHIT TË SARANDËS QË KTHEHEN VULLNETARISHT PRANË FAMILJEVE TË TYRE NË FSHAT

27 qershor 1975

Të dashur shokë dhe shoqe,

Prita me kënaqësi letrën, me të cilën më njoftonit vendimin që morët për t'u kthyer pranë familjeve e të afërmve tuaj në fshat. Ju përgëzoj për mbështetjen që i bëtë iniciativës revolucionare të punëtorëve të uzinës «Traktori» dhe për kuptimin e drejtë të nevojës për të shkuar sot atje ku e lyp më shumë interesi i atdheut.

Ju, ashtu si qindra e qindra të rinj e të reja në të gjithë vendin, me mundin e djersën tuaj do të vazhdoni t'i shërbeni ndërtimit të socializmit në një front të ri pune, po aq të lavdishëm siç është bujqësia, duke zbatuar kështu porosinë e vazhdueshme të Partisë që jeta e fshatit të afrohet gjithnjë e më shumë me qytetin dhe që klasa jo-

në punëtore, e lidhur ngushtë me fshatarësinë kooperativiste, të kurorëzojë me sukses ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë.

Ju përgëzoj për iniciativën dhe ju uroj nga zemra shëndet e punë të mbarë juve, familjeve dhe gjithë kooperativistëve patriotë të rrethit të Sarandës.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Fitorja», nr. 26 (204), 27 qershor 1975

LETËR DREJTUAR POPULLIT TË FSHATIT KËRRË

Gjirokastër

13 shtator 1975

Të dashur shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër të Kërrës,

Ju falemnderit për letrën që më dërguat, me të cilën më bëtë të ditur se më 1 shtator festuat hapjen e shkollës 8-vjeçare[1]. Ky është një gëzim i madh për ju, pse tash e tutje fëmijët do t'ju mbarojnë shkollën 8-vjeçare në fshat. Ky është, gjithashtu, një gëzim i madh edhe për mua, që e njoh fshatin tuaj, që njoh jetën tuaj të vështirë të së kaluarës së zezë jo shumë të largët.

Por ja që, ashtu si për gjithë fshatrat e minoritetit dhe të të gjithë vendit tonë, edhe për bano-

1. Deri në vitin 1975 fëmijët e Kërrës vazhdonin shkollën e ciklit të ulët në këtë fshat dhe shkollën 8-vjeçare në një fshat tjetër.

rët punëtorë të fshatit tuaj malor erdhën ditë të bardha. Banorët e minoritetit, duke përfshirë edhe ju, që nga dita e madhe e 29 Nëntorit 1944, jetojnë të lirë dhe, në bazë të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë, gëzojnë të drejta të plota e të barabarta me tërë popullin shqiptar në atdheun e dashur socialist. Ja pse populli i minoritetit, të dashur motra dhe vëllezër kërrjotë, përgjërohet për Partinë dhe ashtu si gjithë populli shqiptar, punon pa u lodhur për ndërtimin e socializmit, vigjilon ditë e natë për mbrojtjen e atdheut dhe jeton i lumtur.

Edhe fshati juaj, në gjirin e kooperativës bujqësore të Vriserasë, po përparon çdo ditë. Me punën tuaj ju keni kohë që siguroni bukën në vend. Krahina juaj është në lulëzim. Mbi 110 arsimtarë japin mësim në Dropullin e Sipërm, mbi 40 kuadro mjekësorë, me spitale, ambulanca, farmaci, shtëpi lindjeje, dyqane etj. u vijnë në ndihmë banorëve të zonës suaj malore. Fëmijët tuaj rriten tani të shëndetshëm, ata do të mbarojnë këtej e tutje shkollën 8-vjeçare në fshat dhe kush të tregojë më shumë zell në mësime ka mundësi të shkojë aty afër, në Bularat, për të vazhduar shkollën e mesme bujqësore. Po sa e sa djem dhe vajza të minoritetit kanë studiuar dhe vazhdojnë të studiojnë në shkollat e mesme e të larta të vendit. Dhe të gëzon pa masë dëshira e madhe e shumë prej tyre që duan të kthehen përsëri në fshatrat tuaja të bukura për të shtuar prodhimin, për të ndërtuar socializmin.

Jeta e re e lumtur në vendin tonë nuk lindi vetvetiu, po me luftë, me djersë e sakrifica të mëdha. Ashtu si gjithë Dropulli, si gjithë minoriteti dhe populli shqiptar, në unitet të çeliktë dhe të bashkuar si vëllezër të vërtetë, nën udhëheqjen e Partisë, keni dhënë edhe ju kontribut si në çlirimin e vendit e vendosjen e pushtetit popullor, ashtu edhe për gjithë të mirat që gëzojmë sot. Në këtë unitet të popullit rreth Partisë e kanë burimin fitoret e arritura, prandaj ta ruajmë e ta forcojmë gjithnjë këtë unitet, përballë të cilit kanë thyer dhe do të thyejnë hundët të gjithë armiqtë e atdheut tonë, të brendshëm e të jashtëm, bejlerët, agallarët, kapitalistët, tradhtarët, si dhe imperialistët, revizionistët dhe kushdo tjetër që synon të cenojë, qoftë edhe një grimë, truallin tonë të shtrenjtë që po zbukurohet çdo ditë me punën tonë.

Duke marrë pjesë në gëzimin tuaj, shpreh bindjen se shkolla juaj e re 8-vjeçare që hapët, krahas gjithë institucioneve të tjera arsimore, kulturore, shëndetësore etj., që zbukurojnë gjithë zonën tuaj, do të bëhet një vatër revolucionare, ku fëmijët tuaj do të brumosen me dije e arsim, me mësimet e Partisë sonë, për t'u bërë luftëtarë e patriotë të flaktë, punëtorë të palodhur për lulëzimin e fshatit e të kooperativës suaj, për të rritur akoma më shumë rendimentet në bujqësi e blegtori, në frutikulturë e në prodhimet pyjore, që jeta juaj me punë të palodhur, ashtu si e mbarë popullit shqiptar të zbukurohet gjithnjë më shumë.

Me këtë rast ju bëj shumë të fala e shëndet të gjithë juve, motra, vëllezër e fëmijë kërrjotë dhe ju uroj nga zemra jetë të lumtur e të gëzuar dhe suksese në realizimin me nder të të gjitha detyrave.

Juaji

Enver Hoxha

«Dy popuj miq», f. 218

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT FOTO ÇAMI[1]

Krujë

4 tetor 1975

I dashur shoku Foto,

Me rastin e 50-vjetorit të ditëlindjes të uroj shëndet, jetë të gëzuar dhe suksese në detyrën e rëndësishme që të ka ngarkuar Partia.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

1. Në atë kohë shoku Foto Çami ishte sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Krujës.

LETËR DREJTUAR 200 GRAVE KOOPERATIVISTE E PUNËTORE TË DALLUARA TË BUJQËSISË TË RRETHIT TË VLORËS

12 nëntor 1975

Të dashura shoqe kooperativiste e punëtore,

Letra me të cilën më informuat për rezultatet e mira që keni arritur në frontin e bujqësisë gjatë këtij viti, më gëzoi shumë. Ju lumtë, shoqe kooperativiste dhe punëtore të bujqësisë, për punën e lavdërueshme që keni bërë. Kjo tregon se ju i keni mirë të qarta, politikisht dhe ideologjikisht, mësimet e Partisë.

Sukseset tuaja flasin, gjithashtu, për gjithë ato mundësi e rezerva të mëdha që ekzistojnë në bujqësi, të cilat me një frymë të lartë patriotike, me përpjekje të vazhdueshme e punë këmbëngulëse mund të kthehen në të mira materiale për popullin. Nëpërmjet ballafaqimit të rezultateve dhe këmbimit të eksperiencës, në të ardhmen

ju do të zbuloni me siguri rezerva të tjera akoma të pashfrytëzuara, do t'i studioni ato me kujdes dhe do të mobilizoheni me të gjitha forcat fizike dhe mendore për të prodhuar sa më shumë, duke provuar kështu me punë dashurinë për popullin dhe për atdheun.

Rezultatet shembullore të kooperativës bujqësore të tipit të lartë të Këmishtajt, eksperienca e saj në organizimin e drejtimin e punëve në frontin e prodhimit bujqësor, si dhe eksperienca juaj dhe e shoqeve tuaja më të mira, le të bëhen për të gjithë një mbështetje e fuqishme për t'u ngjitur akoma më lart si në frontin ekonomik, ashtu dhe në të gjitha frontet e tjera të veprimtarisë suaj politike e shoqërore.

Me entuziazmin revolucionar që ju karakterizon, jam i bindur se ju do të ngrini akoma më lart frymën e aksioneve dhe të iniciativave përparimtare dhe do të kryeni edhe në të ardhmen të gjitha detyrat që ju vihen. Të rinjtë dhe të rejat fshatare do t'i mirëpresin shokët dhe shoqet e tyre nga qyteti për të punuar së bashku me ta. Burrat dhe djemtë që punojnë në qytete ose në qendra të tjera pune, të frymëzuar nga puna juaj dhe duke kuptuar drejt se bujqësia është çështje e të gjithëve, si patriotë e revolucionarë do t'i përgjigjen me gjithë shpirt thirrjes së shoqeve të Dukatit për t'u kthyer përgjithmonë në fshat ku të punojnë e të jetojnë së bashku me ju në frontin e nderuar të bujqësisë.

Tani, në pragun e festave të Nëntorit, ju,

shoqe të rrethit të Vlorës heroike, ashtu si gjithë punonjësit e vendit tonë, të udhëhequra si kurdoherë nga mësimet jetëdhënëse të Partisë, me forca të shumëfishuara, do të hidheni edhe më shumë në sulm për realizimin e detyrave që keni përpara, me qëllim që vitin e fundit të pesëvjeçarit ta mbyllni me një bilanc sa më të pasur suksesesh dhe, duke pasur si bazë treguesit e arritur gjatë vitit 1975, të avanconi më tej detyrat për të filluar mbarë vitin 1976 dhe gjithë pesëvjeçarin e ardhshëm.

Ju përgëzoj edhe një herë për sukseset tuaja dhe uroj që si kurdoherë nën udhëheqjen e Partisë, të dilni faqebardhë dhe të marshoni përpara për të arritur fitore të reja në plotësimin e detyrave të planit dhe në forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut socialist.

Me këtë rast ju uroj festat e mëdha të 28 e 29 Nëntorit nga mot gëzuar e kurdoherë duarplot!

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i Vlorës», nr. 91 (848), 13 nëntor 1975

LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË PARIS

28 nëntor 1975

Të dashur Hysni e Vito,

Ju urojmë nga zemra festat e mëdha të Nëntorit. Të na rrojë Partia dhe nën udhëheqjen e saj të lulëzojë gjithmonë e më tepër jeta e popullit e të forcohet socializmi. Njoftimet për analizat e të tjera i kemi marrë. Gëzohemi që jeni mirë. Operacioni që do të bësh do të dalë me siguri me sukses. Presim me padurim të na njoftoni. Nga shtëpia e fëmijët janë shumë mirë, mos u bëni merak. Ashtu dhe punët na venë si jo më mirë. Gjithë shokët janë mirë e ju dërgojnë të fala e urime.

Urime gjithë shokëve e shoqeve të ambasadës, veçanërisht prof. Fejziut. I thuaj Fejziut që shpëtova nga hallet, rroftë antibiotiku që më

ngopi dhe do të vete në mbrëmjen e festës i kuq si molla.

Ju përqafojmë me mall

Enver, Nexhmije

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR PRINDËRVE TË YLLI ZAIMIT

Alipostivan — Përmet

3 dhjetor 1975

Të dashur Sheqere dhe Gani,

Si nga shtypi, edhe nga letra juaj, u informova për vdekjen e papritur të birit tuaj të dashur, anëtarit aq aktiv të organizatës së rinisë në fshat, trimit të ri kooperativist, Ylli Zaimit, i cili, për të mbrojtur pasurinë kolektive, bëri fli jetën në moshën më të bukur. Marr pjesë personalisht në këtë hidhërim të thellë të familjes suaj dhe ju dërgoj ngushëllimet më të përzemërta të miat juve, prindërve, dhe gjithë familjes suaj.

Me të lexuar letrën që më dërguat, bashkë me hidhërimin e madh që ndjeva për këtë humbje jo vetëm për ju, më dolën përpara kujtimet e Luftës heroike Nacionalçlirimtare, sidomos ato ditë që unë, me shumë shokë të tjerë luftëtarë,

kemi qëndruar në pyjet e Alipostivanit, ku na kishin rrethuar nazistët gjermanë të ardhur nga Korça, duke kaluar nga Pagria dhe Odriçani. Në këto çaste solla ndër mend fshatarët patriotë të atyre anëve që, duke u vluar në gji ndjenja e fortë e dashurisë për lirinë e mëmëdheut, bashkë me partizanët, ua bënë të pamundur fashistëve e tradhtarëve vënien në jetë të planeve të tyre mizore. Këto kujtime të luftës për çlirim kombëtar e shoqëror për veteranët, siç je edhe ti, i dashur Gani, që i ke jetuar ato kohë të vështira por të lavdishme, pse ke marrë pjesë vetë në Luftën Nacionalçlirimtare, janë të pashlyeshme për ne. Me tregimin e atyre ngjarjeve të mëdha të paharruara brezi ynë ndihmon për edukimin patriotik e revolucionar të bijave dhe bijve tanë që kanë lindur gjatë periudhës së ndërtimit socialist, duke i mbrujtur ata me traditat patriotike e revolucionare të popullit dhe me mësimet e mëdha të Partisë.

Me një edukatë të tillë ishte mbrujtur edhe biri juaj, Ylli, që lindi e u rrit në periudhën po aq të lavdishme të ndërtimit socialist dhe të luftës për mbrojtjen e atdheut nga armiqtë e brendshëm e të jashtëm, prandaj ai ishte bërë shembull në çdo drejtim kudo që jetoi e punoi, si në ushtri, në organizatën e rinisë dhe aty, në kooperativë. Dhe kur iu desh të ndeshej me forcat e verbra të natyrës, ai u bë edhe më trim e i vendosur dhe luftoi deri në fund për një qëllim fisnik, për të shpëtuar me çdo kusht pasurinë kooperativiste,

deri sa dha gjënë më të shtrenjtë, jetën e tij të re. Akti i lartë që i kushtoi jetën Yllit ju ka bërë ju, prindërit, edhe më të fortë. Vdekja e fëmijës, dhe sidomos e një të riu në lulëzim të jetës, sjell natyrisht një dhimbje jashtëzakonisht të fortë, sidomos për prindërit, por ju jeni nga ai brumë që dhimbjet nuk ju mundin. Përkundrazi, siç më shkruani në letër, si ushtarë besnikë të Partisë dhe të popullit, ju dhatë fjalën se do të vazhdoni të punoni edhe më shumë për përparimin e Alipostivanit tuaj malor e të bukur, për rritjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale të kooperativës, për të mirën e popullit e të atdheut, ashtu siç donte Ylli juaj i paharruar, prandaj ju përgëzoj nga zemra për këtë qëndrim tuajin.

Duke përfunduar dëshiroj të jeni mirë me shëndet dhe si patriotë të zjarrtë që jeni, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, të vazhdoni të punoni me të gjitha forcat për forcimin dhe begatinë e fshatit e të kooperativës suaj. Ju të dyve, fëmijëve tuaj dhe gjithë shokëve e shoqeve kooperativistë, ju bëj shumë të fala dhe ju uroj suksese e punë të mbarë.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT MUÇI PAJENGA

Tiranë

1 qershor 1976

Bashkëshortes, prindërve e fëmijëve

Mësova me hidhërim të thellë për vdekjen e papritur të bashkëshortit, djalit dhe babait tuaj të dashur, shokut tonë Muçi Pajengës. Si një bir besnik i popullit, qysh i ri ai u bë anëtar i Partisë dhe si i tillë ia kushtoi tërë jetën e tij çlirimit të atdheut dhe më vonë ndërtimit të socializmit në Shqipëri. Si komunist dhe anëtar i Komitetit Qendror të Partisë shoku Muçi do të mbetet i paharruar. Në këto çaste të dhimbshme ju dërgoj ngushëllimet e mia.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT ALI MYFTIU

Elbasan

25 qershor 1976

E dashur motër Shefikat,

Të dashur djem, vajza, motra e vëllezër të Aliut,

U preka thellë sa mora vesh për vdekjen e bashkëshortit, babait dhe vëllait tuaj, Ali Myftiut, miku dhe shoku ynë i vjetër. Unë ruaj kujtime për Aliun që nga kohët e vështira të Luftës Nacionalçlirimtare, me të cilën si patriot dhe komunist ai u lidh ngushtë dhe qëndroi ushtar besnik i Partisë deri në fund të jetës. Marr pjesë në dhimbjen tuaj dhe ju dërgoj me këtë rast ngushëllimet e mia më të ngrohta.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR PJESËMARRËSEVE TË TAKIMIT TË SHOQEVE NË VENDE DREJTUESE TË RRETHIT TË BERATIT

12 shtator 1976

Të dashura shoqe,

Nëpërmjet letrës që më dërguat, u njoha dhe u gëzova shumë për sukseset e mëdha që keni arritur me punën tuaj të palodhur në vendet me përgjegjësi të rrethit. Me këtë rast, në emër të Komitetit Qendror dhe timin, ju përshëndes e ju përgëzoj nxehtësisht për këto suksese.

Partia dhe Komiteti Qendror e kanë konsideruar dhe e konsiderojnë ngritjen e gruas në vende me përgjegjësi, në radhë të parë, si një çështje të madhe politike e ideologjike, që ka të bëjë me shkallën e emancipimit të gruas dhe të të gjithë shoqërisë. Partia e ka pasur vazhdimisht në qendër të vëmendjes këtë çështje, prandaj jo rastësisht, që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, u

zgjodhën edhe shoqe në vende drejtuese. Sot, qenia e grave dhe e vajzave të shumta në drejtim, deri në postet më të larta në Parti e në shtet, është një dëshmi e gjallë e lartësive të reja ku e ngriti Partia gruan shqiptare, e cila para Çlirimit dhe më parë në shekuj jetonte pa të drejta, e shtypur dhe e përbuzur.

Ju, të dashura shoqe, keni përvojë të pasur në punën prodhuese, jeni rritur bashkë me punën, keni dalë nga balta e ëmbël e atdheut, të cilin Partia jonë e Punës e lartësoi kaq shumë gjatë këtyre viteve heroike të ndërtimit të socializmit me forcat e veta, megjithëse të rrethuar nga armiq të egër e të shumtë.

Shembulli juaj në punë të mbush me frymëzim. Rezultatet e larta që keni arritur deri në zonat malore, si në Kozarë, në Bistricë, në Karkanjoz etj., në kulturën e grurit, të luledielli e të fasules, fryt i djersës së kooperativistëve, po edhe i punës suaj të madhe në drejtim, janë një kontribut i çmuar që ju jepni në drejtim të fuqizimit të ekonomisë dhe mbrojtjes së atdheut. Shoqet dhe shokët që punojnë e do të punojnë me ju, kanë për të mësuar shumë nga vetitë tuaja të mrekullueshme, nga dashuria për punën e për pronën socialiste, nga rregulli e nga disiplina e vetëdijshme, nga ndërgjegjja e patriotizmi juaj i lartë, prandaj ju gëzoni e do të gëzoni kurdoherë respektin e komunistëve, të punëtorëve, të kooperativistëve, të të gjithëve.

Sot në vendin tonë në drejtim nuk ka një

ose disa, por një masë të tërë grash e vajzash të ngritura në përgjegjësi në të gjithë sektorët e jetës, numër ky që vjen vazhdimisht duke u rritur, pse në Shqipërinë socialiste ato vlerësohen njëlloj si burrat dhe djemtë. Sukseset e arritura në këtë drejtim janë një mbështetje e fuqishme për ngritjen në të ardhmen me ritme më të shpejta të grave të afta në përgjegjësi, të cilat, sipas mësimeve të Partisë, nëpërmjet zhvillimit të luftës së klasave bashkë me shokët e tyre të punës, do të luftojnë kundër koncepteve e qëndrimeve konservatore e burokratike për të krijuar kudo opinion të shëndoshë, mendim të qartë dhe bindje të thellë mbi rolin dhe forcën e tyre në drejtim për ndërtimin e socializmit.

Konferencat e Partisë të rretheve që sapo mbaruan, kritikuan qëndrimet e huaja e bartësit e tyre për nënvleftësimin e gruas. Ato kritika të drejta duhet të mbahen vëth në vesh dhe komunistët të mobilizohen të gjithë për të çuar më përpara direktivën e Partisë për vënien e gruas në drejtim. Është detyrë e të gjitha organeve shtetërore dhe ekonomike, e organizatave të masave, sidomos e organizatës së gruas, që, nën udhëheqjen e Partisë, të përkrahin ngritjen në përgjegjësi, rregullisht e jo me fushata, të të gjitha atyre grave e vajzave që me besnikërinë e tyre ndaj socializmit, me zotësinë dhe me talentin e tyre, janë në pararojë për realizimin e detyrave. Të tërë, duke përfshirë edhe familjen tonë socialiste, e kanë për detyrë t'u krijojnë të gjitha

këtyre grave e vajzave kushte dhe ambient të ngrohtë për të punuar e drejtuar, për t'u ngritur politikisht e ideologjikisht, për të studiuar shkencën e teknikën e re dhe për t'u kualifikuar gjithnjë e më shumë si drejtuese.

Vështirësitë që ndeshen gjatë zhvillimit tonë kurrë nuk i kanë përkulur gratë revolucionare të vendit tonë; çdo shfaqje mosbesimi nga të tjerët dhe nga vetë ato në forcën e tyre si drejtuese, në sajë të kujdesit të vazhdueshëm të Partisë, që i çliroi, i përtëriu dhe u dha energji të reja, është duke u kapërcyer me sukses.

Duke ju përshëndetur ju, pjesëmarrëse të takimit të shoqeve drejtuese të rrethit të Beratit, përfitoj nga rasti që, në këto ditë të gëzueshme përpara festës së madhe e të 35-vjetorit të themelimit të Partisë dhe Kongresit të saj të 7-të, të përshëndes për sukseset që kanë arritur të gjitha gratë e vendit tonë, kudo që janë, në prodhim e në drejtim, dhe të shpreh besimin e plotë se, si kurdoherë, të bashkuara në organizatën tuaj të BGSH-së, ju do të mobilizoheni me të gjitha forcat për realizimin e detyrave të planit të gjashtë pesëvjeçar.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Kushtrimi», nr. 83 (936), 16 tetor 1976

LETËR DREJTUAR PIONIEREVE YLLKA LABI DHE MIMOZA HOXHA, NXËNËSE TË SHKOLLËS 8-VJEÇARE «KOTO HOXHI»

Gjirokastër

12 tetor 1976

Të dashura pioniere, Yllka dhe Mimoza,

Kur shokët u kthyen nga konferenca e Partisë e rrethit të Gjirokastrës, bashkë me tufën me lule që kishit mbledhur me shumë kujdes, më sollën edhe përqafimet tuaja, ashtu siç kishit kërkuar.

Ju falemnderit shumë për ndjenjat e pastra dhe për kënaqësinë që më ngjallën fjalët tuaja të ngrohta, të cilat shprehin atë dashuri të thellë që ju, si gjithë pionierët në të katër anët e atdheut, ushqeni për Partinë, mëmën tonë të urtë që punon pareshtur për lumturinë e fëmijëve dhe të të gjithë popullit tonë.

Përshëndetjet tuaja zgjuan për disa çaste kujtimet e rinisë sime për Gjirokastrën tonë të dashur, ku kam lindur edhe unë dhe ku kam dëshirë të madhe të vij ta shoh herë pas here, të çmallem me bukuritë e saj të shumta e, në radhë të parë, me bashkëqytetarët e mi të dashur, trima, punëtorë e patriotë të flaktë, të lidhur si mishi me thoin me Partinë.

Jam i bindur se si kudo, edhe në shkollën tuaj, në këto ditë që kanë mbetur përpara 35-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të lavdishme dhe të Kongresit të saj të 7-të, të gjithë, nxënës e mësues, jeni mobilizuar për të kryer më mirë se kurdoherë tjetër detyrat shkollore dhe shoqërore. Prandaj bashkë me ju të dyja, dëshiroj të uroj nga zemra gjithë kolektivin e shkollës, fatosa, pionierë dhe mësues, punë të mbarë dhe gëzuar e faqebardhë festat e mëdha.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Pararoja», nr. 83 (990), 16 tetor 1976

LETËR DREJTUAR DELEGATËVE TË KONGRESIT TË 8-TË TË BASHKIMEVE PROFESIONALE

Korçë

23 qershor 1977

Të dashur shokë dhe shoqe delegatë të Kongresit të 8-të të Bashkimeve Profesionale,

Me gjithë dëshirën time të zjarrtë për të marrë pjesë në atë forum të lartë të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, duke qenë mjaft i zënë me punë, nuk munda të vij dot kësaj radhe. Ju siguroj se gjithë këto ditë plot veprimtari intensive dhe shumë të frytshme që po zhvilloni për të analizuar punën e kryer dhe për të caktuar detyrat e mëdha që na presin për të ardhmen, mendjen e kam pasur dhe e kam aty, e kam ndier veten sikur të isha midis jush, shokë dhe shoqe delegatë të klasës sonë heroike punëtore

dhe të punonjësve të vendit tonë. Si delegat që kam nderin të jem zgjedhur në këtë Kongres, që po i zhvillon punimet në qytetin historik të Korçës në frymën luftarake dhe në dritën e mësimeve të mëdha të Kongresit të 7-të të Partisë së lavdishme të Punës të Shqipërisë, si të gjithë ju që ndodheni aty, edhe unë e ndiej për detyrë të shpreh miratimin e plotë dhe të jap votën time për ato vendime të rëndësishme që po merrni, për gjithë punimet e Kongresit të 8-të të Bashkimeve Profesionale.

Enver Hoxha

Delegat në Kongresin e 8-të të
Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë

«Për bashkimet profesionale»
(Përmbledhje veprash), f. 635

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT ZYLYFTAR VELESHNJA

Vlorë

27 gusht 1977

Me hidhërim të thellë mësova për vdekjen e bashkëshortit dhe babait tuaj shumë të dashur Zylyftarit, shokut tim të shtrenjtë të luftës, birit të devotshëm të Partisë e të popullit, që ia kushtoi gjithë jetën e tij çlirimit të atdheut, ndërtimit të Shqipërisë së re socialiste, duke mbetur kështu një shembull i lartë i luftëtarit trim dhe komunistit të vendosur.

Në këto çaste hidhërimi me zemër ndodhem pranë jush dhe ju shpreh ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË KOLË MARASH PEPËS

Tamarë — Shkodër

24 tetor 1977

Mësova sot me hidhërim për vdekjen e të dashurit të familjes suaj, birit besnik të maleve kreshnike të Kelmendit, plakut të mirënjohur luftëtar, patriot e zemërzjarrtë, Kolë Marashit, për të cilin ruaj kujtime të pashlyeshme gjatë njohjes me të në ditën e takimit të ngrohtë në Rrapsh-Starje më 2 shtator 1967 me popullin trim e bujar të krahinës suaj.

I dërgoj familjes suaj me këtë rast ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR JOZEFINA LAMBERCIT

25 janar 1978

E nderuara zonja Lamberc,

Ju jam mirënjohës për letrën që më drejtuat dhe për fjalët e mira që thoni në adresën tonë. Më lejoni t'ju dërgoj përshëndetjet më të përzemërta.

Ne e çmojmë lart veprimtarinë e shquar të të ndjerit profesor doktor Lamberc, tek i cili vendi ynë ka pasur gjithmonë një mik të vyer, që ka dhënë një kontribut të çmuar për gjuhën shqipe.

Nga letra juaj mësova se, nëpërmjet gazetave, keni ndjekur arritjet e vendit tonë. Kjo më gëzon.

Uroj që operacioni për të cilin më shkruani, të dalë me sukses.

Shëndet të mirë e jetë të gjatë.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT ZIHNI SAKO

Tiranë

3 maj 1978

I dashur shoku Zihni,

Në letrën me të cilën më informon për kryerjen me sukses të operacionit në zemër që iu bë djalit tuaj, Miroshit, ju shprehni me këtë rast atë dashuri të madhe që kurdoherë ushqeni si komunist për Partinë tonë të lavdishme, qëllimi më i lartë i së cilës është ndërtimi i socializmit, begatia dhe lumturia e mbarë popullit tonë, në të cilat çdo familje e individ i veçantë siguron edhe jetën e mirëqenien e vet. Të falënderoj nga zemra për gjithë ato fjalë të ngrohta e të sinqerta që më dërgon me letrën tënde.

Është i natyrshëm gëzimi i madh që ti, bashkëshortja dhe gjithë pjesëtarët e tjerë të famil-

jes keni në këto ditë që ju kthye në atdhe në gjendje të mirë djali, për të cilin edhe unë ju uroj që ta marrë veten sa më shpejt dhe të bëhet i aftë për të dhënë si gjithë rinia patriote e vendit tonë kontributin e tij për ndërtimin e socializmit dhe forcimin e atdheut tonë të dashur.

Ty, në mënyrë të veçantë, të uroj me këtë rast shëndet, gëzime familjare dhe suksese në punën me vlerë të madhe, siç është ajo e sektorit të folklorit, këtij thesari të paçmuar kulturor të popullit tonë që Partia e ka ngritur në një nivel të paparë. Folklori ynë, që pasqyron kulturën e shumanshme të popullit tonë gjatë shekujve, është një nga stolitë më me vlerë të kulturës sonë socialiste. Ai pasuron gjithnjë e më shumë dhe e bën përherë e më të mirë e më të pasur jetën shpirtërore të masave punonjëse të vendit tonë. Në mënyrë të veçantë te folklori gjejnë një burim të pashtershëm punonjësit e arteve të bukura, sidomos shkrimtarët, kompozitorët, koreografët e talentuar e të tjerë. Këta, të frymëzuar nga traditat e pasura të trashëguara nga e kaluara, u japin krijimeve të tyre krahas veshjes kombëtare edhe një përmbajtje të re të bazuar në mësimet marksiste-leniniste të Partisë dhe ndihmojnë kështu për edukimin me frymën e pastër të patriotizmit socialist njerëzit tanë që punojnë me të gjitha forcat për ta bërë Shqipërinë të ngjitë gjithnjë e më lart shkallët drejt majave të përparimit.

Duke përfunduar ty, bashkëshortes, vajzës dhe djemve ju uroj gjithë të mirat.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR NXËNËSES EDMIRA PETOVA NË SHKOLLËN «QEMAL STAFA»

Elbasan

23 maj 1978

E dashur Edmira,

E lexova me gëzim letrën tënde të shkruar pastër e bukur dhe më pëlqeu shumë. Por më tepër më pëlqyen fjalët aq të ngrohta që ty, vogëlushja Edmirë, t'i thotë zemra për Partinë tonë të dashur.

Ti, si gjithë shoqet e shokët e tu fatosa jeni lulet e freskëta të Shqipërisë sonë të bukur socialiste, prandaj Partia dhe pushteti kujdesen shumë që të rriteni me dashuri për atdheun socialist, për popullin, për prindërit dhe familjet, ata kujdesen që jetën tuaj ta bëjnë sa më të lumtur, që të jeni kurdoherë të fortë, të qeshur e të gëzuar.

Të uroj nga zemra shëndet dhe suksese në mësime, që, kur të rritesh, të bëhesh një vajzë e

edukuar, e ditur, punëtore dhe trimëreshë ashtu si nënat e motrat e tua të rritura në të katër anët e atdheut që në këto ditë presin të zhvillohet kongresi i tyre në Durrës. Prindërve të tu ju bëj të fala.

Të përqafoj me dashuri

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR OSMAN KASEM PANÇOS

Buenos-Ajres, Argjentinë

13 qershor 1978

Ju falënderoj për urimet që më dërguat me rastin e kremtimit të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ngjarje e shënuar në historinë e lavdishme të popullit shqiptar.

Si nga të gjithë ne këtu, edhe nga ju, patriotët shqiptarë në mërgim, përkujtohet me krenari përvjetori i Lidhjes së Prizrenit që është një vazhdim i luftërave e i përpjekjeve heroike që ka bërë populli ynë brez pas brezi për bashkimin kombëtar dhe për krijimin e një shteti të përparuar e demokratik.

Dëshirat e zjarrta të paraardhësve tanë dhe patriotëve të mëdhenj, si vëllezërit Frashëri me shokë, janë realizuar sot në Shqipërinë e re, ku populli shqiptar është bërë zot i fateve të tij dhe

ecën i sigurt përpara në rrugën e ndritur të socializmit i udhëhequr nga Partia e lavdishme e Punës.

Me këtë rast ty dhe gjithë shqiptarëve patriotë që jetojnë në Argjentinë dhe që u gëzohen përparimeve të pandërprera të mëmëdheut, ju dërgoj të falat e mia më të përzemërta e vëllazërore.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT PETRAQ PEPO

Tiranë

30 qershor 1978

Me rastin e 75-vjetorit të lindjes të uroj shëndet dhe jetë të gjatë.

Të përgëzoj që, si shumë pensionistë të tjerë të vendit tonë nuk je shkëputur nga puna, por njohuritë që ke vazhdon t'i vësh në të mirën e popullit dhe të atdheut tonë socialist.

Qofsh i lumtur dhe i gëzuar.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT BILBIL KLOSI

Tiranë

23 nëntor 1978

Bashkëshortes, vajzave dhe djemve,

Jam prekur shumë nga vdekja e papritur dhe e parakohshme e bashkëshortit dhe babait tuaj të dashur. Te Bilbili ne kishim një shok besnik dhe të vendosur, një komunist të vjetër që luftoi dhe punoi vazhdimisht pa u lodhur deri në fund të jetës së tij për çështjen e Partisë dhe të popullit në çdo situatë dhe detyrë që i qe caktuar, prandaj ai do të mbetet i paharruar. Në këtë rast kaq të dhimbshëm për gjithë familjen tuaj ju dërgoj ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHOQES HAJRIE CURRI

Tiranë

17 maj 1979

Vdekja e Ferides më preku thellë. Juve dhe njerëzve të afërt të saj ju dërgoj ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Ferideja ishte bijë e Bajram Currit, këtij biri të lavdishëm e trimi me fletë të popullit tonë, që lindi, u rrit e luftoi në gjirin e një krahine kreshnike dhe nuk kurseu asgjë për të mbrojtur lirinë e pavarësinë e popullit shqiptar nga synimet grabitqare të fuqive imperialiste dhe të armiqve shovinistë fqinjë, që përbuzi e përballoi me burrëri të rrallë persekutimet e egra të regjimit antipopullor e antishqiptar zogollian.

Edhe një herë ju dërgoj ngushëllimet e mia

për vdekjen e Ferides, motrës suaj dhe bijës së Bacë Bajramit të pavdekshëm.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHYQYRI TAIP HAFIZIT

Shkodër

21 qershor 1979

Bashkëshortes, vajzave, djalit,

Jam prekur thellë për vdekjen e papritur të Shyqyriut, njeriut tuaj më të dashur, shokut tonë dhe anëtarit të vjetër e të devotshëm të Partisë.

Shyqyriu tërë jetën e tij e vuri në shërbim të atdheut, të popullit e të Partisë. Si mësues e edukator i brezit të ri, kudo që ishte, ai përhapi me guxim idetë komuniste dhe mësimet e Partisë së Punës, besnik i të cilave qëndroi deri në fund. Si komunist, kuadër e patriot i zjarrtë, ai qëndroi kurdoherë i thjeshtë, i dashur, i ndershëm dhe njeri i sakrificës, prandaj ishte e do të mbetet shembull frymëzimi për të gjithë.

Ju dërgoj me këtë rast kaq të dhimbshëm ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË REXHEP SELIMIT

Pirg — Korçë

20 gusht 1979

E dashura nënë Pashako,

Me hidhërim të madh mësova për vdekjen e djalit tuaj të dashur, Neimit. Me zemër ndodhem aty, pranë jush, në këto momente kaq të hidhura për familjen tuaj të nderuar.

Jeta e Neimit dhe qëndresa e tij burrërore përpara egërsisë së fashistëve, për rininë tonë do të mbeten një shembull guximi, vendosmërie e besnikërie ndaj popullit, atdheut e Partisë.

Ti, e dashur nënë Pashako, nëna e djemve trima që nuk kursyen as jetën për çlirimin e atdheut, ashtu sikurse i kishe mësuar vetë, që me vendosmëri u bëre ballë dallgëve të mëdha të Luftës Nacionalçlirimtare, edhe sot me siguri, si

kurdoherë, do të qëndrosh e pamposhtur e me frymë të lartë patriotike përpara kësaj dhimbjeje të re të madhe.

Ju dërgoj me këtë rast ngushëllimet më të ngrohta të miat dhe të Nexhmijes ty dhe gjithë familjes suaj.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE TË BRAZILIT

27 nëntor 1979

Shokut Zhoao Amazonas,

Me hidhërim të thellë mësuam për vdekjen e papritur e të parakohshme të shokut të dashur Diogenes Arruda, një nga bijtë më të shquar revolucionarë të popullit brazilian, udhëheqës i dashur dhe i respektuar i Partisë Komuniste të Brazilit.

Vdekja e shokut Diogenes Arruda është një humbje e madhe për Partinë Komuniste motër të Brazilit dhe për gjithë revolucionarët e njerëzit përparimtarë brazilianë, sepse ata humbën një nga komunistët e orëve të para, militantin e paepur që për gati 50 vjet vuri në shërbim të popullit e të revolucionit në Brazil gjithë jetën dhe talentin e tij si revolucionar. Ai luftoi me një vendosmëri shembullore kundër reaksionit

dhe sundimit fashist në vend, kundër imperializmit e ndërhyrjeve të tij, zhvilloi në mënyrë konsekuente një luftë të vendosur për fitoren e lirisë, të demokracisë e të socializmit dhe nuk u gjunjëzua asnjëherë nga presionet e shumta, nga burgjet e torturat çnjerëzore. Shoku Arruda i qëndroi kurdoherë besnik marksizëm-leninizmit dhe luftoi me guxim kundër revizionizmit të çdo ngjyre, si në plan kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar. Shembulli i tij si luftëtar revolucionar marksist-leninist dhe si udhëheqës do të mbetet kurdoherë i gjallë në mendjet e në zemrat e shokëve të tij të luftës.

Shoku Diogenes Arruda ishte një mik i dashur e i sinqertë i popullit shqiptar, i Partisë së tij të Punës e i socializmit në Shqipëri. Vizitat e tij në vendin tonë, takimet e bisedat me të do të mbeten një kujtim i paharruar për ne.

Të prekur thellë nga kjo humbje e madhe për Partinë Komuniste motër të Brazilit, në këto momente të rënda ne e ndiejmë veten edhe më afër jush. Ne marrim pjesë në këtë hidhërim bashkë me ju dhe ju lutemi t'i transmetoni familjes së shokut Arruda ngushëllimet tona më të sinqerta.

Jemi të bindur se Partia Komuniste e Brazilit do të dijë të përballojë këtë dhimbje të madhe, duke forcuar edhe më shumë unitetin rreth Komitetit Qendror të saj, për të çuar kurdoherë përpara idealet e revolucionit e të marksizëm-leninizmit, për të cilat shoku Diogenes Arruda

luftoi gjithë jetën e tij si një militant i shquar revolucionar.

Lavdi kujtimit të shokut Diogenes Arruda!

Enver Hoxha

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 287 (9775), 1 dhjetor 1979

TELEGRAM DËRGUAR PROFESOR EQREM ÇABEJT

Romë

29 dhjetor 1979

Ambasadës së RPSSH,

T'i transmetohet nga ana juaj profesor Eqrem Çabejt sa më poshtë:

Ju uroj nga zemra një vit të lumtur e të gëzuar. Ju uroj, gjithashtu, shërim të shpejtë e të na kthehesh me shëndet të plotë.

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR JANI KARAMBISHTIS,

Mandra Attikis Greqi

9 janar 1980

I nderuari zoti Jani Karambishtis,

Ju falënderoj me gjithë zemër për letrën dhe urimet e ngrohta që më dërgove me rastin e Vitit të Ri dhe për gëzimin e ndjenjat e dashurisë që shpreh në të për sukseset që ka arritur populli ynë.

Duke përfituar nga rasti që më jepet për t'iu përgjigjur letrës suaj, dëshiroj të vë në dukje se populli shqiptar ushqen një dashuri e respekt për popullin vëlla grek dhe do të përpiqet ta shtojë miqësinë me të, me të cilin prej shumë shekujsh ju, arvanitasit, keni jetuar në miqësi vëllazërore dhe keni ndarë së toku gëzimet dhe hidhërimet.

Edhe unë ju uroj me gjithë familjen nga mot

gëzuar festën e Vitit të Ri dhe ty jetë të gjatë e të lumtur!

Enver Hoxha

«Dy popuj miq», f. 326

LETËR DREJTUAR PUNONJËSVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

11 mars 1980

Të dashur shokë,

Sihariqi juaj për zbulimin e një vendburimi të ri të naftës ka gëzuar shumë gjithë udhëheqjen e Partisë dhe mua. Ai do të gëzojë, gjithashtu, pa masë gjithë Partinë dhe popullin tonë. Prandaj, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Qeverisë, në emër të të gjithë Partisë dhe timin, ju dërgoj juve përgëzimet më të nxehta për këtë dhuratë që i bëtë atdheut në vitin e fundit të pesëvjeçarit të gjashtë.

Zbulimi i vendburimit të ri të naftës përbën një sukses me vlerë të madhe për ekonominë socialiste të vendit tonë. Kurdoherë, por veçanërisht tani, në momente shumë të rënda të krizës energjetike botërore, nafta, kjo lëndë e parë bazë për vënien në lëvizje të prodhimit dhe të arterieve të ndërlidhjes, ka qenë dhe është një faktor me vlerë shumë të madhe për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit me forcat tona.

Atdheu ynë është i pasur me këtë lëndë kaq të nevojshme e të çmueshme të nëntokës. Në të kaluarën atë na e grabitnin kapitalistët e huaj. Pas Çlirimit armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm u përpoqën të na sabotonin, duke çorientuar kërkimet për zbulimin e kësaj lënde kaq të nevojshme për ne, për ta lënë këtë me qëllim të fshehur në thellësitë e nëntokës, gjersa edhe Shqipërinë socialiste ta kthenin, sikurse synonin, në një vend kapitalist, pastaj pasuritë e saj t'i grabitnin të huajt e t'i përdornin për qëllimet e tyre imperialiste e kolonialiste.

Por ju, të dashur naftëtarë, punëtorë, teknikë, inxhinierë e punonjës të mrekullueshëm të naftës, të brumosur me ndjenjat e një patriotizmi të zjarrtë socialist dhe të udhëhequr nga idealet e larta të Partisë sonë të lavdishme, u dhatë grushtin e vdekjes komploteve, shpresave dhe ëndrrave të çmendura të të gjithë armiqve. Ju bëtë që nafta të mbetet pasuri e popullit përjetë, që ajo të vazhdojë të burojë këtu për zhvillimin dhe përparimin e ekonomisë sonë socialiste, për mirëqenien e punonjësve tanë.

Të dashur shokë,

Zbulimi nga ju i vendburimit të ri të naftës nuk është një ngjarje e rastit, por kurorëzimi i një pune të vazhdueshme të palodhur, që e ka burimin te bindjet tuaja të thella në drejtësinë e vijës së Partisë sonë, te ndërgjegjja e lartë kla-

sore që ju karakterizon për kuptimin e drejtë të situatave, për kapërcimin e vështirësive të rritjes dhe të atyre që na krijojnë armiqtë imperialistë e revizionistë të të gjitha ngjyrave. Suksesi juaj është rezultat i punës së organizuar, i disiplinës proletare, i studimeve shkencore, i përvetësimit dhe i zbatimit të të rejave të shkencës, i bashkëpunimit dhe i unitetit të çeliktë midis punonjësve me teser e pa teser partie. Fitorja juaj është rezultat, gjithashtu, i mirëmbajtjes dhe i shfrytëzimit me efektivitet të plotë e mjeshtëri të madhe të mjeteve të rëndësishme dhe të aparaturave të komplikuara e moderne që Partia, pushteti dhe populli ju kanë besuar.

Ju, shokë, që punoni në sektorin e rëndësishëm të naftës, Partia ju ka konsideruar e ju konsideron nga punëtorët e specialistët e pararojës, luftëtarë të vendosur dhe të papërkulur, që militoni kurdoherë në radhët e para të përpjekjeve për shtimin e prodhimit dhe mbrojtjen e atdheut socialist. Ju gjithnjë keni menduar dhe keni punuar me të gjitha forcat tuaja, fizike e mendore, për të vënë në jetë direktivat e Partisë, për të prodhuar sa më shumë naftë në interes të përparimit të vendit tonë. Suksesi juaj tregon se realizimi i detyrave jetike të prodhimit e të mbrojtjes, lypin nga çdo qytetar i republikës, veç të tjerave, ngritje të vazhdueshme ideologjike, politike e teknike, lypin drejtim shkencor, organizim të përsosur, zbatim të përpiktë të objektivave, kontroll të vazhdueshëm individual e kolektiv të zbati-

mit të detyrave, lypin një disiplinë të fortë e plotësisht të ndërgjegjshme proletare.

Të dashur shokë,

Duke shprehur gëzimin e madh për lajmin që na dhatë, edhe një herë ju përshëndes dhe ju përgëzoj për fitoren që arritët. Ju uroj suksese gjithnjë më të mëdha për të mirën e popullit, të Partisë e të atdheut. Jam plotësisht i bindur se ju do t'i bëni realitet zotimet që merrni për zbulimin e vendburimeve të reja të naftës e të gazit, duke pasur parasysh porosinë e Kongresit të 7-të të Partisë se në punën për zbulimin e këtyre pasurive «brezi ynë e ka për detyrë të mendojë edhe për brezat e ardhshëm».

Përpara, shokë, drejt fitoreve të reja, fitore që forcojnë gjithnjë më shumë atdheun tonë socialist, që thyejnë çdo bllokadë e përpjekje për izolimin e vendit tonë, që na bëjnë gjithnjë e më të pavarur e të paprekshëm nga fenomenet e rënda të krizave të pashërueshme që kanë mbërthyer vendet kapitalisto-revizioniste.

Përshëndetje revolucionare!

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 62 (9862), 13 mars 1980

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT ETHEM GJINUSHI

Tiranë

17 mars 1980

Bashkëshortes, vajzave, djalit,

Mësova me hidhërim të madh për vdekjen e papritur të bashkëshortit dhe babait tuaj të dashur dhe shokut tonë të vjetër të luftës dhe të ndërtimit të socializmit, Ethem Gjinushit.

Ethemi ishte një nga komunistët e parë, anëtar besnik i Partisë sonë dhe luftëtar trim e sypatrembur gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Ai ishte, gjithashtu, një nga kuadrot më të vjetër të Ushtrisë sonë Popullore, në radhët e së cilës shërbeu deri në fund gati tërë periudhën pas Çlirimit të atdheut me devocion e pa u lodhur.

Gjithë familjes suaj i dërgoj në këto çaste pikëllimi ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË FEJZO HOXHËS

Tiranë

Pogradec, 7 korrik 1980

Të dashur Afërdita, Tatjana, Edmond e Robert,

Sapo mësuam lajmin shumë të hidhur, vdekjen e bashkëshortit dhe babait tuaj, që ishte edhe si vëllai im, që e donim dhe e respektonim shumë.

Fejzoja ishte patriot dhe besnik i patundur ndaj popullit tonë dhe Partisë, anëtar i denjë i së cilës ishte. Ai ka luftuar për çlirimin e atdheut dhe ka punuar pa u lodhur me vullnet e ndërgjegje të lartë në radhët e Partisë dhe të Ushtrisë sonë Popullore, prandaj gëzonte dashurinë dhe respektin e shokëve të punës dhe për këtë ai do të mbetet kurdoherë i paharruar për të gjithë.

Në këto çaste hidhërimi të madh për njeriun tuaj të shtrenjtë, unë, Nexhmija dhe fëmijët, e

ndiejmë veten pranë jush, ndajmë së toku dhimbjen e rëndë që ju shkaktoi humbja e tij e parakohshme dhe ju dërgojmë ngushëllimet më të ngrohta.

Të rrosh vetë ti, motër Afërdita, të të rrojnë Tatjana dhe djemtë.

Ju përqafoj me dashuri.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHOQES QANIJE XHINDOLE

Berat

Pogradec, 11 gusht 1980

E dashur shoqja Qanije,

Vdekja e papritur e nënës suaj shumë të dashur e të respektuar, motrës sonë Xhezmie, më ka prekur thellë. Në këto çaste tepër të rënda, veçanërisht për ty personalisht, me zemër e me mendje ndodhem pranë teje për të ndarë këtë dhimbje tënden dhe të të afërmve të tu. Bashkë me Nexhmijen të dërgojmë ngushëllimet më të ngrohta.

Xhezmia, që e kam takuar disa herë dhe kam biseduar shtruar me të, ishte një nënë trime e me zemër të madhe, një patriote e kulluar dhe e flaktë, që e ktheu shtëpinë e vet në një bazë të rëndësishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirim-

tare në rrethin e Beratit. Ajo kurrë nuk iu tremb kërcënimeve e presioneve të egra të armiqve okupatorë dhe shërbëtorëve të tyre vendës, nuk iu tremb asnjë sakrifice, përkundrazi, me frymën e besnikërisë ndaj atdheut dhe Partisë edukoi, rriti dhe ia fali Partisë birin e saj të shtrenjtë, Heroin e Popullit Ajet Xhindole, të edukoi e të rriti edhe ty motër Qanije.

Jam i bindur se ti do ta përballosh me kurajë komuniste e me durim këtë dhimbje të fortë.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT PETRIT RADOVICKA

Tiranë

1 tetor 1980

I dashur shoku Petrit,

Me gëzim të veçantë të dërgoj urimet e mia me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes.

Si një anëtar i denjë i Partisë sonë, si kuadër e shkencëtar, gjithë jetën dhe punën ti ia ke kushtuar veprimtarisë studiuese e krijuese në fushën e hidroenergjetikës si dhe përgatitjes së kuadrove të lartë të vendit. Jam i bindur se edhe në të ardhmen do të vazhdosh të punosh me pasionin që të karakterizon për të mirën e përparimin e pandërprerë të atdheut tonë socialist.

Dëshiroj të kesh shëndet, gëzime e lumturi familjare.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOQES AISHE ALIMERKO[1]

Vlorë

15 tetor 1980

E dashura nënë Aishe,

E prita me gëzim letrën që më dërgove, nga e cila mësova se je mirë me shëndet, e fortë, e lumtur dhe e gëzuar midis nipërve e mbesave që të mbushin shtëpinë. E gëzuar dhe e lumtur qofsh kurdoherë së bashku me gjithë të dashurit e tu.

Me këtë rast të falënderoj nga zemra për urimet aq të ngrohta që më dërgove për ditëlindjen time.

Të përshëndes e të përqafoj me respekt dhe të dëgjofsha gjithnjë të mirën.

Yti

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

1. Nëna e Heroit të Popullit Shyqyri Alimerko.

LETËR DREJTUAR SEKRETARIATIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE PORTUGEZE (E RINDËRTUAR)

Lisbonë

5 nëntor 1980

Të dashur shokë,

Ju falënderoj nga zemra për urimet që më dërguat me rastin e ditëlindjes sime.

Mesazhin tuaj të ngrohtë e plot ndjenja të thella revolucionare e konsideroj si shprehje të solidaritetit internacionalist e të miqësisë së sinqertë të komunistëve marksistë-leninistë e të popullit portugez ndaj komunistëve dhe popullit shqiptar.

Komunistët dhe populli ynë ndjekin me simpati luftën e vendosur të Partisë suaj në mbrojtje të interesave të klasës punëtore dhe të masave të gjera punonjëse portugeze, si dhe për çështjen e revolucionit e të socializmit. Për këto arsye ato

ushqejnë respekt për Partinë motër Komuniste Portugeze (e Rindërtuar).

Përfitoj nga rasti që, në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës, të komunistëve dhe të popullit shqiptar, si dhe në emrin tim personal, t'ju dërgoj juve e nëpërmjet jush gjithë komunistëve dhe popullit punonjës liridashës e përparimtar portugez, përshëndetjet më të përzemërta dhe t'ju uroj suksese gjithnjë më të mëdha në jetën e Partisë dhe të popullit tuaj mik.

Le të rrojë e të triumfojë ideologjia jonë e pavdekshme, marksizëm-leninizmi ngadhënjimtar.

Përshëndetje revolucionare

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR DEGËS SË SHOQATËS SË MIQËSISË FRANCË-SHQIPËRI

Bordo

12 nëntor 1980

Të dashur e të respektuar miq të Shqipërisë nga Bordoja dhe Burzhi,

Më gëzuan shumë letra plot ndjenja miqësie të sinqertë për Shqipërinë socialiste që më dërguat, si dhe urimet për ditëlindjen time. Gjithashtu jam prekur thellë nga gjesti juaj fisnik për pritjen që i bëtë me aq dashamirësi në një mbledhje të ngrohtë një grupi studentësh, bij të popullit tonë që e do dhe e respekton popullin francez. Për të gjitha këto ju falënderoj nga zemra.

Qëndrimi juaj aq miqësor ndaj studentëve tanë nuk është i rastit, ai e ka burimin te mikpritja tradicionale e popullit të talentuar, trim e liridashës francez dhe është shprehje e miqësisë që ekziston prej kohësh midis dy popujve tanë, miqësi që u ka shërbyer gjithnjë qëllimeve të mira, bashkëpunimit dhe mirëkuptimit reciprok. Falënderoj, gjithashtu, miqtë e nderuar të Komi-

tetit të Bordosë të Shoqatës së Miqësisë Francë-Shqipëri për punën që bëjnë dhe për kujdesin që tregojnë për forcimin e miqësisë me popullin tonë.

Ne, shqiptarët, kemi një konsideratë të veçantë për popullin francez, për kulturën e tij të madhe dhe kontributin që ka dhënë e vazhdon të japë ai në thesarin botëror të kulturës, të shkencës, të artit e të teknikës, përhapës të të cilave janë edhe shkollat e larta e universitetet franceze, midis tyre edhe Universiteti i Bordosë, i njohur për traditat e tij.

Me rastin e dërgimit të kësaj letre dëshiroj t'ju them me kënaqësi se e ndiej veten të lumtur që djemtë dhe vajzat tona ndodhen për studime midis miqsh aq të sinqertë e të dashur si ju dhe t'ju siguroj se ata do të punojnë që ta forcojnë këtë miqësi dhe në të njëjtën kohë do të përpiqen me këmbëngulje për të përfituar nga kultura e madhe franceze që vetë personalisht e kam dashur dhe e çmoj shumë.

Ju dërgoj përshëndetjet e mia më të përzemërta. Le të lulëzojë e të forcohet gjithnjë e më shumë miqësia midis popullit shqiptar dhe popullit mik francez!

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOQES KORI ANASTASI

Korçë

10 janar 1981

U gëzova për martesën e mbesës tënde, Mamicës. Tok me shokun e saj të kalojnë jetë të lumtur, të gëzuar e të jenë të palodhur në punë. Ty të uroj shëndet. Bashkë me fëmijët ju përqafoj. Urime keni edhe nga ana e Nexhmijes.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOQES ATLIJE BALLA

Elbasan

28 janar 1981

E nderuara Atlije,

Letra jote e thjeshtë, plot dashuri e besim për jetën, për atdheun e për Partinë, më solli gëzim e kënaqësi. Të falënderoj për të dhe në të njëjtën kohë ju uroj të gjithëve në familje shëndet, gëzime e lumturi. Shpreh bindjen se ti, si nënë e kujdesshme që je, së bashku me burrin, të 11 fëmijët që i doni aq shumë, do t'i rritni të lidhur me shkollën e me punën dhe do t'i edukoni me ndjenjat e dashurisë për Partinë dhe popullin, për t'u bërë njerëz të devotshëm për shoqërinë tonë socialiste.

Ju dërgoj përshëndetjet e mia ty dhe bashkë-

shortit, ndërsa fëmijët tuaj i përqafoj të gjithë së largu.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT MITI BOZO

Tiranë

21 mars 1981

Bashkëshortes, fëmijëve dhe motrave të shokut Miti Bozo,

Me hidhërim të thellë mësova për vdekjen e papritur e të parakohshme të Mitit, bashkëshortit, prindit dhe vëllait tuaj shumë të shtrenjtë, shokut tonë të dashur të luftës e të punës, punëtorit të palodhur të Partisë.

Partia e ngarkoi shokun Miti vazhdimisht me detyra të rëndësishme e me përgjegjësi deri në aparatin e Komitetit Qendror. Këto detyra ai i përmbushi kurdoherë me vullnet e besnikëri dhe nuk u kursye kurrë për t'i shërbyer popullit dhe Partisë derisa vdiq në krye të detyrës.

Aftësitë dhe dijet e çmuara të tij Miti ia ku-

shtoi zhvillimit e përparimit të bujqësisë sonë socialiste. Ai ishte një nga shokët më të aftë e më të përgatitur në këtë degë të ekonomisë. Me punën, sjelljen, urtësinë dhe partishmërinë e tij shembullore, shoku Miti ka merituar gjithnjë dashurinë dhe respektin e shokëve dhe të bashkëpunëtorëve të tij në qendër e në rrethe.

Në këto çaste të rënda dëshiroj të jem pranë jush, të ndaj bashkë me ju dhimbjen që ju shkaktoi humbja e tij dhe të shpreh ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHABAN MURATIT, KRYETAR I SHOQËRISË PATRIOTIKE E I KOLONISË SË SHQIPTARËVE TË AUSTRALISË

Uestern — Australi

8 maj 1981

Mora urimet shumë të ngrohta që më dërguat për festën e 1 Majit dhe ju falënderoj nga zemra. Ju falënderoj, gjithashtu, për fjalët e mira e plot patos patriotik që më shkruani dhe për gëzimin që ndieni për fitoret e popullit shqiptar, të vëllezërve e motrave tuaja, në ndërtimin e jetës së tyre të re.

Juve personalisht dhe nëpërmjet jush gjithë anëtarëve të shoqërisë e të kolonisë shqiptare në Australi ju dërgoj përshëndetjet dhe urimet e mia më të ngrohta. Uroj që familjarisht të jenë gjithnjë të lumtur, të gëzuar e me shëndet të

mirë. Qofshi të palodhur në punën patriotike për Shqipërinë socialiste që aq shumë e doni dhe që ajo, gjithashtu, aq shumë ju do dhe si bijtë e saj të largët nuk ju harron.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM
DËRGUAR PERSEFONI DHE THANAS KARÇINIT

SHBA

8 maj 1981

Ju falënderoj përzemërsisht për urimet që më dërguat me rastin e festës së 1 Majit. Përfitoj nga ky rast, për t'ju dërguar edhe unë përshëndetjet dhe urimet më të mira për familjen tuaj.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT RRAPO DERVISHI

Tiranë

3 tetor 1981

Mësova që ditët e fundit festove 60-vjetorin e ditëlindjes. Të dërgoj me këtë rast të gëzueshëm për ty dhe familjen përshëndetjet e mia më të mira dhe të uroj nga zemra shëndet e vite të tjera të frytshme, aktive e revolucionare në detyrat me përgjegjësi që të ka ngarkuar Partia për të mirën e popullit e të atdheut tonë socialist.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË HEROIT TË POPULLIT MISTO MAME

Tiranë

5 tetor 1981

Të dashura Agathi, Fero, Lefteri dhe Amali,

Lajmi për vdekjen e Aspasisë, nënës suaj të dashur, nënës së shtrenjtë të shokut tonë të paharruar Mistos, më preku shumë thellë. Me zemrën e saj të madhe e me patriotizmin e saj të zjarrtë, ajo ju edukoi ju me ndjenja të pastra e dashuri të thellë për popullin, për atdheun dhe për Partinë, me vendosmëri për t'u qëndruar atyre kurdoherë besnikë siç qëndroi edhe vetë deri në fund të jetës së saj.

Ju dërgoj juve me këtë rast të hidhur ngushëllimet e mia më të mira.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT DRITËRO AGOLLI

Tiranë

13 tetor 1981

Me rastin e 50-vjetorit të lindjes, të dërgoj përgëzimet dhe përshëndetjet e mia më të mira ty dhe familjes tënde. Ashtu si deri më sot, edhe në vitet e ardhshme zemra, mendja dhe pena jote le të jenë burim krijimtarie revolucionare e patriotike në shërbim e për të mirën e popullit, të Partisë e të atdheut socialist.

Të uroj jetë të gjatë, gëzime e lumturi, suksese të mëtejshme në punën krijuese me partishmëri të lartë e me vlera të mëdha edukative, si dhe në veprimtarinë tënde të dobishme shoqërore.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT PROKOP MURRA

Tiranë

24 nëntor 1981

I dashuri shoku Prokop,

Jam shumë i gëzuar që me rastin e 60-vjetorit të lindjes të të dërgoj urimet e mia më të përzemërta.

Partia ka në personin tënd një anëtar besnik dhe luftëtar të vendosur që ka punuar tërë jetën pa u lodhur me ndërgjegje të lartë komuniste, me devotshmëri e besnikëri të pakufishme ndaj popullit, atdheut dhe marksizëm-leninizmit. Në të gjitha detyrat me përgjegjësi që të janë ngarkuar në sektorë të ndryshëm të jetës së vendit, ti ke luftuar me vendosmëri e principialitet të lartë revolucionar për t'i kryer ato kurdoherë me nder.

Me rastin e kësaj ngjarjeje të shënuar të

jetës tënde, të përshëndes nga zemra dhe të uroj shëndet, suksese të mëtejshme në detyrat me përgjegjësi të mëdha që të ka ngarkuar Partia, lumturi e gëzime familjare.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR FALËNDERIMI DREJTUAR XHEK SHULMANIT

2 dhjetor 1981

I dashur shoku Xhek Shulman,

Ju falënderoj nga zemra për urimet që më dërguat me rastin e 40-vjetorit të themelimit të PPSH dhe Kongresit të saj të 8-të si dhe për konsideratat që shprehnit në adresë të Partisë sonë dhe të popullit shqiptar.

Ju uroj juve dhe bashkëshortes shëndet të mirë dhe suksese në punën tuaj të vyer internacionaliste.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT TË NDËRMARRJES BUJQËSORE «8 NËNTORI»

Maliq

4 shkurt 1982

Të dashur shokë e shoqe,

Arritjet që keni shënuar gjatë vitit 1981 dhe njoftimi që më bëtë për tejkalimin e zotimeve që kishit marrë për prodhimin e drithërave të bukës, perimeve, foragjereve, prodhimeve blegtorale, të treguesve të ndryshëm financiarë të ndërmarrjes suaj e të tjera, pas njoftimeve të gëzueshme që mora kohët e fundit nga kooperativa bujqësore e tipit të lartë të Dajçit në rrethin e Shkodrës, ishin për mua një tjetër sihariq. Me këtë rast ju dërgoj urimet e përshëndetjet e mia më të ngrohta shoqërore.

Puna juaj e palodhshme, si dhe rezultatet që keni korrur, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, dëshmojnë për ndërgjegjen e lartë socialiste, mobilizimin e gjithanshëm dhe frymën revolucionare të kolektivit tuaj pararojë. Ato gëzojnë mbarë popullin tonë, që me klasën punëtore heroike në ballë, i është përveshur punës me vrull për të

vënë në jetë detyrat madhështore të Kongresit të 8-të të Partisë për ndërtimin dhe mbrojtjen e atdheut socialist.

Të dashur shokë e shoqe,

Ndërmarrjeve bujqësore, si forma më e lartë e organizimit të bujqësisë socialiste, Partia u ka besuar rolin e pararojës për prodhimin, organizimin dhe zbatimin e metodave të reja agroteknike, me qëllim që ato të bëhen shembull për rendimente të larta dhe rentabilitet në prodhimet bujqësore e blegtorale dhe shkolla ku të mësojnë edhe kuadro e punonjës të kooperativave bujqësore të vendit.

Ndërmarrja juaj bujqësore po e plotëson me nder këtë detyrë. Ajo është bërë një shembull shumë i mirë për të gjitha ekonomitë bujqësore të vendit tonë. Arritjet tuaja janë fakte dhe flasin vetë. Unë, në emër të Partisë dhe në emrin tim personal ju them: ju lumtë! Vazhdoni të ecni përpara në rrugën e drejtë shembullore që keni nisur, në të cilën ju udhëheq Partia jonë e lavdishme.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 30 (10 457), 5 shkurt 1982

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT LLAMBI GEGPRIFTI

Tiranë

14 shkurt 1982

Të dërgoj urimet e mia më të mira për 40-vjetorin e lindjes. Ashtu si deri më sot, edhe në të ardhmen, paç suksese edhe më të mëdha në kryerjen me devotshmëri revolucionare të detyrave me shumë rëndësi që të ka ngarkuar Partia për çështjen e madhe të popullit, për ndërtimin socialist e mbrojtjen e vendit tonë.

Të uroj shëndet dhe gëzime e lumturi në jetën familjare.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR ANËTARËVE TË KOOPERATIVËS SË TIPIT TË LARTË HERO I PUNËS SOCIALISTE TË CAKRANIT

Fier

24 mars 1982

Të dashur shokë kooperativistë e kooperativiste, brigadierë, specialistë e kuadro drejtues të kooperativës,

Më gëzoi shumë letra që më dërguat, me të cilën më njoftuat për arritjet tuaja gjatë vitit që kaloi, pse ato i shërbejnë fuqizimit të kooperativës suaj dhe gjithë ekonomisë së atdheut tonë e, në të njëjtën kohë, vërtetojnë drejtësinë e vijës së Partisë në zhvillimin socialist të fshatit. Më gëzoi, gjithashtu, zotimi juaj për t'i konsideruar këto arritje vetëm si hapat e parë, vendosmëria e vullneti juaj për përparime akoma më të mëdha, që do ta forcojnë më tej kooperativën e do t'ju bëjnë jetën më të begatë.

Kjo vendosmëri e ky vullnet janë shprehje e frymës së lartë revolucionare që ju karakterizon dhe e besimit tuaj të patundur në vijën e urtë të Partisë. Jam i bindur se ju do t'i arrini objektivat e rinj që i keni caktuar vetes. Këtë ju e keni vërtetuar me punën e palodhur, me qartësinë e kuptimin e drejtë politik e ideologjik të detyrave. Të jeni të sigurt se në çdo hap, si kurdoherë edhe në të ardhmen, do të keni mbështetjen e plotë të Partisë dhe ndihmën e pakursyer të pushtetit popullor. Ju dërgoj me këtë rast, në emër të Partisë, të Komitetit Qendror të saj dhe timin, përgëzimet më të mira për çka keni bërë dhe shpreh bindjen se do të ecni gjithnjë përpara e pa u ndalur në rrugën e drejtë që keni nisur.

Të dashur shokë e shoqe të Cakranit,

Kooperativa juaj bën pjesë në krahinën e bukur të Mallakastrës, ku jeton e punon një popull trim me tradita patriotike e revolucionare, i lidhur që në fillim si mishi me thoin me Partinë, së cilës i ka qëndruar e i qëndron vazhdimisht besnik pa ia bërë asnjëherë fjalën dy. Bijtë e bijat e Mallakastrës, ashtu si të gjithë Shqipërisë, luftuan heroikisht, shumë prej tyre dhanë jetën gjatë Luftës së madhe Nacionalçlirimtare dhe sot nuk kursejnë asgjë për ndërtimin socialist dhe mbrojtjen e atdheut.

Por Mallakastra nuk është vetëm një vatër

e zjarrtë patriotike e luftërave për liri, për dije e përparim, ajo është edhe një krahinë nga më pjelloret e atdheut për prodhimin e drithërave, të bimëve industriale e rritjen e blegtorisë, një krahinë shumë e përshtatshme për frutikulturën dhe për pemën me vlera të mëdha të ullirit.

Ashtu si për të gjithë vendin, Partia ka pasë menduar e mendon edhe për zhvillimin ekonomik të Mallakastrës, për përmirësimin e jetës së popullit të saj trim e patriot në rrugën e socializmit. Përparimet në këtë drejtim të gjithë i shohim me sytë tanë, ndërsa të mirat e tij i gëzon vetë populli i kësaj krahine. Ballshi nga një qytet i rëgjuar e pa perspektivë zhvillimi në të kaluarën, është bërë sot një qendër e fuqishme e industrisë sonë të re socialiste. Edhe fshatrat e Mallakastrës, gjithashtu, me transformimin socialist të bujqësisë, kanë ndryshuar si nata me ditën.

Partia është kujdesur vazhdimisht, edhe vetë personalisht jam interesuar dhe kam kërkuar që terreni i thyer i krahinës suaj të vihej nën ujë dhe të kthehej sa më shpejt në blloqe të mëdhenj pemësh frutore të të gjitha llojeve si dhe me ullinj, vreshta etj. kaq shumë të dobishme për ushqimin e njerëzve tanë dhe të nevojshme si lëndë e parë për industrinë ushqimore.

Sot me kënaqësi konstatoj se nën kujdesin e vazhdueshëm të Komitetit Qendror të Partisë, të ndihmës së organizatës të Partisë e të pushtetit në rreth, si dhe të punës suaj të madhe, bujqësia e blegtoria, duke përfshirë edhe pemëtarinë te ju,

janë futur në rrugën e zhvillimit. Vazhdojeni këtë punë më me vrull, në mënyrë që të çohet gjithnjë e më përpara zhvillimi ekonomiko-shoqëror si i kooperativës suaj, edhe ai i Mallakastrës, pse kjo është për të mirën tuaj, të mallakastriotëve dhe të të gjithë popullit e atdheut tonë socialist.

Përfitoj nga ky rast për t'ju dërguar juve e nëpërmjet jush gjithë popullit punëtor, trim e patriot të Mallakastrës së Rrapo e Dervish Hekalit, të Ramiz Aranitasit, të Dino Kalenjës e të sa e sa heronjve e dëshmorëve të tjerë, përshëndetjet e Komitetit Qendror të Partisë dhe të miat, si dhe urimet më të mira në punë e në jetë.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 71 (10 498), 25 mars 1982

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT HAJREDIN ÇELIKU

Elbasan

4 maj 1982

Me rastin e 55-vjetorit të lindjes dëshiroj me gjithë zemër të kesh shëndet, jetë të gjatë dhe të arrish suksese në detyrat me shumë përgjegjësi që të janë ngarkuar për të mirën e Partisë, të popullit, për begatinë dhe forcimin e pandërprerë të atdheut tonë të dashur socialist. Të uroj familjarisht jetë të lumtur e të gëzuar.

Yti

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT PUNONJËS TË KOMBINATIT POLIGRAFIK

6 maj 1982

Të dashur shokë dhe shoqe tipografë e punonjës të tjerë të Kombinatit Poligrafik,

Letra që më dërguat ju, shokë të mi tipografë, ma shtoi më shumë gëzimin që kisha në zemër këto ditë me rastin e 1 Majit. Kjo letër e ngrohtë dhe optimiste më dha lajmin e gëzuar që ju po festoni plot suksese 35-vjetorin e krijimit të ndërmarrjes së parë poligrafike, shtypshkronjës së mirënjohur, që mban me nder emrin e tipografit komunist, shokut tonë të paharruar, Heroit të Popullit Mihal Duri.

Të dashur shokë e shoqe,

35-vjetori i krijimit të ndërmarrjes suaj nuk është vetëm festa juaj, po e gjithë popullit tonë, pse nuk ka familje në Shqipëri që të mos jetë e

lidhur me ju, që të mos ketë libra, broshura, revista ose gazeta, të shtypura nga duart tuaja të arta me mundin, djersën, talentin dhe mjeshtërinë tuaj. Prandaj në këtë ditë, si gjithë populli, edhe unë, në emër të Partisë ju uroj nga zemra: Gëzuar festën e ndërmarrjes, dalshi kurdoherë faqebardhë!

Lufta për shtypin shqiptar dhe traditat revolucionare të tipografëve tanë kanë rrënjë të thella. Këto tradita u thelluan e u pasuruan akoma më shumë në vitet e zjarrta të Luftës Nacionalçlirimtare, kur bijtë e shqipes, ashtu siç i rrëmbenin armët armikut dhe me to luftonin kundër tij, i rrëmbenin edhe shaptilografë, gërma, bojë, letër etj., dhe me to shtypnin traktet e thirrjet e Partisë që demaskonin pushtuesit dhe krimet e tyre të urryera, që i bënin thirrje popullit të ngrihej në luftën e madhe për çlirimin e vet kombëtar e shoqëror. Këto trakte e thirrje të shtypura nga duart e paraardhësve tuaj, ishin tmerr për armikun.

Sot zemra na bëhet mal kur shohim se krahas kombinateve, uzinave e objekteve të tjera të mëdha e moderne në të gjitha degët e fushat e jetës së atdheut tonë socialist, edhe poligrafia është bërë një kombinat i madh dhe shtypshkronjat e saj janë shtrirë në të gjithë vendin. Ajo ka tani një bazë materiale të mirë, që nën kujdesin e Partisë e të pushtetit pasurohet vazhdimisht; në radhët e saj ka punëtorë të talentuar, mjeshtra me përvojë, specialistë e inxhinierë të aftë, nga duart e

të cilëve gjithnjë e më mirë dalin botime me cilësi të lartë teknike dhe estetike që nderojnë atdheun edhe në botën e jashtme, prandaj ju përgëzoj me gjithë zemër për punën tuaj të ndërgjegjshme.

Ju, shokë tipografë, s'pyesni për vështirësitë e profesionit, përkundrazi keni pasion e dashuri të madhe për të. Puna juaj është e lavdishme dhe e nderuar. Ju u jepni njerëzve tanë materiale të shtypura të Partisë, për të ushqyer mendjen e për të mprehur intelektin. Me botimet tuaja politike, artistike, teknike e shkencore, ju ndihmoni në edukimin e njeriut tonë të ri me vijën dhe politikën e Partisë, me idealet e saj revolucionare, me traditat e mrekullueshme patriotike të të parëve tanë.

Edhe një herë gëzuar 35-vjetorin e krijimit të ndërmarrjes së parë poligrafike, shtypshkronjës «Mihal Duri»! Ju uroj gjithnjë e më shumë suksese në punën tuaj, shëndet të mirë dhe gëzime e lumturi në jetë juve dhe familjeve tuaja.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 109 (10 536), 8 maj 1982

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SELIM SHPUZËS

Tiranë

13 maj 1982

Bashkëshortes, vajzës, djemve,

Mësova me hidhërim vdekjen e bashkëshortit dhe prindit tuaj shumë të dashur, anëtarit besnik të Partisë sonë dhe mikut tim të vjetër, Selim Shpuzës.

Selimi që në rininë e vet të hershme ka qenë mbrujtur me ndjenja të pastra atdhedashurie, me ide përparimtare e me kulturë të gjerë, të cilat ka luftuar t'i vërë vazhdimisht në shërbim të atdheut dhe të Partisë, prandaj kujtimi i tij do të mbetet i paharruar.

Marr pjesë në hidhërimin e gjithë familjes suaj dhe ju dërgoj me këtë rast ngushëllimet e mia më të ngrohta.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOQES MERI KOLA, KOMBINATI I TRIKOTAZHEVE «DRAPËR E ÇEKAN»

Korçë

26 maj 1982

Mora letrën, me të cilën më vije në dijeni për punën e mirë që ke bërë e vazhdon të bësh edhe tani për nder të Kongresit të 9-të të Bashkimeve Profesionale. Të përgëzoj për vullnetin dhe për shembullin e mirë që jep në kolektivin e kombinatit. Të falënderoj, gjithashtu, për urimet dhe përshëndetjet që më dërgoje. Edhe unë të uroj të dalësh kurdoherë faqebardhë, të kesh suksese në punë dhe lumturi në jetën familjare.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT XHOXHI ROBO

Tiranë

14 qershor 1982

Të dërgoj përshëndetjet më të përzemërta për 60-vjetorin e lindjes. Si komunist e kuadër i vjetër gjithë jetën ti ke punuar me besnikëri e konsekuencë për zbatimin e mbrojtjen e vijës së drejtë të Partisë, prandaj të uroj jetë të gjatë, shëndet, suksese në punën me rëndësi që të është besuar dhe lumturi në familje.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

FALËNDERIM PËR URIMET E DËRGUARA ME RASTIN E VITIT TË RI 1983

5 janar 1983

Me rastin e Vitit të Ri 1983 më kanë ardhur telegrame e mesazhe shumë të ngrohta urimi nga të katër anët e atdheut, në shumicën e të cilave flitet edhe për arritje të rëndësishme në frontin e prodhimit e të punës shkencore, në përsosjen e gatishmërisë luftarake për mbrojtje e të rritjes së vigjilencës revolucionare.

Këto letra e mesazhe janë shprehje e fuqishme e dashurisë së thellë dhe e respektit që masat tona punonjëse, mbarë populli ynë, ushqejnë për Partinë e Punës, janë shprehje e unitetit të çeliktë popull-Parti, e vendosmërisë për të shkuar gjithnjë përpara në rrugën e socializmit, për rritjen e mirëqenies, për forcimin e aftësisë mbrojtëse dhe për të ruajtur fitoret e arritura në ndërtimin e socializmit, lirinë dhe pavarësinë e atdheut nga çdo komplot e sulm i armiqve, të jashtëm e të

brendshëm. Për mua personalisht, përveç kënaqësisë e gëzimit që më sollën, ato janë një frymëzim i madh për t'u shërbyer akoma më shumë e me të gjitha forcat aspiratave të popullit, interesave të lartë të Partisë sonë heroike e të atdheut tonë socialist.

Të gjithë ju, vëllezër e motra, shokë e shoqe, punëtorë, kooperativistë, intelektualë, ushtarë e kuadro të Ushtrisë Popullore e të Ministrisë së Punëve të Brendshme, prindër dëshmorësh të Luftës Nacionalçlirimtare e të ndërtimit e mbrojtjes së socializmit, të rinj e të reja, pionierë e fatosa, ju falënderoj nga zemra dhe ju uroj edhe unë gëzuar Vitin e Ri 1983, suksese gjithnjë më të mëdha në punë, shëndet, gëzime e lumturi në jetën tuaj personale. Të gjithë së bashku, si një trup i vetëm, të marshojmë si kurdoherë në rrugën e ndritur të socializmit ku na prin Partia jonë e lavdishme.

Ju, bashkatdhetarë patriotë që, edhe pse në dhe të huaj e larg, nuk e harroni mëmëdheun, ju falënderoj për urimet e përzemërta që më dërguat, të cilat i përkasin mbarë popullit tonë, atdheut tuaj që, gjithashtu, ju ruan në mendje e në zemër. Në emrin tim personal dhe në emër të vëllezërve e të motrave tuaja këtu, në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, ju përshëndes vëllazërisht dhe ju uroj gëzuar Vitin e Ri, shëndet e lumturi. Qofshi gjithmonë faqebardhë e të nderuar!

Falënderoj, gjithashtu, nga zemra dhe u uroj gëzuar Vitin e Ri gjithë miqve të Shqipërisë, da-

shamirësve të shumtë e personaliteteve përparimtare që më nderuan duke më dërguar urime për Vitin e Ri 1983.

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 5 (10 747), 6 janar 1983

PËRSHËNDETJE DREJTUAR REDAKSISË SË GAZETËS «BASHKIMI»

Tiranë

24 mars 1983

Të dashur shokë gazetarë, korrespondentë vullnetarë, bashkëpunëtorë e tipografë,

Jam shumë i gëzuar që sot, me rastin e 40-vjetorit të botimit të numrit të parë të gazetës «Bashkimi», t'ju dërgoj përshëndetjet më të mira dhe t'ju uroj nga zemra suksese të reja në misionin tuaj të rëndësishëm për informimin dhe edukimin e punonjësve, për forcimin e vazhdueshëm të organizatës së Frontit Demokratik të Shqipërisë.

Përvjetori i 40-të i gazetës «Bashkimi» më ngjalli edhe një herë këto ditë kujtimet e viteve të paharruara të Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare, ku spikatën me aq forcë heroizmi i pa-

shoq i popullit tonë trim e liridashës, roli i madh i Frontit Nacionalçlirimtar dhe i gazetës së tij për bashkimin, mobilizimin e organizimin e popullit në kryengritjen e armatosur kundër pushtuesve të huaj nazifashistë e tradhtarëve të vendit. Kujtova me nderim e respekt të thellë gjakun e sakrificat e bëra për lirinë e pavarësinë e Shqipërisë që gëzojmë sot, solla ndër mend gazetën «Bashkimi» të viteve të rënda të robërisë që shpërndante fjalën e Frontit, fjalën e kushtrimin e Partisë për një Shqipëri të lirë, demokratike e popullore në qytetet e fshatrat e vendit tonë, në mendjen e në zemrën e punëtorëve e të fshatarëve, të të rinjve e të rejave, të partizanëve e partizaneve legjendare.

Si organ luftarak i Frontit Nacionalçlirimtar, i organizatës së madhe që krijoi e udhëhoqi Partia për çlirimin e vendit dhe vendosjen e pushtetit demokratik popullor, «Bashkimi» u bë një gazetë militante e Frontit, e dashur në vendin tonë e me emër edhe në botën e jashtme. Për 40 vjet me radhë, pandërprerë, ajo ka dhënë një kontribut të shquar në pasqyrimin e përpjekjeve të popullit për hedhjen e themeleve të Shqipërisë së re, për ndërtimin me sukses dhe begatinë e atdheut tonë socialist.

Në të gjitha etapat e mëdha historike që ka kaluar vendi ynë, gazeta juaj i ka kryer mirë detyrat e ngarkuara për propagandimin e arritjeve të mëdha historike, duke shprehur aspiratat e larta të popullit shqiptar, i cili, i bashkuar në Frontin Demokratik, mendon, punon, krijon e

realizon për ta bërë Shqipërinë gjithnjë më të bukur, më të fortë e të pamposhtur.

Sot, të dashur shokë, ashtu si gjithë shtypit tonë popullor, edhe gazetës suaj i dalin detyra të reja shumë të rëndësishme, që lidhen me stadin e ri të zhvillimit të vrullshëm e të gjithanshëm politiko-ekonomik e shoqëror të vendit tonë, me zbatimin e direktivave të Kongresit të 8-të të Partisë.

Shpreh bindjen se gazeta «Bashkimi» do të trajtojë me nivel cilësor e shkencor më të lartë problemet e mëdha të ndërtimit socialist, të forcimit të mëtejshëm të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, të konsolidimit të pandërprerë të diktaturës së proletariatit. Me mësimet e Partisë në mendje e në zemër, ju do ta ngrini më tej nivelin e gazetës, do ta bëni atë një propagandiste e agjitatore sa më luftarake. Me anën e shkrimeve tuaja do të kontribuoni që të çelikoset pareshtur uniteti politik, ideologjik e moral i popullit rreth Partisë, të rritet akoma më shumë roli aktiv i masave në qeverisjen e vendit, në zhvillimin e demokracisë sonë proletare socialiste.

Në këto ditë të fushatës së zgjedhjeve për këshillat e gjykatat popullore, pasqyroni sa më mirë hovin e madh në punë të popullit tonë, frymën e tij të lartë atdhedashëse e revolucionare, dashurinë e tij për Partinë e tij heroike, për pushtetin popullor, për forcimin e demokratizimin e mëtejshëm të të cilit ai do të shkojë si një trup i

vetëm në votimet e 24 prillit dhe do të votojë si kurdoherë njëzëri për kandidatët e Frontit Demokratik.

Edhe një herë, të dashur shokë, ju uroj përzemërsisht gëzuar festën tuaj, 40-vjetorin e daljes së gazetës sonë «Bashkimi»!

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 73 (10 815), 26 mars 1983

LETËR DREJTUAR VAJZAVE KOOPERATIVISTE VOLEJBOLLISTE TË KOOPERATIVËS BUJQËSORE TË KRUTJES

Lushnjë

11 prill 1983

Të dashura vajza volejbolliste të Krutjes,

E këndova me kënaqësi letrën tuaj dhe u gëzova shumë për sukseset që keni arritur në sportin e bukur të volejbollit, gjë që dëshmon se në Shqipërinë socialiste sporti, gjimnastika, atletika etj. janë bërë pjesë e pandarë e jetës së masave tona punonjëse, sidomos e rinisë. Ato nuk janë më si në të kaluarën «privilegj» vetëm i disa të rinjve të qytetit, se me to merren sot edhe vajza të thjeshta fshati, siç jeni ju.

Ju, të dashura vajza volejbolliste, si gjithë shoqet tuaja që po aktivizohen kudo në të tilla veprimtari të dobishme, krahas përpjekjeve për rea-

lizimin e detyrave të ditës në ekonomi, arsim, kulturë e kudo, e keni kuptuar drejt mësimin e Partisë për rëndësinë që ka kalitja fizike e njerëzve tanë, si një faktor i rëndësishëm që sjell shëndet, bukuri fizike e shpirtërore, që ndihmon në gjallërimin e përparimin e jetës së vendit, si dhe në forcimin e mbrojtjes së atdheut tonë socialist. Shembulli juaj është frymëzues për të gjithë, sidomos për të rejat e vendit tonë, prandaj meritoni përgëzimet më të mira të Partisë dhe të miat personalisht.

Ju uroj suksese të reja si volejbolliste, gëzime e lumturi në jetën personale, familjare dhe në zhvillimin e ekonomisë suaj kooperativiste.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR FAMILJES SË JAKUP MAHMUTIT

Francë

17 maj 1983

Zonjës Poletë Mahmuti,

Me hidhërim të madh porsa mësova për vdekjen e bashkëshortit tuaj të nderuar, shokut e mikut tonë të vjetër e besnik, Jakupit. Megjithëse që kur ishte i ri, ai jetoi në vendin tuaj, popullin e të cilit e donte aq shumë sa bashkë me makizarët francezë luftoi për lirinë e tij kundër nazistëve gjermanë, mendjen e kishte këtu e zemra i rrihte për Shqipërinë e shtrenjtë ku kishte lindur dhe e kishte lënë të varfër e të prapambetur. Prandaj bashkoi aty forcat me ato të elementëve më përparimtarë shqiptarë e francezë për demaskimin e regjimit feudo-borgjez të Zogut, më pas edhe të agresionit fashist italian e gjerman mbi Shqipë-

rinë. Ai përshëndeti me gjithë zemër Luftën e madhe Nacionalçlirimtare të popullit tonë, të udhëhequr nga Partia Komuniste për çlirimin e Shqipërisë nga okupatorët fashistë e tradhtarët e vendit dhe gëzohej për realizimet socialiste të popullit shqiptar.

Si patriot e komunist konsekuent i vendosur Jakupi do të mbetet i paharruar për mua dhe për gjithë ata që e kanë njohur. Unë ruaj shumë kujtime për kohën që kam qenë në Francë dhe për takimet që kam pasur me të në Shqipëri.

Me këtë rast të dhimbshëm për ju, më lejoni t'ju shpreh së largu ngushëllimet më të ngrohta. Ju lutem ta konsideroni atdheun e Jakupit si atdheun tuaj, ku do të jeni e mirëpritur sa herë që të dëshironi.

Ju përshëndes miqësisht.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR FAMILJES SË DËSHMORIT YMER MATA

Zapod — Kukës

30 maj 1983

I dashur Hamit,

Të falënderoj për letrën që më dërgove këto ditë, si dhe për ndjenjat plot dashuri që shpreh. Ashtu si për gjithë familjen tuaj, për Partinë dhe për mua personalisht, kujtimi i dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare është i shtrenjtë. Populli dhe Partia kanë pasur e do të kenë kurdoherë respekt të pakufishëm për veprën e tyre të pavdekshme. Prandaj gëzohem shumë kur mësoj që bashkë me prindërit, motrat e vëllezërit, edhe djemtë e vajzat, nipërit e mbesat e tyre mbajnë lart emrin e dëshmorëve, ecin në rrugën e Partisë e të popullit dhe po luftojnë me të gjitha forcat për të çuar në vend amanetin e tyre, ruajtjen me

çdo kusht të lirisë së fituar me gjak e sakrifica të mëdha, për rritjen e fuqisë mbrojtëse të atdheut dhe për t'ua bërë sa më të lumtur e të begatshme jetën punonjësve tanë.

Gjithë pjesëtarët e familjes suaj i përshëndes nga zemra dhe u dërgoj me këtë rast urimet më të mira. Paçi kurdoherë suksese në punën ndërtimtare e atdhetare, si dhe në jetën tuaj familjare!

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT JASHAR MENZELXHIU

Tiranë

5 qershor 1983

I dashur Jashar,

Me rastin e 60-vjetorit të lindjes, ngjarje e gëzuar për ty dhe për familjen, të dërgoj urimet më të përzemërta. Shpreh bindjen që edhe në të ardhmen, ashtu si në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare dhe periudhës së gjatë të pasçlirimit, si anëtar besnik i Partisë, aftësitë e tua organizative dhe prej masoviku revolucionar do t'ua kushtosh si kurdoherë çështjes së popullit, të atdheut dhe fitores së marksizëm-leninizmit.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT XHAFER SPAHIU

5 qershor 1983

I dashur Xhafer,

Me rastin e ditës së shënuar për ty dhe për familjen, 60-vjetorit të lindjes, të dërgoj urimet e mia më të përzemërta, shëndet, jetë të gjatë e si kurdoherë plot aktivitet në shërbim të Partisë dhe të atdheut. Si anëtar i vjetër e besnik i Partisë pjesën më të madhe të jetës me vendosmëri e devotshmëri revolucionare ti ia ke kushtuar çështjes së popullit, fitores së socializmit, mbrojtjes së atdheut e të marksizëm-leninizmit.

Edhe një herë të uroj ditëlindjen.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT AGUSH GJERGJEVICA

Korçë

20 qershor 1983

Vajzave dhe djemve,

U hidhërova shumë për vdekjen e babait tuaj të nderuar, luftëtarit e mikut tim të vjetër, Agush Gjergjevicës. Agushi mbeti bir besnik deri në fund i popullit që e njeh si komandant trim të njësive partizane në malësitë e Gorë-Oparit dhe në gjithë rrethin e Korçës gjatë Luftës Nacional-çlirimtare. Ai ishte komunist i vendosur e propagandist i palodhur i vijës së Partisë deri në fund. Gjithë jeta dhe veprimtaria e tij patriotike dhe besnikëria ndaj çështjes së popullit e të Partisë do të mbeten burim frymëzimi për ju, nipërit e mbesat dhe për brezin e ri të vendit tonë.

I dërgoj familjes suaj ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT PASKO MILO

Tiranë

22 qershor 1983

I dashur shoku Pasko,

E prita me gëzim letrën tënde dhe albumin me përkthimet që më dërgove. Të falënderoj për to, si dhe për interesimin tënd të madh për futjen në vendin tonë të lopës së racës «Gjedhi i hirtë i Tirolit», që po zhvillohet me sukses në zonat malore.

Meqenëse ti po e ndjek me pasion rritjen, zhvillimin dhe cilësitë e mira të kësaj kafshe me vlerë, po të bëj të ditur se parashikojmë të importojmë së shpejti një numër tjetër të konsiderueshëm krerësh si kjo për ta përhapur sa më shpejt te ne. Dëshiroj të të vë, gjithashtu, në dijeni se albumin që më dërgove, ku flitet për cilësitë e mira të lopës së racës «Gjedhi i hirtë i Tirolit», do t'ia vë menjëherë në dispozicion Ministrisë së Bujqësisë, me porosi që jo vetëm të marrin dijeni kuadrot përkatës të këtij dikasteri, por të bëhet kujdes nga ana e tyre që ajo të përhapet gjerë-

sisht në vendin tonë. Për sa u përket propozimeve që më bën, siç është organizimi i komisionit për të ndjekur zhvillimin e kësaj race në Shqipëri, do t'ua rekomandoj shokëve të Qeverisë që t'i studiojnë me kujdes.

Në të ardhmen unë do të mirëprisja çdo propozim ose sugjerim që ti mund të kesh për probleme të ndryshme të zhvillimit të ekonomisë së vendit tonë, pse je një shok me përvojë të madhe dhe jam i bindur se mendimet e tua do të na ndihmojnë.

I dashur Pasko,

Fotografinë e vogël. ku ne të dy kemi dalë me artisten e popullit Tefta Tashko në dasmën e saj, po ta kthej që ta kesh ashtu siç është, pse ajo është një kujtim i çmuar që bashkëshortja jote e ndjerë e ka pasë mbajtur me kujdes për një kohë të gjatë, prandaj është e shtrenjtë edhe për ty. Unë e dhashë atë për riprodhim, prandaj po të dërgoj edhe një kopje të zmadhuar.

Të faleminderit për gjithçka dhe të uroj shëndet të plotë!

Yti

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT AJET SIMIXHIU

Tiranë

26 qershor 1983

I dashur shoku Ajet,

Me rastin e 60-vjetorit të lindjes të uroj nga zemra jetë të lumtur, të gëzuar e plot aktivitet për t'i shërbyer Partisë e popullit edhe në të ardhmen si kurdoherë me devocion shembullor e ndërgjegje të lartë revolucionare. Në tërë këto vite që punon pranë nesh, është ndier kontributi yt i vlefshëm. Me punën tënde të palodhur të përditshme plot modesti, ashtu si kurdoherë e kudo që ke punuar, ke treguar se je një komunist e anëtar i denjë e besnik i Partisë.

Dëshiroj të kesh vazhdimisht shëndet të plo-

të, gëzime në familje e suksese në detyrën shumë të rëndësishme që të ka ngarkuar Partia.

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE TË BATALIONIT «QAMIL PANARITI»

Vithkuq — Korçë

7 korrik 1983

Të dashur ish-partizanë e kuadro të batalionit «Qamil Panariti»,

40 vjet më parë, kur me Partinë në krye, kishim filluar luftën e armatosur, në një ditë të nxehtë korriku, unë erdha në Vithkuqin e bukur, çerdhe e Partisë dhe e partizanëve, fshati i hidrocentralit të parë në vendin tonë. Atje u poqa me ju, të dashur shokë të mi të luftës. Ju kishit formuar batalionin që mban emrin e patriotit «Qamil Panariti» dhe më prisnit mua, përfaqësuesin e Shtabit të Përgjithshëm, për inaugurimin e tij. Kishim emocione të mëdha, ishim të vendo-

sur për luftë dhe kishim bindje të plotë se do ta çlironim atdheun nga pushtuesit nazifashistë.

Batalioni u rreshtua në sheshin e vogël të Vithkuqit. Disa mbanin nga një pushkë që ia kishin rrëmbyer armikut, disa s'kishin fare, por ishin të vendosur t'ia rrëmbenin armikut sa më parë.

Sapo dolëm nga mbledhja e Komitetit të Partisë të Qarkut të Korçës, bashkë me shokët Josif Pashko e Peti Shamblli, u përshëndetëm me ju e u përqafuam me komandantin Nasi Vithkuqi, që na paraqiti forcën e batalionit dhe bëmë inaugurimin e tij.

Batalioni juaj luftoi me trimëri. Shumë partizanë ranë dëshmorë në lulen e rinisë. Ju do të merrnit më vonë pjesë në brigada. Po në Vithkuq ne inauguruam Brigadën I Sulmuese, brigadë që luftoi me heroizëm. Juve ju kujtohet se pikërisht në ato ditë u ndeshëm me forcat italiane që donin të na rrethonin, por dështuan në planet e tyre nga trimëria e Brigadës I dhe e batalionit tuaj.

Po në këtë kohë batalionet tona partizane, Gorë-Opar dhe batalioni i Kolonjës, «Hakmarrja», i goditën në Barmash dhe u prenë rrugën hordhive gjermane, dhe si raprezalje barbarët nazistë i vunë zjarrin Borovës martire.

Të gjitha këto m'u kujtuan kur mora ftesën tuaj për të marrë pjesë në festimin e 40-vjetorit të krijimit të batalionit partizan «Qamil Panariti». Në pamundësi të vij, ju përshëndes dhe ju uroj shëndet e gëzime.

Me këtë rast përqafoj dhe gjithë familjarët e dëshmorëve të batalionit tuaj dhe përulem me respekt përpara kujtimit të tyre.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOQES LENKA ÇUKO

8 korrik 1983

E dashur shoqe Lenka,

Që nga koha që të kam njohur si kooperativiste e brigadiere e dalluar në fushat pjellore të Myzeqesë, si komuniste e devotshme e Partisë dhe e popullit e deri sot që mbush 45 vjeç, si anëtare e nderuar e Byrosë Politike të Komitetit Qendror, jeta dhe puna jote janë karakterizuar kurdoherë nga vullneti e pjekuria për zbatimin e vijës së Partisë, për mbrojtjen e atdheut, të marksizëm-leninizmit e ndërtimin e socializmit.

Duke shprehur bindjen e thellë se edhe në të ardhmen do t'i japësh Partisë e udhëheqjes së saj një ndihmë të frytshme, uroj të kesh kurdoherë shëndet të mirë, satisfaksion në detyrat që të ngarkon Partia e lumturi në familje.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHOQES KOSTANDINA ZHAMO

Tiranë

10 korrik 1983

E dashura shoqe Kostandina[1],

U hidhërova shumë për fatkeqësinë e rëndë që të ra ty dhe Arbenit me vdekjen e burrit tënd të dashur dhe babait të djalit, shokut tonë Lili Zhamo.

Lili ishte një komunist i vendosur dhe punëtor i palodhur. Ai ishte kurdoherë në krye të detyrës për të përhapur dritën e Partisë në të gjitha shkollat, shërbeu edhe si zëvendësministër i Arsimit derisa e rrëmbeu aq të ri sëmundja e papritur dhe e pashërueshme.

---

1. Infermiere e shokut Enver për më se 35 vjet. Heroinë e Punës Socialiste.

Unë dhe gjithë familja ime, që ka qenë dhe është edhe familja jote, të ngushëllojmë dhe të përqafojmë si njeriun e dashur tonin që për vite e vite ke qenë dhe vazhdon të jesh e aferma jonë, kurdoherë besnike, e kujdesshme, e palodhur për ne. Bashkë me fëmijët tanë ti rrite Arbenin e vogël, që tash është bërë burrë, mbaroi shkollën dhe do të martohet e do të mbushë shtëpinë. Të të rrojë e të ecë në rrugën e babait dhe tënden, që kurdoherë ju ka karakterizuar devotshmëria për Partinë.

E dashur Kostandinë, ji kurajoze dhe bëj durim. Nexhmija dhe unë tok me fëmijët jemi dhe do të jemi gjithmonë pranë teje.

Të përqafoj ty dhe Arbenin.

Të rrojë kujtimi i Lilit!

Juaji

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHOKUT RAMIZ ALIA

19 korrik 1983

I dashur shoku Ramiz,

Me hidhërim të madh mora vesh për vdekjen e nënës tënde të dashur, Sebije, që ishte dhe nëna jonë, e cila me shumë mundime të rriti ty që u bëre luftëtar e komunist i vendosur për çështjen e popullit e të Partisë. Do të ruajmë kujtimet më të mira nga ajo grua aq kurajoze, që duroi aq hidhërime, që gjithnjë na priti buzëqeshur, na donte dhe e donim shumë.

Të dërgoj ty dhe gjithë familjes ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Me keqardhje që në këto çaste kaq të dhimbshme nuk ndodhem pranë teje, të përqafoj.

Yti

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT SHEFIK OSMANI NË INSTITUTIN E STUDIMEVE PEDAGOGJIKE

Tiranë

8 shtator 1983

I dashur shoku Shefik,

Librin «Fjalor i pedagogjisë», fryt i punës tënde të palodhur shkencore prej disa vjetësh, që më dërgove, e mora dhe të falënderoj nga zemra. Krahas veprimtarisë shumëvjeçare si arsimtar dhe edukator i brezit të ri me dije të përgjithshme kulturore, i frymëzuar nga mësimet e Partisë dhe nga ndjenja të pastra të atdhedashurisë, ti po jep një ndihmesë të rëndësishme edhe në fushën e literaturës pedagogjike të vendit, duke i ardhur në ndihmë edhe me këtë fjalor armatës së madhe të kolegëve të tu dhe lexuesve.

Të dërgoj me këtë rast përgëzimet e mia dhe

të uroj shëndet, suksese të mëtejshme në punë në shërbim të arsimit popullor dhe gëzime në jetën familjare.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT DHIMITËR TONA

Tiranë

9 tetor 1983

I dashur Dhimitër,

Kam kënaqësinë të të uroj nga zemra me rastin e 60-vjetorit të lindjes. Pjesën më të madhe të këtyre viteve ti, me ndjenjë përgjegjësie e devotshmëri, ia ke kushtuar plotësimit të detyrave me rëndësi që të ka besuar vazhdimisht Partia, sidomos në sektorin e propagandës e të shtypit të saj, ku ke dhënë një kontribut të vlefshëm.

Në këtë ditë të gëzueshme në jetën tënde dhe të familjes dëshiroj të gëzosh shëndet, suksese në punë dhe lumturi.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË MIHAL DHIMËS

Korçë

30 tetor 1983

E dashur motër Afroviti,

Mësova me dhimbje të thellë për vdekjen e usta Mihalit. Ai ishte shumë i dashur jo vetëm për ty, për nusen e Dhimos së paharruar e djemtë e tij, po ishte një shok besnik e vëlla, pra shumë i dashur edhe për mua, pse jemi rritur pranë njëri-tjetrit në vitet e vegjëlisë dhe e kemi ruajtur e forcuar vazhdimisht miqësinë, mbasi Mihali ishte e mbeti deri në fund një patriot i zjarrtë, besnik i Partisë, punëtor i palodhur e i ndershëm si ai dhe i respektuar nga të gjithë.

Për mua do të mbeten të paharruara pjekjet e bisedat aq të ngrohta e vëllazërore me Mihalin sa herë takoheshim pas Çlirimit qoftë kur vinte

na vizitonte në shtëpi, ashtu edhe kur vija unë në familjen tuaj, ku kam gjetur kurdoherë pritje bujare e të ngrohtë. Prandaj vdekja e tij krijon një boshllëk të ndjeshëm në zemrën time, ashtu sikurse lë edhe për ty e pjesëtarët e tjerë të familjes suaj, por Partia na mëson të jemi kurdoherë të fortë e të përballojmë me kurajë çdo ngjarje sado të rëndë, siç është edhe kjo e humbjes së Mihalit.

Në këto çaste hidhërimi për ty, për nusen, nipërit e gjithë rrethin tuaj familjar ju dërgoj ngushëllimet më të përzemërta të miat, të Nexhmijes dhe të fëmijëve.

Qoftë i paharruar kujtimi i Mihalit tonë të dashur!

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT MUHO ASLLANI

Shkodër

12 dhjetor 1983

I dashur shoku Muho,

Me hidhërim të thellë mësova për vdekjen e nënës suaj të dashur. Si shumë nëna shqiptare, që njohën në kurrizin e tyre shtypjen dhe varfërinë e regjimit zogist e të pushtimeve të huaja, edhe nënë Bibja ju rriti ju me një mijë mundime. Por për një kohë të gjatë ajo jetoi edhe ditët e bardha e të lumtura të kohës së Partisë, që e deshi si sytë e ballit dhe këtë dashuri jua rrënjosi të gjithë juve, fëmijëve të saj.

Ju dërgoj ngushëllimet e mia më të përzemërta ty dhe gjithë familjes suaj.

Yti

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT TAHIR MINXHOZI, KOMBINATI I PËRPUNIMIT TË DRURIT «MISTO MAME»

Tiranë

3 janar 1984

I dashur shoku Tahir,

Me rastin e 60-vjetorit të lindjes dhe të dekorimit të merituar, ngjarje e gëzuar për ty, familjen dhe kolektivin ku punon, të dërgoj urimet më të mira. Si anëtar besnik i vjetër i Partisë që në vitet e Luftës heroike Nacionalçlirimtare, ti ke luftuar e punuar, siç vazhdon të luftosh e të punosh edhe tani pa u lodhur. Prandaj dëshiroj të kesh shëndet të mirë që t'i shërbesh çështjes së madhe të popullit e të atdheut socialist në të cilën na udhëheq Partia jonë e lavdishme.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT ARANIT ÇELA

16 janar 1984

I dashur shoku Aranit,

Këto ditë ti mbushe 60 vjeç dhe me këtë rast të shënuar në jetën tënde, të familjes e të gjithë neve, shokëve të tu, të uroj nga zemra shëndet, jetë të gjatë e veprimtari të frytshme në detyrën me shumë përgjegjësi që të është ngarkuar, për të mirën e Partisë e të popullit.

Partia ka tek ti një anëtar besnik dhe luftëtar të vendosur për mbrojtjen me konsekuencë të vijës së saj të drejtë, prandaj të ka besuar të drejtosh në frontet nga më të rëndësishmit, siç janë ato të organeve të drejtësisë sonë popullore, ku ti, duke shërbyer për një kohë të gjatë, ke punuar me devotshmëri e pa u lodhur.

Jam i bindur se edhe paskëtaj, pavarësisht nga vitet që kalojnë, do të vazhdosh të punosh e

të luftosh me atë partishmëri të lartë dhe energji që të ka karakterizuar kurdoherë, duke vënë të gjitha forcat për zbatimin e ligjshmërisë sonë socialiste.

Prandaj edhe një herë të uroj shëndet e gjithë të mirat.

Yti

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 7-TË SULMUESE

16 mars 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 7-të Sulmuese,

Me rastin e 40-vjetorit të formimit të Brigadës së 7-të Sulmuese ju përshëndes dhe ju uroj me gjithë zemër: gëzuar festën!

40 vjet më parë nga njësitë partizane të rretheve të Skraparit, Beratit, Fierit, Lushnjës si dhe të ish-qarqeve të Gjirokastrës e të Korçës, ju erdhët aty, në Vlush, për të krijuar me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Brigadën e 7-të Sulmuese. Të tërë në atë kohë ishit djem e vajza të kalitur qysh më parë në zjarrin e Luftës Nacionalçlirimtare. Kuadrot e parë politikë dhe ushtarakë, midis tyre shoku

Ramiz Alia, një nga udhëheqësit më të shquar politikë të Partisë sonë të Punës dhe Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, i cili, pa mbushur akoma 20 vjeç, u bë anëtar i Seksionit Politik të brigadës suaj e pas disa muajsh komisar politik i Divizionit të 5-të, si dhe shoku Adil Çarçani, gjithashtu udhëheqës i shquar i Partisë dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave, ishte zëvendëskomisar i brigadës suaj dhe më vonë u bë komisar politik i Divizionit të 4-t, dhe shumë të tjerë që u vunë në krye të batalioneve e të kompanive, ishin të gjithë bij trima të Partisë e të popullit, të sprovuar në organizimin dhe udhëheqjen e punës politike, propagandistike dhe të veprimeve luftarake.

Populli heroik mikpritës dhe bujar i rrethit të Skraparit, që e kishte mbajtur kurdoherë të hapur shtëpinë dhe zemrën për partizanët, ju priti të gjithë ju me ngrohtësi si bijtë e bijat e vet, ashtu siç priti e mbajti me çdo gjë që kishte deri në prag të Çlirimit të atdheut shumë nga shokët e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Komiteti Qarkor i Partisë Komuniste të Shqipërisë për Beratin, sekretari politik i këtij qarkori, biri i paharruar i Leshnjës dhe i Partisë, Kahreman Ylli, dhe njësitë partizane të Skraparit e të Beratit, forcat e grupit të tretë të komanduara nga Heroi i Popullit Zylyftar Veleshnja, morën masa dhe zunë të gjitha shtigjet që formimi i brigadës suaj të mos pengohej në asnjë mënyrë nga ar-

miku. Populli i Skraparit, që kishte thyer me heroizëm sulmet e tërbuara e të përsëritura të gjermano-ballistëve, populli i Vlushës e i Krushovës, që e kishte fare të freskët kujtimin e 114 burrave, grave, pleqve e fëmijëve të vrarë mizorisht nga nazistët gjermanë, e priti me gëzim dhe entuziazëm të madh krijimin e Brigadës së 7-të Sulmuese. 17 marsi i vitit 1944 ishte dhe mbeti për të një ditë e shënuar, një festë popullore, ashtu siç janë e do të mbeten datat e formimit të të gjitha reparteve e njësive të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Brigada juaj është një ndër formacionet më të lavdishme të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare. Ajo zhvilloi një varg veprimesh luftarake në qarkun e Beratit dhe, ashtu si shumë njësi e reparte të tjera, kreu me nder edhe misionin e ngarkuar nga Shtabi i Përgjithshëm për të qëndruar në rojë të Kongresit të Përmetit, çliroi Beratin dhe shumë qytete e qendra të tjera banimi.

Trimëria e partizanëve të brigadave tona, që e ndoqën armikun edhe jashtë kufijve tanë shtetërorë, gjaku i qindra të rënëve nga radhët e tyre, si dhe ai i 84 partizanëve të Brigadës së 7-të Sulmuese që dhanë jetën në përleshjet me gjermanët në Mal të Zi e në Bosnjë, në Bioçe e në lartësitë e fortifikuara të Suhagorës, do të mbeten përgjithmonë në kujtesën dhe në zemrat e vëllezërve shqiptarë të Kosovës, të Malit të Zi dhe të vetë popujve të Jugosllavisë.

Sivjet ne do të festojmë 40-vjetorin e Çlirimit të Atdheut. Të gjitha fitoret e arritura në

këto katër dekada i kanë themelet te heroizmi partizan, që populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia, e ruan të gjallë dhe ua transmeton brezave të rinj. Uniteti i popullit rreth Partisë, i çelikosur në betejat për çlirimin e vendit dhe mbrojtjen e forcimin e diktaturës së proletariatit, realizimi dhe tejkalimi i planeve ekonomike, guximi dhe vendosmëria e njerëzve tanë për të ecur në rrugën e socializmit kanë bërë që synimet grabitqare të armiqve të shumtë, imperialistë, revizionistë e gjithfarë reaksionarësh e shovinistësh të tërbuar dhe të veglave të tyre brenda vendit, të dështojnë kurdoherë me turp. Përgatitja e gjithanshme dhe vigjilenca e lartë e Partisë dhe e popullit e bëjnë të pathyeshme kështjellën tonë socialiste.

Duke përfunduar, të dashur shokë dhe shoqe, ju uroj ta kaloni gëzuar festën e 40-vjetorit të Brigadës së 7-të Sulmuese!

Ju përshëndes e ju përqafoj të gjithë me dashuri.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 68 (11 125), 20 mars 1984

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT PIRRO KONDI

Tiranë

10 prill 1984

I dashur shoku Pirro,

Jam i gëzuar të të dërgoj sot përshëndetjet më të përzemërta për 60-vjetorin e lindjes, datë e shënuar kjo për gjithë familjen tënde, për nënë Krison e shokët, si dhe për ty që, si bir besnik i Partisë, ke punuar gjithë jetën pa u lodhur në detyrat me përgjegjësi që të janë ngarkuar, sidomos në fushën e propagandës e të jetës së Partisë.

Të uroj me këtë rast jetë të gjatë, shëndet e suksese në punë, lumturi e gëzime në familje.

Yti

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT PETRO DODE, SEKRETAR I PARË I KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT TË SHKODRËS

16 prill 1984

I dashur shoku Petro,

Të uroj nga zemra me rastin e 60-vjetorit të lindjes, ngjarje e gëzuar për ty, për familjen dhe për të gjithë ne, shokët e tu. Që në moshë të re ti e lidhe jetën me Partinë dhe, si bir besnik i saj, ke punuar me të gjitha energjitë në detyrat e rëndësishme, partie dhe shtetërore, që të janë ngarkuar për të mirën e atdheut socialist.

Dëshiroj të kesh shëndet të plotë që edhe pasketaj të kesh suksese në detyrën që të ka ngarkuar Partia.

Qofsh i lumtur e i gëzuar familjarisht!

Yti

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 8-TË SULMUESE

25 prill 1984

Të dashur shoqe dhe shokë, ish-partizane, partizanë dhe kuadro të Brigadës së 8-të Sulmuese,

Ju përshëndes nga zemra me rastin e 40-vjetorit të formimit të brigadës suaj!

U mbushën 40 vjet nga dita kur në sheshin pranë Sheperit, vendlindjes së poetit tonë të shquar të Rilindjes, Andon Zako Çajupit, aty, në Zagorinë e çliruar, që bashkë me Pogonin u bënë nga bazat e rëndësishme të Luftës Nacionalçlirimtare në jug të atdheut, u krijua Brigada e 8-të Sulmuese. Populli i Zagorisë dhe i Pogonit i priti me ngrohtësi, i strehoi e i ushqeu partizanët e batalioneve «Misto Mame», «Çamëria», «Thanas Ziko» e «Perlat Rexhepi», që u inkua-

druan në radhët e brigadës suaj. Ai i priti të gjithë si bijtë e vet, gjirokastritë e libohovitë, dropullitë e lunxhjotë, tepelenas e përmetarë, delvinjotë e mallakastriotë, që me guximin e trimërinë e treguar në shumë beteja me armiqtë justifikuan kujdesin e dashurinë e tij, besimin e Partisë dhe të Shtabit të Përgjithshëm.

Rruga luftarake e Brigadës së 8-të Sulmuese, si ajo e gjithë brigadave të tjera të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, ka qenë e gjatë, e vështirë dhe e lavdishme. Ajo e kreu me nder detyrën që iu ngarkua për mbrojtjen e punimeve të Kongresit të Përmetit dhe pas luftimeve të përgjakshme me pushtuesit gjermanë e bashkëpunëtorët e tyre tradhtarë, gjatë Operacionit armik të Qershorit, në zbatim të urdhrit të Komandës për kalimin në mësymjen e përgjithshme, u hodh në sulm për çlirimin e plotë të vendit. Flamuri i saj luftarak kaloi krenar nga beteja në betejë. Ai u valëvit fitimtar në Gjirokastër e Konispol, në Berat e në Lushnjë, në Petrelë e në Mushqeta dhe gjatë ditëve të luftës për çlirimin e Tiranës. Me trimërinë e treguar në luftimet e zhvilluara në Mal të Zi e në Sanxhak, me të rënët në këto beteja dhe me gjakun e derdhur për çlirimin e Vishegradit, partizanët e brigadës suaj kryen me nder edhe detyrën internacionaliste të ngarkuar nga Partia.

Në luftimet e zhvilluara partizanët e partizanet, shqiptarë e vëllezërit e tyre minoritarë, gjithë efektivi i Brigadës së 8-të Sulmuese, i

udhëhequr nga komunistët dhe kuadro luftarakë, tregoi vendosmëri të madhe dhe shpirt të lartë sakrifice. Ne sot kujtojmë me nderim të veçantë djalin e paharruar të Çatistës, zëvendëskomandantin e batalionit të parë, Heroin e Popullit Theodhori Mastora, kujtojmë Inajete Karalliun, Arshi Lengon, Ilo Çamin, Jorgo Bakirin, Spiro Partalin, Kosta Çavon, Gori Spiron, Nazif Fejzillarin, Nevro Berdajn dhe gjithë dëshmorët e tjerë të asaj brigade që dhanë jetën për çlirimin e atdheut dhe të popujve të Jugosllavisë.

Të dashur shokë dhe shoqe,

Formimi i njëpasnjëshëm i brigadave partizane, si rezultat i punës së Partisë dhe i shpirtit liridashës të popullit, fuqizoi Ushtrinë tonë Nacionalçlirimtare, e cila, e udhëhequr nga Partia dhe e mbështetur tërësisht te populli, solli ditën e madhe të çlirimit, 29 Nëntorin e vitit 1944, 40-vjetorin e të cilit do ta festojmë me madhështi sivjet. Në këto katër dekada, që populli i quan epoka e Partisë, janë arritur fitore të mëdha në të gjitha fushat e ndërtimit socialist, për të cilat edhe ju keni dhënë kontributin tuaj me punë të palodhur, me mobilizim të lartë e vigjilencë revolucionare për mbrojtjen e fitoreve të arritura nga synimet e tradhtia e armiqve të jashtëm e të brendshëm. Populli ynë, nën udhëheqjen e urtë të Partisë, do t'i çojë gjithnjë përpara këto fitore

për ta bërë kurdoherë më të lumtur jetën e punonjësve tanë dhe Shqipërinë socialiste të pathyeshme.

Ju uroj ta kaloni të gëzuar festën tuaj të shënuar, 40-vjetorin e themelimit të Brigadës së 8-të!

Ju përshëndes me dashuri

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 104 (11 161), 1 maj 1984

TELEGRAM DËRGUAR HULUSI KAVOS, KRYETAR I DEGËS «NAIM FRASHËRI» TË SHOQËRISË «SHQIPËRIA E LIRË»

Nju-Jork

25 prill 1984

I dashur miku im Hulusi,

Me kënaqësi të veçantë mësova se këto ditë mbush 80-vjetorin e lindjes. Të rrosh edhe 100 vjet për gëzimin e familjes dhe të punosh, ashtu sikurse deri më sot për të mirën e atdheut e të popullit tonë, që i do aq shumë e që po lulëzojnë dhe ecin përpara në rrugën e socializmit e të begatisë së përgjithshme.

Të uroj me këtë rast edhe për dekoratën e lartë, «Urdhrin për veprimtari patriotike» me të cilin të nderoi Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Të përshëndes së largu. Shëndet e lumturi me gjithë familjen.

Yti

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 12-TË SULMUESE

19 maj 1984

Të dashur shoqe dhe shokë, ish-partizane, partizanë dhe kuadro të Brigadës së 12-të Sulmuese,

Ju përshëndes të gjithë nga zemra me rastin e festës, 40-vjetorit të formimit të brigadës suaj.

40 vjet më parë, në Sukën malore të krahinës së çliruar të Dëshnicës, nga reparte komplete të grupeve partizane të Gjirokastrës, Vlorës, Mallakastrës e Konispolit u formua Brigada e 12-të Sulmuese. Ju, ish-partizanë e kuadro të efektivit të kësaj njësie të Ushtrisë sonë heroike Nacionalçlirimtare, erdhët në krijimin e saj të kalitur e me një përvojë të pasur luftarake të fituar në luftimet e zhvilluara më parë me armiqtë në

krahina të ndryshme në kushtet shumë të rënda të Operacionit të egër të Dimrit. Populli i varfër por patriot i Dëshnicës, që kishte njohur drejtpërsëdrejti shtypjen dhe demagogjinë e beut tradhtar, Ali Këlcyrës, e të baba Kamberit dhe mizoritë e nazifashistëve, ju hapi juve me bujari dyert e shtëpive dhe të zemrave. Armiqtë bënë gjithçka për ta larguar atë nga rruga e Partisë, terrorizuan, dogjën dhe masakruan 116 veta, por dëshnicarët, bashkë me bijat dhe bijtë që dolën malit, 78 prej të cilëve dhanë jetën për çlirimin e atdheut, u lidhën përjetë me Partinë.

20 maji i vitit 1944 shënon fillimin e rrugës luftarake të Brigadës së 12-të Sulmuese. Në dhjetëditëshin e fundit të majit Shtabi i Përgjithshëm e caktoi atë në rolin e rezervës për t'u përdorur atje ku të qe rreziku më i madh gjatë zhvillimit të punimeve të Kongresit historik të Përmetit. Në qershor, megjithëse akoma e re si formacion, brigada juaj u gjend në drejtimin e goditjes kryesore të Operacionit armik të Qershorit që ishte një provë e rëndë, por heroike, për brigadën tuaj, një shkollë e vërtetë luftarake, që e ndihmoi atë të kryente me nder edhe detyrat e mëdha që iu caktuan më vonë në sektorin Vlorë, Kurvelesh, Bregdet e Sarandë. Është e njohur se, krahas luftës kundër forcave gjermano-balliste, brigadës suaj iu ngarkua edhe detyra me rëndësi të veçantë operativo-strategjike: të zmbrapste çdo orvatje të mundshme të anglo-amerikanëve për zbarkim në bregdetin tonë ju-

gor dhe, me qëndrimet dhe luftën e vet, t'u tregonte këtyre «aleatëve» se, për t'u çliruar, populli shqiptar nuk kishte nevojë për të ashtuquajturën ndihmë të tyre. Zbatimi i urdhrave e udhëzimeve të përditshme të Shtabit të Përgjithshëm, sidomos gjatë përpjekjeve të ethshme të anglezëve për zbarkim, patën një rëndësi të jashtëzakonshme për kryerjen me sukses nga brigada juaj të kësaj detyre sa delikate, aq edhe të vështirë.

Pushka e partizanëve të Brigadës së 12-të Sulmuese gjëmoi në dhjetëra beteja, flamuri i saj u shpalos krenar në shumë fshatra e qytete të vendit tonë. Partizanë të brigadës suaj, në rrethana shumë të vështira, çliruan edhe ishullin e Sazanit, që imperializmi italian e kishte shkëputur përdhunisht nga trungu i Shqipërisë dhe e kishte shndërruar në një bazë ushtarake kundër saj.

Çdo betejë ka historinë e vet dhe të rënët e saj. Ne sot kujtojmë me nderim Shefit Fetiun, Braho Sakon, Jorgo Rizon, Virtyt Dinon, Llambro Shetin, Neto Kanian, Elmaz Hamitin, Labo Karmën dhe gjithë partizanët e tjerë të brigadës suaj, që dhanë jetën për lirinë e atdheut. Gjaku i tyre, si gjaku i dhjetëra mijë të rënëve në Luftën Nacionalçlirimtare, siç thotë populli, u bë dritë, Shqipëria në këta 40 vjet u bë, ashtu siç e ëndërronin partizanët dhe dëshmorët, një vend i begatë, i fuqishëm dhe i nderuar në botë. Të tillë e bënë atë Partia dhe populli, prandaj kë-

ta po e presin 40-vjetorin e Çlirimit me fitore në çdo fushë për ta festuar me madhështi.

Duke përfunduar ju uroj me gjithë zemër ta kaloni gëzuar festën e brigadës, shëndet e lumturi në familjet tuaja.

Juaji me dashuri

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 122 (11 179), 22 maj 1984

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË MUÇO BALILIT

Vlorë

28 maj 1984

E dashur Zilo,

Të dashur Baki, Mevlan, Sinan, Lutfi e Shazije,

Më njoftuan se nga gjiri juaj dhe yni u nda i dashuri i familjes suaj dhe miku im i respektuar, Muço Balili. Në këto çaste ndaj tok me ju hidhërimin e madh që ju sjell vdekja e tij.

Që në rininë e hershme Muçoja njihet si një nga atdhetarët e lavdishëm, shok i Selam Musait e i qindra trimave që morën pjesë në Luftën antiimperialiste historike të Vlorës, pjesëmarrës i guximshëm i Luftës Nacionalçlirimtare dhe luftëtar i ndërtimit të socializmit në atdheun tonë, që i qëndroi besnik deri në fund Partisë. Jeta, lufta

dhe puna e tij do të mbeten të paharruara jo vetëm në zemrat tuaja, por edhe në mendjet e zemrat e të tërë neve, miqve e shokëve të tij të shumtë, dhe shembull frymëzimi për të gjithë.

Edhe një herë ju ngushëlloj, të rroni vetë, të rrojë Partia, anëtar i denjë i së cilës ishte Muçoja deri në ditët e fundit të jetës së tij prej militanti revolucionar.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT SPIRO LENGO

Tiranë

22 qershor 1984

I dashur shoku Spiro,

Me rastin e 60-vjetorit të lindjes, ditë e gëzuar për ty, për familjen, për shokët e miqtë e tu të shumtë, të dërgoj urimet e mia të përzemërta.

Si anëtar besnik i Partisë sonë të lavdishme, pjesën më të madhe të gjithë këtyre viteve ti ia ke kushtuar çështjes së ndërtimit të socializmit, lumturisë e mirëqenies së vëllezërve minoritarë dhe gjithë popullit shqiptar, duke punuar pa u lodhur me ndërgjegje të lartë komuniste e frymë revolucionare në të gjitha detyrat e rëndësishme që të janë ngarkuar, sidomos në drejtim të përparimit të bujqësisë. Përvojën që ke grumbulluar në këtë degë shumë të rëndësishme të ekono-

misë, edhe në vitet që vijnë jam i bindur se do të vazhdosh ta vësh në jetë për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe fuqizimin e pandërprerë të atdheut tonë socialist.

Dëshiroj që edhe paskëtaj të gëzosh shëndet, suksese në punë e në jetë, si dhe gëzime në familje.

Yti

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 15-TË SULMUESE

28 qershor 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 15-të Sulmuese,

Me mendje e me zemër marr pjesë në festën e formimit të brigadës suaj dhe ju uroj ta kaloni sa më të gëzuar.

Vetëm dy javë pas urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm për shpartallimin e Operacionit armik të Qershorit, që vazhdonte ende, krijimi i Brigadës së 15-të Sulmuese, më 29 qershor të vitit 1944, që në të njëjtën kohë shënon dhe fillimin e veprimeve luftarake të saj kundër pushtuesve gjermanë e tradhtarëve të vendit, provoi edhe një herë forcën e pathyeshme të popullit dhe të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare. Betejat e zhvi-

lluara njëra pas tjetrës, qysh në ditët e para të korrikut, të cilat përfunduan të gjitha me fitore mbi armiqtë, ishin dëshmi e qartë se efektivi i brigadës suaj të re përbëhej nga luftëtarë të sprovuar, nga partizanë e kuadro me përvojë të batalioneve «Fuat Babani», «Hakmarrja», «Skënder Çaçi», «Reshit Çollaku», «Tomori» dhe të Batalionit të Rinisë, të dëgjuar për trimërinë e tyre nga mbarë populli ynë.

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare i caktoi Brigadës së 15-të Sulmuese detyra nga më të ndryshmet, të cilat ajo i kreu kurdoherë me sukses. Luftimet që bëri kudo në rrethet e Korçës, Pogradecit, Librazhdit, Elbasanit e Tiranës, çlirimi i qyteteve të Pogradecit e të Elbasanit, pritat dhe betejat gjatë rrugës automobilistike Korçë—Elbasan—Tiranë i japin një vend nderi brigadës suaj në historinë e Luftës sonë të madhe Nacionalçlirimtare.

Fitoret e Brigadës së 15-të Sulmuese kundër reparteve e njësive të armikut, të armatosura deri në dhëmbë dhe disa herë më të mëdha në numër, janë rezultat i mbështetjes së gjithanshme te populli dhe, mbi të gjitha, i udhëheqjes së urtë e largpamëse të Partisë. Ato u arritën në sajë të heroizmit partizan, të organizimit e të drejtimit të veprimeve luftarake nga organizata e Partisë, nga shtabi i brigadës dhe komandanti i saj, militanti i Partisë Komuniste të Shqipërisë, Heroi i Popullit Teki Kolaneci. Në themel të këtyre fitoreve është gjaku i Istref Merkës, Vangjel Lla-

zit, Kiço Blloshtinës, Hamet Arshiut, Shaniko Starjes, Pandi Kreshovës, Manol Zguraliut, Tomka Laçkës, Minash Gjokës dhe i dhjetëra e dhjetëra dëshmorëve të tjerë, kujtimi i të cilëve do të mbetet i paharruar për shokët, për popullin e krahinave ku ranë, për Partinë dhe mbarë popullin shqiptar.

Pas parakalimit në Tiranë, ju, partizanët dhe kuadrot e Brigadës së 15-të Sulmuese, u ngarkuat me detyrën e mbrojtjes së kufijve tanë jugorë. Shqipëria e çliruar ishte dhe mbetej halë në sytë e armiqve, përpjekjet e të cilëve, për ta robëruar popullin tonë, kurrë nuk kanë reshtur, ndaj për asnjë moment nuk i kemi mbyllur sytë e nuk i kemi lëshuar armët nga duart. Fitoret e arritura me Luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare, që i shumëfishuam në këta 40 vjet e do t'i shtojmë akoma më tepër në të ardhmen, kërkojnë nga të gjithë ne, nga gjithë populli dhe Partia, mendje të kthjellët, djersë dhe vigjilencë.

Edhe një herë gëzuar festën! Punë të mbarë, jetë të gjatë, lumturi në familjet tuaja.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 158 (11 215), 3 korrik 1984

LETËR DREJTUAR BANORËVE TË FSHATIT BODRISHTË TË DROPULLIT TË SIPËRM

Gjirokastër

30 qershor 1984

Të dashur shokë e shoqe, motra e vëllezër bodrishtiotë,

Letrën me ftesën që më bëtë për ta vizituar përsëri fshatin tuaj i mora. Ju faleminderit dhe, qysh më parë, dëshiroj t'ju them se edhe mua më ka marrë malli të shihemi e të kuvendojmë së bashku, ashtu si shumë vjet më parë, në qershor të vitit 1959. Akoma sot i kam të gjalla në mendje e në zemër dashurinë e madhe që ju ushqeni për Partinë dhe vendosmërinë për të ecur përpara, krah për krah me vëllezërit shqiptarë, në rrugën e ndërtimit socialist.

Kam ndjekur vazhdimisht me vëmendje dhe jam gëzuar për çdo përparim tuajin. Para 25 vjetësh ju ishit në një kooperativë tok me Bularatin. Atëherë Bodrishta ishte fshat i vogël, kurse tani është dyfishuar, aq sa vargu i shtëpive të reja

u është afruar atyre të Bularatit. Sot, në kooperativën e zgjeruar «Llesh Pal Çupi», që përfshin gjithë fshatrat e Dropullit të Sipërm, ju jetoni të lumtur e të gëzuar, keni të gjitha të drejtat kushtetuese, siguroni rendimente të larta nga bimët që mbillni, nga zhvillimi i blegtorisë e i frutikulturës dhe çdo vit merrni të ardhura gjithnjë më të mira. Në kooperativë keni plot çerdhe, kopshte, shtëpi kulture, shtëpi lindjeje, klinika dentare, spital dhe një rrjet të gjerë dyqanesh. Për fëmijët tuaj, si në gjithë minoritetin, janë të hapura dyert e shkollave në gjuhën amtare greke dhe kuadrot e dalë nga gjiri juaj, që kanë mbaruar me qindra shkollat e mesme e të larta të vendit tonë, japin ndihmesën e çmuar në fusha të ndryshme të jetës në të katër anët e atdheut. Për të gjitha këto Partia dhe unë jemi shumë të gëzuar.

Sa do të gëzoheshin t'i shikonin të tëra këto edhe Heroi i Popullit Çerçiz Topulli me shokë, që ju, kur ata luftonin kundër pushtuesve osmanë, i keni strehuar dhe keni ndarë me ta kafshatën e gojës, sa do të gëzohej për këto të mira Heroi i Punës Socialiste Ilia Qiqi, nga fshati fqinj i Zervatit, i cili punoi dhe ra në krye të detyrës në Lis të Matit. Idetë marksiste-leniniste të Partisë, fitoret, lufta e përpjekjet e përbashkëta për ndërtimin e socializmit, i kanë lidhur gjithnjë më fort shqiptarë e minoritarë në një unitet të çeliktë rreth Partisë.

Sigurisht miqtë e dashamirët e shumtë në botë, të gjithë ata që na e duan të mirën, gëzohen

për arritjet tona dhe na përshëndesin me gjithë zemër, kurse armiqtë, ata që na duan të keqen, tërbohen nga zemërimi dhe s'lënë gur pa lëvizur për të na penguar, por s'kanë ç'na bëjnë. Të parëve u kemi zgjatur dorën e ngrohtë të miqësisë dhe popujve të tyre u urojmë gjithë të mirat. Ky ka qenë kurdoherë zakoni i shqiptarëve. Të dytëve, atyre që na kërcënojnë, u themi se kot e kanë, nuk na trembin dot. Të gjithë ne jemi të vendosur si kurrë ndonjëherë dhe në gjendje të ecim përpara në rrugën që na udhëheq Partia, optimistë e të bindur për të ardhmen akoma më të mirë.

Duke përfituar nga rasti që më jepet t'ju shkruaj këtë letër, ju dërgoj përshëndetjet dhe urimet më të përzemërta për ta pritur 40-vjetorin e Çlirimit të atdheut me duar plot dhe për ta bërë kooperativën tuaj dhe gjithë krahinën e Dropullit akoma më të përparuar dhe shembull.

Të gjithë juve, të dashur vëllezër e motra bodrishtiotë, dhe nëpërmjet jush gjithë vëllezërve e motrave minoritarë, familjeve tuaja, ju dërgoj të falat e mia më të ngrohta.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Pararoja», nr. 53 (1795), 4 korrik 1984

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT LLAZI STRATOBËRDHA

Tiranë

19 korrik 1984

Bashkëshortes, shoqes Mita Stratobërdha, vajzave dhe djalit,

Mësova me hidhërim për vdekjen e parakohshme të burrit e babait tuaj të dashur dhe shokut tonë të luftës e të punës, Llazi Stratobërdhës. Ai do të kujtohet vazhdimisht jo vetëm nga ju, pjesëtarët e të afërmit e familjes, po do të rrojë në zemrat tona si një nga luftëtarët e orëve të para, si anëtar i devotshëm i Partisë që gjithë jetën luftoi e punoi pa u lodhur për çlirimin e atdheut dhe ndërtimin e socializmit. Për një kohë të gjatë Llazi punoi pranë nesh në funksione me përgjegjësi në aparatin e Komitetit Qendror të Partisë,

ku u dallua kurdoherë për kryerjen me besnikëri të detyrave që i qenë ngarkuar.

Ndaj me ju dhimbjen e madhe dhe ju dërgoj ngushëllimet më të përzemërta.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR RËNE LEKSKYERIT

Tiranë

3 gusht 1984

E nderuara zonjë,

Mora vesh me keqardhje për vdekjen e babait tuaj të nderuar, Gzavje de Courville, mik i Shqipërisë, ish drejtori im në Liceun e Korçës, për të cilin kam ushqyer një respekt të veçantë, dhe unë, ashtu si gjithë nxënësit e tij të Liceut, ruaj kujtimet më të mira. Juve personalisht, që ndodheni si mysafirë në vendin tonë dhe nëpërmjet jush edhe motrës suaj Bernadetë që ndodhet në Francë, ju dërgoj me këtë rast të dhimbshëm për ju bijat e tij ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHOQES ZULO ÇANI

8 gusht 1984

E dashura Zulo,

Me keqardhje mësova për vdekjen e bashkëshortit tuaj të nderuar, mësuesit tim të vjetër e të respektuar Elmaz. Juve dhe fëmijëve ju dërgoj ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Si patriot e si njeri i ndershëm, jetën e tij Elmazi ia kushtoi edukimit të brezit të ri dhe përhapjes së arsimit dhe të dijeve dhe për këtë gëzoi dashurinë dhe respektin e qindra e qindra të rinjve e të rejave. Vetë unë ruaj kujtime të shumta për kujdesin prej mësuesi të nderuar që tregonte ai ndaj nxënësve të vet.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT REIZ MALILE

12 gusht 1984

I dashur Reiz,

Me rastin e 60-vjetorit të lindjes, të kësaj dite të shënuar për ty e për familjen tënde, të dërgoj urimet e mia më të mira.

Si bir besnik i popullit e i Partisë pjesën më të madhe të këtyre viteve, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare si dhe pas Çlirimit të vendit, ti ia ke kushtuar plotësimit me devotshmëri detyrave me përgjegjësi që të ka ngarkuar Partia në sektorë të ndryshëm e në mënyrë të veçantë në fushën e diplomacisë, ku ke dhënë një kontribut të rëndësishëm për vënien në jetë e për mbrojtjen e politikës së jashtme marksiste-leniniste të Partisë e të vendit tonë dhe për rritjen e autoritetit të atdheut socialist.

Me këtë rast të gëzuar, në radhë të parë, të

uroj shëndet për t'i shërbyer me të njëjtën frymë edhe në të ardhmen çështjes së popullit e të Partisë. Uroj të keni kurdoherë lumturi e gëzime në familje.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 16-TË SULMUESE

18 gusht 1984

Të dashur shoqe dhe shokë, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 16-të Sulmuese,

Ju përshëndes të gjithë në këtë ditë të gëzuar të festës së 40-vjetorit të brigadës.

Kështu tok ishit edhe para 40 vjetësh, kur në ditët e zjarrta të Luftës Nacionalçlirimtare, më 20 gusht 1944, u mblodhët në një shesh të vogël të Therepelit malor të Skraparit të trimave për të formuar Brigadën e 16-të Sulmuese. Në gjirin e saj Partia bashkoi si një grusht çeliku partizanët e partizanet e ardhur nga Skrapari, Berati dhe krahinat e Mallakastrës e të Kurveleshit.

Nga formimi e në betejë, kjo qe rruga e të gjitha brigadave heroike partizane. Kështu e pre-

zantoi veten edhe Brigada e 16-të Sulmuese. Ju, partizanë e partizane të kësaj brigade, të prirë nga komunistët, i dhatë armikut mu në zemër të Myzeqesë, goditje të forta, aty ku nuk e priste. Të paharruara do të mbeten luftimet e përgjakshme që zhvilloi Brigada e 16-të Sulmuese për shpartallimin e autokolonave gjermane në rrugët Vlorë—Fier—Lushnjë e Berat, në Qafën e Kushovicës, si dhe ato për shkatërrimin e garnizoneve gjermane në qytetet e Fierit e të Lushnjës. Partia dhe populli kujtojnë e do të kujtojnë vazhdimisht me respekt të thellë 53 dëshmorët e Brigadës së 16-të Sulmuese, Heroinën e Popullit, trimen Liri Gero, Abedin Mollasin, Sadush Myftarin, Islam Klosin, Feride Hakimin, Mustafa Radovickën e gjithë të tjerët, vepra e të cilëve do të mbetet e pavdekshme.

Pas çlirimit të qyteteve të Kuçovës (sot Qyteti Stalin), të Lushnjës e të Fierit, Brigada e 16-të Sulmuese kreu me sukses një detyrë tjetër të rëndësishme e të ngarkuar nga Partia, spastrimin e zonave të Myzeqesë, të Elbasanit, të Gramshit, të Tiranës, të Krujës dhe të Vlorës nga mbeturinat e reaksionit.

Si bij besnikë të popullit, krahas detyrave luftarake, ju ndihmuat fuqimisht për forcimin e pushtetit të ri të këshillave nacionalçlirimtarë dhe punuat pa u lodhur e plot entuziazëm përkrah punëtorëve e fshatarëve për rindërtimin e shtëpive të djegura, të rrugëve e të urave të shkatërruara nga pushtuesit e tradhtarët, duke i ngritur

në një shkallë të re lidhjet e zemrës midis popullit e bijve të tij partizanë.

Shokë dhe shoqe,

Ju ishit djem e vajza të reja atëherë kur formuat brigadën, kurse tani ju kanë hije thinjat fisnike. Por zemra e partizanit ju ka mbetur e do t'ju mbetet gjithnjë e re, sepse na rinon e na jep forcë Partia, socializmi që kemi ndërtuar dhe e mbrojmë me forcat tona. Në jubileun e 40-vjetorit të Çlirimit, që do të festojmë me madhështi këtë vit, ne ndihemi edhe më krenarë, edhe më të fortë, sepse shohim të realizuara idealet e mëdha, për të cilat luftuam e fituam.

Populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë sonë heroike, brez pas brezi do t'i çojë përpara fitoret socialiste, do ta bëjë ekonominë më të fuqishme, mbrojtjen të pathyeshme dhe jetën më të lumtur.

Duke përfunduar, ju uroj nga zemra festën e Brigadës, gëzime dhe suksese paçi ngahera!

Ju përqafoj të gjithë me dashuri.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 200 (11 257), 21 gusht 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 18-TË SULMUESE

25 gusht 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës të 18-të Sulmuese,

Ju uroj ta kaloni gëzuar 40-vjetorin e brigadës suaj.

Plot katër dekada më parë, më 20 gusht të vitit 1944, kur në Sllatinë, në gjirin e popullit trim e patriot dibran, që kurdoherë ka ditur ta djegë mirë barutin për të mbrojtur trojet e veta nga sulmet grabitqare të armiqve, u formua Brigada e 18-të Sulmuese. Krijimi i saj ishte kurorëzim i hovit të lëvizjes çlirimtare disavjeçare në qarkun e Dibrës dhe një fitore e shënuar për Partinë dhe mbarë Lëvizjen tonë Nacionalçlirimtare.

Kjo bëri pluhur e hi përpjekjet e bandave ballisto-zogiste dhe të krerëve tradhtarë të Dibrës për të krijuar një bastion të reaksionit në këtë krahinë dhe u tregoi edhe një herë anglo-amerikanëve se sa të kota ishin shpresat e synimet e tyre për të penguar përhapjen dhe fitoren e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Veri të Shqipërisë.

Bashkimi i armëve në radhët e Brigadës së 18-të Sulmuese i shumëfishoi energjitë e partizanëve dhe të kuadrove me përvojë të batalionit të Dibrës e të Martaneshit, që prej vitesh dëgjonin fjalën e pushkën e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm, Heronjve të Popullit Haxhi Lleshi e Baba Faja, të batalionit të Çermenikës e luftëtarëve të rinj të brigadës, ngriti më lart flamurin e luftës, shpeshoi dhe fuqizoi sulmet kundër armiqve. Tri ditë pas formimit të brigadës, më 23 gusht, ju, së bashku me partizanët e Brigadës së 5-të Sulmuese, festuat çlirimin e rrethit të Dibrës nga nazistët gjermanë dhe mercenarët e Xhem Gostivarit. Çlirimi i kësaj krahine, i qyteteve të Dibrës, të Prizrenit e të Kukësit, beteja për çlirimin e Kërçovës, sulmet mbi autokolonat gjermane gjatë rrugës Prizren—Kukës, spastrimi i rretheve të Dibrës, Kukësit e Mirditës nga mbeturinat e reaksionit e tradhtarëve pas Çlirimit dhe mjaft beteja të tjera brenda dhe jashtë kufijve tanë shtetërorë, dëshmojnë për trimërinë dhe pjekurinë e partizanëve e kuadrove të brigadës, për udhëheqjen e drejtë e të mençur të Partisë, për përkrahjen e

gjithanshme të Luftës Nacionalçlirimtare nga populli i Dibrës dhe i gjithë zonave të tjera ku ju luftuat.

Historia e brigadës suaj, si gjithë historia e lavdishme e Luftës sonë Nacionalçlirimtare është shkruar me pushkë, me trimërinë e sakrificat tuaja të panumërta, me gjakun e të rënëve. Në mendje dhe në zemrat tuaja, të atyre që e njohën dhe të mbarë popullit rron dhe do të mbetet e gjallë komunistja 17-vjeçare nga Dibra e Madhe, zëvendëskomisarja e kompanisë, Heroina e Popullit Hibe Palikuqi. Të pavdekshëm do të mbeten edhe Gafur Mehmeti, Sadik Laska, Zenel Paci, Latif Përkola, Myrteza Zuna, Rahman Doda, Xhetan Kojku dhe dhjetëra dëshmorët e tjerë të kësaj brigade. Jeta, vepra, ideali për të cilin ranë ata janë e do të vazhdojnë të jenë shembull frymëzimi për brezat që do të njihen me ta në histori e në këngët e popullit, ku trimat s'vdesin kurrë.

Po mbushen 40 vjet që populli ynë, i udhëhequr nga Partia, jeton i lirë e i lumtur në atdheun e vet socialist. Nga lartësitë e sotme është shumë vështirë ta përfytyrosh Shqipërinë e paraçlirimit; Shqipëria socialiste, me ekonomi e kulturë të lulëzuar, është shndërruar në një kështjellë të pamposhtur, sepse ka themele çeliku të hedhura nga Lufta jonë Nacionalçlirimtare, ka ndërtues dhe mbrojtës të saj mbarë popullin dhe në komandë Partinë.

Qofshi kurdoherë të gëzuar, jetë të gjatë e

punë të mbarë, shëndet dhe lumturi në familjet tuaja!

Ju përqafoj

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 206 (11 263), 28 gusht 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 19-TË SULMUESE

1 shtator 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 19-të Sulmuese,

Me rastin e 40-vjetorit të krijimit të brigadës ju uroj nga zemra ju, familjet tuaja dhe gjithë popullin e rrethit të Sarandës, që ju nxori nga gjiri i vet dhe luftoi krah për krah me ju.

Kanë kaluar 40 vjet nga 30 gushti i vitit 1944, por ngjarja e kësaj dite, formimi i Brigadës së 19-të Sulmuese, do të mbetet e paharruar për ju, për fshatarët e Theollogos dhe për tërë sarandjotët trima, liridashës e punëtorë. Ky ishte kurorëzimi i rrugës luftarake të reparteve partizane të Grupit IV të Zonës së Parë Operative Vlorë—Gjirokastër, që u përfshinë në radhët e kë-

saj brigade. Partizanët e kuadrot e batalioneve «Thoma Lula», «Thanas Ziko» e «Lefter Talo», u betuan edhe një herë atë ditë para Partisë dhe popullit se do ta ngrinin më lart flamurin e lirisë dhe do ta çonin deri në fund amanetin e të rënëve. Shumë nga ju kishit marrë pjesë edhe në betejat heroike gjatë rezistencës frontale 54-ditore kundër pushtuesve gjermanë, kishit marrë pjesë e kishit mbajtur në krahë Polo Bezhanin, Llambi Nikën, Veliko Rexhon, Lejla Malon, Selfo Abedinin, Llambi Llambriqin, Petro Anagnostin, Urani Barin e shumë të tjerë që dhanë jetën në përleshje me armiqtë.

I bindur në drejtësinë e çështjes për të cilën luftonte, me besim të patundur në fitoren mbi armiqtë e tradhtarët, efektivi i Brigadës së 19-të Sulmuese, i edukuar dhe i udhëhequr me pjekuri nga komunistët dhe kuadrot, u hodh nga beteja në betejë. Brigada juaj, së bashku me forca të Brigadës së 14-të Sulmuese çliroi qytetet e Gjirokastrës, Sarandës e Delvinës. Ajo e pastroi rrethin e Sarandës nga forcat gjermano-balliste e bandat zerviste dhe u tregoi ushtrisë së Zervës dhe anglo-amerikanëve se Shqipërisë i kishte dalë zot populli e kushdo që do të guxonte të shkelte tokën e saj, para se të vinte këmbën, do të linte kokën. Thirrja fitore u dëgjua në Qafën e Muzinës, në Dhrovjan, në Livadhja, në Bregdet e kudo që zhvilloi luftime Brigada juaj e 19-të. Ju u bëtë të pathyeshëm në përpjekjet me armiqtë, po të ti-

llë ju bëri ideali, udhëheqja e Partisë dhe mbështetja në masat.

Partia i bëri thirrje gjithë popullit të hidhej në luftë kundër pushtuesve e tradhtarëve për një Shqipëri të lirë e demokratike, ndaj si kudo, edhe në rrethin e Sarandës, u ngritën në këmbë i madh e i vogël, shqiptarë e minoritarë. Në radhët e Brigadës së 19-të Sulmuese u rreshtuan me qindra minoritarë grekë, që luftuan me heroizëm përkrah vëllezërve të tyre shqiptarë kundër armiqve të përbashkët, nazifashistëve, ballistëve e zervistëve. Në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare, në sakrificat dhe gjakun e derdhur në zjarrin e betejave, hodhi rrënjë e u kalit uniteti i çeliktë midis shqiptarëve e minoritarëve, forca e të cilit manifestohet çdo ditë në Shqipërinë Socialiste.

Në këta 40 vjet lirie, populli, nën udhëheqjen e Partisë, ka bërë kudo shndërrime kolosale. Armiqtë revizionistë, dikur, për të na lënë pa bukë e hekur, na thanë të mbillnim vetëm agrume e ullinj, kurse ne bëmë jo vetëm Ksamilin e Lukovën, por edhe Vrinën, Plasën, Dajçin, ashtu si dhe hidrocentralet e mëdha që i japin dritë gjithë atdheut, bëmë edhe azotikun, metalurgjikun e vepra të tjera madhështore që kanë përmirësuar jetën e popullit tonë. Sukseset dhe fitoret që kemi arritur, me punë e mobilizim do t'i thellojmë më tej dhe do t'i mbrojmë edhe me gjak, po të jetë nevoja.

T'i rroni sa më gjatë atdheut, Partisë dhe

familjeve tuaja! U mbledhshi kurdoherë në gëzime të tilla!

Me mall e dashuri

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 212 (11 269), 4 shtator 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 20-TË SULMUESE

8 shtator 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 20-të Sulmuese,

Me rastin e 40-vjetorit të formimit të brigadës suaj ju përshëndes dhe ju uroj për shumë vjet gëzuar këtë ngjarje të shënuar.

Në ditë të tilla kujtimet e viteve të zjarrta të luftës na bëhen të gjithëve më të gjalla se kurrë. Ju vetë më shumë se kushdo e mbani mend mirë 9 shtatorin e vitit 1944, kur, të mbledhur në Protopapë të rrethit të Korçës, formuat Brigadën e 20-të Sulmuese. Kjo ishte një ngjarje e rëndësishme, sidomos për ju, partizanët e kuadrot me përvojë të batalioneve «Reshit Çollaku», «Tomori», «Hakmarrja», «Fuat Babani» e «Skënder Çaçi», që, të bashkuar në radhët e këtij formacioni të madh luftarak, u kallët tmerrin nazistëve gjermanë e bashkëpunëtorëve të tyre tradhtarë në rrethet e Librazhdit e të Korçës.

Ju u bëtë të pathyeshëm, pse ju kishte edukuar Partia t'i qëndronit besnikë çështjes së drejtë të çlirimit të atdheut e të popullit dhe kishit besim të patundur në fitore. Marshi i mirënjohur i Brigadës së 20-të Sulmuese u dëgjua në shumë vende, në fshatrat dhe nëpër rrugët e qytetit të Korçës, mbi shkrepat anës rrugëve Strugë—Elbasan e Korçë—Manastir, ditën e çlirimit të Librazhdit e në betejat e ashpra të përditshme me autokolonat naziste në fillim të nëntorit 1944. Këngët, që ju shoqëruan në çdo betejë, të cilave ju u dhatë jetë, do të vazhdojnë të këndohen nga brezat, sepse në to pasqyrohet në formë shumë të sintetizuar historia e lavdishme e popullit tonë dhe heroizmi partizan i Luftës së madhe Nacionalçlirimtare.

Rruga luftarake e Brigadës së 20-të Sulmuese është e shkurtër, por historia e saj është e lavdishme, sepse u shkrua me sakrifica të panumërta dhe me gjakun e shumë të rënëve. Të paharruar do të mbeten për ju, për popullin e krahinave ku luftuat dhe për mbarë Shqipërinë Heroina e Popullit Qibra Sokoli, dëshmorët Abedin Selenica, Ali Glina, Bido Qyteza, Meleq Gjonbabasi, Murat Mehmet Kamboja, Sejfulla Moglica, Thoma Thimi, Veis Rizai e gjithë dëshmorët e tjerë, shembulli i të cilëve ka frymëzuar e do të frymëzojë edhe në të ardhmen brezat e rinj të Shqipërisë. Ne sot kujtojmë me nderim, gjithashtu, komandantin trim, patriotin dhe luftëtarin e guximshëm Riza Kodhelin, që me qëndrimin e tij bu-

rrëror në rrethanat e vështirësitë e mëdha të luftës, fitoi dashurinë tuaj e të popullit të qarkut të Korçës.

Fitorja e madhe e 29 Nëntorit të vitit 1944 na gjeti të varfër, por shumë entuziastë. Me shpirtin luftarak e revolucionar të viteve të luftës dhe të frymëzuar për çdo ditë nga Partia ju, që vutë në provë jetën, nuk kursyet as djersën e mundin për atdheun. Dhe këto nuk shkuan kot. Përpjekjet, puna dhe djersa e popullit, nën udhëheqjen e Partisë, e bënë Librazhdin, Përrenjasin, Çermenikën dhe gjithë Shqipërinë një vend me ekonomi të përparuar, kulturë të lulëzuar dhe mbrojtje të pathyeshme. Shqipërinë socialiste, 40-vjetorin e së cilës do ta festojmë me madhështi sivjet, e ndërtuam vetë, ndaj e kemi të shtrenjtë çdo fitore dhe jemi të bindur e të vendosur në rrugën që na prin Partia.

Edhe një herë gëzuar festën, shëndet, suksese e lumturi në familjet tuaja!

Ju përqafoj së largu

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 218 (11 275), 11 shtator 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 22-TË SULMUESE

15 shtator 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 22-të Sulmuese,

Me mendje e me zemër ndodhem sot edhe unë në mes jush, aty në Pezën e shtrenjtë për ju, për gjithë popullin tonë, veçanërisht për mua. Sa e sa kujtime të pashlyeshme më lidhin me këtë krahinë, ku jeton një popull atdhedashës i zjarrtë e i lidhur si mishi me kockën me Partinë; sa e sa kujtime më lidhin me ato shtëpi bujare, me sheshet e kodrat që i kam shëtitur pëllëmbë për pëllëmbë. Shumë herë kam qenë aty e vazhdimisht më merr malli për të gjithë ata shokë e shoqe, motra e vëllezër pezakë që i kam njohur nga afër, për veteranët që qëndruan e luftuan me trimëri

krah për krah babë Myslimit, për luftëtarët e orëve të para e për gjithë popullin e Pezës, që u bë qysh në fillim strehë e jatak i sigurt për ne, komunistët, për gjithë luftëtarët e partizanët, simbol i luftës çlirimtare për mbarë Shqipërinë.

Emri i Pezës lidhet ngushtë sidomos me Konferencën historike që hodhi themelet e bashkimit të popullit rreth Partisë, me çetën e parë partizane e me goditjet e saj kundër pushtuesve, me trimërinë e dhjetëra e dhjetëra bijve e bijave të saj, që ndanë kafshatën e gojës me partizanët e partizanet, shumë prej të cilëve dhanë jetën për lirinë dhe ia zbardhën faqen Pezës e mbarë Shqipërisë. Emri i Pezës lidhet ngushtë edhe me jetën dhe veprën e birit të saj të shquar, patriotit dhe luftëtarit legjendar të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, mikut tim të dashur e të paharruar, Heroit të Popullit Myslim Peza.

Operacione të shumta ndëshkimore ndërmorën pushtuesit italianë e gjermanë për ta shuar këtë vatër të fuqishme të Luftës sonë të madhe Nacionalçlirimtare në portat e kryeqytetit, por asnjëherë s'ia arritën dot qëllimit. Partizanët e Pezës dhe trimat sypatrembur si Kajo Karafili u futën tmerrin armiqve edhe brenda në kryeqytet. Masakrat e armikut në Pezën e Vogël, në Pezë-Helmës, në Pajanë, në Grecë e Shënkoll shtuan më shumë flakën e urrejtjes popullore dhe radhët e reparteve partizane. Forcën e katër batalioneve të Grupit të Pezës, që u inkuadruan më 18 shtator 1944 në Brigadën e 22-të Sulmuese, e

njihnin mirë armiqtë. Këtë ata e njohën akoma më shumë pas formimit të brigadës, e cila brenda pak ditësh çliroi gjithë zonën e Pezës dhe i detyroi nazistët gjermanë e tradhtarët e vendit të struken në qytetet rreth saj.

Rruga luftarake e Brigadës së 22-të Sulmuese është e gjatë dhe e lavdishme. Ajo mori pjesë në shumë beteja e vazhdimisht korri fitore. Flamuri i saj u valëvit në Gëziq, në Shënpal, në Gjegjan, në Kryezi, në qafën e Pezhgeve, në qytetin e Pukës e në një varg betejash të tjera, derisa në mëngjesin e 29 Nëntorit 1944 u shpalos krenar në Shkodër, në qytetin e fundit të atdheut që u çlirua nga Ushtria jonë e lavdishme Nacionalçlirimtare, populli atdhedashës i së cilës, ashtu si mbarë populli ynë, dha aq shumë për t'ia arritur kësaj dite të madhe historike.

Shqipëria u çlirua, por ju, si gjithë partizanëve e kuadrove të brigadave të divizioneve të 5-të e të 6-të sulmues, ju prisnin beteja të tjera. Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm edhe brigada juaj kaloi kufirin tonë shtetëror dhe u përlesh fyta-fytas me nazistët gjermanë në Tuz, në Podgoricë, në malet e Suhagorës e deri në Vishegrad, duke dhënë kontributin e vet të gjakut e të sakrificave në çlirimin e popujve të Jugut të Jugosllavisë, duke kryer me nder detyrën internacionaliste.

Ju sot jeni mbledhur në Pezë nga të katër anët e atdheut. Me vete keni sjellë gëzimin e fitoreve të arritura në frontet e ndryshme të ndër-

timit socialist e forcimit të mbrojtjes së vendit e bashkë me të edhe kujtimin e shokëve tuaj të rënë. Ju ju ka ndjekur e frymëzuar në çdo situatë e vështirësi jeta dhe vepra e Heroit të Popullit, pionierit Met Hasa, kujtimi i dëshmorëve Hamdi Grori, Imer Kurti, Halil Tusha, Hamdi Cenoimeri, Koço Çako, Mehmet Felahi, Naun Çaushi, Isuf Molla dhe i gjithë të tjerëve, që do të mbeten kurdoherë të gjallë në zemrat e popullit, për të cilin dhanë jetën.

Po mbushen 40 vjet që populli ynë jeton i lirë e i lumtur në atdheun e vet. Fitoret tona, që s'kanë të numëruar, do t'i shtojmë më tej në të ardhmen, sepse popull e Parti janë një dhe të vendosur të ecin përpara në rrugën e socializmit pa marrë parasysh asnjë sakrificë.

Ju dërgoj në këtë festë të gëzuar urimet e mia më të ngrohta dhe dëshiroj të jeni mirë me shëndet me gjithë familjet tuaja. Punë të mbarë dhe jetë të lumtur!

Ju përqafoj me dashuri

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 224 (11 281), 18 shtator 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 14-TË SULMUESE

15 shtator 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane e kuadro të Brigadës së 14-të Sulmuese,

Ju uroj nga zemra me rastin e 40-vjetorit të formimit të brigadës dhe të fitores suaj të parë të madhe, çlirimin e Gjirokastrës, festimi i të cilave në mes nënave, baballarëve, motrave e vëllezërve gjirokastritë, që luftuan e fituan bashkë me ju më 18 shtator të vitit 1944, e bën më të madh gëzimin e kësaj ngjarjeje të shënuar.

Fitoret e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kishte kaluar në mësymje të përgjithshme, ju kishin bërë me krahë, ndaj ende pa u shuar jehona e «urrave» të 17 gushtit të vitit 1944 në Sheper, qafa e Çajupit përcolli nëpër gjithë krahinën e

Zagorisë gjëmimin e armëve tuaja në përleshjet e para me nazistët gjermanë. Dhe beteja ndoqi betejën e fitorja fitoren, sepse ju bijtë trima të Kurveleshit, të minoritetit e të Mallakastrës, që mbushët radhët e këtij formacioni të madh, ju kishte edukuar Partia e kalitur lufta, ju kishte rritur, ju ndihmonte e ju mbronte populli. Çlirimi i Gjirokastrës, vetëm një muaj pas krijimit të brigadës, ishte treguesi më i mirë i trimërisë, pjekurisë e i vendosmërisë së të gjithë efektivit, partizanëve e kuadrove të saj.

Me luftimet e njëpasnjëshme të zhvilluara në krahinat jugore të vendit, me gjakun e derdhur për çlirimin e Sarandës e të Delvinës, brigada juaj plotësoi me nder detyrat që iu ngarkuan nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare në ditën e formimit të saj. Ju, ish-partizanët e kuadrot e kësaj brigade, krahas njësive të tjera partizane që vepruan bashkë me ju, bëtë pluhur e hi orvatjen dinake të anglezëve për t'u ngulur në Sarandë e për të marshuar në thellësi të vendit, dhe këta «miq» që kishin për qëllim të futnin sadopak këmbët në Shqipëri, i detyruat të ktheheshin mbrapsht dhe ta sodisnin Sarandën nga deti, pse çdo gjë jua kishte bërë me kohë të qartë Partia.

Lirinë e fituam vetë me luftën tonë, me gjakun e derdhur e sakrificat e shokëve tanë. Ju latë në luftë Grigor Diamantin, Ali Goricin, Anife Metën, Hysen Likën, Isa Zhulin, Vangjel Nikën,

Sefer Koshin, Zoto Buzon, Çerçiz Rabin e dhjetëra të tjerë, por veprën e amanetin e tyre s'e harruat kurrë gjatë viteve jo më pak heroike të punës për ndërtimin e Shqipërisë së re socialiste. Ne sot kujtojmë me nderim edhe ish-komisarin e brigadës suaj, birin e denjë të Partisë e të popullit, Kahreman Yllin, që edhe pas Çlirimit luftoi e punoi me frymën e lartë të luftëtarit partizan për përhapjen e arsimit në Shqipëri, për ndriçimin e mendjes së rinisë e të popullit tonë.

Të dashur shokë e shoqe,

40 vjet më parë, kur ju parakaluat fitimtarë në kalldrëmet e Gjirokastrës, ishit të rinj, kurse tani e re është Gjirokastra dhe mbarë Shqipëria, që populli, nën udhëheqjen e mençur të Partisë, e ka zbukuruar dhe e ka kthyer në kala të pamposhtur. Epoka e lirisë, 40-vjetorin e së cilës do ta festojmë me madhështi në nëntor të këtij viti, e ngjiti atdheun tonë në lartësitë e socializmit. Ky zhvillim i gjithanshëm është bazë e shëndoshë edhe për zgjidhjen e detyrave të mëdha të së ardhmes, prandaj popull e Parti, në unitet të çeliktë, si kurdoherë edhe paskëtaj, do t'i vënë gjoksin punës e përpjekjeve për t'i ruajtur me vendosmëri fitoret e arritura dhe për të ecur gjithmonë të sigurt në rrugën e socializmit.

Qofshi shëndoshë e u mbledhshi gjithmonë

në gëzime të tilla! Ju përqafoj me dashuri dhe ju uroj gjithë të mirat.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 224 (11 281), 18 shtator 1984

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHOKUT EMIL PLUMBI

Tiranë

18 shtator 1984

Me hidhërim të thellë mësova për vdekjen e shoqes sonë të nderuar e të respektuar të Luftës Nacionalçlirimtare e të ndërtimit socialist, Ollgës, nënës suaj të dashur për të cilën ruaj kujtimet më të mira.

Si grua me ide përparimtare e patriotike, gjithë jetën shoqja jonë Ollga ia kushtoi luftës dhe punës për emancipimin dhe përparimin e gruas shqiptare, që e përfaqësoi denjësisht në organet më të larta të pushtetit popullor e të vetë organizatës së saj. Gjer në fund të jetës, të mbushur me veprimtari të dobishme në shërbim të atdheut socialist, ajo i qëndroi besnike Partisë dhe popullit, që i deshte me të gjitha forcat e saj.

Ju paraqes me këtë rast të dhimbshëm ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 23-TË SULMUESE

22 shtator 1981

Të dashur shokë e shoqe, ish-partizanë e partizane të Brigadës së 23-të Sulmuese,

Me rastin e 40-vjetorit të formimit të brigadës suaj ju përshëndes dhe ju uroj nga zemra: gëzuar festën!

Dita e formimit të Brigadës së 23-të më 21 shtator të vitit 1944 shënon fillimin e rrugës luftarake të këtij formacioni të ri, që në zjarrin e Luftës së madhe Nacionalçlirimtare iu shtua numrit të brigadave të tjera të lavdishme partizane. Ju, shokë e shoqe, ish-partizanë e partizane, komisarë dhe komandantë, që erdhët në Zall-Mëner dhe formuat brigadën e që ishit kalitur në shumë luftime të zhvilluara më parë kundër pushtuesve e tradhtarëve të vendit në formacionet luftarake me zë, siç ishin batalionet «Dajti», «Krujë-Ishëm» dhe «Mati», i plotësuat me sukses e ndërgjegje të lartë atdhedashurie të gjitha detyrat që ju ngarkoi Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare.

Të paharruara do të mbeten për ju dhe për

popullin e atyre zonave luftimet kundër autokolonave gjermane në rrugën Fushë-Krujë — Mamuras — Laç — Milot, që u bë varr i nazistëve dhe i tradhtarëve të vendit, ashtu siç do të mbeten të paharruara luftimet kundër forcave gjermane për çlirimin e qytetit e të rrethit të Krujës, shpartallimi i postave të organizatave tradhtare të Ballit e Legalitetit në zonën Prezë — Ishëm, luftimet në zonën e Shkodrës për çlirimin e saj dhe të krejt Shqipërisë.

Shpirti juaj luftarak, fryma e atdhedashurisë së zjarrtë, urrejtja e madhe për armikun, dashuria e pafund për popullin nga i cili kishit dalë dhe besimi i patundur te Partia jonë e lavdishme që ju udhëhiqte, ju bënin të pathyeshëm dhe ju nxirrnin kurdoherë fitimtarë në betejat me armikun.

Historia e Brigadës së 23-të Sulmuese dhe luftërat e saj, ashtu si historia dhe luftërat e gjithë Ushtrisë sonë heroike Nacionalçlirimtare, janë burim frymëzimi për njerëzit tanë që ndërtojnë dhe mbrojnë fitoret e socializmit, nën udhëheqjen e urtë të Partisë. Në mendjet dhe në zemrat tuaja, të popullit e të Partisë, rron e do të rrojë kujtimi i partizanëve trima të brigadës, si: Bakushe Visha, Adem Gjeli, Avdi Kazani, Ali Metra, Besim Beja, Llesh Spaçi, Mustafa Mezini, Rexhep Shira, Shaban Lika, Turabi Duro, Vesel Brama, Vat Bushi, Gani Muzhiqi e të tjerë, që dhanë jetën në lulen e rinisë së tyre për ditët e lumtura që gëzon sot mbarë populli ynë.

Të dashur shokë e shoqe,

Me radhë më të shtrënguara se kurrë rreth Partisë dhe nën udhëheqjen e saj, populli ynë trim, punëtor dhe liridashës së shpejti do të festojë me krenari të ligjshme 40-vjetorin e Çlirimit të Atdheut e të fitores së revolucionit popullor. 40 vjet punë dhe luftë këmbëngulëse kundër vështirësive dhe armiqve të brendshëm e të jashtëm e bënë Shqipërinë socialiste një vend me ekonomi të zhvilluar, me arsim, kulturë e shkencë të përparuar, me miq e dashamirë të shumtë në të gjithë botën, me një mbrojtje të fuqishme e të pathyeshme, me perspektiva të qarta e të sigurta në të ardhmen.

Përsëri ju uroj me gjithë zemër, gëzuar festën. Qofshi kurdoherë të lumtur dhe plot shëndet ju vetë dhe familjet tuaja! Suksese në punë për përparimin e mëtejshëm të atdheut tonë të dashur socialist.

Ju përqafoj të gjithë

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 230 (11 287), 25 shtator 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 17-TË SULMUESE

29 shtator 1984

Të dashur shoqe dhe shokë, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 17-të Sulmuese,

Ju dërgoj urimet dhe përshëndetjet e mia më të ngrohta me rastin e 40-vjetorit të brigadës suaj, e cila u formua më 26 shtator 1944, në Gjinar të Shpatit, në këtë krahinë, ku disa muaj më parë, në kushtet shumë të rënda të dimrit të egër, të terrorit të pushtuesve të huaj dhe veglave e shërbëtorëve të tyre vendas, populli i saj bujar, trim e atdhedashës mbajti në gjirin e vet Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, udhëheqjen e Luftës sonë të madhe Çlirimtare. Ju vinit aty nga zjarri i luftës partizane, që Partia kishte ndezur kudo në Shqipëri, të kalitur në përleshje me armiqtë fashistë e tradhtarët e me besim të patundur në fitoren përfundimtare. Partia bashkoi në radhët e brigadës suaj partizanët e kuadrot e batalioneve të Dumre-Darsisë, të Vërçë-Sulovës, të Bërzeshtës, të Shpatit e të Polisit, si dhe forcat vullnetare që vepronin në zonën e Zarani-

kës dhe të gjithëve ju priu si kurdoherë në betejat për çlirimin e plotë të vendit.

Heroizmi juaj, shokë ish-partizanë e partizane, komisarë e komandantë, u mishërua në të gjitha përleshjet që zhvilluat me armiqtë në Broshkë e në Kaçuli të Elbasanit, në zonën e Darsisë, në Ibë e në Bërzhitë për shkatërrimin e autokolonës gjermane të armatosur gjer në dhëmbë, që ishte nisur për t'u ardhur në ndihmë nazistëve të rrethuar në kryeqytet e menjëherë pas Çlirimit edhe në asgjësimin e mbeturinave të bandave tradhtare, duke kryer kështu me nder të gjitha detyrat e ngarkuara nga Partia.

Në luftimet e zhvilluara nga Brigada e 17-të Sulmuese në fushën e betejës ranë dhe u bënë yje të pavdekshme kurrë dëshmorët Ali Jolldashi, Anastas Çakalli, Banush Llapushi, Haxhi Liçi, Jorgji Dule, Kadri Abdihoxha, Lef Bërdufi, Nazmi Dervishhasani, Rrahman Çota, Ramazan Sina, Spiro Sulo, Xhemali Plaka, Xhemal Senja e të tjerë, të cilët Partia dhe populli do t'i kujtojnë kurdoherë me dashuri e respekt të thellë.

Të gjithë ju sot, në këtë përvjetor të shënuar, megjithëse vitet ju rëndojnë në kurriz, bashkë me motrat dhe vëllezërit shpatarakë, që kanë ndarë me ju vështirësitë e luftës dhe gëzimin e fitoreve, kujtoni me krenari ditët e ngjarjet e paharruara në brigadë, betejat e fitoret që keni përjetuar, ndieni përsëri pulsin tuaj të rrahë si në ato kohë heroike e të lavdishme. Por sot përpara jush shpalosen edhe flamurët e fitoreve në betejat po

aq të lavdishme për ndërtimin e socializmit e mbrojtjen e atdheut dhe zemra ju bëhet mal, ashtu siç u bëhet nipërve e mbesave tuaja, gjithë popullit tonë.

Shokë e shoqe,

40-vjetorin e formimit të brigadës ju e festoni në një kohë kur vetëm dy muaj na ndajnë nga jubileu i madh i Çlirimit të Atdheut, në të cilin gjithë populli ynë përgatitet të shkojë me duar plot e krenar për fitoret e korrura dhe me besim të patundur në të ardhmen. Arritjet e pakrahasueshme të deritanishme, nën udhëheqjen e vendosur marksiste-leniniste të Partisë, na frymëzojnë e na shtojnë të gjithëve energjitë për t'u hedhur me të tëra forcat përpara në ndërtimin e plotë të socializmit, për begatinë e popullit e të atdheut, si dhe për t'i bërë gjithnjë më të paprekshëm kufijtë e tij.

Edhe një herë ju uroj nga zemra festën e brigadës. Gëzime e suksese paçi ngahera!

Ju përqafoj të gjithë

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 236 (11 293), 2 tetor 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 24-T SULMUESE

6 tetor 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 24-t Sulmuese,

Ju sot jeni mbledhur për të festuar një ngjarje të paharruar për ju e për mbarë popullin trim e liridashës të rrethit të Kukësit, 40-vjetorin e formimit të Brigadës së 24-t Sulmuese. Kishte kaluar më shumë se një vit nga dita e krijimit të çetës së parë partizane të krahinës së Lumës, që me aksionet kundër pushtuesve e tradhtarëve të vendit e me fjalën e Partisë në zemër e në mendje, i dha zjarr gjithë kësaj zone me tradita atdhedashurie, kur ju u mblodhët përsëri në Bicaj e në

mes gëzimit dhe entuziazmit popullor formuat brigadën. Krijimi i këtij formacioni të ri të madh të Ushtrisë sonë heroike Nacionalçlirimtare kurorëzonte rritjen e lëvizjes çlirimtare të popullit të rrethit tuaj, që kurrë s'u ishte nënshtruar të huajve e s'i kishte lëshuar armët.

Partia i dha forcë dhe kuptimin e vërtetë Lëvizjes së gjerë Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, ndaj si kudo, edhe në rrethin tuaj, populli u ngrit dhe u lëshua me urrejtje mbi nazistët gjermanë e bajraktarët tradhtarë, që me terror e dredhi u përpoqën më kot ta mashtronin e ta nënshtronin. Grushti i Brigadës së 24-t Sulmuese ra fuqishëm mbi kolonat gjermane që lëviznin në rrugën Kukës-Prizren, mbi postat armike në afërsi të ish-qytetit të Kukësit e mbi mercenarët e tradhtarit me damkë, Muharrem Bajraktarit. Në luftën për çlirimin e kryeqytetit dhe të Shkodrës, ju, partizanët e kuadrot me përvojë të batalionit të Lumës, bijtë më të mirë të kësaj krahine, asaj të Gorës e të zonave të tjera të rrethit tuaj, që mbushnit radhët e kësaj brigade, treguat shembuj të shumtë guximi dhe heroizmi dhe, të udhëhequr nga Partia, i ngritët në një shkallë më të lartë traditat e lashta luftarake të gjyshërve e stërgjyshërve tuaj, të trashëguara brez pas brezi.

Shqipëria u çlirua, por ajo duhej mbrojtur e spastruar nga mbeturinat e reaksionit, ndaj ju, siç ju mësoi Partia, nuk i lëshuat pushkët e nuk e pu-

shuat luftën. Vargut të të rënëve gjatë luftës, pas Çlirimit të vendit iu shtuan të tjerë, që për ju, për popullin e Kukësit e për mbarë Shqipërinë do të mbeten të pavdekshëm. Sot kujtojmë me nderim e respekt të thellë birin e Bicajt dhe partizanin e orëve të para të krahinës së Lumës, komunistin dhe kuadrin e Brigadës së 24-t Sulmuese, Heroin e Popullit Hasan Gërxhalliu, kujtojmë dëshmorët Vehbi Shehu, Ramadan Shahu, Nuredin Braha, Sadik Palushi, Idriz Gafuri, Isuf Seferi, Ymer Mata, Veledin Muço, Gani Onuzi e të tjerë, shembulli i të cilëve na ka frymëzuar e do të na frymëzojë kurdoherë në luftën e përpjekjet e vazhdueshme për mbrojtjen e lirisë dhe ndërtimin e socializmit.

Po mbushen 40 vjet që populli ynë jeton i lirë e i lumtur në atdheun e vet socialist. Sukseset madhështore që kemi arritur në forcimin e pandërprerë të ekonomisë dhe të mbrojtjes së vendit, për të cilat me të drejtë jemi krenarë, janë vepër e vullnetit të çeliktë dhe e patriotizmit të lartë të popullit tonë të lirë, që ka në duar pushtetin dhe udhëhiqet nga Partia. Ndaj qëndrojmë gjithnjë syhapur në ruajtjen e këtyre fitoreve dhe nuk do t'i kursejmë mundin e djersën për t'i çuar ato gjithnjë përpara.

E kalofshi gëzuar festën e 40-vjetorit të formimit të Brigadës së 24-t Sulmuese ju dhe gjithë motrat e vëllezërit kuksianë, që marrin pjesë në këtë ngjarje të shënuar. Ju uroj juve e nëpërmjet

jush gjithë banorëve të rrethit shëndet, suksese në punë e lumturi në familje.

Ju përqafoj me dashuri

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 242 (11 299), 9 tetor 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 3-TË SULMUESE

6 tetor 1984

Të dashur ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 3-të Sulmuese, të dashur shokë dhe shoqe,

E ndiej veten me mendje e me zemër pranë jush ashtu si 41 vjet më parë, kur u mblodhëm për të formuar brigadën. Kjo ngjarje, si për të gjithë ju, do të mbetet e paharruar edhe për mua. Ditën e 9 tetorit 1943 unë nuk ju pashë të rreshtuar dhe as duke parakaluar para shtabit, sepse sulmi i befasishëm nazist në Arbanë nuk na lejoi t'i bënim këto ceremoni, por ju njoha nga afër në betejën e përgjakshme me armikun, kur brigada juaj u pagëzua në luftë. Lufta e Arbanës, që shënon edhe datën e formimit të Brigadës së 3-të Sulmuese, tregoi vendosmërinë, guximin dhe

shpirtin tuaj sulmues. Në bashkëpunim me forca të Grupit të Pezës dhe me fshatarët e armatosur trima e patriotë të zonës përreth, gjermanët, që sulmuan frontalisht nga brigjet përballë Arbanës, nga të dy krahët e lumit Erzen, ju i detyruat të tërhiqeshin me turp, duke lënë në fushën e luftës me dhjetëra armiq të vrarë.

Akoma nuk ishte shuar jehona e fitores në Arbanë, kur në kryeqytet ushtoi gjëmimi i topit të Brigadës së 3-të Sulmuese, që goditi ndërtesën ku ishte mbledhur asambleja kuislinge. Ky aksion u futi frikën në palcë dhe nuk i lejoi «baballarët e kombit», të mbledhur nga Gestapoja, të vulosnin në qetësi e me bujë aktin e turpit e të tradhtisë. Predhat e topit të brigadës suaj bënë pluhur e hi shpresën e demagogjinë e nazistëve e të disa bashkëpunëtorëve të shitur shqiptarë që ishin vënë kokë e këmbë në shërbim të tyre për të mashtruar popullin dhe u treguan armiqve se populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë, do ta vazhdonte luftën deri në fund.

Këto fitore të kësaj njësie të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare bënë jehonë në gjithë vendin, por luftërat dhe trimëria e efektivit të Brigadës së 3-të do të bëheshin të njohura edhe gjatë luftimeve të shumta të zhvilluara në Shqipërinë e Mesme, në Jug e në Veri. Atë do ta njihnin, gjithashtu, vëllezërit kosovarë, që luftuan krah për krah me ju për çlirimin nga nazistët gjermanë e bashkëpunëtorët e tyre të një vargu krahinash e qytetesh përtej kufijve shtetërorë. Emri i Briga-

dës së 3-të Sulmuese do të zihej në gojë edhe nga popullsia e zonave të Sanxhakut e të Maqedonisë, ku ajo luftoi e derdhi edhe gjak për çlirimin e tyre, duke kryer me nder detyrën e saj internacionaliste.

Për çështjen e madhe të Partisë e të popullit, për çlirimin e atdheut dhe vendosjen e pushtetit popullor, efektivi i brigadës suaj bëri sakrifica të panumërta dhe shumë nga partizanët e kuadrot e saj falën edhe jetën. Për ju, për ata që i njohën, për Partinë, për popullin dhe për brezat e ardhshëm do të mbetet përjetë i gjallë kujtimi i heronjve të popullit Myslim Keta e Ylbere Bilibashi, i dëshmorëve Muhedin Sherifi, Birçe Sinemati, Shemsi Haka, Kozma Papadhimitri, Muhamet Bakiri, Agim Gjilani, Mersin Lekdushi, Mihal Tase dhe i shumë të tjerëve që ranë në luftën e rinisë.

Të dashur shokë dhe shoqe,

Festimi i ngjarjeve të shënuara të Luftës sonë të lavdishme Nacionalçlirimtare është kthyer në një gëzim masiv popullor, që sivjet, në kuadrin e 40-vjetorit të Çlirimit, është më i madh se kurrë. Sukseset e arritura në ekonomi, arsim, kulturë, shkencë dhe mbrojtje na e shtojnë gëzimin, i bëjnë festat tona më të bukura, por edhe na rritin detyrat e përgjegjësinë për t'i mbrojtur dhe për t'i shpënë më përpara fitoret e Shqipërisë socialiste.

Ju uroj juve dhe gjithë pjesëmarrësve nga fshatrat përreth ta kaloni gëzuar festën. U mbledhshi përherë me më shumë suksese e gëzime në përvjetorë të tillë!

Ju përqafoj të gjithë

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 242 (11 299), 9 tetor 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 11-TË SULMUESE

13 tetor 1984

Të dashur shoqe dhe shokë, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 11-të Sulmuese,

Ju përshëndes me gjithë zemër me rastin e festës, 40-vjetorit të formimit të brigadës ju dhe, nëpërmjet jush, tërë punonjësit trima, atdhedashës e punëtorë të rrethit të Fierit.

40 vjet më parë, menjëherë pas çlirimit të Fierit, nga batalionet «Ismail Kloşi», «Seman», «Petro Sota», batalionet territoriale të Ballshit e të Fratarit, që bënin pjesë në Grupin e 3-të të Mallakastrës, si dhe nga batalioni i forcave vullnetare të Myzeqesë së Fierit u formua Brigada e 11-të Sulmuese. Grupi i 3-të i Mallakastrës, që përbënte bërthamën e brigadës suaj, kishte

përshkuar një rrugë të lavdishme luftarake, duke u bërë burim edhe për furnizimin me partizanë të brigadave të reja të Ushtrisë sonë heroike Nacionalçlirimtare që ishin krijuar e po krijoheshin në atë kohë.

Ju, ish-partizanë e kuadro të efektivit të kësaj njësie, erdhët në krijimin e saj të kalitur e me një përvojë të pasur luftarake, të fituar më parë në ndeshje të shumta e të përgjakshme me armiqtë nazifashistë e bandat tradhtare në Mallakastër e në krahina të tjera të vendit, si në Vlorë, në Tepelenë, Skrapar, Myzeqe etj.

Brigadës suaj, së toku me njësi të tjera të mëdha të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, iu ngarkua menjëherë pas krijimit detyra shumë e rëndësishme, marrja pjesë në luftimet për çlirimin e kryeqytetit. Përmes kushteve tepër të vështira të motit dhe terrenit të përmbytur të Myzeqesë ajo shpartalloi armikun që përpiqej t'i vinte në ndihmë garnizonit nazist të rrethuar nga forcat partizane në Tiranë dhe u vu në mbrojtje të bregdetit tonë perëndimor.

Pas Çlirimit të vendit Brigada e 11-të Sulmuese vazhdoi luftën kundër elementëve armiq e forcave reaksionare për spastrimin e një sërë krahinash të Shqipërisë Veriore, duke arritur deri në Majën e Hekurave. Në kushtet jashtëzakonisht të vështira të dimrit partizanët e brigadës kaluan nëpër tërë krahinën e Dukagjinit dhe zonat e tjera të afërta, për të cilat reaksioni trumbetonte se nuk shkelte dot këmba e par-

tizanëve. Në këtë luftë brigada pati ndihmën dhe përkrahjen e popullit trim e luftëtar të malësive tona kreshnike, bijat e bijtë e të cilit shtuan radhët e saj. Brigada e 11-të Sulmuese e përfundoi kështu me nder detyrën ushtarako-politike që i ngarkuan Partia dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Sot e vazhdimisht Partia dhe mbarë populli ynë kujtojnë e do të kujtojnë me respekt të thellë dëshmorët e Brigadës së 11-të Sulmuese, si: Heroin e Popullit Dino Kalenja, Andon Profkën, Baftjar Haxhinë, Faslli Hodajn, Lipi Dhimën, Sherif Salinë, Shaban Kapllanin dhe gjithë partizanët e tjerë që dhanë jetën për lirinë e atdheut.

Shokë dhe shoqe,

Lufta e mbarë popullit tonë që mbushi me bijat e bijtë e tij radhët e brigadave partizane, nën udhëheqjen e drejtë e largpamëse të Partisë, solli ditën e madhe të Çlirimit, 29 Nëntorin e vitit 1944, 40-vjetorin e të cilit do ta festojmë këtë vit me madhështi. Të gjitha fitoret e arritura në këto katër dekada i kanë themelet te kjo luftë dhe te gjaku i derdhur lumë nga vajzat dhe djemtë më të mirë të popullit tonë. Prandaj t'i çojmë gjithmonë përpara fitoret, për ta bërë gjithnjë më të lumtur jetën e punonjësve tanë dhe Shqipërinë të fortë e të pamposhtur nga asnjë armik, i brendshëm apo i jashtëm qoftë.

Duke përfunduar, të dashur shokë dhe shoqe, ju uroj ta kaloni gëzuar festën e 40-vjetorit të Brigadës së 11-të Sulmuese!

Ju përshëndes e ju përqafoj të gjithë me dashuri.

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 248 (11 305), 16 tetor 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 9-TË SULMUESE

27 tetor 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 9-të Sulmuese,

Ju përshëndes me gëzim të madh ju dhe gjithë popullin e rrethit të Korçës, që luftoi e fitoi bashkë me ju, për të dyja ngjarjet e shënuara që festoni sot, 40-vjetorin e formimit të brigadës dhe çlirimin e qytetit të Korçës.

Beteja e fitore të njëpasnjëshme e shoqëruan vazhdimisht deri në fund Brigadën e 9-të Sulmuese në rrugën e saj luftarake. Më 16 tetor 1944, kur ju, ish-partizanët e kuadrot e batalioneve «Reshit Çollaku», «Skënder Çaçi», «Tomori», «Fuat Babani» dhe «Hakmarrja», në mes gëzimit të fshatarëve trima nga Gora, Opari dhe

krahinat e tjera përreth, u rreshtuat në Lozhan dhe formuat brigadën, Shqipëria ishte në prag të çlirimit të plotë. Bashkimi i armëve dhe afrimi i ditës së madhe të fitores ju shumëfishoi forcat, guximin dhe vendosmërinë për të realizuar me nder detyrat e ngarkuara nga Shtabi i Përgjithshëm, prandaj u hodhët menjëherë në sulm mbi armiqtë, pushtuesin nazist e tradhtarët e vendit, që disfata e pashmangshme i kishte egërsuar në kulm.

Me dhjetëra nga shokët tuaj kishin rënë në përleshjet e përgjakshme me armiqtë në rrethet e Korçës, të Pogradecit e të Kolonjës, shumë të tjerë kishin shtuar radhët e njësive të mëdha partizane të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, me efektiva të batalioneve tuaja u formua edhe Brigada e 20-të Sulmuese, megjithatë radhët partizane, ku ishit inkuadruar ju, njohën vetëm rritje, sepse e kishin burimin te populli.

Me formimin e brigadës ju i fuqizuat goditjet mbi armikun dhe shpejtuat çlirimin përfundimtar të qarkut të Korçës nga thundra e tij. Fitoret tuaja gjatë luftimeve në rrugët Barmash—Helmës, Korçë—Pogradec, në Qafën e Qarrit, në Dvoran e në Bilisht janë dëshmi e përvojës suaj të tpasur të fituar në zjarrin e luftës, e mbështetjes dhe e lidhjes së ngushtë me popullin trim e atdhedashës të krahinave ku vepruat dhe e udhëheqjes së Partisë.

Vend të veçantë në historinë e Luftës sonë Nacionalçlirimtare zë beteja disaditore për çli-

rimin e qytetit të Korçës, ku ju, me përkrahjen e gjithanshme të popullit, krahas forcave të Brigadës së 2-të dhe të 20-të Sulmuese dhatë shembuj të shumtë guximi dhe heroizmi. Me sulmin e rrufeshëm kundër armiqve në qytet ju ua shkurtuat atyre ditët dhe u dhatë fund krimeve të tyre të përbindshme, nuk i lejuat egërsirat hitleriane ta shndërronin qytetin e bukur në gërmadhë, i mbyllët shtegun çdo orvatjeje të krerëve tradhtarë për kombinacione politike me reaksionin e jashtëm dhe i sollët popullit patriot të rrethit të Korçës lirinë e shumëpritur, për të cilën ai kishte bërë mjaft sakrifica e kishte derdhur shumë gjak.

Çlirimi e gjeti vendin tonë të varfër e të shkatërruar, por populli dhe Partia iu përveshën punës ndërtimtare me entuziazëm pa ia shtrirë dorën askujt e pa u mashtruar nga ndihmat skllavëruese që na ofronin gjoja pa interes anglo-amerikanët. Liria dhe ndërtimi i socializmit te ne janë vepra jonë, ndaj me të drejtë jemi krenarë e të vendosur të bëjmë çdo sakrificë për mbrojtjen e tyre. Në Shqipërinë socialiste, që sivjet feston 40-vjetorin e asaj epoke të lavdishme që populli e quan të Partisë, janë bërë ndryshime të pakrahasueshme me të kaluarën në të gjitha lëmet e jetës dhe njerëzit jetojnë të gëzuar, të lumtur e të sigurt. Gjithçka që është ndërtuar e realizuar mban vulën e popullit, është në të mirën e tij dhe mishëron vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë, prandaj Parti e popull ja-

në të lidhur me njëri-tjetrin në unitet të çeliktë dhe s'ka forcë që ta thyejë atë.

Edhe një herë ju uroj ju dhe nëpërmjet jush gjithë punonjësit e rrethit të Korçës gëzim, lumturi dhe suksese në punë!

Ju përqafoj të gjithë

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 260 (11 317), 30 tetor 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 10-TË SULMUESE

27 tetor 1984

Të dashur shokë e shoqe, ish-partizanë, partizane e kuadro të Brigadës së 10-të Sulmuese,

Me rastin e 40-vjetorit të formimit të brigadës suaj ju përshëndes dhe ju uroj nga zemra, gëzuar festën!

Më 29 tetor 1944, në ato ditë të lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, kur populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë po u jepte grushte të rënda pushtuesve gjermanë e tradhtarëve të vendit, aty, në Karbunarën e lidhur ngushtë me Partinë, u formua brigada juaj me partizane e partizanë trima, që vinin nga luftimet e ashpra e fitoret e arritura mbi armiqtë në beteja të ndryshme e që bënin pjesë në batalionet partizane «Riza Cerova» e «Tefik Lapani», në batalionin e rinisë «Ajet Xhindoli» dhe në batalionin e katërt që u formua me partizanët e rrethit të Lushnjës.

Porsa u formua, Brigada e 10-të mori detyrën luftarake me shumë rëndësi që, së bashku me njësitë e tjera partizane, të merrte pjesë në çlirimin e kryeqytetit. Në kushte të motit e të terrenit të vështirë gjatë marshimit, ajo këtë detyrë e plotësoi me vetëmohim e me ndërgjegje të lartë, duke sulmuar e goditur për vdekje në mënyrë të veçantë autokolonën naziste që vinte nga Elbasani në ndihmë të garnizonit gjerman që ndodhej në një gjendje të dëshpëruar në Tiranë.

Rruga luftarake e Brigadës së 10-të Sulmuese, ashtu si gjithë brigadat partizane, janë burim frymëzimi për gjithë masat tona punonjëse, që ndërtojnë e mbrojnë fitoret e socializmit, nën udhëheqjen e Partisë sonë të lavdishme. Në mendjet dhe në zemrat tuaja dhe të mbarë popullit tonë rron e do të rrojë heroizmi e kujtimi i partizanëve trima të brigadës suaj, si Fiqri Mebelli, Hasan Vërzeshta, Avni Prishta, Qani Malinati, Alush Grepcka e të tjerë, si dhe i ish-partizanëve të brigadës suaj, Heroit të Popullit Hajdar Tafa dhe luftëtarëve Agush Gurëzezi e Maliq Gjezi, që ranë heroikisht pas Çlirimit në luftën kundër armiqve të pushtetit të ri.

29 Nëntori i vitit 1944 shënon për myzeqarët, si për mbarë popullin tonë, fundin e vuajtjeve e të mjerimeve të papërshkruara. Për herë të parë në histori lufta e të shtypurve, gjaku i djemve dhe i vajzave të Lushnjës e të gjithë Myzeqesë, që luftuan në radhët partizane në të katër anët e vendit, nuk shkuan kot. Lufta Nacio-

nalçlirimtare i solli mbarë popullit tonë lirinë, ajo edhe myzeqarin e shtypur e bëri zot të fateve të veta. Myzeqeja e dikurshme e kënetave dhe e kasolleve pa oxhak, ku bujkut ia pinte gjakun beu dhe ia shkurtonte jetën malarja, është bërë sot një fushë e begatë me bujqësi moderne. Me fitoret madhështore në të gjitha fushat e jetës, të arritura me mendjen, punën dhe djersën e popullit të udhëhequr nga Partia, ne shkojmë krenarë, ballëlart e me plot arritje në jubileun e madh të 40-vjetorit të Çlirimit. Sukseset e mëdha të deritanishme në prodhim, në arsim e kulturë dhe në mbrojtjen e vendit na mbushin me besim e na shumëfishojnë forcat për të ecur si gjithmonë të sigurt në rrugën e socializmit.

Duke përfunduar, të dashur shokë e shoqe, juve dhe nëpërmjet jush gjithë popullit atdhedashës të rrethit të Lushnjës, ju uroj ta kaloni gëzuar festën e 40-vjetorit të Brigadës së 10-të Sulmuese. Qofshi të lumtur e paçi kurdoherë suksese e gëzime!

Ju përqafoj të gjithë

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 260 (11 317), 30 tetor 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 25-TË SULMUESE

3 nëntor 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 25-të Sulmuese,

Ju uroj me gjithë zemër për festën e gëzueshme të krijimit të brigadës suaj 40 vjet më parë!

Populli i rrethit të Tropojës kishte ditë që jetonte në liri dhe Shqipëria ndodhej në prag të çlirimit të plotë, kur ju, pasardhësit e trimit të maleve, Heroit të Popullit Bajram Curri, u mblodhët në Astë të Tropojës dhe mes entuziazmit të malësorëve formuat Brigadën e 25-të Sulmuese. Krijimi i kësaj njësie të madhe par-

tizane ishte dëshmi e qartë e rritjes së lëvizjes çlirimtare të popullit të Tropojës, që qysh në vitin 1943, në Kuvendin e Malësisë së Gjakovës, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, dha besën dhe vendosi njëzëri të hidhej në luftë kundër pushtuesve e tradhtarëve deri në çlirimin e plotë të vendit. Bjeshkët e larta dhe grykat e maleve, që në shekuj kishin përcjellë jehonën e kushtrimit të të parëve tuaj për mbrojtjen e trojeve nga armiqtë, gjëmuan edhe një herë fuqishëm gjatë viteve të Luftës sonë të madhe Nacionalçlirimtare nga pushkët e çetave dhe batalioneve partizane që u rreshtuan në radhët e brigadës suaj.

Brigadës që sapo formuat Partia i ngarkoi detyra të rëndësishme e të vështira, sepse kishte besim tek trimëria dhe vendosmëria juaj, që ishit mëkuar me dashurinë për lirinë dhe qysh në fëmini kishit mësuar ta përdornit mirë pushkën për mbrojtjen e nderit e të atdheut. Besimin e Partisë ju e përligjët me luftimet e suksesshme kundër armiqve në Nikaj-Mërtur, në krahinën e Dukagjinit dhe veçanërisht gjatë kryerjes së detyrës së ngarkuar nga Partia dhe Shtabi ynë i Përgjithshëm për çlirimin e popujve të Jugut të Jugosllavisë e të vëllezërve tanë shqiptarë që jetojnë në Kosovë, në Mal të Zi e në Maqedoni. Me qëndrimin tuaj burrëror, me sakrificat e panumërta, me gjakun e shokëve të rënë përkrah luftëtarëve kosovarë, malazez e boshnjakë, ju, si gjithë partizanët e kuadrot e divizioneve të

5-të e të 6-të, treguat frymën internacionaliste që karakterizon popullin dhe Partinë tonë.

Në këtë ditë feste për ju dhe për mbarë popullin e rrethit të Tropojës kujtojmë kohën heroike të luftës, vështirësitë e kaluara, betejat e zhvilluara dhe, mbi të gjitha, shokët e rënë. Të paharruar do të mbeten për ju, për malësorët e Tropojës e të Hasit dhe për popullin e krahinave ku dhanë jetën dëshmorët e Brigadës së 25-të Sulmuese, Mushak Kadria, Ukshin Rustemi, Prek Mani, Oso Dauti, Jup Bajrami, Islam Goçi, Ismail Lleshi, Ali Meshi dhe gjithë të tjerët që vunë gjakun e tyre në themel të gëzimeve tona.

Po mbushen 40 vjet nga dita kur populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, shporri një herë e përgjithmonë nga trualli i vet pushtuesit e tradhtarët dhe filloi ndërtimin e jetës së re. Ju dhe gjithë të moshuarit e mbani mend mirë nga e nisëm punën për ndërtimin e socializmit. Pisha e përdorur nga malësori për ndriçim dhe trungu i drurit për jastëk, që janë futur prej kohësh në muze, u flasin brezave të rinj për përpjekjet heroike e për sakrificat e popullit e të Partisë që arritën brenda pak dekadave të kalonin nga bishtuku te gjigantët e dritës, te Fierza e Komani. Me luftë, me punë, me radhë të shtrënguara, popull e Parti, Shqipërinë socialiste do ta bëjmë gjithnjë më të bukur, më të begatë e më të fortë.

Edhe një herë ju uroj shëndet, gëzime nëpër

familje dhe punë të mbarë e të frytshme për të mirën tuaj dhe të mbarë atdheut!

Ju përqafoj me mall

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 266 (11 323), 6 nëntor 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 2-TË SULMUESE

3 nëntor 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 2-të Sulmuese,

Ju përshëndes dhe ju uroj me gjithë zemër për 41-vjetorin e formimit të brigadës suaj, që sivjet e festoni në atmosferën e gëzuar të jubileut të madh, 40-vjetorit të Çlirimit dhe të fitores së revolucionit popullor.

Më 28 Nëntor të vitit 1943, ditën e shënuar të përvjetorit të 31-të të Shpalljes së Pavarësisë, ju zbritët nga stanet e Linosit në Skrep dhe, në sheshin e vogël rrethuar me male, në mes gëzimit të fshatarëve trima, atdhedashës e përparimtarë të krahinës së Shëngjergjit e partizanëve të çetës së saj, formuat Brigadën e 2-të Sulmuese, një nga formacionet e para të mëdha të Ushtrisë sonë heroike Nacionalçlirimtare. Si për të gjithë ju, edhe për mua, do të mbetet i paharruar entuziazmi i asaj dite, gëzimi juaj dhe i popullit të krahinës, që shihte te ju luftëtarët e vendosur të çështjes së Partisë dhe të popullit.

Brigadës së sapoformuar në prag të dimrit, kur e prisnin vështirësitë e mëdha të stinës dhe beteja të ashpra me armiqtë, i mungonin armatimet, i mungonin, gjithashtu, ushqimet e veshmbathja, por ju, ish-partizanët e saj, ishit të vendosur për të ecur në rrugën e luftës për çlirim që ju udhëhiqte Partia.

Brigada e 2-të Sulmuese, ashtu si të gjitha formacionet e Ushtrisë sonë partizane Nacionalçlirimtare, dha ndihmesën e saj për asgjësimin e forcave të konsiderueshme të gjalla e materiale të pushtuesve e tradhtarëve të vendit, për shkatërrimin e pushtetit të vjetër feudo-borgjez dhe ngritjen e forcimin e pushtetit të popullit. Me gjithë dobësitë e drejtimit të kësaj brigade dhe humbjet e rënda që pësoi gjatë Operacionit armik të Dimrit, ajo shpejt e rimori veten dhe vazhdoi pandërprerë veprimtarinë luftarake, duke i mbajtur nazistët e tradhtarët nën presionin e goditjeve të saj kudo ku kaloi dhe luftoi.

Në veprimet luftarake rreth kryeqytetit, në zonat e Krujës e të Martaneshit, duke zbatuar porositë e Partisë dhe urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm, ju treguat guxim dhe trimëri, që do të spikatnin më me forcë në betejat e mëvonshme në Shqipërinë e Mesme e të Jugut, në rrethet e Korçës e të Kolonjës dhe gjatë rrugës automobilistike Strugë—Qafëthanë—Përrenjas etj.

Për të gjithë ne dhe për brezat e ardhshëm të vendit tonë do të mbeten shembull frymëzimi lufta dhe puna e palodhur për çështjen e

Partisë e të popullit e ish-kuadrit të brigadës suaj, udhëheqësit të talentuar të rinisë, Alqi Kondit, ish-komisarit të batalionit të parë të brigadës, Heroit të Popullit Kozma Naska, Heroit të Popullit, të paharruarit Memo Nexhipi, dëshmorëve Nazmi Gaba, Kleanthi Manastirliu, Besim Imami, Kostandina Gaçe, Raqi Themeli, Neshat Kondi dhe gjithë të tjerëve nga radhët e brigadës suaj, që dhanë jetën në luftën për çështjen e madhe të popullit.

Së shpejti mbarë populli ynë do të festojë me gëzim dhe entuziazëm 40-vjetorin e Çlirimit të Atdheut. Fitoret tona të mëdha në çdo fushë të jetës në këto katër dekada, i kanë themelet te Lufta e lavdishme Nacionalçlirimtare, te mençuria, guximi dhe udhëheqja e drejtë e Partisë sonë, që vazhdimisht ka qëndruar në ballë të luftës e të punës së masave dhe udhëheq me sukses popullin tonë në rrugën marksiste-leniniste për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Qofshi kurdoherë të gëzuar e të lumtur! Jetë të gjatë e suksese në detyrat tuaja shtetërore e shoqërore.

Ju përqafoj të gjithë

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 266 (11 323), 6 nëntor 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 27-TË SULMUESE

24 nëntor 1984

Të dashur shokë dhe shoqe,

Ju dërgoj përshëndetjet më të përzemërta me rastin e 40-vjetorit të formimit të brigadës suaj të gjithë juve dhe nëpërmjet jush mbarë punonjësve trima, atdhedashës e përparimtarë të rrethit të Shkodrës.

Formimi i Brigadës së 27-të Sulmuese lidhet ngushtë me çlirimin e Shkodrës dhe të popullit të saj, traditat e shquara patriotike dhe luftarake të të cilit, si të mbarë popullit tonë, Partia i ka ngritur në një shkallë shumë të lartë. Shkodra që në të shkuarën ka nxjerrë vazhdimisht nga gjiri i vet atdhetarë e luftëtarë të shquar, të pushkës e të penës, të Rilindjes e të Pavarësisë Kombëtare, edhe gjatë Luftës së madhe Nacionalçlirimtare nxori revolucionarë të vendosur e të devotshëm ndaj çështjes së popullit e të Partisë si dhe shumë heronj e dëshmorë. Të paharruar do të mbeten për ne dhe për brezat e ar-

dhshëm të vendit tonë proletari dhe militanti i shquar revolucionar, Heroi i Popullit Vasil Shanto, biri trim i Labërisë, Heroi i Popullit Perlat Rexhepi, Heronjtë e Popullit Branko Kadia, Manush Alimani, Shejnaze Juka, Fahri Ramadani e Tom Kola, Heronjtë e Vigut Ndoc Mazi, Naim Gjylbegu, Ahmet Haxhia, Ndoc Deda e Hidajet Lezha, si dhe dhjetëra dëshmorë, si: Jordan Misja, Rifat Nuzi, Ismet Dertliu, Ruzhdi Tuli, Esat Gramshi, Nexhip Luli, Istref Shabani e të tjerë, që dhanë jetën e tyre për lirinë e atdheut.

Brigada e 27-të Sulmuese, që u krijua në një truall luftëtarësh trima, ishte kurorëzim i punës së Partisë dhe i luftës së partizanëve të qarkut të Shkodrës. Batalioni «Perlat Rexhepi», që u bë baza e grupit partizan të atij qarku dhe e brigadës suaj, ishte kalitur në luftëra e vështirësi të mëdha, ku një faqe të lavdishme zë lufta e Reçit, jehona e së cilës u ndje jo vetëm në qarkun e Shkodrës e në gjithë Veriun, por në mbarë vendin tonë.

Megjithëse Shqipëria u çlirua, brigadës suaj të posaformuar Partia i ngarkoi detyra të rëndësishme për spastrimin nga bandat reaksionare të krahinave të Veriut. Së toku me ish-efektivat e brigadave të tjera, mbasi asgjësoi forcat reaksionare në rrethin e Pukës, Brigada e 27-të vazhdoi me sukses aksionet kundër tyre në Dibër e në Pogradec. Edhe pse pati një rrugë të shkurtër luftarake, partizanët e brigadës suaj, të edukuar nga Partia, kudo ku vepruan, në kushtet e një

reaksioni të organizuar e në zonat e prapambetura, bënë një punë të madhe jo vetëm për shpartallimin e reaksionit, por edhe për propagandimin e vijës së drejtë të Partisë.

Të dashur shokë e shoqe,

Si mbarë populli ynë ju po festoni krenarë këto ditë 40-vjetorin e Çlirimit të Atdheut. Fitoret tona të mëdha në çdo fushë të jetës gjatë këtyre katër dekadave i kanë themelet te Lufta heroike Nacionalçlirimtare, te mençuria, guximi dhe udhëheqja e drejtë e Partisë sonë. Prandaj Shqipërinë socialiste, që e ndërtuam me duart tona, e kemi të shtrenjtë dhe jemi të vendosur ta çojmë përpara në rrugën që na tregon Partia drejt ndërtimit të socializmit e të komunizmit dhe ta mbrojmë nga çdo armik.

Ju dërgoj në këtë festë të gëzuar urimet e mia më të ngrohta dhe dëshiroj të jeni mirë me shëndet, ju dhe familjet tuaja. Punë të mbarë dhe jetë të lumtur!

Ju përqafoj me dashuri

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 284 (11 341), 27 nëntor 1984

PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE TË BRIGADËS SË 4-T SULMUESE

24 nëntor 1984

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-partizanë, partizane dhe kuadro të Brigadës së 4-t Sulmuese,

Marr pjesë në gëzimin tuaj dhe ju uroj me gjithë zemër 41-vjetorin e formimit të brigadës, që sivjet e kremtoni në prag të jubileut të madh të Çlirimit, gjë që jua bën edhe më të bukur festën.

Krijimi i njësisë së katërt të madhe të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare në Voskopojën e çliruar, me tradita atdhedashurie, arsimore e kulturore dhe vatër e rëndësishme e Luftës legjendare Nacionalçlirimtare, ishte një gëzim i madh për Partinë, për ju dhe mbarë popullin e qarkut të Korçës. E përmendur në luftërat për liri, demokraci e përparim, e lidhur ngushtë me Partinë,

Korça e demonstratave të mëdha antifashiste, të udhëhequra nga komunistët dhe e guerilјeve të guximshme i rreshtoi bijat e bijtë e vet më të mirë në radhët e çetave, batalioneve e më vonë të brigadave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në këtë luftë të madhe kënga «Për mëmëdhenë» e patriotit të shquar Mihal Grameno mori një kuptim të ri dhe u pasua nga marshet e fuqishme partizane, ashtu siç u ngritën në një shkallë më të lartë traditat patriotike të korçarëve, kolonjarëve e pogradecarëve.

Në vargun e ngjarjeve të shënuara të Luftës Nacionalçlirimtare 28 dhjetori i vitit 1943, data e krijimit të brigadës suaj, zë një vend të veçantë. Atë ditë ju, partizanë e kuadro të batalioneve «Shqiponja», «Fuat Babani», «Hakmarrja», «Tomori», «Reshit Çollaku» e «Skënder Çaçi» nuk e festuat dot bashkimin e armëve, se lufta ziente e koha s'priste. Partia dhe dhjetëra shokët tuaj komunistë, të rreshtuar në radhët e brigadës, ju kishin bërë të ndërgjegjshëm për këtë, prandaj u hodhët menjëherë nga beteja në betejë. Përleshjet me armikun gjatë dhe pas Operacionit armik të Dimrit ishin të ashpra, por brigada e re doli fitimtare, sepse ju ju kishte edukuar Partia, ju mbështeste populli dhe kishit kaluar nëpër shkollën luftarake të punës në terren, të njësiteve guerile, të çetave e batalioneve partizane.

Detyra të rëndësishme e të vështira i ngarkoi Partia dhe Shtabi i Përgjithshëm Brigadës së 4-t Sulmuese. Efektivat e saj luftuan me he-

roizëm në gjithë betejat e zhvilluara në ish-qarkun e Korçës, pastaj në Mat, Dibër e Mirditë. Në epopenë e madhe për çlirimin e Tiranës, që përbën një nga faqet më të ndritura të historisë së lavdishme të Luftës sonë Nacionalçlirimtare, brigada juaj, e inkuadruar në Divizionin I Sulmues, ka luajtur një rol të rëndësishëm, duke mbajtur për dhjetëra ditë nën zjarrin e goditjeve të pandërprera pikat kyç të armikut dhe duke asgjësuar shumë nga forcat e gjalla të tij.

Shokë dhe shoqe,

Bashkë me ju në brigadë luftuan e punuan edhe komunistët e orëve të para, bijtë e shquar të Partisë e të popullit tonë, Rita Marko, Pilo Peristeri, Josif Pashko e Petro Papi. Me fjalët e Partisë në gojë dhe me besimin e patundur në fitore dhanë jetën Pano Xhamballo, Xhafer Cenko Lubonja, Raqi Qirinxhi, Pandi Çifligu, Ligor Ruço, Sotir Pojani, Jorgji Pashko, Rukie Roshi, Nasi Burnazi e qindra dëshmorë të tjerë të brigadës, veprën e të cilëve e vazhduat ju, e kurorëzoi lufta e popullit të udhëhequr nga Partia. Fitoret e punës ndërtimtare ndoqën ato të luftës çlirimtare dhe sot, nga lartësia 40-vjeçare, shikojmë me krenari të ligjshme veprën tonë, të popullit dhe të Partisë, Shqipërinë e lirë e të lumtur socialiste.

Ju përshëndes me këtë rast ju, familjet tuaja, voskopojarët mikpritës, trima e liridashës dhe gjithë popullin atdhedashës të rrethit të Korçës. Qofshi të lumtur, të gëzuar e gjithmonë në pararojë të punës ndërtimtare që udhëheq Partia!

Ju përqafoj me mall

Juaji

Enver Hoxha

Gazeta «Zëri i popullit», nr. 284 (11 341), 27 nëntor 1984

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT SOFOKLI LAZRI

12 dhjetor 1984

I dashur shoku Sofokli,

Me rastin e 60 vjetorit të lindjes, ditë e shënuar për ty dhe familjen tënde, të dërgoj urimet e mia më të mira.

Me armë në dorë e pa rezerva ti more pjesë që në moshë të re në luftën e lavdishme për çlirimin e atdheut e të popullit që udhëhoqi Partia jonë. Edhe pas Çlirimit si luftëtar e militant i Partisë qëndrove në radhët e para të luftës për ndërtimin e Shqipërisë së re, duke punuar në sektorët e rëndësishëm të propagandës e të politikës së jashtme të vendit tonë, ku ke dhënë e vazhdon të japësh ndihmesën tënde me besnikëri e devotshmëri.

Jam i bindur se edhe në të ardhmen do të

punosh po me ato forca e gjallëri si deri më sot për të mirën e popullit, të Partisë e të atdheut socialist.

Të uroj shëndet e gëzime në jetë ty dhe familjes!

Yti

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES KOLANECI

30 janar 1985

Shumë të dashur Florian, Tamara, Klemi e Lutfi,

Vdekja e nënës suaj të shtrenjtë, shoqes sonë të dashur Liri, më hidhëroi shumë. Në këto çaste të rënda e të dhimbshme për të gjithë ju, ju dërgoj ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Që në bankat e shkollës, gjatë gjithë Luftës Nacionalçlirimtare, ashtu edhe mbas Çlirimit, Liria luftoi e punoi me të gjitha forcat si komuniste e orëve të para e si bijë besnike e popullit, për zbatimin e vijës së Partisë në punët që iu ngarkuan. Si bashkëshorte e devotshme e burrit të saj, shokut tonë të paharruar, komunistit e luftëtarit të shquar Teki Kolaneci, Liria ju rriti dhe ju edukoi ju me ndjenjat e pastra e fisnike të atdheda-

shurisë dhe me frymën revolucionare të Partisë së Punës për çështjen e madhe të socializmit.

Edhe një herë ju ngushëlloj ju, vëllezërit e të afërmit e Lirisë.

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LËNDA

1. Letër drejtuar Fan S. Nolit 7
Prill 1946

2. Mesazh përshëndetjeje drejtuar shqiptarëve që jetojnë në SHBA 9
14 qershor 1946

3. Telegram dërguar popullit të Peshkopisë 12
31 gusht 1949

4. Telegram dërguar Komitetit të Partisë dhe Komitetit Ekzekutiv të Durrësit 14
4 shtator 1949

5. Telegram dërguar J. V. Stalinit 16
20 dhjetor 1949

6. Përshëndetje drejtuar popullit të Mokrës 18
10 tetor 1950

7. Përshëndetje drejtuar ndërtuesve të kombinatit të tekstileve «Stalin» 20
1 nëntor 1951

8. Përshëndetje drejtuar ndërtuesve të Ujësjellësit Lanabregas—Tiranë—kombinati i tekstileve «Stalin» 22
2 nëntor 1951

9. Letër drejtuar nxënësve dhe mësuesve të shkollës së mesme «Asim Zeneli», Gjirokastër 23
3 prill 1954

10. Letër drejtuar pionierëve të shkollës së fermës «Çlirimi», Fier 26
Tetor 1954

11. Letër drejtuar konviktorëve të Ballshit 28
Tetor 1954

12. Letër drejtuar kursantëve të Rafinerisë së Naftës të Cërrikut në Moskë 30
Tetor 1954

13. Telegram dërguar dy miqve të Shqipërisë, Zhysten Godarit dhe Admiral Mulekut, Paris 32
2 dhjetor 1955

14. Letër drejtuar organizatave të Partisë të studentëve e të kursantëve që studiojnë jashtë shtetit 34
13 mars 1956

15. Telegram dërguar kolektivit punonjës të uzinës «Enver», Tiranë 40
20 tetor 1956

16. Letër drejtuar pionierëve të shkollës 11-vjeçare «Skënderbeu», Krujë 41
21 tetor 1957

17. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo 43
16 nëntor 1957

18. Letër drejtuar anëtarëve të kooperativës bujqësore «Udha e Leninit», Ajazmë 45
16 dhjetor 1957

19. Telegram dërguar kryesisë së kooperativës bujqësore të Leskovikut 47
19 dhjetor 1957

20. Letër drejtuar punonjësve të shtypshkronjave «K. Marks» të Posnekut dhe «A. Nekse» të Lajpcigut 48
17 qershor 1958

21. Telegram dërguar komisionit për organizimin e festës së Batalionit të Dumresë 50
21 qershor 1958

22. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo 52
11 gusht 1958

23. Telegram dërguar Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës për kooperativistët e lokalitetit të Dajçit 55
29 shtator 1958

24. Telegram dërguar Vilhelm Pikut 57
20 tetor 1958

25. Letër drejtuar shoqes Andromaqi Harito 59
20 tetor 1958

26. Letër drejtuar shokut Rita Marko 60
22 tetor 1958

27. Letër drejtuar bashkatdhetarit Andon Zuni, Paris 62
25 tetor 1958

28. Letër drejtuar Evelina Reduth, RDGJ 64
7 maj 1959

29. Telegram dërguar komisionit të festës së çlirimit të Gjirokastrës 65
17 shtator 1959

30. Përshëndetje drejtuar redaksisë së gazetës «Pionieri» 67
16 dhjetor 1959

31. Telegram dërguar kolektivit punonjës të stacionit hekurudhor, Durrës 69
9 maj 1960

32. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo në Bukuresht 70
21 qershor 1960

33. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo në Bukuresht 71
23 qershor 1960

34. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo në Bukuresht 72
24 qershor 1960

35. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo në Bukuresht 74
24 qershor 1960

36. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Bukuresht 75
25 qershor 1960

37. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo në Bukuresht 76
25 qershor 1960

38. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo në Moskë 78
9 tetor 1960

39. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo në Moskë 80
11 tetor 1960

40. Letër drejtuar një qytetari çekosllovak 81
25 tetor 1960

41. Letër drejtuar shoqes Nexhmije Hoxha 82
13 nëntor 1960

42. Letër drejtuar shoqes Nexhmije Hoxha 85
16 nëntor 1960

43. Letër drejtuar shoqes Nexhmije Hoxha 87
20 nëntor 1960

44. Letër drejtuar pionierëve të shkollës 7-vjeçare «Kuvshinskaja» 92
26 dhjetor 1960

45. Mesazh përshëndetjeje drejtuar Uiliam Fosterit 94
28 shkurt 1961

46. Radiogram dërguar delegacionit shqiptar në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, Moskë 96
28 mars 1961

47. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia në Pekin 98
26 maj 1962

48. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia 102
1 qershor 1962

49. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia 103
1 qershor 1962

50. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia 105
13 qershor 1962

51. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia 109
13 qershor 1962

52. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia 111
16 qershor 1962

53. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia 114
19 qershor 1962

54. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia 117
20 qershor 1962

55. Letër drejtuar profesor doktor Maksimilian Lambercit 120
18 korrik 1962

56. Telegram dërguar kolektivit punonjës të Hidrocentralit të Bistricës 122
10 tetor 1963

57. Letër drejtuar Barinë Lëklerit, Belgjikë 124
29 shtator 1964

58. Përshëndetje drejtuar efektivit të Policisë Popullore 125
14 maj 1965

59. Letër drejtuar traktoristit Shyqyri Kanapari 130
25 qershor 1965

60. Letër drejtuar nxënësve të Institutit të fëmijëve të verbër e shurdhmemecë, Tiranë 132
18 janar 1967

61. Përshëndetje drejtuar nxënësve dhe mësuesve të politeknikumit «7 Nëntori» 134
23 janar 1967

62. Telegram dërguar vullnetarëve të brigadës «Adem Reka» 139
20 shkurt 1967

63. Telegram dërguar grave dhe vajzave të Shalës, Dukagjin 140
22 shkurt 1967

64. Telegram dërguar shokut Thoma Papapano, Gjirokastër 141
3 mars 1967

65. Letër drejtuar popullit të katundit Greshicë të Mallakastrës 142
9 mars 1967

66. Telegram dërguar komisionit të festës, Tepelenë 144
1 korrik 1967

67. Letër drejtuar djalit, Sokolit 147
13 korrik 1967

68. Telegram ngushëllimi dërguar shokut Haxhi Kroi, Tiranë 150
23 korrik 1967

69. Letër drejtuar kufitarëve të repartit ushtarak «N», Kukës 151
23 nëntor 1967

70. Letër drejtuar kooperativistëve të Rrashbullit 152
25 nëntor 1967

71. Letër drejtuar anëtarëve të kooperativës bujqësore «21 dëshmorët» të Cepos, Kardhiq 156
26 nëntor 1967

72. Letër drejtuar shokut Rustem Grori, Romanat—Durrës 160
22 janar 1968

73. Letër drejtuar shoqes Xhevrije Xhindolli, Durrës 163
22 qershor 1968

74. Telegram dërguar shokut Spiro Koleka, Gjirokastër 165
7 korrik 1968

75. Letër drejtuar shokut Gani Burnaci, Lushnjë 167
23 dhjetor 1968

76. Letër drejtuar prindërve të kufitarit Kristaq Mone, Tiranë 168
9 janar 1969

77. Letër drejtuar shokut Qani Muskaj, Patos 170
31 mars 1969

78. Letër drejtuar shokut Shaban Rexh Hajdarmataj, Zogaj—Tropojë 172
3 prill 1969

79. Letër drejtuar pensionistëve dhe invalidëve të qytetit të Cërrikut 174
21 prill 1969

80. Letër drejtuar djalit, Ilirit 176
24 qershor 1969

81. Letër drejtuar vajzës, Pranverës 178
6 korrik 1969

82. Letër drejtuar anëtarëve të kooperativës bujqësore Qinam—Radovickë të rrethit të Kolonjës 181
16 shtator 1969

83. Telegram dërguar familjes së dëshmorit Bajram Makriu, Gjirokastër 184
20 shtator 1969

84. Letër drejtuar shokut Sejd Cakrraj, Llugaj—Tropojë 186
20 tetor 1969

85. Letër drejtuar kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë dhe organizatës-bazë të Partisë 188
24 tetor 1969

86. Letër drejtuar pesëdhjetë grave e të rejave të Dropullit të Poshtëm, Gjirokastër 192
31 dhjetor 1969

87. Letër drejtuar njëzetepesë grave të katundit Domgjon në rrethin e Kukësit 196
10 janar 1970

88. Telegram dërguar Hajrie Kalbajt e Halil Gjonajt, Geghysen—Tropojë 198
26 janar 1970

89. Telegram ngushëllimi dërguar shoqes Lilo Andoni (Nushi) në Pekin 199
9 prill 1970

90. Letër drejtuar njëzeteshtatë familjeve vllehe, Delvinë 201
3 mars 1971

91. Letër drejtuar shokut Ismail Hoshafi 204
1 tetor 1971

92. Letër drejtuar nxënësve dhe mësuesve të shkollës pedagogjike «Luigj Gurakuqi», Elbasan 205
13 tetor 1971

93. Telegram dërguar shokut Taqo Qirici në Paris 208
13 shkurt 1972

94. Përshëndetje drejtuar Komitetit të Partisë të Rrethit të Pogradecit 209
20 prill 1972

95. Telegram dërguar Athina e Kolë Kitos, Sarandë 214
6 maj 1972

96. Letër drejtuar nxënëses Merita Sinani, Gjirokastër 218
22 maj 1972

97. Telegram dërguar organizatës-bazë të Partisë, Kuç—Vlorë 220
27 maj 1972

98. Telegram ngushëllimi dërguar Kato dhe Olimbi Durit, Tiranë 222
12 qershor 1972

99. Telegram ngushëllimi dërguar familjes Serani, Tiranë 223
18 tetor 1972

100. Telegram dërguar shokut Hekuran Isai, Peshkopi 226
7 maj 1973

101. Letër drejtuar shoqes Raze Syla, Shkodër 227
12 qershor 1973

102. Telegram dërguar Shtabit dhe gjithë ndërtuesve vullnetarë të Hekurudhës Elbasan—Përrenjas 228
12 janar 1974

103. Telegram ngushëllimi dërguar shokut Egon Gjadri, Tiranë 230
14 mars 1974

104. Telegram dërguar kolektivit ndërtues të Hidrocentralit të Fierzës 231
4 prill 1974

105. Telegram ngushëllimi dërguar Tote Meksit, Tiranë 232
8 gusht 1974

106. Telegram dërguar shoqes Fahrije Saliçaj, Tiranë 233
26 janar 1975

107. Letër drejtuar shokut Spiro Lera, Korçë 234
7 maj 1975

108. Letër drejtuar 170 punëtorëve të rrethit të Sarandës 236
27 qershor 1975

109. Letër drejtuar popullit të fshatit Kërrë, Gjirokastër 238
13 shtator 1975

110. Telegram dërguar shokut Foto Çami, Krujë 242
4 tetor 1975

111. Letër drejtuar 200 grave kooperativiste e punëtore të dalluara të bujqësisë të rrethit të Vlorës 243
12 nëntor 1975

112. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Paris 246
28 nëntor 1975

113. Telegram ngushëllimi dërguar prindërve të Ylli Zaimit, Alipostivan—Përmet 248
3 dhjetor 1975

114. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Muçi Pajenga, Tiranë 251
1 qershor 1976

115. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Ali Myftiu, Elbasan 252
25 qershor 1976

116. Letër drejtuar pjesëmarrëseve të takimit të shoqeve në vende drejtuese të rrethit të Beratit 253
12 shtator 1976

117. Letër drejtuar pionierëve Yllka Labi dhe Mimoza Hoxha, Gjirokastër 257
12 tetor 1976

118. Letër drejtuar delegatëve të Kongresit të 8-të të Bashkimeve Profesionale, Korçë 259
23 qershor 1977

119. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Zylyftar Veleshnja, Vlorë 261
27 gusht 1977

120. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Kolë Marash Pepës, Tamarë—Shkodër 262
24 tetor 1977

121. Letër drejtuar Jozefina Lambercit 263
25 janar 1978

122. Letër drejtuar shokut Zihni Sako, Tiranë 264
3 maj 1978

123. Letër drejtuar nxënëses Edmira Petova, Elbasan 267
23 maj 1978

124. Telegram dërguar Osman Kasem Panços, Buenos-Ajres, Argjentinë 269
13 qershor 1978

125. Telegram dërguar shokut Petraq Pepo, Tiranë 271
30 qershor 1978

126. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Bilbil Klosi, Tiranë 272
23 nëntor 1978

127. Telegram ngushëllimi dërguar shoqes Hajrie Curri, Tiranë 273
17 maj 1979

128. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Shyqyri Taip Hafizit, Shkodër 275
21 qershor 1979

129. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Rexhep Selimit, Pirg—Korçë 277
20 gusht 1979

130. Letër drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Brazilit 279
27 nëntor 1979

131. Telegram dërguar profesor Eqrem Çabejt, Romë 282
29 dhjetor 1979

132. Letër drejtuar Jani Karambishtis Mandra Attikis—Greqi 283
9 janar 1980

133. Letër drejtuar punonjësve të naftës dhe të gazit 285
11 mars 1980

134. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Ethem Gjinushi, Tiranë 289
17 mars 1980

135. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Fejzo Hoxhës, Tiranë 291
7 korrik 1980

136. Telegram ngushëllimi dërguar shoqes Qanije Xhindole, Berat 293
11 gusht 1980

137. Telegram dërguar shokut Petrit Radovicka, Tiranë 295
1 tetor 1980

138. Letër drejtuar shoqes Aishe Alimerko, Vlorë 296
15 tetor 1980

139. Letër drejtuar Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Portugeze (e Rindërtuar), Lisbonë 297
5 nëntor 1980

140. Letër drejtuar degës së shoqatës së miqësisë Francë—Shqipëri, Bordo 299
12 nëntor 1980

141. Telegram dërguar shoqes Kori Anastasi, Korçë 301
10 janar 1981

142. Letër drejtuar shoqes Atlije Balla, Elbasan 302
28 janar 1981

143. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Miti Bozo, Tiranë 304
21 mars 1981

144. Telegram dërguar Shaban Muratit, kryetar i Shoqërisë patriotike e i kolonisë së shqiptarëve të Australisë, Uestern—Australi 306
8 maj 1981

145. Telegram Persefoni e Thanas Karçinit — SHBA 308
8 maj 1981

146. Telegram dërguar shokut Rrapo Dervishi, Tiranë 309
3 tetor 1981

147. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Heroit të Popullit Misto Mame, Tiranë 310
5 tetor 1981

148. Telegram dërguar shokut Dritëro Agolli, Tiranë 311
13 tetor 1981

149. Telegram dërguar shokut Prokop Murra, Tiranë 312
24 nëntor 1981

150. Letër falënderimi drejtuar Xhek Shulmanit 314
2 dhjetor 1981

151. Letër drejtuar kolektivit të ndërmarrjes bujqësore «8 Nëntori», Maliq 315
4 shkurt 1982

152. Telegram dërguar shokut Llambi Gegprifti, Tiranë 317
14 shkurt 1982

153. Letër drejtuar anëtarëve të Kooperativës së Tipit të Lartë të Cakranit, Fier 318
24 mars 1982

154. Telegram dërguar shokut Hajredin Çeliku, Elbasan 322
4 maj 1982

155. Letër drejtuar kolektivit punonjës të Kombinatit Poligrafik 323
6 maj 1982

156. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Selim Shpuzës, Tiranë 326
13 maj 1982

157. Telegram dërguar shoqes Meri Kola, Kombinati i Trikotazheve, Korçë 327
26 maj 1982

158. Telegram dërguar shokut Xhoxhi Robo, Tiranë 328
14 qershor 1982

159. Falënderim për urimet e dërguara me rastin e Vitit të Ri 1983 329
5 janar 1983

160. Përshëndetje drejtuar redaksisë së gazetës «Bashkimi» 332
24 mars 1983

161. Letër drejtuar vajzave kooperativiste volejbolliste të kooperativës bujqësore të Krutjes, Lushnjë 336
11 prill 1983

162. Letër drejtuar familjes së Jakup Mahmutit, Francë 338
17 maj 1983

163. Letër drejtuar familjes së dëshmorit Ymer Mata, Zapod—Kukës 340
30 maj 1983

164. Telegram dërguar shokut Jashar Menzelxhiu, Tiranë 342
5 qershor 1983

165. Telegram dërguar shokut Xhafer Spahiu 343
5 qershor 1983

166. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Agush Gjergjevica, Korçë 344
20 qershor 1983

167. Letër drejtuar shokut Pasko Milo, Tiranë 346
22 qershor 1983

168. Telegram dërguar shokut Ajet Simixhiu, Tiranë 348
26 qershor 1983

169. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve të batalionit «Qamil Panariti», Vithkuq—Korçë 350
7 korrik 1983

170. Telegram dërguar shoqes Lenka Çuko 353
8 korrik 1983

171. Telegram ngushëllimi dërguar shoqes Kostandina Zhamo, Tiranë 354
10 korrik 1983

172. Telegram ngushëllimi dërguar shokut Ramiz Alia 356
19 korrik 1983

173. Letër drejtuar shokut Shefik Osmani, Tiranë 357
8 shtator 1983

174. Telegram dërguar shokut Dhimitër Tona, Tiranë 359
9 tetor 1983

175. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Mihal Dhimës, Korçë 360
30 tetor 1983

176. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Muho Asllani, Shkodër 362
12 dhjetor 1983

177. Telegram dërguar shokut Tahir Minxhozi, Tiranë 363
3 janar 1984

178. Telegram dërguar shokut Aranit Çela 364
16 janar 1984

179. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 7-të Sulmuese 366
16 mars 1984

180. Telegram dërguar shokut Pirro Kondi, Tiranë 370
10 prill 1984

181. Telegram dërguar shokut Petro Dode, Shkodër 371
16 prill 1984

182. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 8-të Sulmuese 372
25 prill 1984

183. Telegram dërguar Hulusi Kavos, Nju-Jork 376
25 prill 1984

184. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 12-të Sulmuese 378
19 maj 1984

185. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Muço Balilit, Vlorë 382
28 maj 1984

186. Telegram dërguar shokut Spiro Lengo, Tiranë 384
22 qershor 1984

187. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 15-të Sulmuese 386
28 qershor 1984

188. Letër drejtuar banorëve të fshatit Bodrishtë të Dropullit të Sipërm, Gjirokastër 389
30 qershor 1984

189. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Llazi Stratobërdha, Tiranë 392
19 korrik 1984

190. Telegram ngushëllimi dërguar Rëne Lekskyerit 394
3 gusht 1984

191. Telegram ngushëllimi dërguar shoqes Zulo Çani 395
8 gusht 1984

192. Telegram dërguar shokut Reiz Malile 396
12 gusht 1984

193. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 16-të Sulmuese 398
18 gusht 1984

194. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 18-të Sulmuese 401
25 gusht 1984

195. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 19-të Sulmuese 405
1 shtator 1984

196. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 20-të Sulmuese 409
8 shtator 1984

197. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 22-të Sulmuese 412
15 shtator 1984

198. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 14-t Sulmuese 416
15 shtator 1984

199. Telegram ngushëllimi dërguar shokut Emil Plumbi, Tiranë 420
18 shtator 1984

200. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 23-të Sulmuese 421
22 shtator 1984

201. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 17-të Sulmuese 424
29 shtator 1984

202. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 24-t Sulmuese 427
6 tetor 1984

203. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 3-të Sulmuese 431
6 tetor 1984

204. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 11-të Sulmuese 435
13 tetor 1984

205. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 9-të Sulmuese 439
27 tetor 1984

206. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 10-të Sulmuese 443
27 tetor 1984

207. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 25-të Sulmuese 446
3 nëntor 1984

208. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 2-të Sulmuese 450
3 nëntor 1984

209. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 27-të Sulmuese 453
24 nëntor 1984

210. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së 4-t Sulmuese 456
24 nëntor 1984

211. Telegram dërguar shokut Sofokli Lazri 460
12 dhjetor 1984

212. Telegram ngushëllimi dërguar familjes Kolaneci 462
30 janar 1985

Shtypur: Kombinati Poligrafik

Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1987